



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



DIREKTIVA E BE-së MBI PROKURIMIN PUBLIK DHE KONTRATAT KONCESIONARE

- ✓ *Direktiva 2014/24/BE
"Mbi Prokurimin publik"*
- ✓ *Direktiva 2014/23/BE
"Kontratat Koncesionare"*
- ✓ *Botime të SIGMA
mbi Prokurimet Publike*
- ✓ *Formaliteti kundrejt
principeve të 3 E-ve
në procedurat e prokurimit,
nga Dr. Igor Šoltes*
- ✓ *Ligji i Prokurimit Publik
në Shqipëri*
- ✓ *Auditimet e KLSH-së
lidhur me prokurimet publike
2012 - 2015*

Seria: Botime KLSH: 05/2016/56

Tiranë, 2016

DIREKTIVA E BE-së
MBI
PROKURIMIN PUBLIK
DHE
KONTRATAT KONCESIONARE

Titulli :

Direktiva e BE-së

mbi

Prokurimin Publik dhe Kontratat Koncesionare

Botimi u përgatit nga : Bujar Leskaj, Irena Islami

Redaktor: Miranda Haxhia

Art Design: Elisa Metaj

Përkthimi u realizua nga audituesit e KLSH-së :

Helena Solis, Irma Idrizaj, Ildir Dervishi, Jonild Hoxhaj,

Krisi Anastas, Redi Ahmetllari.

Seria : Botime KLSH - 05/2016/56

ISBN : 978-9928-159-45-8

Shtypur në Shtypshkronjën "ILAR"

Tiranë, 2016

	Faqe
PËRMBAJTJA	
Hyrje	5
I. Direktiva 2014/24/BE “Mbi Prokurimin publik”	11
II. Direktiva 2014 /23/BE “ Mbi dhënien e kontratave të koncesionit”	77
III. Botime të SIGMA mbi Prokurimet Publike	193
1. Udhëzuesi Nr. 1 <i>Prokurimi publik në BE: Struktura ligjore, Parimet bazë dhe Institucionet</i>	195
2. Udhëzuesi Nr. 10 <i>Cilat janë procedurat e prokurimeve publike dhe kur mund të përdoren ato?</i>	205
3. Udhëzuesi Nr. 28 <i>Auditimi i Prokurimeve Publike</i>	219
4. Udhëzuesi Nr. 29 <i>Zbulimi dhe korrigjimi i gabimeve të zakonshme në prokurimin publik</i>	237
5. Udhëzuesi Nr. 31 <i>Direktiva 2014/23 e BE-së: Kontratat Koncesionare</i>	257
IV. Formaliteti kundrejt principeve të 3 E-ve në procedurat e prokurimit, nga Dr. Igor Šoltes	277
V. Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Mbi Prokurimin publik” në Republikën e Shqipërisë”	285
VI. Auditimet e KLSH-së lidhur me prokurimet publike për periudhën 2012-2015	349

HYRJE

I nderuar lexues,

Direktiva 2014/24 /BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të BE-së, e datës 26 shkurt 2014 mbi “*Prokurimin Publik*” përfaqëson një nga drejtimet bazë të legjislacionit të Evropës së Bashkuar në miradministrimin e fondeve publike dhe të “*Acquis Communautaire*”, tërësisë së ligjeve dhe rregullave të Bashkimit Evropian. Shqipëria po e instalon gradualisht “*Acquis Communautaire*” nëpërmjet përafrimeve dhe përshtatjeve të ligjeve dhe rregullave edhe në legjislacionin shqiptar, si parakusht i domosdoshëm për integrimin e shpejtë të vendit tonë në familjen e madhe evropiane.

Në të njëjtën gazetë zyrtare të Bashkimi Evropian me direktivën 2014/24/BE u botua edhe direktiva e re 2014/23/BE mbi “*Kontratat Koncesionare*” si pjesë e një “*paketë legjislative*” për reformimin e rregullave të prokurimit publik në Bashkimin Evropian. Përpara daljes së kësaj direktive, mungesa e rregullave të qarta në nivelin e BE-së mbi kontratat koncesionare krijonte pengesa dhe pasiguri ligjore për ofrimin e lirë të shërbimeve, duke shkaktuar çrregullime në funksionimin e tregut të brendshëm. Për këtë arsye, Komisioni Evropian synoi të krijonte një kornizë ligjore të përshtatshme, fleksibël dhe të balancuar për dhënien e kontratave koncesionare, për t’u siguruar operatorëve ekonomikë, në veçanti bizneseve të vogla dhe të mesme, një akses efektiv dhe jodiskriminues në tregjet evropiane të koncesioneve.

Këto Direktiva shërbejnë si dokumente kryesore me të cilat punojnë audituesit e Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA), në realizimin e misionit dhe detyrës së tyre të kqyrjes së rregullsisë dhe mënyrës së shpenzimit të fondeve të Bashkimit Evropian. Këto direktiva janë të rëndësishme jo vetëm për Bashkimin Evropian dhe Shtetet Anëtare, por edhe për vendet candidate, sikurse është vendi ynë.

Për ne, në Shqipëri, njohja e plotë e Direktivës 2014/24 /BE mbi “Prokurimin Publik” dhe e direktivës 2014/23/BE mbi “Kontratat Koncesionare” realizohet nëpërmjet këtij botimi. Pavarësisht faktit se këto dy direktiva aplikohen vetëm në zonën ekonomike evropiane, botimi do të përbëjë referencë dhe do të jetë një ndihmë konkrete për të gjithë punonjësit tanë publikë, që përfshihen në një procedurë prokurimi publik, për audituesit e brendshëm dhe të jashtëm publikë të vendit, si dhe më gjerë për mbarë opinionin publik e qytetarin, i cili ka të drejtën si taksapagues të ndjekë ciklin e menaxhimit të financave publike, dhe sidomos pjesën më të rëndësishme të këtyre fondeve që jepen nëpërmjet prokurimeve publike. Vetëm nëse audituesit zotërojnë legjislacionin tërësor aktual në fushën e prokurimeve, rekomandimet dhe veprimet korrigjuese të rekomanduara prej tyre do të jenë koherente dhe efektive.

Shqipëria është vend kandidat për në BE dhe përkthimi i këtyre direktivave dhe i materialeve shtesë që lidhen me procedurën e prokurimit publik do të ndihmojë të gjithë punonjësit e administratës publike dhe audituesit e KLSH-së që të përgatiten dhe të përshtaten me ligjet dhe rregullat e BE-së, duke i paraprirë integritet të vendit.

Zoti Igor Šoltes, deputet i Parlamentit Europian dhe ish-President i Gjykatës Sllovene të Auditimit, i cili është një njohës shumë i mirë i fushës së Prokurimeve Publike, në një nga punimet e tij është shprehur për rëndësinë e legjislacionit të fushës, *“...Për shkak të diversitetit të madh të situatave përgjatë jetës së përditshme, legjislacioni nuk mund të përfshijë norma për çdo çështje ligjore, kështu që njohja e parimeve bazë të prokurimit publik është me shumë rëndësi.*

Është e nevojshme të kuptohen rregullat ligjore nëpërmjet disa parimeve të cilat udhëheqin vendim-marrjen e Autoritetit Kontraktor si dhe Operatorin Ekonomik në njohjen e të drejtave të tij në një procedurë prokurimi. Në fushën e prokurimeve publike, përveç parimeve specifike, duhen marrë në konsideratë edhe parime të tjera, të cilat në ditët e sotme shërbejnë tashmë si një kriter bazë në shoqërinë tonë dhe mbulojnë gjithë sistemin ligjor....”

Vlen të theksohet se legjislacioni i prokurimit publik, si në vendet e BE-së dhe tek ne, është gjithnjë në evolucion për shkak të ndryshimeve legjislative dhe reformave të shumta. BE i përditëson gjithmonë direktivat e veta dhe Direktiva 2014/24 /BE

përfaqëson një përditësim dhe domosdoshmëri të rregullave komunitare në prokurimin publik.

Parë në këtë këndvështrim, dhënia e kontratave publike nga ose në emër të autoriteteve të Shteteve Anëtare të BE, duhet të jetë në përputhje me parimet e Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFEU), dhe në veçanti të lëvizjes së lirë të mallrave, lirisë së veprimtarive dhe lirisë për të ofruar shërbime, si dhe parimeve që rrjedhin prej saj, të tilla si trajtimi i barabartë, mos-diskriminimi, njohja reciproke, proporcionaliteti dhe transparenca.

Në Deklaratën Globale Kundër Korrupsionit të Samitit Anti-Korrupsion të Londrës më 12 maj 2016, i cili formoi një koalicion ndërkombëtar unikal qeverish, agjencish ligj-zbatuese, organizatash ndërkombëtare, shoqatash të shoqërisë civile dhe kompanish private të angazhuara, në pikën e parë të saj theksohet se : “ *Korrupsioni duhet të zbulohet dhe denoncohet – të sigurohemi që nuk ka vend ku të fshihet...- Duke rritur transparencën e buxheteve qeveritare, informacionit tatimor dhe prokurimit publik, për të penguar evazionin fiskal dhe për të vënë në dukje vjedhjen ose keqpërdorimin e parave të taksapaguesve*”.

Duke marrë parasysh angazhimet e sotme shumë serioze të shteteve të ndryshme anëtare të Bashkimit Evropian në këtë koalicion, Direktiva 2014/24/BE përfaqëson jo vetëm përditësimin e rregullave komunitare në prokurimin publik, por së bashku me direktivën e re 2014/23/BE janë edhe një kontribut i drejtpërdrejtë në transparencën dhe luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit financiar.

Prokurimi publik luan gjithashtu një rol kyç në strategjinë “Europa 2020”, të përcaktuar në Komunikatën e Komisionit të 3 Marsit 2010 me titull “Europa 2020, një strategji për rritjen e zgjuar, të qëndrueshme dhe përfshirëse”, si një nga instrumentet e bazuar te tregu që siguron përdorimin me efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Për këtë qëllim, rregullat e prokurimit publik, miratuar në përputhje me Direktivën 2014/24 /BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, janë në përditësim dhe rishikim të vazhdueshëm, me qëllim rritjen e efektivitetit të shpenzimeve publike, duke lehtësuar në veçanti pjesëmarrjen e shoqërive të vogla dhe të mesme tregtare (SME-ve) në prokurimin publik, dhe për t’i mundësuar autoriteteve kontraktore përdorimin sa më të mirë të prokurimit publik në mbështetje të qëllimeve të

përbashkëta të zhvillimit të qëndrueshëm. Gjithashtu, lind nevoja për të qartësuar nocionet bazë dhe konceptet, për të garantuar siguri ligjore dhe për të përfshirë aspekte që janë të lidhura me raste të caktuara ligjore (casus), zgjidhur nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian.

Për të pasur një panoramë më të qartë të kësaj direktive, në këtë botim janë shtuar edhe disa botime të SIGMA (Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit)¹ lidhur me procedurat e prokurimeve publike, si cilat janë llojet e procedurave të prokurimeve publike dhe kur mund të përdoren ato; auditimi i prokurimeve (objektivat dhe kriteret e auditimit, fazat kryesore të prokurimit dhe çështjet e tyre kryesore, etj) si edhe zbulimi dhe korigjimi i gabimeve të zakonshme në prokurimin publik.

Për përdoruesit dhe lexuesit e këtij botimi, është vendosur edhe Ligji shqiptar i Prokurimit Publik, me qëllim që tabloja në fushën e prokurimeve publike të jetë e kompletuar.

Në këtë botim është përfshirë edhe një artikull i z. Igor Šoltes, deputet i Parlamentit Europian dhe ish-Kryetar i Gjykatës Sllovene të Auditimit, i cili ka një eksperiencë shumë vjeçare në fushën e prokurimeve publike.

Audituesit e KLSH-së dhe të gjithë të interesuarit e fushës së prokurimeve publike do të kenë mundësi të konsultojnë në këtë botim edhe rezultatet e auditimeve të KLSH-së në fushën e prokurimeve publike për periudhën 2012-2015, si gjetjet e konstatuara ashtu edhe vlerësimin e performancës së prokurimeve publike gjatë kësaj periudhe.

Direktivat e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të BE-së për prokurimet publike dhe kontratat koncesionare janë një ndihmesë reale për të gjithë zyrtarët shtetërorë në Shqipëri, por sidomos për audituesit e brendshëm dhe të jashtëm të Shtetit, për të frenuar korrupsionin dhe gjurmuar mashtrimin financiar, dukuri këto që gjejnë terren dendur në këtë fushë të veprimtarisë shtetërore që praktikisht përdor pjesën më të madhe të parasë publike.

¹ *Iniciativë e përbashkët e Bashkimit Europian dhe Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim(OECD), financuar kryesisht nga BE*

Banka Botërore po bashkëpunon me Agjencinë e Prokurimit Publik për projektin “Përmirësimi i kontrollit të përputhshmërisë dhe nxitja e transparencës në Prokurimet Publike në Shqipëri”, në të cilin është përfshirë edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit si përfitues dytësor i këtij projekti. Ky projekt do të ndikojë dhe do të jetë mbështetje për KLSH-në në zhvillimin e ekspertizës profesionale në auditimin e prokurimeve me qëllim rritjen e cilësisë së auditimit.

Ky botim i ri në kolanën e botimeve të KLSH-së synon pikërisht sjelljen e akteve të plota ligjore për prokurimin publik të Shteteve Anëtare të BE-së, duke krijuar një vizion të qartë të funksionimit të rregullave të sotme dhe duke dhënë perspektivën e përafrimit të plotë të legjislacionit shqiptar drejt përmbajtjes së Direktivave të Parlamentit dhe të Komisionit Evropian.

Dëshira dhe vullneti i Institucionit Suprem të auditimit të Shqipërisë (KLSH) për të zbatuar kuadrin ligjor të BE-së dhe Direktivat e *Acquis Communautaire* në auditimin e prokurimeve publike në vend, krahas marrjes së eksperiencës më të mirë sipas motos së INTOSAI-t “*Experientia mutua Omnibus Prodest*”(Nga Eksperiencia e përbashkët fitojnë të gjithë), reflekton njëkohësisht edhe aspiratat e palëkundura të të gjithë shqiptarëve për integrim në familjen e madhe të Bashkimit Evropian.

Bujar LESKAJ



I. Direktiva 2014/24 /BE e Parlamentit
Evropian dhe e Këshillit të BE-së, e datës 26
shkurt 2014 mbi *Prokurimin Publik*

DIREKTIVA 2014/24/EU E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT

26 Shkurt 2014

Mbi prokurimin publik dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/EC

(Tekst me fuqi në Zonën Ekonomike Evropiane)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, dhe në veçanti nenin 53 (1), nenin 62 dhe nenin 114,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit Evropian,

Pas transmetimit të draft aktit legjislativ tek parlamentet kombëtare,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit të Rajoneve,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative,

Ndërsa:

- (1) Dhënia e kontratave publike nga ose në emër të autoriteteve të Shteteve Anëtare duhet të jetë në përputhje me parimet e Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian (TFEU), dhe në veçanti të lëvizjes së lirë të mallrave, lirisë së veprimtarive dhe lirisë për të ofruar shërbime, si dhe parimet që rrjedhin prej saj, të tilla si trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi, njohja reciproke, proporcionaliteti dhe transparenca. Megjithatë, për kontratat e punëve

publike mbi një vlerë të caktuar, dispozitat duhet të hartohen në koordinim me procedurat kombëtare të prokurimit për t'u siguruar kështu se këto parime kanë efekt praktik dhe prokurimi publik është i hapur për konkurim.

- (2) Prokurimi publik luan një rol kyç në strategjinë Evropa 2020, të përcaktuar në Komunikatën e Komisionit të 3 Marsit 2010 me titull “Evropa 2020, një strategji për rritjen e zgjuar, të qëndrueshme dhe përfshirëse”, si një nga instrumentet e bazuar te tregu që do të përdoret për të arritur rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar përdorimin më efikas të fondeve publike. Për këtë qëllim, rregullat e prokurimit publik, miratuar në përputhje me Direktivën 2004/17/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe Direktivës 2004/18/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, duhet të rishikohen dhe modernizohen me qëllim rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike, duke lehtësuar në veçanti pjesëmarrjen e shoqërive të vogla dhe të mesme (NVM) në prokurimin publik, dhe për ti mundësuar autoriteve kontraktore përdorimin sa më të mirë të prokurimit publik në mbështetje të qëllimeve të përbashkëta shoqërore. Gjithashtu lind nevoja për të qartësuar nocionet bazë dhe konceptet, për të garantuar siguri ligjore dhe për të përfshirë aspekte që janë të lidhura me raste të caktuara ligjore (casus), zgjidhur (si çështje) nga Gjykata e Drejtësisë të Bashkimit Evropian.
- (3) Për zbatimin e kësaj Direktive duhet të merret parasysh Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, në veçanti në lidhje me zgjedhjen e mjeteve të komunikimit, specififikimet teknike, kriteret e kualifikimit dhe kushtet e zbatimit të kontratës.’
- (4) Format gjithnjë e më të ndryshme të veprimit public (pra nevojës për blerje, shërbime dhe punë publike nga administrate publike) kanë bërë të nevojshëm përcaktimin e qartë të nocionit të prokurimit; megjithatë ky përkufizim nuk duhet të zgjerohet fushën e kësaj Direktive në krahasim me atë të Direktivës 2004/18/EC. Rregullat e BE-së për prokurimin publik nuk janë të destinuara për të mbuluar të gjitha format e disbursimit të fondeve publike, por vetëm ato që synojnë në kryerjen e punëve publike, furnizimeve apo shërbimeve me anë të një kontrate publike. Duhet të qartësohet se kryerja e punëve tilla publike, furnizimeve apo shërbimeve duhet të jenë subjekt i kësaj Direktive, pavarësisht nëse ato janë zbatuar përmes blerjes, dhënies me qira ose formave të tjera kontraktuese. Nocioni i blerjes duhet të kuptohet

gjerësisht në marrjen e përfitimeve të punëve, furnizimeve ose shërbimeve në fjalë, pa kërkuar domosdoshmërisht transferimin e pronësisë tek autoritetet kontraktuese. Për më tepër, financimi i thjeshtë, në veçanti përmes granteve, i një veprimtarie, e cila është e lidhur shpesh me detyrimin për të rimbursuar shumat e marra kur ato nuk janë përdorur për qëllimet e synuara, zakonisht nuk ndodhet brenda fushës së rregullave të prokurimit publik. Në mënyrë të ngjashme, situata ku të gjithë operatorët ekonomikë që plotësojnë kushte të caktuara kanë të drejtë për të kryer një detyrë të caktuar, pa ndonjë përzgjedhje, të tilla si zgjedhja e konsumatorit dhe sistemi i kuponit të shërbimit, nuk duhet të kuptohet si prokurim, por si skemë e thjeshtë autorizimi (për shembull licencat për ilaçe ose shërbimet mjekësore).

- (5) Duhet të kujtojmë se në këtë Direktivë asgjë nuk detyron shtetet anëtare që të kontraktojnë jashtë, ofrimin e shërbimeve që ata dëshirojnë ti ofrojnë vetë apo për ti organizuar në mënyra të tjera nga kontratat publike në kuptimin e kësaj Direktive. Ofrimi i shërbimeve në bazë të ligjeve, rregulloreve ose kontratave të punës nuk duhet të mbulohet. Në disa shtete anëtare, ky mund të jetë për shembull rasti i shërbimeve të caktuara administrative dhe qeveritare të tilla si shërbimet legjislativë dhe ekzekutive ose ofrimi i shërbimeve të caktuara për komunitetin, për shembull, shërbimet e punëve të jashtme, shërbimet e drejtësisë ose shërbimet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore.
- (6) Gjithashtu është e përshtatshme të kujtojmë atë se kjo Direktivë nuk duhet të ndikojë në legjislacionin e sigurimeve shoqërore të shteteve anëtare dhe as nuk duhet të merret me liberalizimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, të rezervuar për subjektet publike ose private, ose me privatizimin e subjekteve publike që ofrojnë shërbime. Për më tepër, duhet të kujtojmë se Shtetet Anëtare të BE janë të lira të organizojnë ofrimin e shërbimeve të detyrueshme shoqërore ose të shërbimeve të tjera të tilla si ato postare, shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik, shërbime jo-ekonomike me interes të përgjithshëm, ose si një përzierje e tyre. Është e nevojshme të sqarohet se shërbimet jo-ekonomike me interes të përgjithshëm nuk duhet të ndodhen brenda fushës së veprimit të kësaj Direktive.

- (7) Si përfundim, duhet të kujtojmë atë se kjo Direktivë nuk cenon lirinë e autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale për të përcaktuar, në përputhje me ligjin e BE, shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik, qëllimin e tyre dhe karakteristikat e shërbimit që do të ofrohet, duke përfshirë çdo kusht në lidhje me cilësinë e tyre, në mënyrë që të ndjekin objektivat e politikave publike. Kjo Direktivë nuk duhet të cenojë pushtetin e autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale për të siguruar, shërbime financiare me interes të përgjithshëm ekonomik, në përputhje me nenin 14 të TFEU dhe Protokollin Nr. 26 mbi Shërbimet me Interes të Përgjithshëm, bashkëngjitur si aneks në TFEU dhe në Traktatin mbi Bashkimin Evropian (TEU). Për më tepër, kjo Direktivë nuk merret me financimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, ose me sistemet e ndihmës së dhënë nga Shtetet Anëtare në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian mbi konkurrencën, në veçanti në fushën sociale.
- (8) Një kontratë duhet të konsiderohet si kontratë për punë publike vetëm nëse objekti i saj mbulon në mënyrë të veçantë kryerjen e aktiviteteve të listuara në shtojcën II, edhe nëse kontrata përfshin shërbime të tjera të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të tilla. Kontratat publike të shërbimeve, në veçanti në sferën e shërbimeve të menaxhimit të pronës, mundet që në rrethana të caktuara të përfshijnë punime në objektin e kontratës. Megjithatë, për aq kohë sa punë të tilla janë episodike në lidhje me objektin e kontratës, dhe janë një pasojë e mundshme e saj ose një plotësuese për të, fakti që punë të tilla janë të përfshira në kontratë, nuk justifikon cilësimin e kontratës publike të shërbimeve si një kontratë të punëve publike. Megjithatë, duke pasur parasysh larminë e kontratave të punëve publike, autoritetet kontraktuese duhet të jenë në gjendje të bëjnë dispozita për kontratat në lidhje me projektimin dhe ekzekutimin e punës në mënyrë që të jepen veçmas ose së bashku. Kjo Direktivë nuk ka për qëllim të përcaktojë çmime të përbashkëta ose të veçanta të kontratës.
- (9) Realizimi i një pune (në kontratat e punëve publike), që përputhet me kërkesat e specifikuara nga autoriteti kontraktues, kërkon që autoriteti në fjalë të marrë masa për të përcaktuar llojin e punës ose, të paktën, të ketë një ndikim vendimtar në hartimin e saj. Pavarësisht nëse kontraktuesi realizon të gjithë ose një pjesë të punës me mjetet e veta apo siguron realizimin e saj me mjete të tjera, kjo nuk duhet të ndryshojë cilësimin e

kontratës si një kontratë e punëve publike, për sa kohë që kontraktori merr përsipër një detyrim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që është ligjërisht i zbatueshëm për të garantuar se puna do të realizohet.

- (10) Nocioni “autoritet kontraktor” dhe në veçanti ai i “organeve të së drejtës publike” është ekzaminuar në mënyrë të përsëritur në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Për të qartësuar se qëllimi i kësaj Direktive “ratione personae” duhet të mbetet i pandryshuar, është e përshtatshme të ruhen përkufizimet në të cilat Gjykata është bazuar dhe të përfshihet një numër i caktuar i sqarimeve të dhëna nga jurisprudenca si një çelës për të kuptuar vetë përcaktimet, pa qëllim për të ndryshuar të kuptuarin e koncepteve të përpunuara nga praktika gjyqësore. Në këtë kontekst, duhet të sqarohet se një operator ekonomik, i cili operon në kushtet normale të tregut, ka për qëllim fitimin, dhe përballon humbjet që rezultojnë nga ushtrimi i veprimtarisë së tij, nuk duhet të konsiderohet si një “organ i së drejtës publike”, duke qenë se në interes të përgjithshëm nga nevojat që i janë dhënë detyrë për t’i përmbushur, mund të konsiderohet se ka një karakter prodhues ose komercial. Në mënyrë të ngjashme, gjendja në lidhje me origjinën e fondeve të organit në fjalë, është shqyrtuar gjithashtu në praktikën gjyqësore, e cila ka sqaruar ndër të tjera se financimi i "pjesës më të madhe " do të thotë më shumë se gjysma, dhe se një financim i tillë mund të përfshijnë pagesat e përdoruesve, të cilat janë vendosur, llogaritur dhe mbledhur në përputhje me rregullat e së drejtës publike.
- (11) Në rastin e kontratave të përbëra, rregullat e zbatueshme duhet të përcaktohen në respekt të objektit kryesor të kontratës, kur pjesët e ndryshme të cilat e përbëjnë atë, nuk janë objektivist të ndashme. Për këtë arsye duhet të sqarohet se si autoritetet kontraktuese përcaktojnë nëse pjesë të ndryshme janë të ndashme ose jo. Një sqarim i tillë duhet të bazohet në jurisprudencën përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Përcaktimi duhet të kryhet rast pas rasti, ku qëllimet e shprehura apo të supozuara të autoritetit kontraktor për të konsideruar aspektet e ndryshme që e bëjnë kontratën të përbërë të pandashme, nuk duhet të jenë të mjaftueshme, por duhet të mbështeten me dëshmi objektive të afta për ti justifikuar ato dhe për të krijuar nevojën e përfundimit të një kontrate të vetme. Një nevojë e tillë për të lidhur një kontratë të vetme, mund të jetë e pranishme për shembull në rastin e ndërtimit të një ndërtese të vetme, një

pjesë e së cilës do të përdoret drejtpërdrejt nga autoriteti kontraktues dhe pjesa tjetër që do të operohet në bazë të koncesioneve, për shembull për të siguruar mjediset e parkimit për publikun. Duhet sqaruar se nevoja për të përfunduar një kontratë mund të vijë si pasojë e dy arsyeve me natyrë teknike dhe një me natyrë ekonomike.

- (12) Në rastin e kontratave të përbëra, të cilat mund të jenë të ndashme, autoritetet kontraktuese janë gjithmonë të lira të zgjedhin për të lidhur kontrata të veçanta për pjesë të veçanta të kontratës së përbërë dhe në këtë rast dispozitat e zbatueshme për secilën pjesë të veçantë duhet të përcaktohen ekskluzivisht në lidhje me karakteristikat specifike të kontratës. Nga ana tjetër, kur autoritetet kontraktuese zgjedhin të përfshijnë elemente të tjera në prokurim, cilësdo vlerë apo regjimi juridik t'i përkisnin këto elemente, parimi kryesor duhet të jetë se, kur një kontratë duhet të jepet në përputhje me dispozitat e kësaj Direktive, në qoftë se ajo akordohet më vete, atëherë kjo Direktivë vazhdon të zbatohet për të gjithë kontratën e përzier.
- (13) Megjithatë, dispozita të veçanta duhet të përcaktohen për kontratat e përbëra që përfshijnë aspekte të mbrojtjes ose të sigurisë ose pjesë që nuk përfshihen në objektin e TFEU. Në raste të tilla, mos-aplikimi i kësaj Direktive duhet të jetë i mundur me kusht që dhënia e një kontrate të vetme të jetë e justifikuar për arsye objektive dhe se vendimi për të dhënë një kontratë të tillë të mos jetë marrë me qëllim për të përjashtuar kontratat nga zbatimi i kësaj Direktive ose Direktivës 2009/81/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Duhet sqaruar se autoritetet kontraktuese nuk mund të përjashtohen nga mundësia për të aplikuar këtë Direktivë për kontrata të përbëra specifike, në vend që të aplikojnë Direktivën 2009/81/EC.
- (14) Për më tepër, nocioni "operatorët ekonomikë" duhet të interpretohet në mënyrë të gjerë, duke përfshirë personat dhe / ose subjektet, të cilët ofrojnë kryerjen e punimeve, furnizimin e produkteve ose ofrimin e shërbimeve në treg, pavarësisht nga forma juridike në të cilën ata kanë zgjedhur të operojnë. Kështu, shoqëritë tregtare, degët, bashkimet e shoqërive tregtare, shoqëritë kooperative, kompanitë e kufizuara, universitetet, publike ose private, dhe format tjera të subjekteve, të ndryshëm nga personat fizikë duhet të përfshihen në nocionin e operatorit ekonomik, pavarësisht nëse janë apo jo "persona juridikë" në të gjitha rrethanat.

- (15) Duhet sqaruar se grupet e operatorëve ekonomikë, përfshirë edhe ata që janë bashkuar në formën e një shoqërie të përkohshme, mund të marrin pjesë në procedura, pa qenë e nevojshme të marrin një formë të veçantë ligjore. Për aq kohë sa është e nevojshme, për shembull kur përgjegjësia e përbashkët është e pashmangshme, atëherë mund të përdoret një formë specifike në rastet kur grupeve të tilla iu akordohet kontrata. Gjithashtu duhet të qartësohet se autoritetet kontraktuese duhet të jenë në gjendje për të përcaktuar në mënyrë të qartë se si grupet e operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat në lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare, sipas përcaktimeve të kësaj Direktive, ose kriteret që kanë të bëjnë me aftësinë teknike dhe profesionale, të cilat janë të detyrueshme për operatorët ekonomikë që marrin pjesë më vete.

Performanca e kontratave në rastin e bashkimeve të operatorëve ekonomikë mund të kërkojë vendosjen e kushteve të cilat nuk iu imponohen në rastin kur ato paraqiten si operator i vetëm (individual). Këto kushte, të cilat duhet të justifikohen me arsye objektive dhe të jenë proporcionale, mund të përfshijnë për shembull emërimin e një përfaqësuesi të përbashkët apo një partneri udhëheqës për qëllim të procedurës së prokurimit ose kërkimit të informacionit mbi statusin e tyre.

- (16) Autoritetet kontraktuese duhet të përdorin të gjitha mjetet e mundshme të vëna në dispozicion të tyre nga ligji kombëtar, në mënyrë që të parandalohen shtrembërimet në procedurat e prokurimit publik, të cilat rrjedhin nga konfliktet e interesit. Kjo mund të përfshijë procedura për të identifikuar, parandaluar dhe korrigjuar konfliktet e interesit.
- (17) Vendimi i Këshillit 94/800/EC miratoi Marrëveshjen e Organizatës Botërore të Tregtisë për Prokurimin Publik (GPA). Qëllimi i GPA është të krijojë një kuadër shumëpalësh të të drejtave dhe detyrimeve të balancuara që lidhen me kontratat publike, me synimin për të arritur liberalizimin dhe zgjerimin e tregtisë botërore. Për kontratat e mbuluara nga Anekset 1, 2, 4 dhe 5 dhe Shënimet e Përgjithshme të Shtojcës I të Bashkimit Evropian në GPA, si dhe nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare të nënshkruara nga BE, autoritetet kontraktuese duhet të përmbushin detyrimet e tyre duke aplikuar këtë Direktivë mbi operatorët ekonomikë të vendeve të treta që janë nënshkruese të këtyre marrëveshjeve.

- (18) GPA-ja zbatohet për kontratat e mësipërme mbi disa pragje të caktuara, të përcaktuara në vetë GPA dhe të quajtura “të drejtat speciale”. Pragjet e përcaktuara nga kjo Direktivë duhet të jenë në një linjë për të siguruar që korrespondojnë me ekuivalentet e pragjeve të përcaktuara në GPA. Duhet të vendosen rregulla për shqyrtimet periodike të pragjeve të shprehura në euro në mënyrë që ato të rregullohen me anë të një operacioni thjesht matematikor, për variacionet e mundshme të vlerës së euros në raport me ato “të drejta speciale”. Përveç këtyre rregullimeve periodike matematikore, duhet shqyrtuar edhe mundësia e rritjes së pragjeve të vendosura në GPA, gjatë raundit të ardhshëm të bisedimeve.
- (19) Duhet të sqarohet se, për vlerësimin e vlerës së një kontrate, të gjitha të ardhurat duhet të merren parasysh, pavarësisht nëse janë marrë nga autoriteti kontraktues apo nga palët e treta. Duhet gjithashtu të qartësohet se, me qëllim vlerësimin e kufijve, nocioni ‘furnizime të ngjashme’ duhet të kuptohet si produkte të cilat janë të destinuara për përdorime identike ose të ngjashme, të tilla si furnizimet e një game ushqimesh ose sende të ndryshme për të mobiluar zyrën. Zakonisht, një operator ekonomik, i cili është aktiv në fushën në fjalë, ka gjasa të kryejë furnizime të tilla, si pjesë e gamës së produktit të tij.
- (20) Për vlerësimin e ofertës në një prokurim të caktuar, duhet të sqarohet nëse lejohet vlerësimi në bazë të vlerës të përafërt në një nënndarje të prokurimit, vetëm kur kjo justifikohet me arsye objektive. Për shembull, mund të justifikohet vlerësimi i përafërt i kontratës në nivelin e një njësie të veçantë operacionale të autoritetit kontraktues, të tilla si shkollat apo kopshtet, me kusht që njësia në fjalë të jetë në mënyrë të pavarur përgjegjëse për prokurimin e saj. Kjo mund të supozohet kur njësia e veçantë operacionale drejton në mënyrë të pavarur procedurat e prokurimit dhe merr vendime për blerjen, kur ka një linjë të veçantë buxhetore në dispozicion të saj për prokurimet në fjalë dhe kur përfundon kontratën në mënyrë të pavarur dhe e financon atë nga një buxhet që ka në dispozicion të saj. Një nënndarje nuk justifikohet kur autoriteti kontraktues thjesht organizon një procedurë prokurimi në mënyrë të decentralizuar.
- (21) Kontratat publike të akorduara nga autoritetet kontraktuese që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që

përfshihen brënda sferës së këtyre aktiviteteve, janë të mbuluara nga Direktiva 2014/25/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Megjithatë, kontratat e dhëna nga autoritetet kontraktuese në kuadrin e operacioneve të transportit detar, bregdetar apo lumor përfshihen brenda fushës së veprimit të kësaj Direktive.

- (22) Duke iu drejtuar shteteve anëtare, kjo Direktivë nuk zbatohet për prokurimet e kryera nga organizata ndërkombëtare në emër të tyre dhe për llogari të tyre. Megjithatë, ka nevojë të sqarohet se në çfarë mase kjo Direktivë duhet të zbatohet për prokurimet e udhëhequra nga rregulla të veçanta ndërkombëtare.
- (23) Dhënia e kontratave publike për disa shërbime të medias audio-vizive dhe radios nga ofruesit, duhet të lejojë aspekte të rëndësishme kulturore apo shoqërore që do të merren në konsideratë, gjë që e bën zbatimin e rregullave të prokurimit të papërshtatshëm. Për këto arsye, duhet të bëhet një përjashtim për kontratat e shërbimeve publike, dhënë nga vetë ofruesit e shërbimeve të medias, për blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e programeve 'standard' dhe shërbimeve të tjera përgatitore, siç janë ato që kanë të bëjnë me skriptet apo performancat artistike të nevojshme për prodhimin e programit. Gjithashtu, përjashtimi duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë midis transmetuesve dhe atyre që ofrojnë shërbime sipas kërkesës (shërbime jo-lineare). Megjithatë, ky përjashtim nuk duhet të zbatohet për furnizimin me pajisje teknike të nevojshme për prodhimin, bashkëprodhimin dhe transmetimin e programeve të tilla.
- (24) Duhet të kujtojmë se arbitrazhi, pajtimi dhe forma të tjera të ngjashme të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, përdoren zakonisht nga organet apo individët të cilët kanë rënë dakord paraprakisht për një mënyrë të tillë zgjidhjeje, e cila nuk mund të rregullohet nga rregullat e prokurimit. Duhet sqaruar se kjo Direktivë nuk zbatohet për kontratat e shërbimit për ofrimin e shërbimeve të tilla, cilido qoftë emërtimi i tyre sipas ligjit kombëtar.
- (25) Një numër i caktuar i shërbimeve juridike të bëra nga ofruesit e shërbimeve, të caktuara nga gjykata ose gjyqësori i një Shteti Anëtar, përfshijnë përfaqësimin e klientëve në procedurat gjyqësore nga ana e avokatëve,

sigurimin nga noterët ose ushtrimin e autoritetit zyrtar. Shërbime të tilla ligjore janë dhënë zakonisht nga organizmat ose individët e përcaktuar ose zgjidhur në një mënyrë që nuk mund të qeveriset nga rregullat e prokurimit, e tillë si për shembull caktimi i Avokatëve të Shtetit në disa shtete anëtare. Prandaj këto shërbime ligjore duhet të përjashtohen nga fusha e veprimit të kësaj Direktive.

- (26) Është e përshtatshme të specifikohet se nocioni i instrumenteve financiare të referuara në këtë Direktivë është dhënë në të njëjtin kuptim si në legjislacionin tjetër të tregut të brendshëm dhe, në funksion të krijimit të fundit të Objektivit të Stabilitetit Financiar Evropian dhe Mekanizmit të Stabilitetit Evropian, duhet të përcaktohet se operacionet e kryera me atë Objekt dhe atë Mekanizëm duhet të përjashtohen nga fusha e veprimit të kësaj Direktive. Përfundimisht duhet të sqarohet se kreditë, pavarësisht nëse kanë apo jo lidhje me lëshimin e letrave me vlerë apo instrumenteve të tjera financiare ose operacioneve të tjera, duhet të përjashtohen nga fusha e veprimit të kësaj Direktive.
- (27) Duhet të kujtojmë se Neni 5 (1) i Rregullores (EC) Nr. 1370/2007 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit parashikon në mënyrë eksplicite se Direktivat 2004/17/EC dhe 2004/18/EC zbatohen, respektivisht, për kontratat publike të shërbimeve për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me autobus apo tramvaj, ndërsa Rregullorja (EC) Nr. 1370/2007 zbatohet për koncesionet e shërbimit publik për transportin e udhëtarëve me autobus apo tramvaj. Duhet të kujtojmë se ajo Rregullore vazhdon të zbatohet për kontratat publike të shërbimeve, si dhe për koncesionet e shërbimit të transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë ose metro. Për të sqaruar marrëdhënien mes kësaj Direktive dhe Rregullores (EC) Nr. 1370/2007, duhet të parashikohet në mënyrë të qartë se kjo Direktivë nuk zbatohet për kontratat publike të shërbimeve për ofrimin e shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë ose metro, dhënia e të cilave duhet të vazhdojë të jetë subjekt i Rregullores. Për aq kohë sa Rregullorja (EC) Nr. 1370/2007 ia lë në dorë ligjit kombëtar largimin nga rregullat e përcaktuara në këtë Rregullore, Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të vazhdojnë të parashikojnë në legjislacionin e tyre kombëtar që kontratat publike të shërbimeve për shërbimet e transportit publik të pasagjerëve me hekurudhë

ose metro, duhet të jepen duke ndjekur rregullat e tyre të përgjithshme të prokurimit publik.

(28) Kjo Direktivë nuk duhet të zbatohet për shërbime të caktuara të emergjencës, kur këto kryhen nga organizata jofitimprurëse apo shoqata, që nga natyra e veçantë e tyre do të ishte e vështirë të kuptohej nëse ofruesit e shërbimeve duhej të zgjidheshin në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Direktivë. Megjithatë, përjashtimi nuk duhet të zgjatet përtej linjës rreptësisht të nevojshme. Prandaj duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë se shërbimet e transportit të ambulancës nuk duhet të përjashtohen. Në këtë kontekst është tepër e nevojshme për të sqaruar se Grupi CPV 601 "Shërbimet e Transportit Tokësor" nuk i mbulon shërbimet e ambulancës, të cilat gjenden në CPV 8514. Prandaj duhet theksuar se shërbimet e mbuluara nga kodi CPV 85143000-3, i përbërë ekskluzivisht nga shërbimet e transportit të ambulancës, duhet të jenë subjekt i një regjimi të veçantë të përcaktuar për shërbime të veçanta sociale dhe shërbime të tjera ('regjimi i lehtë'). Si pasojë, kontratat e përziera për ofrimin e shërbimeve të ambulancës në përgjithësi do të ishin gjithashtu subjekt i regjimit të lehtë, në qoftë se vlera e shërbimit të transportit do të ishte më e madhe se vlera e shërbimeve të tjera të ambulancës.

(29) Duhet të kujtojmë se kjo Direktivë zbatohet vetëm për autoritetet kontraktore të Shteteve Anëtare. Si pasojë, partitë politike, duke mos qenë autoritete kontraktuese, nuk janë subjekt i dispozitave të saj. Megjithatë, këto parti në disa shtete anëtare mund të përfshihen në nocionin e organeve të së drejtës publike. Megjithatë, shërbime të caktuara në kuadrin e një fushate zgjedhore (si video propaganduese dhe prodhimi i video-kasetave) janë të lidhura kaq ngushtë me pikëpamjet politike të ofruesit të shërbimit, sa që ofruesit e shërbimeve zgjidhen normalisht në një mënyrë që nuk mund të rregullohet nga rregullat e prokurimit.

Së fundi, duhet të kujtojmë se statuti dhe financimi i partive politike evropiane dhe fondacioneve politike evropiane janë subjekt i rregullave të tjera nga ato të përcaktuara në këtë Direktivë.

(30) Në disa raste, autoriteti kontraktues ose disa autoritete kontraktuese mund të jenë i vetmi burim për një shërbim të caktuar, në lidhje me ofrimin e të cilit

ajo gëzon një të drejtë ekskluzive në pajtim me ligjet, rregulloret ose dispozitat e botuara administrative, të cilat janë në përputhje me TFEU. Duhet qartësuar se kjo Direktivë nuk duhet zbatuar për lidhjen e kontratave të shërbimeve publike atij autoriteti kontraktues ose shoqate.

- (31) Ka pasiguri ligjore të konsiderueshme për faktin se sa larg kontratat e lidhura midis subjekteve në sektorin publik duhet të jenë të mbuluara nga rregullat e prokurimit publik. Rastet (ligjore) përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian janë interpretuar në mënyra të ndryshme ndërmjet shteteve anëtare, madje edhe ndërmjet autoriteteve kontraktuese. Prandaj është e nevojshme për të sqaruar se në cilat raste kontratat e lidhura brenda sektorit publik nuk janë subjekt i zbatimit të rregullave të prokurimit publik.

Një sqarim i tillë duhet të udhëhiqet nga parimet e përcaktuara në rastin (ligjor) përkatës të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Vetëm fakti që të dyja palët në një marrëveshje janë autoritete publike nuk mund ta përjashtojë aplikimin e rregullave të prokurimit. Megjithatë, zbatimi i rregullave të prokurimit publik nuk duhet të ndërhyjë në lirinë e autoriteteve publike për të kryer detyrat përkatëse të shërbimit publik duke përdorur burimet e tyre, të cilat përfshijnë mundësinë e bashkëpunimit me autoritetet e tjera publike.

Duhet siguruar që çdo bashkëpunim midis organeve publike të mos rezultojë në shtrembërimin e përgjdhjes në lidhje me operatorët ekonomik privatë, për sa kohë që vendoset një ofrues shërbimesh privat në pozicion të favorshëm përballë konkurrentëve të tij.

- (32) Kontratat publike të akorduara për personat juridikë të kontrolluar nuk duhet të jenë subjekt i aplikimit të procedurave të parashikuara nga kjo Direktivë, nëse autoriteti kontraktues ushtron një kontroll mbi personin juridik në fjalë i cili është i ngjashëm me atë që ai ushtron mbi departamentet e veta, me kusht që personi juridik i kontrolluar të kryejë më shumë se 80% të aktiviteteve dhe detyrave, të besuara atij nga autoriteti kontrollues kontraktues ose nga persona të tjerë juridikë të kontrolluar nga ai autoritet kontraktues, pavarësisht nga përfituesit e zbatimit të kontratës.

Përjashtimi nuk duhet të shtrihet në situatat ku ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë nga një operator ekonomik privat në kapitalin e personit

juridik të kontrolluar duke qenë se, në rrethana të tilla, dhënia e një kontrate publike pa procedurë konkurruese do ti siguronte këtij operatori ekonomik privat një avantazh të padrejtë mbi konkurrentët e tij. Megjithatë, duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të organeve publike me anëtarësim të detyrueshëm, të tilla si organizatat përgjegjëse për menaxhimin ose ushtrimin e disa shërbimeve publike, kjo nuk duhet të zbatohet në rastet kur pjesëmarrja e operatorëve ekonomik privat në kapitalin e personit juridik të kontrolluar është bërë e detyrueshme nga një dispozitë legislative kombëtare në përputhje me Traktatet, gjithmonë nëse një pjesëmarrje e tillë është jo-kontrolluese dhe jo-bllokuese dhe nuk ka një ndikim parësor në vendimet e personit juridik të kontrolluar. Prandaj, pjesëmarrja e kapitalit privat në autoritetin kontraktues kontrollues ose në organet kontraktuese kontrolluese, nuk përjashton dhënien e kontratave publike personit juridik të kontrolluar, pa zbatuar procedurat e parashikuara nga kjo Direktivë, duke qenë se kjo pjesëmarrje nuk ndikon negativisht në përgjedhjen ndërmjet operatorëve ekonomikë privatë.

Duhet të qartësohet se autoritetet kontraktuese të tilla si organet e rregulluara nga e drejta publike, që mund të kenë pjesëmarrje të kapitaleve private, duhet të jenë në gjendje të përfitojnë nga përjashtimi për bashkëpunim horizontal. Rrjedhimisht, kur janë plotësuar të gjitha kushtet e tjera në lidhje me bashkëpunimin horizontal, përjashtimi duhet të shtrihet për autoritete të tilla kontraktuese, kur kontrata është përfunduar vetëm ndërmjet autoriteteve kontraktuese.

- (33) Autoritetet kontraktuese duhet të jenë në gjendje të zgjedhin për të ofruar bashkërisht shërbimet e tyre publike nëpërmjet bashkëpunimit, pa qenë të detyruara të përdorin ndonjë formë të veçantë ligjore. Një bashkëpunim i tillë mund të mbulojë të gjitha llojet e aktiviteteve që kanë të bëjnë me kryerjen e shërbimeve dhe përgjegjësive të caktuara ose të marra nga autoritetet pjesëmarrëse, të tilla si detyrat e detyrueshme ose vullnetare të autoriteteve lokale apo rajonale, apo shërbime të vendosura nga organe të së drejtës publike. Shërbimet e ofruara nga autoritetet e ndryshme pjesëmarrëse nuk duhet të jenë domosdoshmërisht identike; ato mund të jenë edhe plotësuese.

Kontratat për ofrimin e përbashkët të shërbimeve publike nuk duhet të jenë subjekt i zbatimit të rregullave të përcaktuara në këtë Direktivë, nëse ato kanë përfunduar vetëm ndërmjet autoriteteve kontraktuese, nëse zbatimi i këtij bashkëpunimin drejtohet vetëm nga konsiderata që kanë të bëjnë me interesin publik dhe nëse asnjë ofrues privat i shërbimit nuk është vendosur në një pozicion avantazhi vis-à-vis (ballë për ballë) me konkurrentët e tij.

Në mënyrë që të përmbushë këto kushte, bashkëpunimi duhet të bazohet në një koncept bashkëpunues. Një bashkëpunim i tillë nuk kërkon që të gjitha autoritetet pjesëmarrëse të marrin përsipër përmbushjen e detyrimeve kryesore të kontratës, për aq kohë sa ka angazhime që kontribuojnë në drejtim të performancës bashkëpunuese të shërbimit publik në fjalë. Përveç kësaj, zbatimi i bashkëpunimit, duke përfshirë transfertat financiare ndërmjet autoriteteve kontraktuese që marrin pjesë, duhet të qeveriset vetëm nga konsiderata që kanë të bëjnë me interesin publik.

- (34) Ekzistojnë disa raste, ku sipas dispozitave përkatëse të ligjit kombëtar, një person juridik që vepron si një instrument apo shërbim teknik për autoritetet kontraktuese të përcaktuara, është i detyruar të zbatojë urdhrat e dhëna nga këto autoritete dhe nuk ka ndikim në shpërblimin për performancën e tij. Duke pasur parasysh natyrën e saj jo-kontraktuale, një marrëdhënie e tillë thjesht administrative nuk duhet të bjerë në kuadrin e procedurave të prokurimit publik.
- (35) Bashkëfinancimi i programeve të kërkimit dhe zhvillimit (R&D) nga burime të industrisë duhet të inkurajohet. Për pasojë, duhet të sqarohet se kjo Direktivë zbatohet vetëm aty ku nuk ka një bashkë-financim të tillë dhe ku rezultati i aktiviteteve të R&D shkon tek autoriteti kontraktues në fjalë. Kjo nuk duhet të përjashtojë mundësinë që ofruesi i shërbimit, pasi të ketë kryer këto aktivitete, të mund të publikojë një llogari të tij për aq kohë sa autoriteti kontraktues ruan të drejtën ekskluzive për të përdorur rezultatin e R&D në kryerjen e punëve të veta. Megjithatë ndarja fiktive e rezultateve të R&D ose pjesëmarrja thjesht simbolike në shpërblimin e ofruesit të shërbimeve nuk duhet të pengojë zbatimin e kësaj Direktive.
- (36) Punësimi dhe profesionalizmi kontribuojnë në integrimin në shoqëri dhe janë elementë kyç në garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë. Në këtë

kontekst, seminarët mund të luajnë një rol të rëndësishëm. E njëjta gjë është e vërtetë për bizneset e tjera sociale, qëllimi kryesor i të cilave është të mbështesin integrimin dhe riintegrimin social apo profesional të personave me aftësi të kufizuara dhe atyre jo të favorizuar, si të papunë, pjesëtarë të pakicave apo grupeve shoqërore të veçuara. Megjithatë, seminare apo biznese të tilla mund të mos jenë në gjendje të lidhin kontrata në kushte normale të konkurrencës. Si pasojë, është e përshtatshme të parashikohet se Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të rezervojnë të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e fitimit të kontratave publike apo zbatimit të kontratave në kuadrin e programeve të punësimit.

- (37) Me synim integrimin e duhur të kërkesave mjedisore, sociale dhe të punës në procedurat e prokurimit publik, ka rëndësi të veçantë që shtetet anëtare dhe autoritetet kontraktuese të marrin masat përkatëse për të siguruar përmbushjen e detyrimeve në fushën e legjislacionit mjedisor, social dhe të punës që zbatohet në vendin ku janë ekzekutuar punimet ose shërbimet e ofruara dhe të rezultojë nga ligjet, rregulloret, dekretet dhe vendimet, në nivel kombëtar dhe të BE, si dhe nga marrëveshjet kolektive, për sa kohë që rregullat dhe zbatimi i tyre, janë në përputhje me ligjin e BE. Njëlloj, detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga të gjitha Shtetet Anëtare dhe të listuara në Aneksin X duhet të përmbushen gjatë zbatimit të kontratës. Megjithatë, kjo nuk duhet që në asnjë mënyrë të parandalojë zbatimin e termave dhe kushteve të punësimit, të cilat janë më të favorshme për punëtorët.

Masat përkatëse duhet të zbatohen në përputhje me parimet bazë të ligjit të Bashkimit Evropian, me qëllim që të sigurohet trajtim i barabartë. Këto masa duhet të zbatohen në përputhje me Direktivën 96/71/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe në një mënyrë të tillë që siguron trajtim të barabartë dhe nuk diskriminon drejtpërdrejtë ose tërthorazi operatorët ekonomikë dhe punëtorët nga shtete të tjera anëtare.

- (38) Shërbimet duhet të ofrohen në vendin në të cilin ekzekutohet performanca karakteristike. Kur shërbimet ofrohen në një distancë, për shembull shërbimet e ofruara nga qendrat e thirrjes, duhet marrë në konsideratë ofrimi i tyre në vendin ku shërbimet janë ekzekutuar, pavarësisht nga vendet dhe shtetet anëtare për të cilat shërbimet janë drejtuar.

- (39) Detyrimet përkatëse mund të pasqyrohen në klauzolat e kontratës. Gjithashtu, duhet të jetë e mundur përfshirja e klauzolave për sigurimin e përputhshmërisë me marrëveshjet kolektive në pajtim me ligjin e BE në kontratat publike. Mosrespektimi i detyrimeve përkatëse mund të konsiderohet si sjellje e gabuar nga ana e operatorit ekonomik në fjalë, gjë që mund të shkaktojë përjashtimin e këtij operatori nga procedura për dhënien e një kontrate publike.
- (40) Kontrolli i respektimit të dispozitave ligjore mjedisore, sociale dhe të punës duhet të kryhet në fazat përkatëse të procedurës së prokurimit, gjatë zbatimit të parimeve të përgjithshme që rregullojnë zgjedhjen e pjesëmarrësve dhe lidhjen e kontratave, gjatë aplikimit të kriterëve të përjashtimit dhe dispozitave në lidhje me tenderët me vlere anomalisht të ulët. Verifikimi i nevojshëm për këtë qëllim duhet të kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Direktive, në veçanti ato që drejtojnë mjetet e provës dhe vetë-deklarimet.
- (41) Asgjë në këtë Direktivë nuk duhet të ndalojë vënien ose zbatimin e masave të nevojshme për të mbrojtur politikat publike, moralin publik, sigurinë publike, shëndetin, jetën e njeriut dhe të kafshëve, ruajtjen e jetës bimore ose masa të tjera mjedisore, në veçanti për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm, me kusht që këto masa të jenë në përputhje me TFEU.
- (42) Kemi një nevojë të madhe që autoritetet kontraktuese të kenë fleksibilitet shtesë për të zgjedhur një procedurë prokurimi, e cila ofron negociata. Një përdorim më i madh i këtyre procedurave ka gjithashtu gjasa për të rritur tregtinë ndërkufitare, pasi rezultatet kanë treguar se kontratat me procedurë të negociuar me shpallje paraprake kanë një shkallë shumë të lartë suksesi, si tenderë ndërkufitarë. Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të sigurojnë përdorimin e procedurës konkurruese me negociim ose dialogut konkurrues, në situata të ndryshme, kur procedurat e hapura ose të kufizuara pa negociata kanë të ngjarë të mos çojnë në rezultate të kënaqshme të prokurimit. Duhet të kujtojmë se përdorimi i dialogut konkurrues është rritur në mënyrë të konsiderueshme në drejtim të vlerave të kontratës gjatë viteve të fundit. Ai ka treguar se është i dobishëm në rastet kur autoritetet kontraktuese nuk janë në gjendje të përcaktojnë mjetet për kënaqjen e nevojave të tyre, ose të vlerësimit të asaj që tregu mund të ofrojë në drejtim

të zgjidhjeve teknike, financiare ose ligjore. Kjo situatë mund të lindë në mënyrë të veçantë gjatë projekteve novatore, gjatë zbatimit të projekteve të mëdha të integruara të infrastrukturës së transportit, rrjeteve të mëdha kompjuterike apo projekteve që përfshijnë financim kompleks dhe të strukturuar. Aty ku është relevante, autoritetet kontraktuese duhet të inkurajohen për të emëruar një udhëheqës projekti për të siguruar bashkëpunim të mirë ndërmjet operatorëve ekonomik dhe autoritetit kontraktues gjatë procedurës së akordimit.

- (43) Për kontratat e punëve, situata të tilla përfshijnë vepra të cilat nuk janë ndërtesa standarde ose kur përfshihet dizajni apo zgjidhje të reja. Për shërbimet ose furnizimet që kërkojnë përshtatje ose përpjekje për projektim, përdorimi i një procedure konkurruese me negociim apo dialog konkurrues ka mundësi të jetë i vlefshëm. Përshtatje apo përpjekje të tilla janë veçanërisht të nevojshme në rastin e blerjeve komplekse si produkte të sofistikuar, shërbime intelektuale, për shembull disa shërbime të konsulencës, shërbime arkitektonike ose inxhinierie, ose projekte të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Në ato raste, negociatat mund të jenë të nevojshme për të garantuar se furnizimi ose shërbimi në fjalë korrespondon me nevojat e autoritetit kontraktues. Në lidhje me shërbimet ose furnizimet standarde që mund të ofrohen nga operatorët të ndryshëm në treg, procedura konkurruese me negociim dhe dialog konkurrues nuk duhet të përdoret.
- (44) Procedura konkurruese me negociim duhet të përdoret në rastet kur një procedurë e hapur ose e kufizuar ka rezultuar vetëm në tenderë të parregullt ose të papranueshëm. Në raste të tilla, autoritetet kontraktuese duhet të lejohen të kryejnë negociata me qëllim që të marrin oferta të rregullta dhe të pranueshme.
- (45) Procedura konkurruese me negociim duhet të shoqërohet me masa mbrojtëse adekuate që sigurojnë respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë dhe transparencës. Në veçanti, autoritetet kontraktuese duhet të shtojnë paraprakisht kërkesat minimale të cilat karakterizojnë natyrën e prokurimit dhe që nuk duhet të ndryshohen në negociata. Kriteret e akordimit dhe matja e tyre duhet të mbeten të qëndrueshme gjatë gjithë procedurës dhe nuk duhet të jenë subjekt i bisedimeve, për të garantuar

trajtimin e barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë. Negociatat duhet të synojnë përmirësimin e tenderëve në mënyrë që të lejojnë autoritetet kontraktuese të blejnë vepra, furnizime dhe shërbime të përshtatura për nevojat e tyre të veçanta. Negociatat mund të prekin të gjitha karakteristikat e punëve, furnizimeve dhe shërbimeve të blera, duke përfshirë për shembull, cilësinë, sasinë, klauzolat komerciale, si dhe aspekte sociale, mjedisore dhe novatore, për aq kohë sa ato nuk përbëjnë kërkesat minimale.

Duhet sqaruar se kërkesat minimale që do të përcaktohen nga autoriteti kontraktues janë ato kushte dhe karakteristika (veçanërisht fizike, funksionale dhe ligjore) që çdo tender duhet të plotësojë apo posedojë në mënyrë që të lejojë autoritetin kontraktues të akordojë kontratën në përputhje me kriteret e zgjedhura. Në mënyrë që të sigurohet transparenca dhe lënia gjurmë e procesit, të gjitha fazat duhet të dokumentohen në mënyrë të rregullt. Për më tepër, të gjithë tenderët gjatë procedurës duhet të paraqiten me shkrim.

- (46) Autoritetet kontraktore duhet të lejohen të shkurtojnë afatet e caktuara që zbatohen për procedurat e hapura dhe të kufizuara dhe procedurat konkurruese me negociim, kur afatet në fjalë do të ishin të pamundura për shkak të gjendjes së urgjencës që duhet përballuar siç duhet nga autoritetet kontraktuese. Duhet sqaruar se nuk është e nevojshme të jetë një urgjencë ekstreme, sjellë nga ngjarje të paparashikuara dhe që nuk i atribuohen autoritetit kontraktues.
- (47) Hulumtimi dhe inovacioni, përfshirë eko-inovacionin dhe inovacionin social, janë ndër drejtuesit kryesorë të rritjes në të ardhmen dhe janë vënë në qendër të strategjisë së Evropës 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe përfshirëse. Autoritetet publike duhet të bëjnë përdorimin sa më të mirë strategjik të prokurimit publik për të nxitur risi. Blerja e produkteve të reja, punimet dhe shërbimet luajnë një rol kyç në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve publike, duke adresuar njëkohësisht sfidat e mëdha shoqërore. Kjo kontribuon në arritjen e vlerës më të mirë për paratë publike, si dhe në përfitime më të gjera ekonomike, mjedisore dhe shoqërore në drejtim të gjenerimit të ideve të reja, përkthimit të tyre në produkte dhe shërbime dhe rrjedhimisht nxitjes së rritjes të qëndrueshme ekonomike.

Duhet të kujtojmë se një seri e modeleve të prokurimit ka qenë e përshkruar në Komunikatën e Komisionit të datës 14 dhjetor 2007 të titulluar "Prokurimi Para-komercial: Drejtimi i risive për të siguruar shërbime publike të qëndrueshme të cilësisë së lartë në Evropë", e cila merret me prokurimin e shërbimeve R&D që nuk bien brenda fushëveprimit të kësaj Direktive. Këto modele do të vazhdonin të ishin në dispozicion, por kjo Direktivë duhet të kontribuojë gjithashtu për të lehtësuar prokurimin publik të inovacionit dhe për të ndihmuar shtetet anëtare në arritjen e objektivave të BE për Inovacionin.

- (48) Për shkak të rëndësisë së inovacionit, autoritetet kontraktuese duhet të inkurajohen për të lejuar variante të ndryshme sa më shpesh të jetë e mundur. Vëmendja e këtyre organeve duhet të orientohet tek nevoja për të përcaktuar kërkesat minimale që duhet të plotësohen nga këto variante, përpara se të hapet mundësia për paraqitjen e tyre.
- (49) Kur nevoja për zhvillimin e një produkti, shërbimi ose pune inovative dhe rrjedhimisht blerja e mëvonshme e furnizimeve, shërbimeve ose punëve nuk mund të plotësohet nga zgjidhjet e vëna në dispozicion në treg, autoritetet kontraktuese duhet të kenë akses në një procedurë të veçantë të prokurimit në lidhje me kontratat që janë brenda fushës së veprimit të kësaj Direktive. Kjo procedurë specifike duhet të lejojë autoritetet kontraktuese të krijojnë një partneritet afatgjatë inovacioni për zhvillimin dhe blerjen e mëvonshme të një produkti, shërbimi apo pune inovative, me kusht që produkti inovativ të mund të dorëzohet në nivele të pranueshme të performancës dhe kostove, pa nevojën e një procedure të veçantë të prokurimit për blerjen. Partneriteti duhet të bazohet në rregulla procedurale që zbatohen në procedurën konkurruese me negociim dhe kontratat duhet të akordohen mbi bazën e raportit më të mirë çmim-cilësi, i cili është më i përshtatshëm për krahasimin e tenderëve për zgjidhje inovative. Në lidhje me projekte shumë të mëdha ose projekte të vogla të reja, partneriteti i inovacionit duhet të strukturohet në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë "tërheqjen e nevojshme të tregut", duke nxitur zhvillimin e një zgjidhjeje inovative pa e mbyllur tregun.

Për këtë arsye, autoritetet kontraktuese nuk duhet ti përdorin partneritetet inovative në mënyrë të tillë që të parandalojnë, kufizojnë ose shtrembërojnë

konkurrencën. Në raste të caktuara, ngritja e partneriteteve të tilla me disa partnerë mund të kontribuojë për të shmangur këto efekte.

- (50) Nga pikëpamja e efekteve dëmtuese mbi konkurrencën, procedurat me negociim pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës duhet të përdoren vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Ky përjashtim duhet të limitohet në rastet kur publikimi është ose jo i mundur, për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara dhe që nuk i atribuohen autoritetit kontraktues, ose kur është e qartë që nga fillimi se publikimi nuk do të shkaktojë më shumë konkurrencë ose rezultate më të mira prokurimi, për shkak se ekziston objektivisht vetëm një operator ekonomik që mund të zbatojë kontratën. Ky është rasti i veprave të artit, ku identiteti i artistit në vetvete përcakton karakterin unik dhe vetë vlerën e objektit. Ekskluziviteti mund të lindë nga shkaqe të tjera, por vetëm situata të ekskluzivitetit objektiv mund të justifikojnë përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim, kur gjendja e ekskluzivitetit nuk është krijuar nga vetë autoriteti kontraktues në kuadër të procedurës së prokurimit në të ardhmen.

Autoritetet kontraktuese, duke u mbështetur në këtë përjashtim, duhet të japin arsyet se pse nuk ka alternativa të arsyeshme ose zëvendësues të tillë si përdorimi i kanaleve alternative të shpërndarjes, përfshirë ato jashtë shtetit anëtar të autoritetit kontraktues ose marrja në konsideratë e produkteve, furnizimeve dhe shërbimeve të krahasueshme.

Kur gjendja e ekskluzivitetit vjen për shkak të arsyeve teknike, këto të fundit duhet të përcaktohen në mënyrë rigoroze dhe të justifikohen në një bazë rast pas rasti. Për shembull, ato mund të përfshijnë pamundësinë teknike të një tjetër operatori ekonomik për të arritur performancën e kërkuar, ose nevojën për të përdorur mjete të veçanta ose mjete të cilat i disponon vetëm një operator ekonomik. Arsyet teknike mund të burojnë nga kërkesat specifike të ndërveprimit, të cilat duhet të përmbushen për të siguruar funksionimin e punimeve, furnizimeve apo shërbimeve që do të prokurohen.

Së fundi, një procedurë e prokurimit nuk është e dobishme, kur furnizimet blihen direkt në tregun e mallrave, duke përfshirë platforma tregtare për mallra të tilla si produktet bujqësore, lëndët e para dhe shkëmbimet e

energjisë, ku struktura shumëpalëshe e rregulluar dhe mbikëqyrur e tregtisë, garanton çmimet e tregut.

- (51) Duhet sqaruar se dispozitat lidhur me mbrojtjen e informacionit konfidencial në asnjë mënyrë nuk duhet të ndalojnë publikimin e pjesëve jo-konfidenciale të kontratave të lidhura, duke përfshirë çdo ndryshim të mëvonshëm.
- (52) Mjetet elektronike të informimit dhe komunikimit mund të lehtësojnë në masë të madhe publikimin e kontratave dhe të rrisin efikasitetin dhe transparencën e proceseve të prokurimit. Ato duhet të bëhen mjete standarde të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit në procedurat e prokurimit, duke qenë se rrisin ndjeshëm mundësitë e operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit në të gjithë tregun e brendshëm. Për këtë qëllim, transmetimi i njoftimeve në formë elektronike, disponueshmëria elektronike e dokumenteve të prokurimit dhe - pas një periudhe tranzicioni prej 30 muajsh - komunikimi plotësisht elektronik, që do të thotë komunikim me mjete elektronike në të gjitha fazat e procedurës, duke përfshirë edhe publikimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe njëkohësisht, publikimi i tenderëve (në formë elektronike) duhet të bëhet i detyrueshëm. Shtetet Anëtare dhe autoritetet kontraktuese duhet të mbeten të lira për të shkuar më tej, nëse dëshirojnë. Duhet gjithashtu të qartësohet se përdorimi i detyrueshëm i mjeteve elektronike të komunikimit në përputhje me këtë Direktivë nuk duhet të obligojë autoritetet kontraktuese për të kryer përpunimin elektronik të tenderëve, dhe as nuk duhet të mandatojë vlerësimin elektronik apo përpunimin automatik. Për më tepër, në zbatim të kësaj Direktive, asnjë element i procesit të prokurimit publik pas dhënies së kontratës nuk duhet të mbulohet nga detyrimi për të përdorur mjetet elektronike të komunikimit, përfshirë edhe komunikimin e brendshëm të autoritetit kontraktues.
- (53) Autoritetet kontraktore duhet, përveçse në situata të caktuara specifike, të përdorin mjete elektronike të komunikimit, të cilat nuk janë diskriminuese, gjerësisht në dispozicion dhe ndërvepruese me produktet e TIK në përdorim të përgjithshëm dhe të cilat nuk e kufizojnë qasjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit. Përdorimi i mjeteve të tilla të komunikimit duhet gjithashtu të marrë në konsideratë aksesin për personat me aftësi të kufizuara. Duhet sqaruar se detyrimi për të përdorur mjete elektronike në të gjitha fazat

e procedurës së prokurimit publik nuk do të ishte i përshtatshëm as kur përdorimi i mjeteve elektronike të kërkonte mjete ose formate skedarësh të specializuar që nuk janë në dispozicion dhe as kur komunikimi në fjalë mund të trajtohet vetëm duke përdorur pajisje zyre të specializuara. Pra, autoritetet kontraktore nuk duhet të jenë të detyruara të kërkojnë përdorimin e mjeteve elektronike të komunikimit në procesin e dorëzimit të dokumentacionit në raste të caktuara, të cilat duhet të jenë të listuara në mënyrë shteruese. Kjo Direktivë përcakton se në raste të tilla duhet të përfshihen situatat të cilat do të kërkonin përdorimin e pajisjeve të specializuara të zyrës që nuk janë në dispozicion të autoriteteve kontraktuese, si p.sh. printerë me format të gjerë. Në disa procedura të prokurimit, dokumentet e prokurimit mund të kërkojnë dorëzimin e një modeli apo shkalle fizike që nuk mund të paraqitet tek autoritetet kontraktore duke përdorur mjete elektronike. Në situata të tilla, modeli duhet t'i transmetohet autoriteteve kontraktore me postë ose rrugë tjetër të përshtatshme.

Megjithatë, duhet të qartësohet se përdorimi i mjeteve të tjera të komunikimit duhet të jetë i kufizuar në ato elemente të tenderit, për të cilët mjetet elektronike të komunikimit nuk janë të nevojshme.

Është e nevojshme të sqarohet se, autoritetet kontraktore duhet të jenë në gjendje të vendosin një kufi maksimal në madhësinë e skedarëve që mund të paraqiten, atëherë kur kjo është e nevojshme për arsye teknike.

- (54) Mund të ketë raste të jashtëzakonshme në të cilat autoritetet kontraktore duhet të lejohen që mos të përdorin mjetet elektronike të komunikimit. Kjo është e nevojshme në mënyrë që të mbrojë natyrën veçanërisht të ndjeshme të informacionit. Duhet të qartësohet se, kur përdorimi i mjeteve elektronike të cilat nuk janë përgjithësisht në dispozicion mund të ofrojë nivelin e nevojshëm të mbrojtjes, mjete të tilla elektronike duhet të përdoren. Për shembull mund të jetë rasti kur autoritetet kontraktore kërkojnë përdorimin e mjeteve të dedikuara të sigurta të komunikimit për të cilat ata ofrojnë akses.
- (55) Formatet e ndryshme teknike ose proceset dhe standardet e mesazheve, në mënyrë potenciale mund të krijojnë pengesa për ndërveprimet, jo vetëm

brenda secilit shtet anëtar, por gjithashtu dhe në veçanti ndërmjet shteteve anëtare. Për shembull, për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi, në të cilën përdorimi i katalogëve elektronike, i cili është një format për prezantimin dhe organizimin e informacionit në një mënyrë të përbashkët për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës, dhe që i përket trajtimit elektronik, është e lejuar ose kërkuar, që operatorët ekonomikë, në mungesë të standardizimit, do të duhet të rregullojnë katalogët e tyre për çdo procedurë të prokurimit, që do të kërkojnë dhënien e informacionit shumë të ngjashëm, por në formate të ndryshme në varësi të specifikave të autoritetit kontraktor në fjalë. Standardizimi i formateve të katalogut do të përmirësojë kështu nivelin e ndërveprimit; do të rrisi efikasitetin, si dhe do të zvogëlojë përpjekjet e nevojshme që duhen ndërmarrë nga operatorët ekonomik.

- (56) Duhet marrë në konsideratë nëse ekziston nevoja për të siguruar ose për të rritur ndërveprimin midis formateve teknike apo proceseve dhe mesazheve standarde të ndryshme, duke e bërë përdorimin e standardeve specifike të detyrueshme, si dhe duhet marrë parasysh se cilat standarde duhen zbatuar. Komisioni duhet të marrë parasysh edhe opinionet e palëve të interesuara. Gjithashtu, duhet marrë në konsideratë shkalla në të cilën një standard i dhënë tashmë është përdorur në praktikë nga ana e operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktore dhe sa mirë ka funksionuar. Para se të bëhet i detyrueshëm ndonjë standard i veçantë teknik, Komisioni, gjithashtu duhet të marrë me kujdes në konsideratë kostot që kjo mund të përfshijë, në veçanti në drejtim të përshtatjeve ndaj zgjidhjeve ekzistuese të prokurimit elektronik, duke përfshirë infrastrukturën, proceset ose softëare. Atje ku standardet në fjalë nuk janë zhvilluar nga një organizatë ndërkombëtare, evropiane apo kombëtare të standardizimit, duhet të plotësohen kërkesat e aplikueshme për standardet e ICT, ashtu siç është përcaktuar në Rregulloren (EU) 1025/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.
- (57) Para se të specifikohet niveli i sigurisë të nevojshme për mjetet elektronike të komunikimit që do të përdoren në faza të ndryshme të procedurës së vlerësimit, shtetet anëtare dhe autoritetet kontraktore duhet të vlerësojnë proporcionalitetin, ndërmjet kërkesave që synojnë sigurimin e identifikimit të saktë dhe të besueshëm të dërguesit dhe komunikimit në fjalë, si dhe integritetin e përmbajtjes së tij nga njëra anë, dhe riskut të problemeve të tilla, si në situata kur mesazhet janë dërguar nga një dërgues i ndryshëm nga

ai ç'mund të duket. Kur të gjitha gjërat e tjera janë të barabarta, kjo do të thotë se niveli i sigurisë që kërkohet nga, për shembull, një e-mail që kërkon konfirmimin e adresës së saktë në të cilën një takim për informacion do të mbahet, nuk do të duhet të jetë vendosur në të njëjtin nivel si për ofertën në vetvete, e cila përbën një ofertë të detyrueshme për operatorin ekonomik. Në mënyrë të ngjashme, vlerësimi i proporcionalitetit mund të rezultojë në nivele të ulëta të sigurisë që kërkohen në lidhje me riparqitjen e katalogëve elektronike ose dorëzimin e ofertave në kuadër të mini-konkurseve për një marrëveshje kuadër ose aksesin në dokumentet e prokurimit.

- (58) Elementët thelbësore të një procedure prokurimi siç janë dokumentet e tenderit, kërkesat për pjesëmarrje, konfirmimi i konfliktit të interesit dhe ofertave, gjithmonë duhet të bëhet me shkrim, ndërsa komunikimi me gojë me operatorët ekonomikë duhet të vazhdojë të jetë i mundur, me kusht që përmbajtja e tij është e dokumentuar në një shkallë të mjaftueshme. Kjo është e nevojshme për të siguruar një nivel të mjaftueshëm të transparencës që lejon për të verifikuar nëse parimi i trajtimit të barabartë është respektuar. Në veçanti, është thelbësore që komunikimet me gojë me ofertuesit, të cilat mund të ndikojnë në përmbajtjen dhe vlerësimin e ofertave, të dokumentohen në një masë të mjaftueshme dhe me mjete të përshtatshme të tilla si të dhënat e shkruara ose audio, ose përmbledhje të elementeve kryesore të komunikimit.
- (59) Ka një tendencë në rritje në të gjithë tregjet e prokurimit publik të BE në drejtim të mbledhjes së kërkesave nga ana e blerësve publike, me synim arritjen e ekonomisë së shkallës duke përfshirë çmime dhe kosto transaksioni më të ulëta, përmirësimin dhe profesionalizimin e menaxhimit të prokurimit. Kjo mund të arrihet duke përqëndruar blerjet nga numri i autoriteteve kontraktore të përfshira ose nga vëllimi dhe vlera. Megjithatë, grumbullimi dhe centralizimi i blerjeve duhet të monitorohet me kujdes për të shmangur përqëndrimin e tepërt të fuqisë blerëse dhe marrëveshjeve të fshehta, dhe për të ruajtur transparencën dhe konkurrencën, si dhe për të krijuar mundësi të aksesit në treg për bizneset e vogla dhe të mesme.
- (60) Instrumenti i marrëveshjeve kuadër është përdorur gjerësisht dhe është konsideruar si një teknikë efikase e prokurimit në të gjithë Evropën. Dhe për këtë arsye nuk duhet të ndryshohet. Megjithatë, marrëveshjet kuadër nuk

duhet të përdoren nga autoritetet kontraktore të cilat nuk identifikohen me to. Për këtë qëllim, autoritetet kontraktore që janë palë në një marrëveshje të veçantë kuadër, që nga fillimi duhet të identifikohen në mënyrë të qartë, goftë me emër ose me mjete të tjera të tilla si një referencë për një kategori të caktuar të autoriteteve kontraktore brenda një zone të përkufizuar në mënyrë të qartë gjeografike. Kështu, autoritetet kontraktore në fjalë mund të identifikohen lehtësisht dhe pa mëdyshje. Për më tepër, një marrëveshje kuadër nuk duhet të jetë e hapur për hyrjen e operatorëve të rinj ekonomik pasi ajo ka përfunduar. Kjo do të thotë se, kur një organ qëndror blerës përdor një regjistër të përgjithshëm të autoriteteve kontraktore apo kategori të tyre të tilla si autoritetet lokale në një zonë të caktuar gjeografike, që kanë të drejtë të kenë rekurs në marrëveshjet kuadër që konkludohen, organi qëndror blerës duhet ta bëjë këtë në një mënyrë që e bën të mundur për të verifikuar jo vetëm identitetin e autoritetit kontraktor në fjalë, por edhe datën nga e cila ai fiton të drejtën për të pasur rekurs në marrëveshjen kuadër të konkluduar nga organi qëndror blerës, pasi ajo datë përcakton se cilat marrëveshje kuadër të veçanta autoriteti kontraktor duhet të lejohet të përdori.

- (61) Kushtet objektive për përcaktimin, se cila palë e operatorëve ekonomik në një marrëveshje kuadër duhet të kryejë një detyrë të caktuar të tillë si mallra apo shërbime të destinuara për përdorim nga personat fizikë, në kontekst të marrëveshjeve kuadër që përcaktojnë të gjitha kushtet, mund të përfshijë nevojat ose zgjedhjet e personave fizikë të interesuar.

Autoriteteve kontraktore u duhet dhënë fleksibilitet shtesë gjatë prokurimeve për marrëveshjet kuadër të cilat lidhen me më shumë se një operator ekonomik dhe të cilat përcaktojnë të gjitha kushtet.

Në raste të tilla, autoritetet kontraktore duhet të lejohen të ndërmarrin punë të veçanta, mallra apo shërbime, të cilat janë të mbuluara nga marrëveshja kuadër, duke i kërkuar ato nga njëri prej operatorëve ekonomik, i përzgjedhur në përputhje me kriteret objektive dhe kushtet e përcaktuara tashmë, ose duke lidhur një kontratë të veçantë për punët, mallrat apo shërbimet në fjalë pas një mini-konkursi midis operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër. Për të siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë, autoritetet kontraktore duhet të tregojnë në dokumentet e

tenderit për marrëveshjen kuadër kriteret objektive që do të qeverisin përzgjedhjen midis atyre dy metodave të kryerjes së marrëveshjes kuadër. Kriteret e tilla, për shembull, mund të kenë të bëjnë me sasinë, vlerën apo karakteristikat e punëve, mallrave ose shërbimeve përkatëse, duke përfshirë nevojën për një shkallë më të lartë të shërbimit, rritjen e nivelit të sigurisë, ose për zhvillimet në nivelin e çmimeve në krahasim me një indeks të paracaktuar të çmimeve. Marrëveshjet kuadër nuk duhet të përdoren në mënyrë të paligjshme ose në një mënyrë të tillë që të parandalojnë, kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën. Autoritetet kontraktore nuk duhet të jenë të detyruar në zbatim të kësaj Direktive të prokurojnë punë, mallra apo shërbime që janë të mbuluara nga një marrëveshje kuadër, në bazë të asaj marrëveshjeve kuadër.

- (62) Gjithashtu duhet qartësuar se, për kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër duhen lidhur para përfundimit të afatit të marrëveshjes kuadër në vetvete, kohëzgjatja e kontratave individuale në bazë marrëveshjes kuadër nuk duhet të përkojë me kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër, por, sipas rastit, mund të jetë më e shkurtër apo më e gjatë. Në veçanti, duhet të lejohet të vendosi për kohëzgjatjen e kontratave individuale në bazë të një marrëveshje kuadër, duke marrë në konsideratë faktorë të tillë si koha e nevojshme për realizimin e kontratave, kur mirëmbajtja e pajisjeve me një jetë të pritshme për më shumë se katër vjet është e përfshirë, ose kur për kryerjen e kontratës është i nevojshëm një trajnim i gjerë i personelit.

Duhet qartësuar, se mund të ketë raste të jashtëzakonshme në të cilat kohëzgjatja e vetë marrëveshjeve duhet të lejohet të jetë më shumë se katër vjet. Raste të tilla, të cilat duhet të jenë të justifikuara, në veçanti nga subjekti i marrëveshjes kuadër, mund të lindin kur operatorët ekonomik kanë nevojë të nxjerrin jashtë përdorimit pajisje të cilat e kanë periudhën e amortizimit më shumë se katër vjet dhe të cilat duhet të jenë në dispozicion në çdo kohë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër.

- (63) Nga pikëpamja e përvojës së fituar, është gjithashtu e nevojshme përmirësimi i rregullave që rregullojnë sistemet dinamike të blerjes, për tu mundësuar autoriteteve kontraktore të marrin përparësi të plotë të mundësive të ofruara nga ai instrument. Sistemet duhet të thjeshtohen, në veçanti ato duhet të operohen në formën e një procedure të kufizuar, pra duke eliminuar

nevojën për oferta paraprake, të cilat janë identifikuar si një nga pengesat e mëdha që lidhen me sistemet dinamike të blerjes. Kështu, çdo operator ekonomik që dorëzon një kërkesë për pjesëmarrje dhe i plotëson kriteret e përzgjedhjes duhet të lejohet të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të kryera nëpërmjet sistemit dinamik të blerjes gjatë periudhës së tij të vlefshmërisë. Kjo teknikë blerjeje i lejon autoritetit kontraktor që të ketë një gamë të gjerë të ofertave, duke siguruar kështu, përdorimin optimal të fondeve publike nëpërmjet konkurrencës së hapur në lidhje me produktet e përdorura zakonisht ose nga shporta e produkteve, punëve ose shërbimeve të cilat janë në dispozicion gjerësisht në treg.

- (64) Shqyrtimi i këtyre kërkesave për pjesëmarrje, duhet normalisht të kryhet brenda një maksimumi prej 10 ditësh pune, duke pasur parasysh se vlerësimi i kriterëve të përzgjedhjes do të zhvillohet mbi bazën e kërkesave të thjeshtuara për dokumentacionin që është përcaktuar në këtë Direktivë. Megjithatë, kur një sistem dinamik i blerjes është krijuar për herë të parë, autoritetet kontraktore, në përgjigje të botimit të parë të njoftimit të kontratës ose ftesës për të konfirmuar interesin, mund të përballen me një numër kaq të madh të kërkesave për pjesëmarrje sa që atyre do t'u duhet më shumë kohë për të shqyrtuar kërkesat. Kjo duhet të jetë e pranueshme, me kusht që asnjë prokurim specifik mos të jetë nisur para se të gjitha kërkesat të jenë shqyrtuar. Autoritetet kontraktore duhet të jenë të lirë për të organizuar mënyrën me anë të së cilës ata kanë qëllim të shqyrtojnë kërkesat për pjesëmarrje, për shembull duke vendosur për të kryer ekzaminime të tilla vetëm një herë në javë, me kusht që afatet për shqyrtimin e çdo kërkesë të pranimit të merren parasysh.
- (65) Në çdo kohë, gjatë periudhës së vlefshmërisë së sistemit dinamik të blerjes, autoritetet kontraktore duhet të jenë të lira të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të parashtrajnë një vetëdeklarim, të përtërirë dhe të përditësuar, për përmbushjen e kriterëve për përzgjedhjen cilësore, brenda një afati kohor të përshtatshëm. Duhet të kujtojmë se ekziston mundësia e parashikuar në dispozitat e përgjithshme të mjeteve të provës të kësaj Direktive, që autoritetet kontraktore mund të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të dorëzojnë dokumentet mbështetëse, dhe detyrimin për ta bërë këtë e ka ofertuesi me të cilin është vendosur se do të lidhet kontrata.

Gjithashtu duhet të zbatohet në mënyrë të veçantë konteksti i sistemeve dinamike të blerjes.

- (66) Në mënyrë që të rritet mundësia për bizneset e vogla dhe të mesme për të marrë pjesë në një shkallë të gjerë të sistemit dinamik të blerjes, për shembull në një që drejtohet nga një organ qendror blerës, autoriteti kontraktor duhet të jetë në gjendje të ndajë sistemin në kategori produktesh të përcaktuara objektivisht, në punë ose shërbime. Kategori të tilla duhet të përcaktohen duke iu referuar faktorëve objektivë të cilët mund të përfshijnë, për shembull, madhësinë maksimale të lejueshme të kontratave të veçanta që do të jepen në kuadër të kategorisë në fjalë, ose një zonë të caktuar gjeografike, në të cilën kontrata specifike duhet të kryhet. Kur një sistem dinamik i blerjes është i ndarë në kategori, autoriteti kontraktor duhet të zbatoj kriteret e përzgjedhjes që janë në proporcion me karakteristikat e kategorisë përkatëse.
- (67) Duhet të sqarohet se ankandet elektronike zakonisht nuk janë të përshtatshme për kontrata të caktuara të punëve publike dhe disa kontrata të caktuara të shërbimit publik që kanë si objekt punë apo shërbime intelektuale të tilla si dizajni i punimeve, sepse objekt i blerjes elektronike mund të jenë vetëm elementët e përshtatshëm për vlerësimin automatik me anë të mjeteve elektronike, pa asnjë ndërhyrje ose vlerësim nga autoriteti kontraktor, dhe konkretisht elemente të cilat janë të matshme në mënyrë që mund të shprehen në shifra apo përqindje. Megjithatë, duhet sqaruar se ankandet elektronike mund të përdoren në një procedurë prokurimi për blerjen e një të drejte të veçantë të pronës intelektuale. Gjithashtu duhet kujtuar se ndërsa autoritetet kontraktore mbeten të lira për të zvogëluar numrin e kandidatëve ose ofertuesve për aq kohë sa ankandi nuk ka filluar akoma, një reduktim i mëtijshëm i numrit të tenderuesve që marrin pjesë në ankandin elektronik nuk duhet të lejohet pasi ankandi ka filluar.
- (68) Teknikat e reja elektronike të blerjes janë vazhdimisht duke u zhvilluar, si për shembull katalogët elektronik. Katalogët elektronikë janë një format për prezantimin dhe organizimin e informacionit në një mënyrë që është e përbashkët për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës dhe i cili është i gatshëm për trajtim elektronik. Një shembull i tillë mund të jenë ofertat e paraqitura në formën e një fletë palosjeje. Autoritetet kontraktore duhet të jenë në gjendje

të kërkojnë katalogët elektronik në të gjitha procedurat në dispozicion, ku përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit është i nevojshëm. Katalogët elektronik ndihmojnë për të rritur konkurrencën dhe të modernizojnë blerjet publike, veçanërisht në drejtim të kursimit të kohës dhe të hollave. Megjithatë, rregulla të caktuara duhet të përcaktohen për të siguruar që, përdorimi i teknikave të reja të jetë në përputhje me këtë Direktivë dhe me parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës. Kështu, përdorimi i Katalogëve elektronik për paraqitjen e ofertave, nuk duhet të përfshijë mundësinë e operatorëve ekonomik për të kufizuar veten e tyre vetëm tek transmetimi i katalogut të tyre të përgjithshëm. Operatorët ekonomik duhet ti përshtasin Katalogët e tyre të përgjithshëm në kuadrin e procedurës së veçantë të prokurimit. Përshtatja e tillë siguron që një katalog që transmetohet në përgjigje të një procedure të caktuar të prokurimit, të përmbajë vetëm produkte, punë ose shërbime që operatorët ekonomikë vlerësojnë - pas një shqyrtimi aktiv – të korrespondojnë me kërkesat e autoritetit kontraktor. Duke vepruar kështu, operatorët ekonomikë duhet të lejohen të kopjojnë informacionin që gjendet në katalogun e tyre të përgjithshëm, por nuk duhet të lejohen ta paraqesin katalogun e përgjithshëm si të tillë.

Për më tepër, kur ka garanci të mjaftueshme në lidhje me sigurimin e gjurmës së procesit dhe trajtimit të barabartë, autoritetet kontraktore duhet të lejohet të krijojnë tendera në lidhje me blerjet e caktuara, në bazë të katalogëve të transmetuar më parë elektronikisht, në mënyrë të veçantë, kur konkurrenca është rihapur me një marrëveshje kuadër ose kur sistemi dinamik i blerjes është duke u përdorur.

Kur tenderët janë krijuar nga autoriteti kontraktor, operatorit ekonomik të interesuar duhet t'i jepet mundësia për të verifikuar, se tenderi i krijuar nga autoriteti kontraktor nuk përmban ndonjë gabim material. Atje ku gabimet materiale janë të pranishme, operatori ekonomik nuk duhet të jetë i detyruar të marrë pjesë, nëse gabimi nuk është korrigjuar.

Në përputhje me kërkesat e rregullave për mjetet elektronike të komunikimit, autoritetet kontraktore duhet të shmangin pengesat e pajustificuara për akses nga ana e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit në të cilat tenderët do të prezantohen në formën e katalogëve

elektronik, dhe që garantojnë përputhje me parimet e përgjithshme të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë.

- (69) Teknikat e blerjes së përqëndruar përdoren gjithnjë e më shumë nga shtetet anëtare. Organet qendrore të blerjes janë përgjegjëse për të bërë blerjet, për menaxhimin e sistemeve dinamike, blerjen apo lidhjen e kontratave/marrëveshjeve publike kuadër për autoritetet e tjera kontraktore, me ose pa shpërblim. Autoritetet kontraktore, për të cilat një marrëveshje kuadër ka përfunduar, duhet të jenë në gjendje ta përdorin atë për blerje individuale ose të përsëritura. Në pikëpamjen e sasive të mëdha të blera, këto teknika mund të ndihmojnë në rritjen e konkurrencës dhe duhet të ndihmojnë për të profesionalizuar blerjet publike. Prandaj duhet të merren masa për një përkufizim të unifikuar të organeve qendrore të blerjes të dedikuara për autoritetet kontraktore, si dhe duhet sqaruar se organet qendrore të blerjes të veprojnë në dy mënyra të ndryshme.

Së pari, ata duhet të jenë në gjendje të veprojnë si tregtarët me shumicë duke blerë, të mbajnë në stok dhe rishesin ose, së dyti, duhet të jenë në gjendje të veprojnë si ndërmjetës për lidhjen e kontratave me anë të përdorimit të sistemeve dinamike të blerjes ose duke bërë marrëveshje kuadër që do të përdoren nga autoritetet kontraktore. Një rol i tillë ndërmjetës, në disa raste, mund të kryhet duke zhvilluar procedurat përkatëse në mënyrë autonome, pa udhëzime të hollësishme nga ana e autoriteteve kontraktore të interesuara; në raste të tjera, duke kryer procedurat përkatëse sipas udhëzimeve të autoriteteve kontraktore të interesuara, në emër të tyre dhe për llogari të tyre.

Për më tepër, rregullat duhet të përcaktohen në ndarjen e përgjegjësisë për respektimin e detyrimeve sipas kësaj Direktive, ndërmjet trupit të blerjeve qendrore dhe autoriteteve kontraktore që prokurojnë nga ose nëpërmjet tij. Kur organi qendror i blerjes ka përgjegjësinë e vetme për kryerjen e procedurave të prokurimit, ai duhet gjithashtu të jetë i vetmi dhe drejtpërdrejt përgjegjës për ligjshmërinë e procedurave të ndjekura. Kur një autoritet kontaktor kryen pjesë të caktuara të procedurës, për shembull rihapjen e përzgjedhjes, sipas një marrëveshje kuadër ose dhënien e kontratave individuale të bazuara në një sistem dinamik të blerjes, ai duhet të vazhdojë të jetë përgjegjës për fazat që ndjek.

- (70) Autoritetet kontraktore duhet të lejohen të lidhin një kontratë publike shërbimi për ofrimin e veprimtarive të centralizuara të blerjes, tek një organ qëndror blerës, pa zbatuar procedurat e parashikuara në këtë Direktivë. Gjithashtu duhet të lejohen për kontrata të tilla publike shërbimi, që përfshijnë sigurimin e aktiviteteve ndihmëse të blerjes. Kontratat publike të shërbimit për ofrimin e veprimtarive ndihmëse të blerjes duhet të lidhen sipas rregullave të kësaj Direktive kur nuk kryhen nga një organ qendror blerës, në lidhje me ofrimin e aktiviteteve qendrore të blerjes tek autoriteti kontraktor i interesuar. Gjithashtu duhet të kujtojmë se kjo Direktivë nuk duhet të zbatohet kur aktivitetet e centralizuara ose ndihmëse të blerjes ofrohen nëpërmjet një kontrate tjetër, përveç shpërblimit në para, i cili përbën prokurim në kuptimin e kësaj Direktive.
- (71) Forcimi i dispozitave në lidhje me organet qendrore blerëse, nuk duhet në asnjë mënyrë të parandaloj praktikat aktuale të prokurimit të përbashkët, dmth blerjen e përbashkët më pak të institucionalizuar dhe sistematike ose praktikën e vendosur e të pasurit rekurs ndaj ofruesve të shërbimeve që përgatisin dhe menaxhojnë procedurat e prokurimit, në emër dhe për llogari të autoritetit kontraktor dhe nën udhëzimet e tij. Përkundrazi, karakteristika të caktuara të prokurimit të përbashkët duhet të sqarohen për shkak të rolit të rëndësishëm që mund të luaj prokurimi i përbashkët në lidhje me projektet inovative.

Prokurimi i përbashkët mund të marrë forma të ndryshme, duke filluar nga prokurimi i koordinuar nëpërmjet përgatitjes së specifikimeve të përbashkëta teknike për punë, mallra apo shërbime që do të prokurohen nga një numër i autoriteteve kontraktore, ku secili kryen një procedurë të veçantë të prokurimit, në situata kur autoritetet kontraktore të interesuar bashkërisht kryejnë një procedurë prokurimi ose duke vepruar së bashku, ose duke i besuar një autoriteti kontraktor menaxhimin e procedurës së prokurimit, në emër të të gjitha autoriteteve të tjera kontraktore.

Kur disa autoritete kontraktore janë duke kryer së bashku një procedurë prokurimi, ata duhet të jenë përgjegjës bashkërisht për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Direktive. Megjithatë, kur vetëm një pjesë e procedurës së prokurimit është kryer bashkërisht nga autoritetet kontraktore, përgjegjësia e përbashkët duhet të zbatohet vetëm për ato

pjesë të procedurës që janë kryer së bashku. Çdo autoritet kontraktor duhet të jetë përgjegjës vetëm për sa i përket procedurave ose pjesëve të procedurave që ndjek vetë, të tilla si lidhja e një kontrate, përmbyllja e kontratës publike kuadër, funksionimi i një sistemi dinamik të blerjes, rihapja e përzgjedhjes në një marrëveshje kuadër ose vendimi se cili prej operatorëve ekonomik, palë të një marrëveshjeje kuadër, duhet të kryejë një detyrë të caktuar.

- (72) Mjetet elektronike të komunikimit janë veçanërisht të përshtatshme për të mbështetur praktikat e centralizuara të blerjes dhe mjetet, për shkak të mundësisë që ato ofrojnë për të ripërdorur dhe automatikisht të përpunojnë të dhënat, si dhe për të minimizuar kostot e informacionit dhe transaksioneve. Përdorimi i mjeteve të tilla elektronike të komunikimit, për këtë arsye, si hap i parë, duhet të bëhet i detyrueshëm për organet qendrore të blerjes, duke lehtësuar gjithashtu praktikat konvergjente në të gjithë Bashkimin Evropian. Kjo duhet të pasohet nga një detyrim i përgjithshëm për të përdorur mjetet elektronike të komunikimit në të gjitha procedurat e prokurimit pas një periudhe tranzicioni prej 30 muajsh.
- (73) Lidhja e përbashkët e kontratave publike nga autoritetet kontraktore të Shteteve të ndryshme Anëtare, aktualisht has vështirësi ligjore të veçanta në lidhje me konfliktin e ligjeve kombëtare. Pavarësisht nga fakti se Direktiva 2004/18 / EC e lejon në mënyrë implicite (nënkupton) prokurimin publik të përbashkët ndërkufitar, autoritetet kontraktore, ende përballen me vështirësi të konsiderueshme ligjore dhe praktike në lidhje me blerjen nga organet qendrore të blerjes në Shtetet e tjera Anëtare, ose në lidhje me nëshkrimin e përbashkët të kontratave publike. Në mënyrë që autoritetet kontraktore të lejohen që të përfitojnë maksimumin e potencialit të tregut të brendshëm në drejtim të ekonomive të shkallës dhe ndarjen e riskut dhe përfitimit, për projektet inovative përfshijnë një sasi më të madhe të riskut se sa mund të përballohet në mënyrë të arsyeshme nga një autoritet kontraktor i vetëm, këto vështirësi duhet të rregullohen. Prandaj rregullat e reja mbi prokurimin ndërkufitar të përbashkët duhet të krijohen në mënyrë që të lehtësojnë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kontraktore dhe rrisin përfitimet e tregut të brendshëm, duke u krijuar mundësi të biznesit ndërkufitare për furnizuesit dhe ofruesit e shërbimeve. Këto rregulla duhet të përcaktojnë kushtet për shfrytëzim ndërkufitar të organeve qendrore të

blerjes dhe të caktojnë ligjet e aplikueshme të prokurimit publik, duke përfshirë legjislacionin e aplikueshëm mbi mjetet juridike, në rastet e procedurave ndërkufitare të përbashkëta, duke plotësuar rregullat e ligjit të konfliktit të Rregullores (KE) Asnjë 593/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (13). Përveç kësaj, autoritetet kontraktore nga Shtetet Anëtare të ndryshme duhet të jetë në gjendje për të ngritur entet e përbashkëta të themeluara sipas ligjeve kombëtare dhe atij të Bashkimit Evropian. Duhet të vendosen rregulla specifike për forma të tilla të prokurimit të përbashkët.

Megjithatë, autoritetet kontraktore nuk duhet ti përdorin këto mundësi për prokurim të përbashkët ndërkufitar me qëllim shmangien e rregullave të detyrueshme të ligjit publik, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian, të cilat janë të zbatueshme për ta në Shtetin Anëtar ku ata ndodhen. Rregullat e tilla mund të përfshijnë, për shembull, dispozita për transparencë dhe akses në dokumente ose kërkesa specifike për gjurmueshmërinë e mallraves të ndjeshme.

- (74) Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik, duhet të lejojnë që prokurimi publik të jetë i hapur për konkurrencë, si dhe të arrihen objektivat e qëndrueshmërisë. Për këtë qëllim, duhet dorëzohen ofertat që pasqyrojnë larminë e standardeve të zgjidhjeve teknike dhe specifikimet teknike në treg, duke përfshirë edhe ato të hartuara mbi bazën e kriterëve të zbatimit, të lidhura me ciklin e jetës dhe qëndrueshmërinë e procesit të prodhimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve.

Si pasojë, specifikimet teknike duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të shmangët artificialisht ngushtimi i konkurrencës përmes kërkesave që favorizojnë një operator të caktuar ekonomik, duke pasqyruar karakteristikat kryesore të mallrave, shërbimeve ose punëve që ofrohen zakonisht nga ky operator ekonomik. Hartimi i specifikimeve teknike në drejtim të kërkesave funksionale dhe për zbatim në përgjithësi, lejon që objektivi të arrihet në mënyrën më të mirë të mundshme. Kërkesat funksionale dhe të zbatimit janë edhe mjetet e duhura për të favorizuar inovacionin në prokurimin publik, dhe duhet të përdoren sa më gjerësisht të jetë e mundur. Kur i bëhet referencë një standardi evropian ose, në mungesë të tij, një standardi kombëtar, ofertat duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktore bazuar

në rregullimet ekuivalente. Është përgjegjësi e operatorit ekonomik për të vërtetuar ekuivalencën me markën e kërkuar.

Për të vërtetuar ekuivalencën, kërkohet nga ofertuesit që t'i sigurojnë palës së tretë, prova të verifikueshme. Megjithatë, mjete të tjera të përshtatshme të provës, si një dosje teknike e prodhuesit, duhet të lejohet kur operatori ekonomik i interesuar nuk ka akses në certifikata të tilla ose raporte të tilla testimi, ose në pamundësinë e marrjes së tyre, brenda afateve të caktuara, me kusht që operatori ekonomik i interesuar, në këtë mënyrë dëshmon se punët, mallrat apo shërbimet plotësojnë kërkesat ose kriteret e përcaktuara në specifikimet teknike, kriteret e lidhjes ose kushtet e zbatimit të kontratës.

- (75) Autoritetet kontraktore që dëshirojnë të blejnë punë, mallra apo shërbime me karakteristika të veçanta mjedisore, sociale apo të tjera, duhet të jenë në gjendje që t'iu referohen markave të veçanta, të tilla si Eko-Marka Evropiane, marka (multi-)nacionale eko apo ndonjë emërtim tjetër me kusht që kërkesat për markat të jenë të lidhura me objektin e kontratës, si për shembull përshkrimi i produktit dhe prezantimi i tij, duke përfshirë edhe kërkesat e paketimit. Është tepër e rëndësishme që këto kërkesa të jenë përpiluar dhe miratuar në bazë të kriterëve të verifikueshme, duke përdorur një procedurë në të cilën palët e interesuara, të tilla si organet qeveritare, konsumatorët, prodhuesit, shpërndarësit dhe organizatat mjedisore, mund të marrin pjesë, dhe se marka është e arritshme dhe në dispozicion për të gjitha palët e interesuara. Duhet të sqarohet se palët e interesuara mund të jenë organe publike apo private, biznese apo ndonjë lloj i organizatës jo-qeveritare (një organizatë që nuk është pjesë e një qeverie dhe nuk është një biznes konvencional). Kjo duhet t'iu sqarohet organeve ose organizatave të veçanta kombëtare apo qeveritare që mund të përfshihen në ngritjen e kërkesave për markat, që mund të përdoren në lidhje me prokurimin nga autoritetet publike, duke përjashtuar ato organe ose organizata të cilat kanë humbur statusin e tyre si palë të treta.

Referencat për këtë nuk duhet të kenë efektin e kufizimit të inovacionit.

- (76) Për të gjitha prokurimet e destinuara për përdorim nga personat, qoftë publiku i gjerë ose stafi i autoritetit kontraktor, është e nevojshme që autoritetet kontraktore të hartojnë specifikimet teknike në mënyrë që të

marrin në konsideratë kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose dizajnin për të gjithë përdoruesit, përveç rasteve të justifikuara.

- (77) Gjatë hartimit të specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të marrin parasysh kërkesat që rrjedhin nga e drejta e BE në fushën e ligjit për mbrojtjen e të dhënave, në veçanti në lidhje me hartimin e përpunimit të të dhënave personale (mbrojtjes së të dhënave me qëllim).
- (78) Prokurimi publik duhet t'i përshtatet nevojave të bizneseve të vogla dhe të mesme. Autoritetet kontraktore duhet të inkurajohen për të përdorur e Kodin e Praktikave më të Mira të përcaktuara në Dokumentin e Punës të Stafit të Komisionit të datës 25 qershor 2008 e titulluar "Kodi Evropian i Praktikave më të Mira që Lehtëson Aksesin e bizneseve të vogla dhe të mesme për Kontratat e Prokurimit Publik", që japin udhëzime se si ata mund të aplikojnë në një marrëveshje kuadër të prokurimit publik, në një mënyrë që lehtëson pjesëmarrjen e bizneseve të vogla dhe të mesme. Për këtë qëllim për të rritur konkurrencën, autoritetet kontraktore duhet të inkurajohen për të ndarë kontratat e mëdha në lote. Një ndarje e tillë mund të bëhet në baza sasiore, duke e bërë madhësinë e kontratave individuale që ti korrespondojnë më mirë kapaciteteve të bizneseve të vogla dhe të mesme, apo në një bazë cilësore, në përputhje me profesionet e ndryshme dhe specializimet e përfshira, për të përshtatur përmbajtjen e kontratave individuale më ngushtë me sektorët e specializuar të bizneseve të vogla ose të mesme, në përputhje me fazat e ndryshme të projektit.

Madhësia dhe objekti i loteve, duhet të përcaktohet nga autoriteti kontraktor, i cili, në përputhje me rregullat përkatëse për llogaritjen e vlerës së prokurimit, duhet të lejohet që të hapi disa nga lotet, pa zbatuar procedurat e kësaj Direktive. Autoriteti kontraktor duhet të ketë për detyrë të marri në konsideratë përshtatshmërinë e ndarjes së kontratave në lote, duke mbetur i lirë të vendosë në mënyrë autonome në bazë të ndonjë arsyeje që ai e konsideron të rëndësishme, pa qenë objekt i mbikëqyrjes administrative apo gjyqësore. Kur autoriteti kontraktor vendos se nuk do të jetë e përshtatshme për të ndarë kontratën në lote, raporti individual ose dokumentet e prokurimit duhet të përmbajnë një tregues për arsyet kryesore për vendimin e autoritetit kontraktor. Arsye të tilla mund të jenë, për shembull kur autoriteti kontraktor konstaton se ndarja e tillë mund të

rrezikojë konkurrencën, kufizon apo rrezikon ekzekutimin e kontratës teknikisht të vështirë ose të shtrenjtë, apo se nevoja për të koordinuar kontraktorët e ndryshëm për lotet mund të rrezikojë seriozisht ekzekutimin e duhur të kontratës.

Shtetet Anëtare duhet të mbeten të lira për të shkuar më tej në përpjekjet e tyre për të lehtësuar përfshirjen e bizneseve të vogla e të mesme në tregun e prokurimit publik, duke zgjeruar fushëveprimin e detyrimit për të marrë në konsideratë përshtatshmërinë e ndarjes së kontratave në lote për kontrata të vogla, si dhe duke u kërkuar autoriteteve kontraktore për të siguruar një justifikim për vendimin për mos ndarjen e kontratave në lote, ose duke bërë një ndarje në lote të detyrueshme nën kushte të caktuara. Me të njëjtin qëllim, Shtetet Anëtare duhet të jenë të lira që të sigurojnë mekanizma për kryerjen e pagesave direkte nënkontraktorëve.

- (79) Kur kontratat janë ndarë në lote, autoritetet kontraktore, në mënyrë që të ruajnë konkurrencën ose për të siguruar besueshmërinë e mallrave, duhet të lejohen për të kufizuar numrin e loteve për të cilat një operator ekonomik mund të marrë pjesë; ata gjithashtu duhet të lejohen të kufizojnë numrin e loteve që mund të jepen për çdo operator.

Megjithatë, objektivi i lehtësimit të aksesit më të madh në prokurimin publik nga bizneset e vogla e të mesme, mund të pengohet në qoftë se autoritetet kontraktore do të jenë të detyruara të lidhin kontratën për çdo lot edhe kur kjo do të sillte një detyrim për të pranuar zgjidhje më pak të dobishme në krahasim me një kontratë që grupon disa ose të gjitha lotet së bashku. Kur mundësia për të aplikuar një metodë të tillë është parashtruar në mënyrë të qartë më parë, atëherë duhet të jetë e mundur që autoritetet kontraktore të kryejnë një vlerësim krahasues të ofertave, në mënyrë që të vendosi nëse ofertat e dorëzuara nga ofertuesit e veçantë për një kombinim të veçantë të loteve, të marra së bashku, plotësojnë më mirë kriteret e lidhjes së kontratës të përcaktuara në përputhje me këtë Direktivë në lidhje me ato lote në veçanti. Nëse është kështu, autoriteti kontraktor duhet të lejohet për të lidhur një kontratë të që kombinon lotet në fjalë. Duhet të sqarohet se, autoritetet kontraktore duhet të kryejnë një vlerësim të tillë krahasues me parë, për të përcaktuar se cilat oferta i përmbushin më mirë kriteret e lidhjes së kontratës për secilin lot individualisht dhe pastaj duke e krahasuar atë me

ofertat e dorëzuara nga pjesëmarrësit e veçantë për një kombinim të veçantë të loteve në terësi.

- (80) Në mënyrë që procedurat të bëhen më të shpejta dhe më efikase, afatet kohore për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit duhet të jenë sa më të shkurtra të jetë e mundur, pa krijuar pengesa të panevojshme për operatorët ekonomikë nga i gjithë tregu i brendshëm dhe në veçanti për bizneset e vogla e të mesme. Për këtë arsye duhet të mbahet në mendje se, kur përcaktohen afatet kohore për pranimin e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti kontraktor duhet të marrë parasysh kompleksitetin e kontratës dhe kohën e nevojshme për përgatitjen e dokumenteve të tenderit, edhe nëse kjo nënkupton vendosjen e afateve kohore që janë më të gjata se minimumi i parashikuar sipas kësaj Direktive. Përdorimi i mjeteve elektronike të informimit dhe komunikimit, në veçanti vënia në dispozicion të plotë elektronik operatorëve ekonomik, ofertuesve dhe kandidatëve, të dokumenteve të prokurimit, ndërsa transmetimi elektronik i komunikimit të çon, në anën tjetër, në rritjen e transparencës dhe kursimit të kohës. Prandaj, duhet të merren masa për reduktimin e afateve kohore minimale në përputhje me rregullat e vendosura nga GPA dhe me kusht që ato janë në përputhje me mënyrën specifike të transmetimit të parshikuar në nivel të BE-së. Për më tepër, autoritetet kontraktore duhet të kenë mundësinë për të shkurtuar më tej afatet për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe të ofertave në rastet kur emergjenca bën të pamundur respektimin e kufijve të rregullt kohor, por që nuk e bën një procedurë të rregullt me publikim të pamundur. Vetëm në situata të jashtëzakonshme kur nevoja ekstreme është shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, dhe që nuk i atribuohen atij autoriteti kontraktor, ai bën të pamundurën për të kryer një procedurë të rregullt edhe me afatet e shkurtuara. Autoritetet kontraktore duhet që, për aq kohë sa është e domosdoshme, të kenë mundësi për lidhjen e kontratave me procedurë të negociuar pa publikim paraprak. Ky mund të jetë rasti kur katastrofat natyrore kërkojnë veprim të menjëhershëm.
- (81) Duhet të sqarohet se nevoja për të siguruar që operatorët ekonomikë të kenë kohë të mjaftueshme për të hartuar një ofertë, mund të sjellë që afatet kohore të cilat ishin vendosur fillimisht mund të shtyhen. Ky do të jetë rasti kur ndryshime të rëndësishme janë bërë në dokumentet e tenderit.

Gjithashtu duhet të specifikohet se, në këtë rast, ndryshime të rëndësishme duhet të kuptohen si ndryshime mbuluese, në veçanti për specifikimet teknike, në lidhje me të cilat operatorëve ekonomik do t'iu duhet kohë shtesë në mënyrë që të kuptojnë dhe të përgjigjen në mënyrë të përshtatshme. Megjithatë, duhet sqaruar se ndryshimet e tilla nuk duhet të jenë aq të rëndësishme sa që pranimi i kandidatëve të tjerë përveç atyre të zgjedhur fillimisht do të ishte lejuar ose pjesëmarrës tjerë do të tërhiqeshin nga procedura e prokurimit. Ky mund të jetë rasti kur ndryshimet e bëjnë kontratën apo marrëveshjen kuadër materialisht të ndryshme në karakter nga ajo e përcaktuar fillimisht në dokumentet e prokurimit.

- (82) Duhet të sqarohet se informacioni lidhur me vendime të caktuara të marra gjatë një procedure të prokurimit, duke përfshirë edhe vendimin për të mos lidhur një kontratë apo për mos të bërë një marrëveshje kuadër, duhet të dërgohet nga autoritetet kontraktore, pa nevojën e kandidatëve ose ofertuesve për të kërkuar një informacion të tillë. Gjithashtu duhet të kujtojmë se Direktiva e Këshillit 89/665 / EEC (14) parashikon një detyrim për autoritetet kontraktore, për t'iu siguruar kandidatët dhe ofertuesve të interesuar me një përmbledhje të arsyeve përkatëse për disa vendime qëndrore që janë marrë gjatë një procedure të prokurimit pa qenë nevoja për ta kërkuar një informacion të tillë. Duhet përfundimisht të sqarohet se kandidatët dhe ofertuesit duhet të jenë në gjendje për të kërkuar më shumë informacion të detajuar në lidhje me arsyet se cilat autoritete kontraktore duhet të jenë të nevojshme për të dhënë, përveç në rastet kur nuk do të ketë arsye serioze për të mos e bërë këtë. Këto arsye duhet të përcaktohen në këtë Direktivë. Për të siguruar transparencën e nevojshme në kontekstin e procedurave të prokurimit që përfshin negociatat dhe dialogje me ofertuesit, ofertuesit që kanë bërë një ofertë të pranueshme duhet, përveç në rastet kur nuk do të ketë arsye serioze për të mos e bërë këtë, edhe të të aktivizohen për të kërkuar informacion mbi zhvillimin dhe përparimin e procedurave.
- (83) Kërkesat e tepruara në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar, shpesh përbëjnë një pengesë të pajustificuar për përfshirjen e bizneseve të vogla e të mesme në fushën e prokurimit publik. Çdo kërkesë e tillë duhet të jetë e lidhur ngushtë dhe në përpjesëtim me objektin e kontratës. Në veçanti, autoritetet kontraktore nuk duhet të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të kenë një xhiro minimale që do të jetë në disproporcion me objektin e

kontratës; kërkesa normalisht nuk duhet të kalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Megjithatë, në rrethana të justifikuara siç duhet, kjo duhet të jetë e mundur për të aplikuar kërkesat më të larta. Rrethanat e tilla mund të lidhen me rreziqe të larta bashkangjitur me zbatimin e kontratës ose faktin se ekzekutimi i saj në kohë dhe i saktë është i rëndësishëm, për shembull për shkak se ajo përbën një fazë përgatitore të nevojshme për përmbytjen e kontratave të tjera.

Në raste të tilla të justifikuara, autoritetet kontraktore duhet të mbeten të lirë të vendosin në mënyrë autonome nëse kërkesat e larta të xhiros minimale do të jenë të përshtatshme dhe me vend, pa qenë objekt i mbikëqyrjes administrative apo gjyqësore. Kur kërkesat më të larta të xhiros minimal duhet të zbatohen, autoritetet kontraktore duhet të mbeten të lira për të vendosur nivelin sa kohë që ajo është e lidhur dhe në përpjesëtim me objektin e kontratës. Kur autoriteti kontraktor vendos se kërkesa minimale e xhiros duhet të jetë vendosur në një nivel më të lartë se dyfishi i vlerës së parashikuar e kontratës, raporti individual ose dokumentet e prokurimit duhet të përmbajnë një tregues për arsyet kryesore të vendimit të autoritetit kontraktor.

Autoritetet kontraktore duhet gjithashtu të jenë në gjendje të kërkojnë informacion mbi raportet, për shembull, midis aktiveve dhe detyrimeve në llogaritë vjetore. Një raport pozitiv që tregon nivele më të larta të aktiveve sesa të detyrimeve, mund të sigurojë prova shtesë që kapaciteti financiar i operatorëve ekonomikë është i mjaftueshëm.

- (84) Shumë operatorë ekonomik, sidomos bizneset e vogla dhe të mesme, hasin në një pengesë të madhe për pjesëmarrjen e tyre në prokurimin publik, që konsiston në pengesat administrative që dalin nga nevoja për të prodhuar një numër të konsiderueshëm të certifikatave ose dokumenteve të tjera që lidhen me kriteret e përjashtimit dhe të përzgjedhjes. Kufizimi i kërkesa të tilla, për shembull, me anë të përdorimit të një Dokumenti të Vetëm Evropian të Prokurimit (ESPD) i përbërë nga një formular vetëdeklarimi të përditësuar, mund të rezultojë në thjeshtëzim të konsiderueshëm për të mirën e të dy autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomik.

Ofertuesi me të cilin do të lidhet kontrata duhet, ti kërkohet që të sigurojë prova relevante dhe autoritetet kontraktore nuk duhet të lidhin kontrata me ofertuesit që nuk janë në gjendje për ta bërë këtë. Autoritetet kontraktore duhet gjithashtu të kërkojnë të gjitha ose një pjesë të dokumenteve mbështetëse, në çdo moment që ata konsiderojnë të nevojshme, në funksion të zhvillimit të duhur të procedurës. Ky mund të jetë veçanërisht rasti i procedurave me dy faza - procedurave të kufizuara, procedurave konkurruese me negociim, dialogje konkurruese dhe partneriteteve inovative - në të cilat autoritetet kontraktore bëjnë të mundur kufizimin e numrit të kandidatëve të ftuar për të dorëzuar ofertat. Kërkesa e paraqitjes së dokumenteve mbështetëse në momentin e përzgjedhjes së kandidatëve që do të ftohen, mund të justifikohet për të shmangur që autoritetet kontraktore të ftojnë kandidatët të cilët më vonë nuk janë në gjendje të dorëzojnë dokumentet mbështetëse në fazën e lidhjes së kontratës, duke i privuar kështu kandidatët e tjerë të kualifikuar nga pjesëmarrja.

Duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë se ESPD duhet gjithashtu të sigurojë informacionin e duhur në lidhje me entet, mbi kapacitetet e të cilit mbështetet një operator ekonomik, në mënyrë që verifikimi i informacionit në lidhje me ente të tilla mund të kryhet së bashku me dhe në të njëjtat kushte si verifikimi në lidhje me operatorin kryesor ekonomik.

(85) Është e rëndësishme që vendimet e autoriteteve kontraktore duhet të bazohen në informacionin e fundit, në veçanti përsa i përket arsyeve të përjashtimit, duke pasur parasysh se ndryshime të rëndësishme mund të ndërhyjnë shumë shpejt, për shembull në rast të vështirësive financiare të cilat do ta bëjnë operatorin ekonomik të papërshtatshëm apo, anasjelltas, për shkak se një borxh i papaguar në kontributet shoqërore është paguar ndërkohë. Për këtë arsye është e preferueshme që, kur është e mundur, autoritetet kontraktore duhet të verifikojnë një informacion të tillë duke hyrë në bazat e të dhënave përkatëse, të cilat duhet të jenë kombëtare në kuptimin e të qenit të administruara nga autoritetet publike. Në fazën e tanishme të zhvillimit, ka raste kur kjo nuk mund të realizohet për shkak të arsyeve teknike. Prandaj, Komisioni duhet të parashikojë promovimin e masave që mund të lehtësojnë rekursin e lehtë për informacion të përditësuar në mënyrë elektronike, të tilla si forcimi i mjeteve që ofrojnë

akses në dosjet virtuale të kompanisë, apo mjeteve që lehtësuar ndërveprimin ndërmjet bazave të të dhënave.

Gjithashtu duhet të sigurohet që autoritetet kontraktore nuk duhet të kërkojë ende dokumente të përditësuara, të cilat ata tashmë posedojnë nga procedurat e mëparshme të prokurimit. Megjithatë, duhet gjithashtu të sigurohet që, autoritetet kontraktore nuk do të ballafaqohen me arkivimin disproporcional në këtë kontekst. Rrjedhimisht, zbatimi i kësaj detyre duhet të jetë i aplikueshëm menjëherë për sa kohë që përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit është i detyrueshëm, pasi menaxhimi elektronik i dokumenteve do ta lehtësojë punën për autoritetet kontraktore.

- (86) Lehtësimi i mëtejshëm, si për operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore mund të arrihet me anë të një formulari standard për vetëdeklarimet, i cili mund të zvogëlojë problemet e lidhura me hartimin e saktë të deklaratave formale dhe deklaratat e pëlqimit, si dhe çështjet e gjuhës.
- (87) Komisioni siguron dhe menaxhon një sistem elektronik, e-Certis, i cili aktualisht, përditësohet dhe verifikohet në mënyrë vullnetare nga autoritetet kombëtare. Qëllimi i e-Certis është për të lehtësuar shkëmbimin e certifikatave dhe dëshmimeve të tjera të dokumentuara, të cilat kërkohen shpesh nga autoritetet kontraktore. Përvoja e fituar deri tani tregon se përditësimi vullnetar dhe verifikimi është i pamjaftueshëm për të siguruar se e-Certis mund të japë potencialin e tij të plotë për thjeshtimin dhe lehtësimin e shkëmbimeve dokumentare për të mirën e bizneseve të vogla e të mesme në veçanti. Prandaj, mirëmbajtja duhet të jetë e detyrueshme në një hap të parë. Rekursi në e-Certis do të bëhet i detyrueshëm në një fazë të mëvonshme.
- (88) Autoritetet kontraktore duhet të jenë në gjendje të kërkojnë që masat e menaxhimit mjedisor ose skemat të zbatohen gjatë ekzekutimit të një kontrate publike. Skemat e menaxhimit të mjedisit, nëse janë apo jo të regjistruara nën instrumentet e BE, të tilla si Rregullorja (KE) Nr 1221/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (15), mund të tregojnë se operatori ekonomik ka aftësitë teknike për të realizuar kontratën. Kjo përfshihet te certifika Ecolabel që përmban kriteret e menaxhimit të mjedisit. Kur një

operator ekonomik nuk ka akses në këto skema të regjistrimit të menaxhimit të mjedisit ose mundësi për sigurimin e tyre brenda afateve të caktuara, ai duhet të lejohet të paraqesë një përshkrim të masave të menaxhimit të mjedisit të realizuara, me kusht që operatori ekonomik në fjalë tregon se këto masa sigurojnë të njëjtin nivel të mbrojtjes së mjedisit si masat e kërkuara nën menaxhimin e mjedisit.

- (89) Nocioni i kriterëve për lidhjen e kontratës është në thelb të kësaj Direktive. Prandaj është e rëndësishme që dispozitat përkatëse të paraqiten në një mënyrë aq të thjeshtë dhe të efektshme sa të jetë e mundur. Kjo mund të arrihet duke përdorur terminologjinë 'oferta ekoekonomike më e favorshme' si koncept thelbësor, pasi që të gjitha ofertat fituese duhet përfundimisht të zgjidhet në përputhje me atë që autoriteti kontraktor e konsideron të jetë zgjidhja më e mirë ekonomike midis atyre të ofruara. Për të shmangur konfuzionin me kriterin çmimit që është i njohur deri tani si "oferta ekonomike më e favorshme" në Direktivat 2004/17 / EC dhe 2004/18 / EC, një terminologji e ndryshme duhet të përdoret për të mbuluar këtë koncept," çmimit e më të mirë në raport me cilësinë '. Rrjedhimisht, duhet të interpretohet në përputhje me jurisprudencën e atyre Direktivave, përveç në rastet kur ka një zgjidhje të qartë materialisht të ndryshme në këtë Direktivë.
- (90) Kontratat duhet të lidhen në bazë të kriterëve objektive që sigurojnë pajtueshmërinë me parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, me qëllim që të sigurohet një krahasim objektiv i vlerës relative të ofertave, në mënyrë që të përcaktohet, në kushtet e konkurrencës efektive, se cila ofertë është ekonomike më e favorshme. Duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë se oferta ekonomike më e favorshme, duhet të vlerësohet mbi bazë e raportit çmim-cilësi, e cila gjithmonë duhet të përfshijë një çmim ose element të kostos. Në mënyrë të barabartë të duhet sqarohet se vlerësimi i tillë i ofertës ekonomike më të favorshme gjithashtu mund të kryhet në bazë të çmimit ose efektivitetit të kostos vetëm. Është tepër e nevojshme për të kujtuar se autoritetet kontraktore janë të lira për të vendosur standardet e duhura të cilësisë duke përdorur specifikimet teknike ose kushtet e ekzekutimit të kontratës.

Në mënyrë që të inkurajohet një orientim më i madh i cilësisë së prokurimit publik, Shtetet Anëtare duhet të ndalojnë ose kufizojnë përdorimin e çmimit

vetëm ose koston vetëm, në vlerësimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, kur ata e konsiderojnë se kjo është e përshtatshme.

Për të siguruar përputhjen me parimin e trajtimit të barabartë në lidhjen e kontratave, autoritetet kontraktore janë të detyruar të krijojnë transparencën e nevojshme për tu mundësuar të gjithë ofertuesve të informohen në mënyrë të arsyeshme për kriteret dhe marrëveshjet të cilat do të aplikohen në vendimin për lidhjen e kontratës. Prandaj, autoritetet kontraktore janë të detyruar për të treguar kriteret e lidhjes së kontratës dhe peshën relative të dhënë secilit prej këtyre kriterëve. Autoritetet kontraktore megjithatë, lejohen që të shmangen nga detyrimi për të treguar peshën e kriterëve në raste të justifikuara siç duhet, për të cilat ata duhet të jenë në gjendje të japin arsyet, kur koeficienti i peshës nuk mund të përcaktohet paraprakisht, në mënyrë të veçantë për shkak të kompleksitetit të kontratës. Në raste të tilla, ato duhet të tregojnë në rend zbritës kriteret me rëndësi.

- (91) Neni 11 i TFEU kërkon që kërkesat për mbrojtjen e mjedisit të integrohen në përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve të BE, në veçanti me synimin promovimin e një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo Direktivë sqaron se si autoritetet kontraktore mund të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, duke siguruar që ata mund të marrin vlerën më të mirë për paratë nga kontratat e tyre.
- (92) Gjatë vlerësimit të raportit çmim-cilësi, autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë kriteret ekonomike dhe cilësore të lidhura me objektin e kontratës që ata do të përdorin për këtë qëllim. Këto kriteret duhet kështu të lejojnë për një vlerësim krahasues të nivelit të performancës së ofruar nga çdo ofertues objektin e kontratës, siç përcaktohet në specifikimet teknike. Në kontekstin e raportit më të mirë çmim-cilësi, një listë jo shteruese e kriterëve të mundshme të lidhjes së kontratës të cilat përfshijnë aspektet mjedisore dhe sociale, është e përcaktuar në këtë Direktivë. Autoritetet kontraktore duhet të inkurajohen që të zgjedhin kriteret e lidhjes së kontratës që mundësojnë ata për të marrë punë me cilësi të lartë, mallra dhe shërbimet që janë të përshtatshme me nevojat e tyre.

Kriteret i zgjedhur nuk duhet të japë një liri të pakufizuar për të zgjedhur autoritetit kontraktor dhe ata duhet të sigurojnë mundësinë e konkurrencës

efektive dhe të drejtë, si dhe të shoqërohen nga organizime që lejojnë që informacioni i ofruar nga ofertuesit të verifikohet në mënyrë efektive.

Për të identifikuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, vendimi për lidhjen e kontratës nuk duhet të bazohet në kriterin vetëm kosto. Prandaj, kriteret cilësore duhet të shoqërohen nga një kriter i kosto që në zgjedhjen e autoritetit kontraktor, mund të jetë ose çmimi ose një qasje efektive në kosto, të tilla si kostoja e ciklit të jetëgjatësisë. Megjithatë, kriteret e lidhjes së kontratës nuk duhet të ndikojë në zbatimin e dispozitave kombëtare që përcaktojnë shpërblimin e shërbimeve të caktuara ose që përcaktojnë çmimet fikse për mallra të caktuara.

- (93) Në rastet kur aplikimi i dispozitave kombëtare përcakton, shpërblimin e këtyre shërbimeve ose vendosjen e një cmimi fiks për disa lloje të caktuara furnizimesh, duhet të saktësohet që është e mundur të vlerësohet raporti cilësi/cmim në bazë të faktorëve të ndryshëm nga cmimi ose shpërblimi. Në varësi të shërbimit ose të produktit, për të cilin jemi të interesuar, të tillë faktorë mund të përfshijnë, për shembull kushtet e dorëzimit ose të pagesës, aspekte ligjore të shërbimit të periudhës pas shitjes (për shembull përdorimi i shërbimeve të konsulencës ose të zëvendësimit) ose aspekte mjedisore apo sociale (për shembull nëse librat janë stampuar me letër të ricikluar apo me letër prej druri të qëndrueshëm, shpenzimet mjedisore të ndotjes së jashtme apo integrimin social të personave të pafavorizuar ose anëtarët të grupeve vulnerabël midis personave që kanë për detyrë realizimin e kontratës). Duke parë mundësitë e shumta për vlerësimin e raportit cilësi/cmim mbi bazën e kriterëve thelbësore, duhet të evitohet përdorimi i shortit si i vetmi mjet për vlerësimin e kontratës.
- (94) Në rastet kur cilësia e stafit të punësuar ndikon në nivelin e performancës së kontratës, autoritetet kontraktore duhet të lejohen të përdorin si kriter fitues organizimin, kualifikimin, eksperiencën e stafit që ka për detyrë të realizojë kontratën në fjalë, meqënëse kjo mund të ndikojë në cilësinë e realizimit të kontratës dhe si pasojë në vlerësimin ekonomik të ofertës. Ky mund të jetë rasti, si për shembull, në kontratat për shërbimet intelektuale si shërbimet e konsulencës ose të arkitekturës. Autoritetet kontraktore që përdorin këtë mundësi duhet të garantojnë, me kushte kontraktuale të përshtatshme, që stafi përgjegjës për realizimin e kontratës të përmbush efektivisht standardet

cilësore të specifikuara dhe se ky staf mund të zëvendësohet vetëm me miratimin e autoritetit kontraktor, i cili verifikon që stafi zëvendësues ka të njëjtin nivel të cilësisë.

- (95) Një rëndësi thelbësore është shfrytëzimi plotësisht i potencialit të prokurimit publik për arritjen e objektivave e strategjisë Europa 2020 për një zgjerim inteligjent, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Në këtë kontekst, duhet të rikujtohet se prokurimet publike janë thelbësore për promovimin e inovacionit, që ka rëndësi parësore për zgjerimin e Europës në të ardhmen. Duke patur parasysh diferencat e rëndësishme midis sektorëve individual dhe tregjeve, nuk është akoma e përshtatshme të fiksohen kërkesa të përgjithshme detyruese për prokurimet në fushën mjedisore, sociale dhe të inovacionit.

Ligjvënësi i BE ka përcaktuar kërkesat detyruese për prokurimet, për arritjen e qëllimeve specifike në sektorin e mjeteve të transportit rrugor (direktiva 2009/33/CE e Parlamentit

Europian dhe e Këshillit(1) dhe e pajisjeve për zyrat (rregullorja (CE) nr.106/2008 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit (2). Gjithashtu, përkufizimi i metodologjive të përbashkëta për llogaritjet e kostove të ciklit jetësor, ka arritur progres të madh.

Për këtë arsye duket e përshtatshme të vazhdohet në këtë rrugë, duke e lënë në dorë të legjislacionit specifik, të përcaktojë objektivat dhe qëllimet e detyrueshme në funksion të politikave dhe kushteve të vecanta, të përhapura në sektorin përkatës dhe të promovojë zhvillimin dhe përdorimin e përqsjes Europiane për llogaritjet e kostove të ciklit jetësor në mënyrë që të favorizohet akoma edhe më shumë përdorimi i prokurimeve publike në mbështetje të zgjerimit të qëndrueshëm.

- (96) Masa të tilla specifike në sektorë të caktuar, duhet të integrohen në përshtatje të direktivave 2004/17/CE dhe 2004/18/CE, që lejon autoritetet kontraktore të ndjekin objektivat e strategjisë Europa 2020 për një zgjerim inteligjent, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në strategjitë e tyre të blerjeve. Duhet, për këtë arsye, të sqarohet se, përvec rastit ku vlerësimi është bazuar vetëm të cmimi, autoritetet kontraktore mund të përcaktojnë ofertën ekonomikisht më të mirë dhe koston më të ulët duke përdorur një

qasje të bazuar në kostot e ciklit jetësor. Koncepti i kostos së ciklit jetësor nënkupton të gjithë kostot që dalin gjatë ciklit jetësor të punonjësve, të furnizimeve dhe të shërbimeve.

Koncepti i mësipërm përfshin kostot e brendshme, si kërkesat që duhet të realizohen; zhvillimin; prodhimin; transportin; përdorimin dhe mirëmbajtjen dhe kostot e asgjësimit final, por mund dhe të përfshijë kosto mjedisore të ndotjeve të jashtme, sic është ndotja e shkatuar nga nxjerrja e lëndëve të para të përdorura në produkt ose shkaktuar nga vet produkti ose nga fabrikimi i tij, me kusht që të jenë të vlerësueshëm në para dhe të kontrolluar. Metodatat e përdorura nga autoritetet kontraktuese për të vlerësuar kostot mjedisore të ndotjeve të jashtme duhet të jenë përcaktuar më parë në mënyrë objektive dhe jo-diskriminuese dhe të jenë të aksesueshme për të gjithë palët e interesuara. Metoda të tilla mund të përcaktohen në nivel kombëtar, rajonal ose lokal, por për të shmangur shtrembërime të konkurrencës me anë të metodologjive ad hoc, duhet të mbeten të përgjithshme në sensin që nuk duhet të përcaktohen në mënyrë specifike për një procedurë të vecantë prokurimi.

Është e nevojshme të përpunohen metodologji të përbashkëta në nivel të BE për llogarjen e kostove të ciklit jetësor për kategori specifike të furnizimeve dhe shërbimeve. Në rast kur këto metodologji të përbashkëta zhvillohen, përdorimi i tyre duhet të bëhet i detyrueshëm.

Duhet gjithashtu të shqyrtohet mundësia e krijimit të një metodologjie të përbashkët për përcaktimin e kostove sociale në ciklin jetësor, duke patur parasysh metodologjitë ekzistuese, sic janë orientimet për analizën sociale të ciklit jetësor të produkteve të miratuara në kuadër të programit të Kombeve të Bashkuara për mjedisin.

(97) Gjithashtu, me qëllim të integritit më të mirë të kushteve sociale dhe mjedisore në procedurat e prokurimit, autoritetet kontraktore duhet të kenë të drejtë të përdorin kriteret vlerësimi ose kushte të ekzekutimit të kontratës në lidhje me punë, furnizime apo shërbime, objekt të prokurimit publik:

(1) Direktiva 2009/33/CE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, në 23 prill 2009, mbi promovimin e mjeteve të pastra dhe me konsum të ulët energjistik të transportit rrugor (GU L 120 e 15.05.2009, faqe 5)

- (2) Rregullorja (CE) nr. 106/2008 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, në 15 janar 2008, në një program komunitar të etiketimit në lidhje me përdorimin eficient e energjisë për aparaturat e zyrës (GU L 39 e 13.02.2008. faqe 1)

Mund të përdorin kriteret e mësipërme duke shqyrtuar cdo aspekt dhe në cdo fazë ciklet të tyre jetësore; nga nxjerrja e lëndëve të para për produktin deri në fazën e asgjësimit; përfshirë faktorët gjatë procesit specifik të prodhimit; performancës ose tregtimit dhe në varësi të kushteve të këtyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve ose në një proces specifik përgjatë një fazë të mëtejshme të ciklit të tyre jetësor, dhe pse këta faktorë nuk janë pjesë të përbërjes së tij thelbësore. Kriteret ose kushtet që lidhen me këto procese prodhimi ose furnizimi mund të konsistojnë në faktin që prodhimi i produkteve të blera nuk përfshin përdorimin e substancave kimike toksike ose që shërbimet të realizohen duke përdorur makineri efektive nga pikëpamja energjitike. Në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të BE, në kriteret e mësipërme përfshihen edhe kriteret e vlerësimit ose kushtet e ekzekutimit të kontratës të lidhura me furnizimin ose përdorimin e produkteve të tregtisë së lirë gjatë ekzekutimit të kontratës që vlerësohet. Kriteret dhe kushtet e lidhura me tregtimin dhe kushteve e këtij tregtimi mund, për shembull të referohen prejardhjes së produktit nga tregjet e lira, që përfshin detyrimin e pagimit të cmimit minimal dhe rritjen e cmimit nga prodhuesit. Kushtet e ekzekutimit të kontratës bazuar në konsideratat mjedisore mund të përfshijnë, për shembull paketimin, furnizimin ose asgjësimin e produkteve, dhe përsa i përket prokurimeve të punëve dhe shërbimeve, zvogëlimi në minimum të mbetjeve ose përdorimin me efikasë të burimeve.

Megjithatë, kushti i lidhjes me objektin e prokurimit përjashton kriteret ose kushte që kanë të bëjnë me politikën e përgjithshme të ndërmarrjes, e cila nuk mund të konsiderohet si një faktor që karakterizon procesin specifik të prodhimit ose furnizimit të punëve, të furnizimeve ose të shërbimeve objekt të blerjes. Autoriteteve kontraktore nuk duhet t'u lejohet të detyrojnë ofertuesit të kenë një politikë të caktuar të përgjegjësisë sociale apo mjedisore të ndërmarrjes.

- (98) Thelbësore është që kriteret e vlerësimit dhe kushtet e ekzekutimit të kontratës, që lidhen me aspektet sociale në procesin e prodhimit, të kenë

lidhje me punët, furnizimet dhe shërbimet objekt prokurimi. Kriteret duhet gjithashtu të aplikohen në përputhje me direktivën 96/71/CE, e cila është interpretuar nga Gjykata e Drejtësisë të BE, dhe nuk duhet të aplikohen që të diskriminojnë në mënyrë direkte ose indirekte operatorët ekonomik të shteteve të tjera anëtare ose të shteteve të treta që janë pjesë e GPA ose e marrëveshjeve të tregëtisë së lirë ku BE është anëtare. Kërkesat në lidhje me kushtet minimale të punës të rregulluara nga direktiva 96/71/CE, sipas së cilës niveli i pagave më ultra, duhet të jenë në nivelin e përcaktuar nga legjislacioni kombëtar ose nga kontratat kolektive të aplikuara në përputhje me të legjislacionin e BE, në kontekstin e kësaj direktive. Kushtet e ekzekutimit të kontratës mund të kenë si qëllim favorizimin e implementimit të masave për promovimin e barazisë midis femrave dhe meshkujve në punë, rritjen e pjesëmarrjes së femrave në tregun e punës dhe barazpeshimit të punës me jetën private, mbrojtjen e mjedisit ose mirëqënies së kafshëve dhe të zbatohen në thelb dispozitat e konventave themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe të punësohen më shumë njerëz në nevojë se sa parashikohet nga legjislacionet kombëtare.

- (99) Mund të jenë objekt të kriterëve të vlerësimit ose të kushteve të ekzekutimit të kontratës dhe masat që kanë si qëllim mbrojtjen e shëndetit të stafit të përfshirë në proceset e prodhimit, promovimin e integritit të personave të pafavorizuar ose të pjesëtarëve të

grupeve në nevojë në stafin e ngarkuar të ekzekutojë kontratën ose në trajnimin për aftësitë e kërkuara për kontratën në fjalë, me kusht që lidhen me punët, furnizimet apo shërbimet objekt prokurimi. Për shembull të tilla kriterë ose kushte mund të kenë të bëjnë me punësimin e personave të papunësuar për një kohë të gjatë, implementimin e masave për trajnimin e të papunëve ose të rinjve përgjatë realizimit të kontratës që vlerësohet. Në specifikimet teknike, autoritetet kontraktuese mund të parashirojnë kërkesa sociale që karakterizojnë drejtpërdrejt produktin ose shërbimin në fjalë, si aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose programimi për të gjithë përdoruesit.

- (100) Prokurimet publike nuk duhet të fitohen nga operatorë ekonomik që marrin pjesë në një organizatë kriminale ose që janë shpallur fajtorë për korrupsion, mashtrim në dëm të interesave financiare të BE, akte terroriste, pastrimin e

parave të pista që vijnë nga aktivitete të paligjshme ose financimi i terrorizmit. Mospagimi i taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore duhet të cojë në përjashtimin e detyrueshëm në nivel të BE. Shtetet anëtare gjithsesi, duhet të parashikojnë një derogim për këto përjashtime të detyrueshme, në situata të jashtëzakonshme kur kërkesa themelore të interesit të përgjithshëm e bëjnë të domosdoshëm vlerësimin e kontratës. Ky mund të jetë rasti, për shembull kur nevoja urgjente për vakcina ose pajisjet e emergjencës mund të blihen vetëm nga një operator ekonomik, për të cilin në rast të kundërt do të ishte aplikuar një nga arsyet e përjashtimit të detyrueshëm.

- (101) Autoritetet kontraktore duhet të kenë mundësinë të përjashtojnë operatorë ekonomik që janë treguar të pabesueshëm, për shembull për shkak të shkeljes së detyrimeve mjedisore apo sociale, përfshirë normat ligjore në fushën e aksesit të personave me aftësi të kufizuar, ose lloje të tjera të shkeljeve të rënda të detyrave profesionale sic mund të jenë shkeljet normave ligjore në fushën e konkurrencës ose të drejtat e pronësisë intelektuale. Është e nevojshme të sqarohet se një shkelje e rëndë e detyrave profesionale mund të vë në diskutim integritetin e operatorit ekonomik dhe si pasojë e bën këtë të fundit të papërshtatshëm të fitojë një prokurim publik, pavarësisht faktit se ka kapacitetet e tjera teknike dhe ekonomike për të realizuar kontratën.

Duke patur parasysh që autoriteti kontraktor do të jetë përgjegjës për pasojat, në rast të marrjes së një vendimi të gabuar, autoritetet kontraktore kanë të drejtën të konsiderojnë që ka patur shkelje të rënda profesionale, përpara marrjes së vendimit përfundimtar dhe detyruet që përcakton praninë e arsyeve të përjashtimit të detyruar. Ata duhet të vërtetojnë me cdo mjet të mundshëm që operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij, përfshirë detyrimet e lidhura me pagimin e taksave apo sigurimin e kontributeve shoqërore, përvec rastit kur thuhet ndryshe në dispozitat e ligjit kombëtar. Gjithashtu, ata mund të përjashtojnë kandidatë ose operatorë ekonomik, të cilët në prokurimet e mëparshme publike kanë shfaqur mangësi të mëdha në lidhje me detyrat themelore, për shembull mosfurnizimin ose mosrealizimin, mangësi thelbësore të produktit ose shërbim i ofruar në mënyrë që bëhet i papërdorshëm për qëllimin e parashikuar ose sjellje të pandershme që shkaktojnë dyshime të mëdha në besueshmërinë e

operatorit ekonomik. Legjislacioni kombëtar duhet të parashikojë një afat maksimal për këto përjashtime.

- (102) Megjithatë, duhet që operatorëve ekonomik t'iu jepet mundësia që të marrin masa për të siguruar respektimin e detyrave me qëllim rregullimin e pasojave të krimeve apo shkeljeve dhe të ndalojnë efektivisht që sjellje të tilla të pandershme të rishfaqen përsëri. Masa të tilla mund të konsiderohen, në vecanti, masa në lidhje me personelin dhe organizimin, sic është shkëputja e raporteve me njerëz dhe organizata të përfshira në sjellje të pandershme, masa të përshtatshme për riorganizimin e stafit, implementimin e sistemeve të raportimit dhe kontrollit, krijimin e një strukture të auditit të brendshëm për të monitoruar pajtueshmërinë dhe miratimin e rregullave të brendshme për përgjegjësinë dhe shpërblimin e dëmit. Kur masa të tilla ofrojnë garanci të mjaftueshme, operatori ekonomik në fjalë nuk duhet të përjashtohet bazuar vetëm mbi bazën e atyre arsyeve. Operatorët ekonomik duhet të kenë mundësinë të kërkojnë shqyrtimin e masave të marra për respektimin e detyrave, me qëllim pranimin e mundshëm në procedurat e prokurimit publik. Megjithatë duhet të lihet në dorë të shteteve anëtare të përcaktojnë në mënyrë të saktë kushtet procedurale dhe thelbësore, të aplikueshme në secilin rast. Ato duhet, në vecanti, të jenë të lira të vendosin nëse do lejojnë autoritetin kontraktor të realizojë vlerësimin e përshtatshëm ose një detyrë e tillë të lihet në dorë të autoriteteve në nivel qëndror ose të decentralizuara.
- (103) Ofertat që duken jashtëzakonisht shume të ulta në lidhje me punën, furnizimin apo shërbimin, mund të bazohen në vlerësime apo praktika të gabuara nga ana teknike, ekonomike apo ligjore. Kur ofertuesi nuk mund të jap shpjegime të mjaftueshme, autoriteti kontraktor ka të drejtën e refuzimit të ofertës. Refuzimi duhet të jetë i detyrueshëm në rastet kur autoriteti kontraktor ka përcaktuar se kostot jashtëzakonisht shumë të ulta të propozuara, rezultojnë se nuk janë në përputhje me legjislacionin detyrues të BE ose legjislacionin kombëtar, në fushën sociale, të punës, legjislacionit mjedisor ose në dispozitat ndërkombëtare e së drejtës së punës.
- (104) Kushtet e realizimit të kontratës kanë si qëllim përcaktimin e kërkesave specifike në lidhje me realizimin e kontratës. Ndryshe nga kriteret e vlerësimit të kontratës të cilat janë themelore në vlerësimin krahasues për cilësinë e ofertave, kushtet e realizimit të kontratës janë kërkesa objektive të

paracaktuara që nuk ndikojnë në vlerësimin e ofertave. Kushtet e realizimit të kontratës duhet të jenë në përputhje me këtë direktivë dhe që ato nuk duhet të jenë diskriminuese në mënyrë direkte apo indirekte dhe të jenë të lidhura me objektin e kontratës, që nënkupton të gjithë faktorët e përfshirë në procesin specifik të prodhimit, furnizimit apo tregtimit. Kjo përfshin kushte që lidhen me procesin e realizimit të kontratës, por përjashton kërkesat në lidhje me politikën e përgjithshme të ndërmarrjes.

Kushtet e ekzekutimit të kontratës duhet të jenë përcaktuar në njoftimin për tender, në njoftimin e informacionit paraprak që ka si qëllim thirrjen për pjesëmarrje në tender ose në dokumentat e tenderit.

- (105) Është e rëndësishme që mbikëqyrja e nënkontraktorëve për detyrimet që aplikohen në fushën e së drejtës mjedisore, sociale dhe të punës, të vendosura këto nga ligjet e BE, ligjet kombëtar, kontratat kolektive ose nga dispozitat ndërkombëtare fushën e së drejtës mjedisore, sociale dhe të punës të listuara në këtë direktivë, me kusht që aplikimi i tyre të jetë në përputhje me legjislacionin e BE, të garantohet nëpërmjet veprimeve të përshtatshme nga autoritetet kombëtare kompetente, brenda limiteve të detyrave dhe mandatit të tyre, sic mund të jenë inspektoriat i punës apo agjencitë e mbrojtjes së mjedisit.

Gjithashtu është e nevojshme të sigurohet një farë transparence në vargun e nënkontraktorëve, në mënyrë që t'i japet informacion autoriteteve kontraktore, se kush ndodhet në kantieret e ndërtimit, në të cilat po realizohen punët për llogari të tyre ose cilat ndërmarrje sigurojnë shërbimet në këto ndërtesa apo infrastruktura, si për shembull bashki, shkolla, terrene sportive, porte apo autostrada, për të cilat autoritetet kontraktore janë përgjegjëse ose mbi të cilat ushtrojnë kontroll direkt. Duhet të sqarohet se detyrimin për të dhënë informacionin e kërkuar, bie mbi kontraktuesin kryesor, në bazë të klauzolave themelore apo specifike që cdo autoritet kontraktor përfshin në procedurat e prokurimit, ose në bazë të detyrimeve që cdo shtet anëtar mund të ketë vendosur mbi kontraktuesin në fjalë, nëpërmjet aplikimit të dispozitave të përgjithshme.

Gjithashtu duhet të sqarohet se kushtet që lidhen me kontrollin dhe respektimin e detyrimeve në fushën e legjislacionit mjedisor, social apo të

punës, i vendosur ky nga ligjet e BE, ligjet kombëtare, kontratat kolektive ose nga dispozitat ndërkombëtare fushën e së drejtës mjedisore, sociale dhe të punës të listuara në këtë direktivë, me kusht që aplikimi i tyre të jetë në përputhje me legjislacionin e BE, duhet të aplikohen në rast kur e drejta e brendshme e një shteti anëtar, parashikon një mekanizëm të përgjegjësishë të përbashkët midis të nënkontraktuarve dhe të kontraktuarit kryesor. Njëkohësisht duhet të jetë përcaktuar qartë që shtetet anëtare duhet të kenë mundësinë të vendosin kushte më të rrepta, me qëllim zgjerimin e detyrimeve të transparencës, duke bërë të mundur pagimin direkt të nënkontraktorëve ose duke lejuar që autoritetet kontraktore të verifikojnë që nënkontraktorët nuk ndodhen në asnjë nga situatat që do të justifikonte përjashtimin e operatorit ekonomik. Për aplikimin e këtyre masave ndaj nënkontraktorëve, është e nevojshme që ata të jenë në koherencë me dispozitat e aplikuara ndaj të kontraktuarve kryesor, duhet të sigurohet ekzistenca e arsyeve për përjashtimin e detyrueshëm dhe të ndiqet nga një kërkesë ku i kontraktuari kryesor të kërkojë zëvendësimin e të nënkontraktuarit në fjalë. Në rastet kur rezulton prezenca e arsyeve jo të detyrueshme të përjashtimit, duhet të përcaktohet se autoritetet kontraktore mund të kërkojnë zëvendësimin. Gjithashtu duhet të përcaktohet qartë se autoritetet kontraktore mund të jenë të detyruara të kërkojnë zëvendësimin e nënkontraktorit në rastet kur përjashtimi i të kontraktuarit kryesor është e detyrueshme.

Njëkohësisht duhet të përcaktohet qartë që shtetet anëtare, do të jenë të lirë të vendosin dispozita të brendshme më të rrepta në fushën e përgjegjësishë ose dispozita shtesë në fushën e pagesave direkte të nënkontraktuarve.

- (106) Duhet të theksohet se rregullorja e Këshillit (EEC,Euroatom) nr. 1182/71 (3) aplikohet për llogaritjen e afateve kohore të shprehura në këtë direktivë.
- (107) Është e nevojshme të sqarohen, bazuar kjo në praktikën gjyqësore të Gjykatës të drejtësisë Europiane, kushtet në të cilat modifikimi i një kontrate gjatë ekzekutimit, kërkon realizimin e një procedurë të re prokurimi. Procedura e re e prokurimit është e nevojshme në rastet kur janë bërë ndryshime thelbësore të kontratës fillestare, në vecanti në fushën e zbatimit dhe përmbajtjes së të drejtave dhe detyrave reciproke të palëve, duke përfshirë shpërndarjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Modifikimet e kontratës, në të cilat përfshihen modifikimet e vogla, deri në një masë të caktuar, të vlerës së kontratës duhet të bëhen pa patur nevojë të realizohet një procedurë e re prokurimi. Me qëllim që të garantohet siguria juridike, Rregullorja e Këshillit (EEC, Euroatom) nr. 1182/71 e 3 korrik 1971 që përcakton rregullat e aplikueshme për afatet, datat dhe limitet (GU L 124 08.06.1971 faqe 1) duhet të parashikojë prag minimal, nën limitin e të cilit nuk është e nevojshme kryerja e një procedure të re prokurimi. Modifikimet e kontratës që janë mbi këtë prag minimal, mund të bëhen pa qenë e nevojshme kryerja e një procedure të re prokurimi, në masën kur këto modifikime përmbushin kushtet thelbësore të parashikuara në këtë direktivë.

- (108) Autoritetet kontraktore mund të ndodhen para situatave, në të cilat janë të nevojshme punë, furnizime apo shërbime shtesë; në raste të tilla mund të justifikohet një modifikim i kontratës fillestare, pa patur nevojë realizimin e një procedure prokurimi tjetër, vecanërisht kur si qëllim i dërgesave plotësuese është një zëvendësim i pjesëshëm ose një zgjerim të shërbimeve, furnizimeve ose pajisjeve ekzistuese, kur ndryshimi i furnizuesit detyron autoritetin kontraktues të blejë materiale, punë ose shërbime me karakteristika të ndryshme teknike, e cila sjellë si pasojë mospërputhshmërinë dhe vështirësi teknike disproporcionale në përdorim dhe mirëmbajtje.
- (109) Autoritetet kontraktore mund të përballen me rrethana të jashtme, që nuk mund të parashikoheshin në momentin e caktimit të kontratës fituese, vecanërisht kur realizimi i kontratës kërkon një periudhë të gjatë kohe. Në këtë rast është e nevojshme një farë fleksibiliteti për të përshtatur kontratën në këto rrethana, pa realizuar një procedurë të re prokurimi. Koncepti i rrethanave të paparashikuara i referohet rrethanave që nuk mund të parashikoheshin pavarësisht nga përgatitja e arsyeshme dhe e kujdeshme të vlerësimit fillestar nga autoritetet kontraktuale, duke patur parasysh mjetet në dispozicion, natyrën dhe karakteristikat e projektit specifik, praktikën e mira të fushës në fjalë dhe e nevojës për të garantuar një raport të përshtatshëm midis burimeve të investuara në përgatitjen e vlerësimit dhe vlerësimit të parashikuar. Gjithësesi, kjo s' mund të aplikohet në rastet kur një modifikim sjellë si pasojë ndryshimin e përgjithshëm të natyrës së kontratës, për shembull duke zëvendësuar punët, furnizimet apo shërbimet objekt kontrate me dicka tjetër të ndryshme, apo që të sjellë një ndryshim thelbësor

të tipit të kontratës aq sa në një situatë të atij lloji mund të mendohet se ka patur ndikim në dhënien e rezultatit.

- (110) Në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës, kontraktuesi i suksesshëm nuk duhet, për shembull kur kontrata ka përfunduar për shkak të mangësive gjatë realizimit, të zëvendësohet nga një operator tjetër ekonomik, pa rihapur procedurat e fitimit të kontratës, për operatorët e tjerë konkurrentë. Gjithësesi, në rastet kur kontraktuesi i suksesshëm duhet që në realizimin e kontratës, në vecanti kur kontrata i është dhënë më shumë se një ndërmarrjeje, të bëj disa ndryshime strukturore gjatë realizimit të kontratës, sic mund të jetë rasti i një riorganizimi të brendshëm, përthithjen, shkrirjen, blerjen apo falimentimin. Këto ndryshime strukturore nuk duhet të kërkojnë automatikisht procedurë të re prokurimi për të gjitha kontratat publike të realizuara nga ky ofertues.
- (111) Në lidhje me kontratat individuale, autoritetet kontraktuese duhet të kenë mundësinë të parashikojnë modifikime nëpërmjet klauzolave të rishikimit ose alternative, duke mos patur diskrecion të palimituar. Kjo direktivë duhet të përcaktojë se deri në çfarë mase mund të parashikohen modifikimet në kontratën fillestare. Duhet të sqarohet se klauzola të rishikimit apo alternative, të formuluar qartë, mund të parashikojnë për shembull indekset e cmimeve apo të garantojnë për shembull, që pajisjet e komunikimit të furnizohen përgjatë një periudhe të caktuar kohe, të jenë të përshtatshme dhe në rastet e modifikimit të protokollit të komunikacionit apo të modifikimeve të tjera teknologjike. Gjithsashtu duhet të jetë e mundur që, nëpërmjet klauzolave mjaftueshmërisht të qarta, të parashikohen përshtatje të kontratës, të cilat janë të nevojshme gjatë vështirësive teknike që mund të ndodhin gjatë procesit të funksionimit apo mirëmbajtjes. Duhet të rikujtohet që kontratat, për shembull, përfshijnë si mirëmbajtjen e përditshme por dhe mirëmbajtje të jashtëzakonshme që mund të jetë e nevojshme për të garantuar vazhdimsinë e një shërbimi publik.
- (112) Autoritetet kontraktore ndodhen shpesh herë në situata që kërkojnë zgjidhjen para kohe të kontratës publike, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që lindin nga legjislacioni i BE në fushën e prokurimit publik. Shtetet anëtare duhet të garantojnë që autoritetet kontraktuale të kenë mundësinë, sipas kushteve të përcaktuara në ligjin kombëtar, të zgjidhin një

kontratë publike, para skadimit të afatit, për shkak të kërkesave të legjislacionit të BE.

- (113) Rezultatet e dokumentave të punës së Komisionit e datës 27 qershor 2011, me titull “Raport Vlerësimi: Impakti dhe efektiviteti i legjislacionit të BE për prokurimin publik” sugjeronte se duhet të rishikohet përjashtimi i të tilla shërbimeve nga aplikimi i plotë i direktivës 2004/18/EC. Si pasojë, aplikimi i plotë i kësaj direktive duhet të shtrihet mbi këto shërbime.
- (114) Disa kategori shërbimesh, për shkak të natyrës së tyre, kanë një limit ndërkufitar të kufizuar, të tillë janë shërbimet ndaj individit, si ato sociale, shëndetësore dhe edukuese. Këto shërbime sigurohen në përputhje me një kontekst të caktuar që ndryshon shumë nga një shtet anëtar në një tjetër, për shkak të traditave të ndryshme kulturore. Pra duhet të vendoset një regjim specifik për kontratat publike që kanë për objekt këto shërbime, me një prag më të madh sesa ai i aplikuar për shërbimet e tjera.

Shërbimet ndaj individit me vlera nën këtë prag, në përgjithësi, nuk do të përbëjnë asnjë interes për ofruesit nga shtetet e tjera anëtare, po të mos ketë tregues konkret që vertetojnë të kundërtën, si për shembull financimin nga BE për projektet jashtë-kufitare.

Kontratat për shërbimet ndaj individit, me vlerë mbi këtë prag, duhet të karakterizohen nga transparenca, në përputhje me parashikimet e nivelit evropian. Si pasojë e rëndësisë të kontekstit kultural dhe ndjeshmërisë për këto shërbime, shteteteve anëtare duhet t’u jepet diskrecion i gjerë që të organizojnë zgjedhjen e ofruesve të shërbimeve, në mënyrën që ata konsiderojnë të përshtatshme. Rregullat e kësaj direktive mbajnë parasysh këtë domosdoshmëri, duke detyruar vetëm respektimin e parimeve themelore të transparencës dhe të trajtimit të barabartë dhe të sigurojnë që autoritete kontraktore janë të afta të aplikojnë kritere cilësore specifike për të zgjedhur ofruesit e shërbimit, si kritere jo të detyrueshme të vendosura nga Kuadri Evropian për Cilësinë e Shërbimeve Sociale, publikuar nga Komiteti i Mbrotjes Sociale. Pas përcaktimit të procedurave që duhet të përdoren, për përzgjedhjen e kontratës fituese për shërbime ndaj individit, shtetet anëtare duhet të mbajnë parasysh artikullin 4 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian dhe Protokollin nr.6. Duke bërë këtë,

shtetet anëtare, njëkohësisht zbatojnë objektivat e thjeshtëzimit dhe zvogëlimit të barrës administrative të autoriteteve kontraktore dhe operatorëve të tjerë ekonomik. Duhet të qartësohet se kjo mund të sjellë dhe përdorimin e normave që aplikohen për kontrata shërbimesh, që s' janë subjekt i këtij regjimi specifik.

Shtetet anëtare dhe autoritetet publike janë të lira të realizojnë vetë të tilla shërbime ose të organizojnë shërbime sociale nëpërmjet mënyrave të tilla, që nuk kërkojnë realizimin e kontratave publike, për shembull nëpërmjet financimit të thjeshtë të këtyre shërbimeve ose dhënien e licensave apo autorizimeve për të gjithë operatorët ekonomik që përmbushin kushtet e vendosura paraprakisht nga autoriteti kontraktor, pa parashikuar limite apo kuota, me kusht që një sistem i tillë të garantojë një reklamim të mjaftueshëm dhe të respektojë parimet e transparencës dhe mos diskriminimit.

- (115) Në analogji, shërbimet e hotelerisë dhe restoranteve ofrohen zakonisht nga operatorë që janë vendosur në zona specifike për ofrimin e këtyre shërbimeve dhe kanë gjithashtu një shtrirje të kufizuar ndërkufitare. Pra duhet të përfshihen në regjimin e lehtë, me një prag prej 750,000 euro. Kontratat e shërbimeve të hotelerisë e restoranteve që përballojnë këtë prag, mund të jenë me interes për shumë operatorë ekonomik, si agjenci udhëtimi ose ndërmjetës të tjerë, gjithashtu mbi bazë ndërkufitare.
- (116) Në mënyrë të ngjashme, disa shërbime ligjore që lidhen ekskluzivisht me çështje të së drejtës kombëtare dhe janë të ofruar, vetëm nga operatorë të vendosur në shtetin anëtarë në fjalë dhe kanë si pasojë një shtrirje të kufizuar ndërkufitare. Pra, si rezultat, hyjnë vetëm në regjimin e lehtë, me prapun prej 750,000 euro. Kontratat e mëdha të shërbimeve ligjore, që janë mbi këtë prag, janë në interes të shumë operatorëve ekonomik, si firmat ligjore ndërkombëtare, gjithashtu mbi bazë ndërkufitare, në vecanti kur lidhen me çështje ligjore që burojnë nga e drejta e BE ose nga e drejta ndërkombëtare apo çështje juridike në interes të më shumë se një vendi.
- (117) Eksperienca ka treguar se një sërë shërbimesh të tjera, si shërbimet e shpëtimit, e zjarrëfikseve dhe shërbimet në burgje, paraqesin një interes ndërkufitar vetëm kur arrijnë një masë kritike të mjaftueshme të rritjes së

vlërës së tyre. Për derisa këto shërbime nuk janë përjashtuar nga aplikimi i kësaj direktive, ato duhet të përfshihen nën regjimin e lehtë. Deri në masën që realizimet e tyre janë të bazuara në kontrata, kategori të tjera shërbimesh, sic janë shërbimet e administratës apo shërbimet ndaj komunitetit, mund të përbejnë një interes në nivel ndërkufitar, duke u nisur nga pragu 750.000 euro dhe vetëm atëherë mund të jenë subjekt i regjimit të lehtë.

- (118) Me qëllim të sigurohet vazhdimësia e shërbimeve publike, kjo direktivë duhet të lejojë që pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, për disa shërbime në fushën e shërbimeve shëndetësore, sociale dhe kulturore, të lejohen organizata që bazohen në sindikatata të të punësuarve ose pjesëmarrja e tyre aktive në qeverisjen e ndërmarrjeve, dhe për organizatat ekzistuese si kooperativat të marrin pjesë në dhënien e këtyre shërbimeve për përdoruesit final. Aplikimi i kësaj dispozite është i limituar për t'u përdorur ekskluzivisht për disa shërbime shëndetësore, sociale apo shërbime të lidhura me to, disa shërbime edukimi dhe trajnimi, për bibliotekat, arkivat, muzetë dhe shërbime të tjera kulturore, shërbime sportive dhe shërbime shtëpiake dhe nuk lidhet me asnjë nga përjashtimet e parashikuara nga kjo direktivë. Këto shërbime rregullohen nga normat mbi regjimin e lehtë.
- (119) Është e përshtatshme, që këto shërbime të përcaktohen nëpërmjet referimit të pozicionit specifik në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimeve të miratuar me rregulloren (EC) nr. 2195/2002 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit (4), e cila është një nomenklaturë e strukturuar në mënyrë hierarkike, e strukturuar në ndarje, grupe, klasa, kategori dhe nënkategori, 4 rregullorja (EC) nr. 2195/2002 e Parlamentit Europian dhe këshillit e 5 nentor 2002 mbi Fjalorin e Përbashkët për Prokurimet (CPV) (GU L 340, 16.12.2002. faqe 1). Kjo përmbledhje gjithëpërfshirëse duhet specifikisht të përcaktohet nëpërmjet referimit të të gjitha pozicioneve përkatëse, ku është më e përshtatshme në radhën e kodeve.
- (120) Konkursset për projekte janë përdorur zakonisht në fushat e planifikimit territorial, urbanistikë, arkitekturor, inxhenerik ose në përpunimin e të dhënave. Duhet të theksohet gjithashtu se instrumente të tilla fleksibël duhet të përdoren dhe për qëllime të tjera, sic mund të jenë programet për inxhinierinë finaciare që mund të përmirësojë suportin e SME në kuadrin e iniciativës Burime të Përbashkëta për Biznesin e Vogël dhe të Mesëm

(JEREMIE) ose programe të tjera suporti të BE për SME në një shtet të caktuar anëtar. Konkursi i projektimit i përdorur për të realizuar një program të inxhenerisë financiare, mund të përcaktojë se kontratat pasardhëse të shërbimeve për realizimin e kësaj inxhinierie financiare t'i jepen fituesit apo fituesve të konkursit të projektit me një procedurë të negociuar, pa njoftim paraprak.

- (121) Vlerësimi i bërë ka treguar se ka hapësirë për përmirësim në aplikimin e rregullave të BE për prokurimin publik. Që aplikimi i rregullave të jetë më eficient dhe koherent, është e rëndësishme që të kemi një kuadër të qartë të problemeve të mundshme strukturore dhe tendencave të përgjithshme të politikave kombëtare në fushën e prokurimeve, me qëllim që të adresohen problemet e mundshme në mënyrën e synuar. Një kuadër i tillë mund të përfitohet nëpërmjet një monitorimi të përshtatshëm, ku rezultatet duhet të publikohen periodikisht, me qëllim që të realizohet një debat i mirë informuar mbi përmirësimet e mundshme të normave dhe praktikave në fushën e prokurimeve. Përfitimi i një kuadri të qartë mund të jap informacione rreth aplikimit të normave të prokurimeve publike, në kontekstin e projekteve të bashkëfinancuara nga BE. Shtetet anëtare duhet të ruajnë të drejtën të vendosin se si dhe prej kujt duhet të kryhet ky monitorim në praktikë, gjithashtu ato duhet të jenë të lira të vendosin nëse monitorimet duhet të bazohen në një përgjedhje mostrash nga kontrolli aposteriori apo në një kontroll sistematik paraprak të procedurave të prokurimit publik që mbulohen nga kjo direktivë. Duhet të bëhet e mundur sjellja e problemeve të mundshme në vëmendjen e organizmave përbërës; kjo nuk duhet domosdoshmërisht të kërkojë, që ata që kanë kryer monitorimin, të jenë të legjitimuar të vlerësojnë në mënyrë të pavarur në gjykata.

Përmirësimi në dhënien e orientimeve, informacioneve dhe mbështetjes së autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomik, mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në rritje e efikasitetit të prokurimit publik, nëpërmjet njohurive më të mira; rritjen e sigurisë juridike dhe profesionalizmit në praktikën e prokurimit publik. Orientime të tilla duhet të vihen në dispozicion të autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomik sa herë të jetë e nevojshme për të përmirësuar aplikimin e normave. Këto orientime të dhëna, mund të përfshijnë të gjitha fushat në lidhje me prokurimin publik, sic janë planifikimi i blerjeve, procedurat, zgjedhjet e

teknikave dhe instrumentave dhe praktikat e mira, në zhvillimin e procedurave. Në lidhje me çështjet ligjore, orientimi nuk duhet të përbëhet domosdoshmërisht nga një analizë e plotë ligjorë e çështjeve problematike; ai duhet të jetë i limituar në një përcaktim të përgjithshëm të elementëve që duhet të merren në konsideratë për analizën e mëtejshme të detajuar të çështjeve, për shembull referimi tek precedentët që mund të kenë lidhje apo tek shënimet orientuese ose burime të tjera që kanë shqyrtuar çështjen specifike në fjalë.

- (122) Direktiva 89/665/EEC parashikon se për disa procedura rishikimi të ketë akses për ata persona që kanë apo kanë patur interes në fitimin e një kontrate të caktuar dhe kush ka qenë apo rrezikon të dëmtohet si pasojë e shkeljeve të së drejtës së BE në fushën e prokurimit publik apo të së drejtës kombëtare për këtë fushë. Këto procedura rishikimi nuk duhet të ndikohen nga kjo direktivë. Gjithësesi, qytetarët, subjektet e interesuara të organizuar ose jo, dhe persona të tjerë apo organizma që nuk kanë akses në procedurat e apelimit sipas direktivës 89/665/EEC, kanë përsëri një interes të ligjshëm, si taksapagues, në zhvillimin korrekt të procedurave të prokurimit. Pra, ata duhet të kenë mundësinë, në mënyrë të ndryshme nga sistemi i apelimit i parashikuar nga direktiva 89/665/EEC, pa qenë e nevojshme paraqitja e tyre para gjykatës, për të treguar shkelje të mundshme të kësaj direktive, autoriteteve apo strukturave kompetente. Me qëllim të mos krijohen autoritete apo struktura kompetente të dyfishta, shtetet anëtare duhet të parashikojnë procedura apelimi para autoriteteve apo strukturave të kontrollit të përgjithshëm, organeve të mbikëqyrjes sektoriale, autoriteteve të mbikëqyrjes bashkiake, autoritetet e konkurrencës, Avokatit të Popullit apo autoriteteve kombëtare të auditimit.
- (123) Me qëllim që të shfrytëzohet plotësisht potenciali i përkrahjeve publike në arritjen e objektivave të strategjisë Europa 2020 për një zgjerim të inteligjent, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, prokurimet në fushën mjedisore, sociale dhe të inovacionit duhet të bëjnë pjesën e tyre. Pra është e nevojshme të sigurohet një panoramë e zhvillimeve në fushën e prokurimit strategjik, që bën të mundur krijimin e një ideje për tendencën e përgjithshme të këtij sektori, në nivel global. Eventualisht, raporte të përshtatshme të përgatitura më parë, mund të përdoren edhe në këtë kontekst.

- (124) Nisur nga potenciali i SME për krijimin e vendeve të punës, të zhvillimit dhe inovacionit, është e rëndësishme të inkurajohet pjesëmarrja e tyre në prokurimin publik, nëpërmjet dispozitave të përshtatshme në këtë direktivë apo dispozitave kombëtare. Dispozitat e reja të parashikuara në këtë direktivë duhet të kontribuojnë në përmirësimin e nivelit të suksesit, që nënkupton përqindjen e pjesëmarrjes së SME në raport me vlerën totale të kontratave të fituara. Nuk është e përshtatshme të vendosen përqindje detyruese suksesi, iniciativat kombëtare që nxisin pjesëmarrjen e SME, për shkak të rëndësisë së saj, duhet të jenë në monitorim të vazhdueshëm.
- (125) Një sërë procedurash dhe metoda pune janë ngritur në lidhje me komunikimet e Komisionit dhe kontaktet me shtetet anëtare, si komunikimet dhe kontaktet në lidhje me procedurat e parashikuara nga Artikulli 258 dhe 260 TFEU, Rrjeti për Zgjidhjen e Problemeve në Tregun e Brendshëm (SOLVIT) dhe EU Pilot, të cilat nuk modifikohen nga kjo direktivë. Gjithësesi ato duhet të plotësohen nëpërmjet përcaktimit të një pike të vetme referimi, në cdo shtet anëtar, për bashkëpunimin me Komisionin, i cili do të funksionojë si pikënisja e vetme për çështjet që lidhen me prokurimin publik, në shtetin anëtar në fjalë. Ky funksion mund të përmbushet nga persona apo struktura që janë rregullisht në kontakt me Komisionin, për çështje që lidhen me prokurimin publik, si pikat kombëtare të kontaktit, anëtarët e Komitetit Këshillimor për Prokurimin Publik, anëtarët të Rrjetit të Prokurimeve ose organizmat koordinuese kombëtare.
- (126) Transparenca dhe lënia gjurmë në procesin e vendimmarrjes në procedurat e prokurimit është thelbësore për të siguruar procedura të drejta, duke përfshirë luftën efektive ndaj korrupsionit dhe mashtrimit. Autoritetet kontraktore duhet të ruajnë kopje të kontratave të konkluduara, që kanë vlerë të lartë, me qëllim që palët e interesuara të kenë akses në këto dokumenta, në zbatim të rregullave të aplikueshme për aksesin e dokumentacioneve. Për më tepër, elementët thelbësore dhe vendimet e procedurave të vecanta të prokurimit duhet të dokumentohen në një raport prokurimi. Për të shmangur pengesat administrative sa më shumë të jetë e mundur, duhet të lejohet që raporti i prokurimit, të përmbajë informacione të dhëna paraprakisht në njoftimin e kontratës fituese. Sistemi elektronik për publikimin e këtyre njoftimeve, i menaxhuar nga Komisioni, duhet të

përmirësohet duke lehtësuar hyrjen e të dhënave dhe njëkohësisht nxjerrjen e raporteve botërisht apo shkëmbimin e të dhënave midis sistemeve.

- (127) Në interes të thjeshtësimit administrativ dhe zvogëlimit të pengesave në shtetet anëtare, Komisioni duhet të shqyrtojë periodikisht cilësinë dhe plotësinë e informacionit të njoftimeve, të cilat publikohen në lidhje me procedurat e prokurimit, me qëllim që ato të jenë të mjaftueshme dhe t'i lejojnë Komisionit të nxjerrë informacione statistikore, që në të kundërt duhet t'i transmetoheshin shteteve anëtare.
- (128) Një bashkëpunim administrativ efektiv është i domosdoshëm për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për zhvillimin e procedurave të vlerësimit, në situatat ndërkufitare, në vecanti për sa i përket arsyeve të përjashtimit dhe kriterëve të përzgjedhjes, aplikimin e standarteve cilësore dhe mjedisore dhe të listës të aprovuar të operatorëve ekonomik. Shkëmbimi i informacionit bazohet në ligjet kombëtare mbi konfidencialitetin. Kjo direktivë nuk parashikon asnjë detyrim për shtetet anëtare, të shkëmbejnë informacion që shkon përtej aksesit të autoriteteve kontraktore kombëtare. Sistemi i Informimit të Tregut të Brendshëm (IMI) miratuar me rregulloren nr. 1024/2012 të Parlamentit Europian dhe Këshillit (5) mund të sigurojë një mjet elektronik të dobishëm për lehtësimin dhe përforcimin e bashkëpunimit administrativ, duke menaxhuar shkëmbimin e informacionit mbi bazën e procedurave të thjeshta dhe të unifikuara, që kapërcejnë barrierat gjuhësore. Si pasojë, duhet të nisët sa më shpejt një projekt pilot që të testohet mundësia e zgjerimit të IMI në shkëmbimin e informacionit sipas kësaj direktive.
- (129) Me qëllim përshtatjen ndaj progreseve të shpejta teknologjike ekonomike dhe ligjore, e drejta për përshtatjen e akteve në përputhje me artikullin 290 TFEU duhet t'i delegohet Komisionit, që lidhen me modifikimet e një numër elementësh jo thelbësore në këtë direktivë. Nisur nga nevoja e respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, duhet t'i delegohet Komisionit e drejta për të modifikuar procedurat teknike për metodat e llogaritjes së pragut si dhe rishikimin e pragjeve dhe përshtatjen me anekset V dhe XI; listat e autoriteteve qëndrore qeveritare janë subjekt i ndryshimeve si pasojë e modifikimeve administrative në nivel kombëtar. Këto masa i njoftohen Komisionit i cili duhet të ketë të drejtën të përshtat aneksin I; referimet e

nomeklaturës CPV mund të pësojnë ndryshime normative në nivel të BE dhe është e nevojshme të reflektohen ndryshime të tilla në tekstin e kësaj direktive; detajet dhe karakteristikat teknike të pajisjeve për faturat elektronike duhet të mbahen të azhurnuara me zhvillimet teknologjike; njëkohësisht është e nevojshme t'i jepet Komisionit e drejta të bëjë të detyrueshme normat teknike për komunikimin elektronik, duke garantuar kështu ndërveprimin e formateve teknike, proceseve dhe dërgimit të mesazheve në procedurat e prokurimit të realizuara nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit elektronik, duke mbajtur parasysh zhvillimet teknologjike; lista e akteve ligjore të BE, 5 rregullore nr. 1024/2012 të Parlamentit Europian dhe Këshillit e 25 tetor 2012 për bashkëpunimin administrativ nëpërmjet sistemit informativ të tregut të brendshëm dhe shfuqëzon vendimin e Komisionit 2008/49/EC (rregulloren IMI) (GU L e 14.11.2012, faqe 1) që rregullojnë metodat e përbashkëta për llogaritjen e kostos të ciklit jetësor, duhet të përshtatet sa më shpejt që të përfshijë masat e adoptuara mbi një bazë sektori. Me qëllim që të përmbushen këto nevoja, Komisioni duhet të ketë të drejtën të mbajë të azhurnuar listën e akteve ligjore përfshirë dhe metodat që lidhen me koston e ciklit jetësor. Është e një rëndësie të vecantë që në përgatitjen e akteve deleguese, Komisioni të bëjë njëkohësisht një përhapje të përshtatshme dhe në kohë të dokumentave që lidhen me Parlamentin Europian dhe Këshillin.

- (130) Në aplikimin e kësaj direktive, Komisioni duhet të konsultohet me grupe të përshtatshme ekspertësh në fushën e prokurimeve elektronike, duke garantuar një përbërje të ekuilibruar të grupeve kryesore të palëve të interesuara.
- (131) Me qëllim që të garantohen kushte të njëjta për implementimin e kësaj direktive, duhet që Komisionit t'i jepen kompetenca ekzekutive në lidhje me hartimin e formularëve standard për publikimin e njoftimeve dhe formular standard për vetëdeklarimin. Këto kompetenca duhet të realizohen në përputhje me rregulloren 182/2011 të Parlamentit Europian dhe Këshillit (6).
- (132) Procedura këshillimore duhet të përdoret për miratimin e akteve ekzekutive, që lidhet me formularët standard për publikimin e njoftimeve, të cilët nuk kanë ndonjë impakt as nga pikëpamja financiare ose nga natyra apo qëllimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo direktivë. Në të kundërt, akte të tilla

karakterizohen nga një qëllim final thjesht administrativ dhe shërben në thjeshtësimin e aplikimit të rregullave të përcaktuara në këtë direktivë.

- (133) Procedura e shqyrtimit duhet të përdoret në miratimin e formularëve standard të vetëdeklarimit, për shkak të impaktit që këto vetëdeklarime kanë në prokurim dhe sepse ata luajnë një rol të rëndësishëm në thjeshtimin dokumentacionit të kërkuar në procedurat e prokurimit.
- (134) Komisioni duhet të rishqyrtojë efektet në tregun e brendshëm që vijnë si pasojë e aplikimit të prageve dhe t'i raportojë Parlamentit European dhe Këshillit. Ndërkohë duhet të mbajë parasysh faktorë si nivelin e prokurimeve ndërkufitare, pjesëmarrjen e SME, kostot e transaksionit dhe raportin kosto-përfitim.

Në përputhje me artikullin XXII (7) GPA do jetë subjekt e negociatave të mëtejshme, tre vjet pas hyrjes në saj në fuqi dhe më tej në intervale periodike. Në këtë kontekst, përshtatshmëria e nivelit të pragut duhet të shqyrtohet, duke patur parasysh impaktin e inflacionit në pragjet e pandryshuara për një kohë të gjatë nga GPA; në rastin e ndryshimit të prageve, Komisioni, si pasojë duhet të miratojë një propozim për një akt ligjor që ndryshon pragun e parashikuar në këtë direktivë.

- (135) Duke marrë parasysh diskutimet aktuale mbi dispozitat horizontale që rregullojnë marrëdhëniet më vendet e treta, nën kontekstin e prokurimeve publike, Komisioni duhet të monitorojë nga afër kushtet e tregut global dhe të vlerësojë aftësinë konkurruese të BE.

6 rregullore 182/2011 të Parlamentit European dhe Këshillit e 16 shkurt 2011 që përcakton rregullat dhe parimet kryesore në lidhje me mekanizmat e kontrollit nga Shteteve Anëtare të ushtrimit të të drejtave të implementimit nga Komisioni (GU L 55 e 28.02.2011, faqe 1)

- (136) Duke qenë se objektivi e kësaj direktive, që është përkatësisht koordinimi i dispozitave ligjore, rregulloreve dhe normave administrative, të shteteve anëtare gjatë aplikimit në disa procedura të prokurimeve publike, nuk është arritur mjaftueshëm nga shtetet anëtare për shkak të madhësisë dhe efekteve të saj, mund të arrihet më mirë në nivel të BE, pasi kjo e fundit mund të ndërhyjë në bazë të parimit të subsidiarititetit të parashikuar në

aritullin 5 të Traktatit të Bashkimit European. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, të parashikuar në po atë artikull, kjo direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e objektivit.

(137) Direktiva 2004/18 EC duhet të shfuqizohet.

(138) Në mbështetje të Deklaratës të Politikës së Përbashkët të Shteteve Anëtare dhe Komisionit, datë 28 shtator 2011, mbi dokumentat shpjeguese, shtetet anëtare marrin përsipër, në raste të justifikuara, të shoqërojnë masat implementuese me një apo disa dokumenta që shpjegojnë raportin midis komponentëve të direktivës dhe pjesëve korresponduese në instrumentat implementues kombëtar. Përsa i përket kësaj direktive, ligjvënësi konsideron se implementimi i këtyre dokumentave është i justifikuar.

Përktheu:Krisi Anastasi

Redaktoi: Miranda Haxhia, Irena Islami

II. DIREKTIVA 2014/23/EU E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT 26 Shkurt 2014

Mbi dhënien e kontratave të koncesionit

(Tekst përshtatur me EEA1)

¹ EEA-Zona Ekonomike Evropiane për lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve dhe punëve.

DIREKTIVA 2014/23/EU E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT 26 Shkurt 2014

Mbi dhënien e kontratave të koncesionit

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin mbi Funksonimin e Bashkimit Evropian, dhe në veçanti nenin 53 (1) dhe nenet 62 dhe 114 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni Evropian,

Pas transmetimit të projekt-aktit legjislativ tek parlamentet kombëtare,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit të Rajoneve,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legjislativë,

Ndërsa:

- (1) Mungesa e rregullave të qarta në nivel të Unionit **2** që rregullojnë dhënien e koncesioneve krijon pasiguri ligjore dhe pengesa në ofrimin e lirë të shërbimeve dhe shkakton shtrembërime në funksionimin e tregut të brendshëm. Si rezultat i kësaj, operatorët ekonomikë, në veçanti bizneset vogla dhe të mesme (BVM), janë duke u privuar nga të drejtat e tyre në tregun e brendshëm dhe humbasin mundësi të rëndësishme biznesi, ndërkohë që autoritetet publike mund të mos zbatojnë përdorimin më të mirë të parave publike në mënyrë që qytetarët e Unionit të përfitojnë nga

² *Kuptohet Bashkimi Evropian*

shërbime cilësore me çmimin më të mirë. Një kuadër i përshtatshëm, i balancuar dhe fleksibël ligjor për dhënien e koncesioneve do të siguronte një qasje efektive dhe jodiskriminuese në treg për të gjithë operatorët ekonomikë të BE dhe sigurinë juridike, duke favorizuar investimet publike në infrastrukturë dhe shërbimet strategjike ndaj qytetarit. Një kornizë e tillë ligjore do të përballojë siguri më të madhe për operatorët ekonomikë dhe mund të jetë një bazë dhe për mjetet e hapjes mëtejshme së tregjeve ndërkombëtare të prokurimit publik dhe rritjen e tregtisë botërore. Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet përmirësimit të mundësive për qasje të BVM-ve në të gjithë tregjet e koncesionit të BE.

- (2) Rregullat e kuadrit ligjor në fuqi për dhënien e koncesioneve duhet të jenë të qarta dhe të thjeshta. Ato duhet të reflektojnë në mënyrë të rregullt specifikat e koncesioneve në krahasim me kontratat publike dhe nuk duhet të krijojnë një sasi të tepruar burokracie.
- (3) Prokurimi publik luan një rol kyç në strategjinë Evropa 2020, të përcaktuar në Komunikatën e Komisionit të 3 marsit 2010 me titull "Evropa 2020, një strategji për një rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse", si një nga instrumentet e bazuara në treg që do të përdoret për të arritur rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse duke siguruar përdorimin më efikas të fondeve publike. Në këtë kontekst, kontratat koncesionare paraqesin instrumente të rëndësishme në zhvillimin strukturor afatgjatë të infrastrukturës dhe strategjisë së shërbimeve, duke kontribuar në përparimin e konkurrencës brenda tregut të brendshëm, duke bërë të mundur përfitimin nga ekspertiza e sektorit privat dhe duke ndihmuar për të arritur efikasitet dhe inovacion.
- (4) Akordimi i koncesioneve të punëve publike është aktualisht subjekt i rregullave themelore të Direktivës 2004/18/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit; ndërsa dhënia e koncesioneve të shërbimeve me interes ndërkufitar është subjekt i parimeve të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), dhe në veçanti parimet e lëvizjes së lirë të mallrave, lirisë së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime, si dhe parimeve që rrjedhin si trajtimi i barabartë, parimi i mosdiskriminimit, njohja reciproke, proporcionaliteti dhe transparenca. Ekziston rreziku i paqartësisë ligjore lidhur me interpretimet e ndryshme të parimeve të Traktatit nga legjislatorët kombëtarë dhe i

dallimeve të gjera midis legjislacioneve të Shteteve të ndryshme Anëtare. Një rrezik i tillë është konfirmuar nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian që megjithatë ka adresuar vetëm pjesërisht aspekte të caktuara të dhënies së kontratave të koncesionit.

- (5) Një aplikim uniform i parimeve të TFBE nëpër të gjitha shtetet anëtare dhe eliminimi i mospërputhjeve në të kuptuarit e këtyre parimeve është i nevojshëm në nivel Unioni, në mënyrë që të eliminohen deformimet e vazhdueshme të tregut të brendshëm. Kjo do të favorizojë efikasitetin e shpenzimeve publike, për të lehtësuar qasjen e barabartë dhe pjesëmarrjen e drejtë të BVM-ve në dhënien e kontratave të koncesionit, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel BE-je, dhe për të mbështetur arritjen e objektivave të qëndrueshme të politikave publike.
- (6) Kjo Direktivë njeh dhe riafirmon të drejtën e Shteteve Anëtare dhe autoriteteve kontraktore për të vendosur mjetet e administratës që gjykohet të jenë më të përshtatshme për kryerjen e punëve dhe ofrimin e shërbimeve. Në veçanti, kjo Direktivë nuk duhet në asnjë mënyrë të ndikojë në lirinë e Shteteve Anëtare dhe autoriteteve kontraktore për të kryer punime apo ofruar shërbime direkte për publikun apo për të transferuar këtë dispozitë duke e deleguar atë tek palët e treta. Shtetet Anëtare apo autoritetet kontraktore duhet të mbeten të lirë për të përcaktuar dhe të specifikuar karakterin e shërbimeve që do të ofrohen, duke përfshirë edhe kushtet në lidhje me cilësinë apo çmimin e shërbimeve, në përputhje me të drejtën e BE-së, në mënyrë që të ndjekin objektivat e tyre të politikave publike.
- (7) Duhet të kujtojmë se Shtetet Anëtare janë të lira të vendosin, në përputhje me parimet e TFBE mbi trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, transparencën dhe lëvizjen e lirë të personave për të organizuar dhënien e shërbimeve si shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik, ose si shërbime jo-ekonomike të interesit të përgjithshëm, apo si një përzierje e tyre. Gjithashtu duhet të kujtojmë se kjo direktivë nuk cenon lirinë e autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale për të përcaktuar, në përputhje me ligjin e Unionit, shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik, shtrirjen e tyre dhe karakteristikat e shërbimit që do të ofrohet, duke përfshirë edhe kushtet në lidhje me cilësinë e shërbimit, për të ndjekur objektivat e politikave publike. Ajo nuk duhet të cenojë fuqinë e autoriteteve kombëtare,

rajonale dhe lokale për të siguruar, komisionuar dhe financuar shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik në përputhje me nenin 14 TFBE dhe Protokollin Nr 26 bashkëlidhur TFBE dhe Traktatit të Bashkimit Europian. Përveç kësaj, kjo Direktivë nuk merret me financimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, ose me sistemet e ndihmës së dhënë nga Shtetet Anëtare, në veçanti në fushën sociale, në pajtim me rregullat e BE për konkurrencën. Është e nevojshme të sqarohet se shërbimet jo-ekonomike të interesit të përgjithshëm nuk janë brenda fushës së veprimit të kësaj direktive.

- (8) Është gjithashtu e nevojshme të kujtojmë se kjo direktivë nuk duhet të ndikojë në legjislacionin e sigurimeve shoqërore të shteteve anëtare dhe as nuk duhet të sjellë liberalizimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, e rezervuar për subjektet publike ose private, ose privatizimin e subjekteve publike që ofrojnë shërbime.
- (9) Për koncesionet e barabarta me ose mbi një vlerë të caktuar, është e përshtatshme të sigurohet një koordinim minimal i procedurave kombëtare për dhënien e kontratave të tilla të bazuara në parimet e TFBE, në mënyrë që të garantohet hapja e koncesioneve ndaj konkurrencës dhe siguria ligjore adekuate. Këto dispozita koordinuese nuk duhet të shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për të realizuar objektivat e mësipërme dhe për të siguruar një shkallë të caktuar fleksibiliteti. Shtetet Anëtare duhet të lejohet të përfundojnë dhe të zhvillojnë më tej këto dispozita, nëse ata e shohin të përshtatshme, në mënyrë të veçantë për të siguruar më mirë përputhjen me parimet e përcaktuara më sipër.
- (10) Duhet sqaruar se grupet e operatorëve ekonomikë, përfshirë ata që kanë ardhur së bashku në formën e një shoqate të përkohshme, mund të marrin pjesë në procedurat e dhënies pa qenë e nevojshme që të marrin një formë të veçantë ligjore. Për atë që është e nevojshme, kur kërkohet përgjegjësi e përbashkët, një formë e veçantë mund të jetë e detyrueshme, për shembull kur këto grupe janë dhënë me koncesion. Gjithashtu, duhet të qartësohet se autoritetet kontraktuese ose subjektet kontraktuese duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë në mënyrë të qartë se si grupet e operatorëve ekonomikë duhet të përmbushin kërkesat në lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare, apo kriteret që kanë të bëjnë me aftësinë teknike dhe

profesionale të cilat janë të nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Performanca e kontratave koncesionare nga grupet e operatorëve ekonomikë mund të kërkojë vendosjen e kushteve të cilat nuk janë të vendosura mbi dispozita individuale dhe këto kushte, të cilat duhet të justifikohen me arsye objektive dhe të jenë proporcionale, për shembull mund të përfshijnë emërimin e një përfaqësuesi të përbashkët apo një partneri udhëheqës për qëllime procedurale për dhënie të koncesionit apo të kërkojë informacion mbi kushtetutën e tyre.

- (11) Dispozita të caktuara të koordinimit duhet të futen për akordimin e punëve dhe shërbimeve të koncesioneve në sektorin e energjisë, transportit dhe shërbimeve postare, duke pasur parasysh se autoritetet kombëtare mund të ndikojnë në sjelljen e subjekteve që veprojnë në këto sektorë, dhe natyrën e mbyllur të tregjeve në të cilët ata veprojnë, për shkak të ekzistencës së të drejtave të veçanta ose ekskluzive të dhënë nga Shtetet Anëtare në lidhje me furnizimin, sigurimin apo funksionimin e rrjeteve për ofrimin e shërbimeve në fjalë.
- (12) Koncesionet janë kontratat me shpërblim, me anë të të cilave një ose më shumë autoritete kontraktuese ose subjekte kontraktuese u beson kryerjen e punimeve, ofrimin ose menaxhimin e shërbimeve, një ose më shumë operatorëve ekonomikë. Objekt i kontratave të tilla është prokurimi i punëve ose shërbimeve me anë të një koncesioni, shqyrtimi i të cilit përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar punimet ose shërbimet, por edhe bashkë me pagesë. Këto kontrata mund të përfshijnë, por jo domosdoshmërisht, një transferim të pronësisë ndaj autoriteteve ose subjekteve kontraktuese, por këto të fundit gjithmonë të marrin përfitimet e punëve ose shërbimeve në fjalë.
- (13) Për qëllim të kësaj Direktive, duhet të sqarohet se një financim i thjeshtë, në veçanti përmes granteve për një aktivitet, i cili është i lidhur shpesh me detyrimin për të rimbursuar shumat e marra, kur ato nuk janë përdorur për qëllimet e synuara, nuk bie në fushëveprimin e kësaj Direktive.
- (14) Për më tepër, marrëveshjet ku të gjithë operatorët që plotësojnë kushte të caktuara kanë të drejtë për të kryer një detyrë, pa ndonjë zgjedhje të veçantë, të tilla si zgjedhja e konsumatorit dhe kuponi i shërbimit të

sistemeve, nuk duhet të kualifikohen si koncesione, duke përfshirë edhe ato të bazuara në marrëveshje ligjore mes autoritetit publik dhe operatorëve ekonomikë. Sisteme të tilla janë të bazuara në mënyrë tipike në një vendim të një autoriteti kontraktor që përcakton kushtet transparente dhe jo-diskriminuese për aksesin e vazhdueshëm të operatorëve ekonomikë për ofrimin e shërbimeve të veçanta, të tilla si shërbimet sociale, duke i lejuar konsumatorët të zgjedhin midis operatorëve të tillë.

- (15) Përveç kësaj, disa akte të shteteve anëtare që veprojnë si autorizime ose licenca, ku Shteti Anëtar ose autoriteti publik i tij përcakton kushtet për ushtrimin e një aktiviteti ekonomik, duke përfshirë edhe një kusht për të kryer një operacion të caktuar, të dhëna, normalisht, me kërkesë të operatorit ekonomik dhe jo me iniciativën e autoritetit kontraktues ose subjektit kontraktues dhe ku operatori ekonomik mbetet i lirë të tërhiqet nga ofrimi i punimeve apo shërbimeve, nuk duhet të kualifikohen si koncesione. Në rastin e këtyre akteve të Shteteve Anëtare, zbatohen dispozitat e veçanta të Direktivës 2006/123/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Në kontrast me këto akte shtetërore, kontrata koncesionare parashikon detyrimet reciproke, ku ekzekutimi i punëve ose shërbimeve është subjekt i kërkesave specifike të përcaktuara nga autoriteti kontraktues, të cilat janë të zbatueshme me ligj.
- (16) Përveç kësaj, marrëveshjet e caktuara që kanë si objekt të drejtën e një operatori ekonomik për të shfrytëzuar disa fusha publike ose burime sipas ligjit privat apo publik, të tilla si toka ose ndonjë pronë publike, në veçanti në detet, portet apo aeroportet në brendësi të sektorit, ku Shteti ose autoriteti kontraktues përcakton vetëm kushtet e përgjithshme për përdorimin e tyre pa prokurimin e punëve të veçanta ose shërbimeve, nuk duhet të kualifikohen si koncesione brenda kuptimit të kësaj Direktive. Ky është zakonisht rasti i kontratave të dhënies me qira të tokës shtetërore, të cilat në përgjithësi përmbajnë kushtet lidhur me marrjen në posedim nga ana e qiramarrësit, mënyra se si prona duhet të përdoret, detyrimet e qiradhënësit dhe qiramarrësit në lidhje me mirëmbajtjen e pronës, kohëzgjatja e qirasë dhe heqja dorë nga posedimit e pronarit, qiraja dhe pagesave të rastit që duhet të paguhet nga qiramarrësi.

- (17) Përveç kësaj, marrëveshjet që u japin të drejta që mbulojnë përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike për ofrimin ose operimin e linjave fikse apo rrjetet për qëllim të ofrimit të shërbimeve për publikun duhet të mos të konsiderohen koncesione në kuptim të kësaj Direktive, për aq sa këto marrëveshje nuk imponojnë një detyrim furnizimi apo të përfshijnë blerjen e shërbimeve nga një autoritet ose subjekt kontraktues për vete ose për përdoruesin.
- (18) Kontratat që nuk përfshijnë pagesat për kontraktuesit dhe ku kontraktuesi shpërblehet në bazë të tarifave të rregulluara, të llogaritura në mënyrë që të mbulojnë të gjitha shpenzimet dhe investimet e kryera nga kontraktuesi për ofrimin e shërbimit, nuk mbulohej nga kjo Direktivë.
- (19) Vështirësitë që lidhen me interpretimin e koncepteve të koncesionit dhe të kontratës publike kanë krijuar pasiguri të vazhdueshme ligjore mes palëve të interesuara dhe kanë prodhuar gjykime të shumta të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Prandaj, përkufizimi i koncesionit duhet të qartësohet, në veçanti duke iu referuar konceptit të rrezikut operativ. Karakteristika kryesore e një koncesioni, e drejta për të shfrytëzuar veprat apo shërbimet, gjithmonë nënkupton transferimin tek koncesionari të një rreziku operativ të natyrës ekonomike që përfshin mundësinë e mos mbledhjes së investimeve të bëra dhe shpenzimeve të shkaktuara nga punët ose shërbimet e dhëna në kushte normale të operimit, edhe në qoftë se një pjesë e rrezikut mbetet me autoritetin kontraktues. Aplikimi i rregullave të veçanta që rregullojnë dhënien e koncesioneve nuk do të ishte i justifikuar nëse autoriteti kontraktues liron operatorin ekonomik nga çdo humbje e mundshme, duke garantuar një të ardhur minimale, të barabartë ose më të lartë se investimet e bëra dhe shpenzimet që operatori ekonomik duhet të bëjë në lidhje me zbatimin e kontratës. Në të njëjtën kohë duhet të bëhet e qartë se rregullimet e caktuara të cilat janë paguar ekskluzivisht nga autoriteti kontraktues duhet të kualifikohen si koncesione kur kompensimi i investimeve dhe kostot e shkaktuara nga operatori për kryerjen e punës apo ofrimin e shërbimit varen nga kërkesa aktuale për furnizimin e shërbimit.
- (20) Kur rregullimi i sektorit specifik eliminon rrezikun duke siguruar një garanci të koncesionarit për të pasur rentabilitet në investimet dhe shpenzimet e bëra për funksionimin e kontratës, atëherë një kontratë e tillë nuk duhet të

kualifikohet si koncesion brenda kuptimit të kësaj Direktive. Fakti se rreziku është i kufizuar nga fillimi nuk duhet të pengojë kualifikimin e kontratës si një koncesion. Ky mund të jetë për shembull rasti në sektorët me tarifa të rregulluara ose aty ku rreziku operativ është i kufizuar me anë të marrëveshjeve kontraktuale për të siguruar kompensim të pjesshëm, duke përfshirë kompensimin, në rast të përfundimit të parakohshëm të koncesionit për arsye të autoritetit kontraktues ose për shkak të një force madhore.

- (21) Një rrezik operativ duhet të rrjedhë nga faktorë që janë jashtë kontrollit të palëve. Rreziqet të tilla si ato të lidhura me menaxhimin e keq, shkelje kontraktuale nga ana e operatorit ekonomik, ose në rastet e forcës madhore nuk janë vendimtare për qëllim të klasifikimit si koncesion, pasi këto rreziqe janë të pandara në çdo kontratë, qoftë ajo një kontratë prokurimi publik ose një koncesion. Një rrezik operativ duhet të kuptohet si rreziku i ekspozimit ndaj faktorëve të tregut, të cilët mund të përbëhen nga rreziku i kërkesës apo një rrezik i furnizimit, ose si një rrezik i kërkesës dhe ofertës. Rreziku i kërkesës duhet të kuptohet si një rrezik i kërkesës aktuale për vepra ose shërbime që janë objekt i kontratës. Rreziku i furnizimit duhet të kuptohet si një rrezik për sigurimin e punimeve ose shërbimeve që janë objekt i kontratës, në mënyrë të veçantë rreziku që ofrimi i shërbimeve nuk do të përputhet me kërkesën. Për qëllim të vlerësimit të rrezikut operativ vlera aktuale neto e të gjitha investimeve, shpenzimeve dhe të ardhurave të koncesionarit duhet të merren parasysh në mënyrë konsistente dhe uniforme.
- (22) Nocioni i "organeve që rregullohen nga e drejta publike" është shqyrtuar në mënyrë të përsëritur në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Disa sqarime janë të rëndësishme për të kuptuarit e plotë të këtij koncepti. Prandaj, duhet të theksohet se një organ i cili vepron në kushtet normale të tregut, ka për qëllim të fitojë, dhe mban humbjet që rezultojnë nga ushtrimi i veprimtarisë së tij nuk duhet të konsiderohet si një "organ që rregullohet nga e drejta publike", pasi nevojat me interes të përgjithshëm që duhet të përmbushen, mund të konsiderohen se kanë një karakter industrial ose tregtar. Në mënyrë të ngjashme, origjina e fondeve është shqyrtuar gjithashtu nga Gjykata, e cila ka sqaruar se financim "për pjesën më të madhe" do të thotë më shumë se gjysma dhe se një financimi i

tillë mund të përfshijë pagesa nga përdoruesit të cilat janë të imponuara, llogaritura dhe mbledhura në përputhje me rregullat e së drejtës publike.

- (23) Është e rëndësishme të përcaktohen "të drejtat ekskluzive" dhe "të drejtat të veçanta", pasi këto nocione janë vendimtare për fushën e veprimit të kësaj direktive dhe nocionin e subjekteve kontraktuese. Duhet sqaruar se subjektet të cilat nuk janë as subjekte kontraktuese në pajtim me pikën (a) të nenit 7 (1) dhe as ndërmarrje publike, janë subjekt i dispozitave të saj vetëm deri në masën që ato ushtrojnë një nga aktivitetet e mbuluara në bazë të këtyre të drejtave. Megjithatë, ato nuk do të konsiderohen të jenë subjekte kontraktuese, nëse këto të drejta janë dhënë me anë të një procedure të bazuar në kritere objektive, në mënyrë të veçantë në pajtim me legjislacionin e BE-së, dhe për të cilat është siguruar publicitet adekuat. Legjislacioni duhet të përfshijë Direktivën 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Direktivën 2009/72/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Direktivën 97/67/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Direktivën 94/22/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe Rregulloren (KE) Nr 1370/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Gjithashtu, duhet të sqarohet se kjo listë e legjislacionit nuk është e plotë dhe se të drejtat e çfarëdo forme, të cilat janë dhënë me anë të procedurave të tjera të bazuara në kritere objektive dhe për të cilat është siguruar publicitet adekuat nuk janë përshtatshme për qëllimet e përcaktimit të subjekteve kontraktuese të mbuluara nga kjo Direktivë.
- (24) Kjo direktivë duhet të zbatohet vetëm për kontratat e koncesionit vlera e të cilave është e barabartë ose më e madhe se një prag i caktuar, të cilat duhet të pasqyrojnë interes të qartë ndërkufitar të koncesioneve ndaj operatorëve ekonomikë të vendosur në një Shtet Anëtar të ndryshëm nga ai i autoritetit kontraktues. Si rrjedhojë, metoda e llogaritjes së vlerës mesatare të një koncesioni duhet të përcaktohet dhe duhet të jetë identike për punët dhe shërbimet e koncesioneve, pasi të dyja kontratat shpesh mbulojnë elementet e punëve dhe shërbimeve. Llogaritja duhet t'i referohet xhiros totale të koncesionarit për punimet dhe shërbimet që janë objekt i koncesionit, siç vlerësohet nga autoriteti ose subjekti kontraktues, duke përjashtuar TVSH-në, gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

- (25) Për të siguruar një hapje reale të tregut dhe një ekuilibër të drejtë në zbatimin e rregullave të dhënies me koncesion në sektorët e energjisë, transportit dhe shërbimeve postare, është e nevojshme që subjektet e mbuluara të identifikohen mbi një bazë tjetër përveç statusit të tyre ligjor. Duhet të sigurohet që trajtimi i barabartë i subjekteve kontraktuese që veprojnë në sektorin publik dhe atyre që veprojnë në sektorin privat nuk është në rrezik. Është gjithashtu e nevojshme që në përputhje me nenin 345 TFBE, rregullat që rregullojnë sistemin e pronësisë në Shtetet Anëtare të mos paragjyken. Për këtë arsye, rregulla specifike dhe uniforme duhet të zbatohen për koncesionet e dhëna nga subjektet që ushtrojnë një nga aktivitetet e lartpërmendura me qëllim për të ndjekur aktivitete të tilla, pavarësisht nëse janë autoritete shtetërore, lokale apo rajonale, organe që rregullohen nga e drejta publike, ndërmarrje publike apo të tjera subjekte që gëzojnë të drejta të veçanta ose ekskluzive. Subjektet të cilat janë përgjegjëse, sipas ligjit kombëtar, për sigurimin e shërbimeve që lidhen me një nga aktivitetet e përmendura në Shtojcën II, duhet të supozohet se ndjekin aktivitete të tilla.
- (26) Duhet të sqarohet se aktiviteti në fushën e aeroporteve gjithashtu mbulon shërbimet e ofruara për udhëtarët, të cilat kontribuojnë në funksionimin normal të shërbimeve të aeroportit dhe priten të jenë në një aeroport funksional modern, të tilla si pika ku shitet ushqim dhe parkimi i makinave.
- (27) Disa subjekte janë aktive në fushën e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së ngrohjes dhe ftohjes. Mund të ketë disa paqartësi në lidhje me cilat rregulla vlejnë respektivisht për aktivitetet e lidhura me ngrohjen dhe ftohjen. Prandaj, duhet të sqarohet se transmetimi dhe shpërndarja e ngrohjes është një aktivitet i mbuluar në Aneksin II dhe kështu subjektet të cilat janë aktive në sektorin e ngrohjes janë subjekt i rregullave të kësaj Direktive, të aplikueshme për subjektet kontraktuese, në masën që ato kualifikohen si të tilla. Nga ana tjetër, ata që operojnë në fushën e ftohjes janë subjekt i rregullave të kësaj Direktive, të aplikueshme për autoritetet kontraktuese, në masën që ato të kualifikohen si të tilla. Duhet përfundimisht të sqarohet se koncesionet e dhëna për ndjekjen e kontratave të ngrohjes dhe ftohjes duhet të shqyrtohen sipas dispozitave mbi kontratat për ndjekjen e disa aktiviteteve për të përcaktuar se cilat rregulla të prokurimit, do të vendosin çmimin e tyre.

- (28) Para se të parashikohet ndonjë ndryshim i fushës së veprimit të kësaj direktive për sektorin e ftohjes, gjendja e këtij sektori duhet të shqyrtohet në mënyrë që të merren informata të mjaftueshme, veçanërisht për sa i përket situatës konkurruese, shkallës së prokurimit ndërkufitar dhe pikëpamjeve të palëve të interesuara. Duke pasur parasysh se zbatimi i kësaj direktive për sektorin mund të ketë një ndikim të konsiderueshëm në drejtim të hapjes së tregut, ekzaminimi duhet të kryhet kur bëhet vlerësimi i ndikimit të kësaj Direktive.
- (29) Duhet sqaruar se për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2 të shtojcës II, "furnizimi" përfshin prodhimin me shumicë dhe shitjen me pakicë. Megjithatë, prodhimi i gazit në formën e nxjerrjes, bie nën fushëveprimin e paragrafit 6 të kësaj shtojce.
- (30) Në rastin e kontratave të përziera, rregullat e zbatueshme duhet të përcaktohen në lidhje me temën kryesore të kontratës, nëse pjesë të ndryshme të cilat përbëjnë kontratën nuk janë objektivist të ndashme. Prandaj duhet të sqarohet se si autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktuese duhet të përcaktojnë nëse pjesë të ndryshme janë të ndashme apo jo. Një sqarim i tillë duhet të bazohet në jurisprudencën përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Përcaktimi duhet të bëhet mbi një bazë rast pas rasti, mbi të cilën qëllimet e shprehura apo të supozuara të autoritetit kontraktues për të trajtuar aspektet e ndryshme që përbëjnë një kontratë të përzierë si të pandashme, nuk duhet të jenë të mjaftueshme, por duhet të mbështeten me dëshmi objektive të afta për të justifikuar ato dhe për të krijuar nevojën e lidhjes së një kontratë të vetme. Një nevojë e tillë e arsyeshme për të lidhur një kontratë të vetme, për shembull mund të jetë e pranishme në rastin e ndërtimit të një ndërtesë të vetme, një pjesë e së cilës të përdoret direkt nga autoriteti kontraktues në fjalë dhe një pjesë tjetër të operohet në bazë të koncesionit, për të siguruar mjedise parkimi për publikun. Duhet sqaruar se nevoja për të lidhur një kontratë të vetme mund të jetë për shkak të arsyeve të natyrës teknike dhe ekonomike.
- (31) Në rastin e kontratave të përziera, të cilat mund të jenë të ndara, autoritetet kontraktuese subjekte janë gjithmonë të lirë të japin kontrata të veçanta për pjesët e ndryshme të kontratës të përzier dhe në këtë rast dispozitat e zbatueshme për secilën pjesë të veçantë duhet të përcaktohen ekskluzivisht

në lidhje me karakteristikat e kësaj kontrate. Nga ana tjetër, kur autoritetet kontraktuese zgjedhin për të dhënë një kontratë, duke përfshirë koncesionin dhe elementë të tjerë, cilado qoftë vlera e tyre dhe regjimi ligjor pjesë e të cilit do të ishin, rregullat e zbatueshme për raste të tilla duhet të tregohen qartë. Një dispozitë e veçantë duhet të bëhet për kontratat e përziera që përfshijnë aspekte të mbrojtjes ose të sigurisë apo pjesë të caktuara që nuk bien brenda fushës së TFBE.

- (32) Koncesionet mund të jepen nga subjektet kontraktuese me qëllim plotësimin e kërkesave të disa aktiviteteve, kryesisht pjesë e regjimeve të ndryshme ligjore. Duhet sqaruar se regjimi ligjor i zbatueshëm për një koncesion të vetëm që synon të mbulojë disa veprimtari duhet të jetë subjekt i rregullave në fuqi për aktivitetin për të cilin është destinuar. Përcaktimi i aktivitetit për të cilin koncesioni është destinuar mund të bazohet në një analizë të kërkesave të cilat koncesioni specifik duhet të plotësojë, të kryera nga subjekti kontraktues për qëllimet e vlerësimit të koncesionit dhe hartimit të dokumenteve për dhënien e koncesionit. Në disa raste, mund të jetë objektivist e pamundur të përcaktohet se cilin aktivitet koncesioni kryesisht ka për qëllim. Rregullat e zbatueshme për raste të tilla duhet të përcaktohen.
- (33) Në disa raste, një autoritet kontraktues i cili mund të jetë një shtet, autoritet rajonal apo vendor, ose organ që rregullohet nga e drejta publike ose një shoqatë mund të jetë burimi i vetëm për një shërbim të caktuar, për ofrimin e të cilit gëzon një të drejtë të veçantë në pajtim me ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të publikuara të cilat janë në përputhje me TFBE. Duhet sqaruar se në këto situata një autoritet kontraktues ose njësi kontraktuese mund të akordojnë koncesione për organe të tilla pa pasur nevojën e aplikimit të kësaj Direktive.
- (34) Është gjithashtu e nevojshme të përjashtohen nga objekti i kësaj Direktive disa koncesione të shërbimeve të dhëna operatorëve ekonomikë, ku ata janë dhënë mbi bazën e një të drejtë ekskluzive që ai operator gëzon sipas ligjeve vendore, rregulloreve ose dispozitave administrative të publikuara dhe të cilat janë dhënë në përputhje me TFBE dhe aktet e BE-së që përcaktojnë rregullat e përbashkëta për aksesin në treg të zbatueshme për aktivitetet e përmendura në Aneksin II, duke qenë se e drejta ekskluzive e bën të pamundur ndjekjen e një procedure konkurruese për çmimin. Duke

anashkaluar pasojat ligjore të përjashtimit nga fushëveprimi i kësaj Direktive, koncesionet e përmendura në nënparagrafin e dytë të nenit 10 (1) duhet të jenë subjekt i detyrimit për të publikuar njoftimin mbi dhënien e koncesionit për të siguruar transparencën themelore, përveç rastit kur kushtet e transparencës janë dhënë në legjislacionin sektorial. Për të përforcuar transparencën, ku një Shtet Anëtar i jep një të drejtë ekskluzive një operatori ekonomik për ushtrimin e një prej veprimtarive të përmendura në Shtojcën II, ai duhet të informojë Komisionin.

- (35) Për qëllim të kësaj Direktive, nocionet e interesave thelbësore të sigurisë, pajisjeve ushtarake, pajisjeve, punimeve dhe shërbimeve të ndjeshme duhet të kuptohen në nocionin e Direktivës 2009/81/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit.
- (36) Kjo direktivë nuk duhet të ndikojë në lirinë e Shteteve Anëtare për të zgjedhur, në përputhje me ligjin e Bashkimit, metodat për organizimin dhe kontrollin e funksionimit të lojërave të fatit dhe basteve, duke përfshirë edhe atë me anë të autorizimeve. Është e përshtatshme të përjashtohet nga objekti i kësaj Direktive, koncesionet që kanë të bëjnë me funksionimin e llotarive dhënë nga një Shtet Anëtar tek një operator ekonomik në bazë të një të drejtë ekskluzive të dhënë me anë të një procedure pa publicitet në pajtim me ligjet e aplikueshme kombëtare, rregulloret ose dispozitat administrative të publikuara në përputhje me TFBE. Ky përjashtim justifikohet nga dhënia e një të drejtë ekskluzive për një operator ekonomik, duke e bërë një procedurë konkurruese të pazbatueshme, si dhe nga nevoja për të mbajtur mundësinë që Shtetet Anëtare të rregullojnë sektorin e lojërave të fatit në nivel kombëtar në funksion të detyrimeve të tyre në aspektin e mbrojtjes së rendit publik dhe social.
- (37) Kjo direktivë nuk duhet të zbatohet për disa shërbime emergjente që kryhen nga OJF-të ose shoqatat, pasi nga natyra e veçantë e këtyre organizatave do të jetë e vështirë të ruhet, nëse ofruesit e shërbimeve duhet të zgjidheshin në përputhje me procedurat e përcaktuara në kjo Direktivë. Megjithatë, përjashtimi nuk duhet të shtrihet përtej kësaj domosdoshmërie. Prandaj duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë se shërbimet e ambulancës për transportin e pacientit nuk duhet të përjashtohen. Në këtë kontekst, është tepër e nevojshme për të sqaruar se CPV Grupi 601 "Land Transport Services"

nuk mbulon shërbimet e ambulancës, që gjenden në klasën CPV 8514. Prandaj duhet të sqarohet se shërbimet të cilat janë të mbuluara nga kodi FPP 85143000-3, të përbëra ekskluzivisht nga shërbimet e ambulancës për transportin e pacientit duhet t'i nënshtrohen regjimit të posaçëm të përcaktuar për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike. Si pasojë, kontratat e përziera të koncesionit për ofrimin e shërbimeve të ambulancës, në përgjithësi do të jenë subjekt i regjimit të lehtë, nëse vlera e këtij shërbimi do të ishte më e mëdha se vlera e shërbimeve të tjera të ambulancës.

- (38) Është e përshtatshme të kujtojmë se kjo direktivë zbatohet vetëm për autoritetet kontraktuese dhe njësitë kontraktuese të Shteteve Anëtare. Si pasojë, partitë politike meqenëse nuk janë autoritete kontraktuese ose subjekte kontraktuese nuk janë as objekt i dispozitave të saj. Megjithatë, partitë politike në disa shtete anëtare mund të bien në nocionin e organeve që rregullohen nga e drejta publike. Shërbime të caktuara (të tilla si prodhimi i spoteve propaganduese) janë aq në mënyrë të pazgjydhshme të lidhura me pikëpamjet politike të ofruesit të shërbimit kur parashikohen në kuadrin e një fushate zgjedhore, sa që ofruesit e shërbimeve janë zgjedhur zakonisht në një mënyrë që nuk mund të qeveriset nga rregullat e koncesionit. Së fundi duhet të kujtojmë se statuti dhe financimi i partive politike evropiane dhe fondacioneve politike janë subjekt i rregullave të tjera nga ato të përcaktuara në këtë Direktivë.
- (39) Shumë subjekte kontraktuese janë të organizuara si një grup ekonomik i cili mund të përbëjnë një sipërmarrje të veçantë; shpesh secila prej këtyre ndërmarrjeve ka një rol të specializuar në kuadrin e përgjithshëm të grupit ekonomik. Prandaj është e nevojshme të përjashtohet shërbimi apo puna e caktuar nga koncesionet e dhëna për një ndërmarrje të lidhur që ka si aktivitet kryesor ofrimin e shërbimeve ose punëve të tilla në grupin e të cilave bën pjesë, në vend që ti ofrojë ato në treg. Është gjithashtu e nevojshme të përjashtohen shërbime apo punë të caktuara nga koncesionet e dhëna nga një subjekt kontraktues për një sipërmarrje të përbashkët, e cila është formuar nga një numër subjektësh kontraktuese për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve të mbuluara nga kjo Direktivë dhe pjesë e të cilave është kjo njësi. Megjithatë, është gjithashtu e nevojshme të sigurohet që ky përjashtim nuk do të shkaktojë shtrembërim të konkurrencës në dobi të ndërmarrjeve ose sipërmarrjeve të përbashkëta që janë të lidhura me subjektet

kontraktuese; është e përshtatshme të sigurohet një paketë e duhur rregullash, veçanërisht në lidhje me kufijtë maksimalë, brenda të cilëve sipërmarrjet mund të marrin një pjesë të qarkullimit të tyre nga tregu dhe mbi të cilat ato do të humbasin mundësinë e marrjes së koncesioneve pa thirrje për konkurrim, përbërjen e ndërmarrjeve të përbashkëta dhe stabilitetin e lidhjeve midis këtyre ndërmarrjeve dhe subjektet kontraktuese.

(40) Ndërmarrjet duhet të konsiderohen të jenë të lidhura aty ku ekziston një ndikim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë dominant mes subjektit kontraktues dhe ndërmarrjes në fjalë, ose kur të dyja janë subjekt i ndikimit mbizotërues të ndërmarrjes tjetër; në këtë kontekst, pjesëmarrja private nuk duhet të jetë relevante në vetvete. Verifikimi nëse një ndërmarrje është e lidhur me një subjekt të caktuar kontraktues duhet të kryhet sa më lehtë të jetë e mundur. Si pasojë, duke mbajtur parasysh ekzistencën e mundshme të një ndikimi të tillë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dominues, tashmë do të duhej të verifikohej me qëllim për të vendosur nëse llogaritë vjetore të sipërmarrjeve dhe subjekteve të interesuara duhet të konsolidohen; ndërmarrjet duhet të konsiderohen të jenë të lidhura kur llogaritë e tyre vjetore janë konsoliduar. Megjithatë, rregullat e BE-së në llogaritë e konsoliduara nuk janë të zbatueshme në një numër të caktuar të rasteve, për shembull për shkak të madhësisë së ndërmarrjeve të përfshira, ose për shkak se disa kushte të caktuara në lidhje me formën e tyre ligjore nuk janë përmbushur. Në raste të tilla, kur Direktiva 2013/34/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit nuk është e zbatueshme, do të jetë e nevojshme të shqyrtohet nëse një ndikim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë dominant është i pranishëm në marrjen në pronësi të llogarisë, pjesëmarrjen financiare, ose dispozitave mbi ndërmarrjet.

(41) Koncesionet në sektorin e ujit janë shpesh subjekt i marrëveshjeve të veçanta dhe të ndërlikuara, të cilat kërkojnë një vëmendje të veçantë duke pasur parasysh rëndësinë e ujit si një e mirë publike me vlerë themelore për të gjithë qytetarët e Unionit. Karakteristika të veçanta të këtyre marrëveshjeve justifikojnë përjashtimet nga fusha e veprimit të kësaj directive. Përjashtimi mbulon punët dhe shërbimet e koncesioneve për të siguruar ose operuar rrjete fikse me qëllim ofrimin e shërbimeve për publikun në lidhje me prodhimin, transportin ose shpërndarjen e ujit të pijshëm apo furnizimin me ujë të pijshëm të këtyre rrjeteve. Koncesionet për depozitim ose trajtimin e

ujërave të zeza dhe për projekte inxhinierike hidraulike, ujitjen apo kullimin e tokës (me kusht që vëllimi i ujit që do të përdoret për furnizimin e ujit të pijshëm përfaqëson më shumë se 20% të vëllimit të përgjithshëm të ujit të vënë në dispozicion nga projekte të tilla ose ujitja ose instalimet e kullimit), duhet të përjashtohen për sa kohë janë të lidhura me një aktivitet të përjashtuar.

- (42) Kjo direktivë nuk duhet të zbatohet për koncesionet e dhëna nga subjektet kontraktuese dhe ka për qëllim të lejojë kryerjen e një aktiviteti referuar në Aneksin II, nëse, në Shtetin Anëtar në të cilin aktiviteti është kryer, ai është i ekspozuar direkt ndaj konkurrencës në tregjet në të cilat qasja nuk është e kufizuar, e themeluar pas një procedure të parashikuar për këtë qëllim nga Direktiva 2014/25/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Prandaj është e nevojshme të mbahet procedura, e zbatueshme për të gjithë sektorët, ose për një pjesë të tyre, mbuluar nga kjo direktivë, që do të mundësojë marrjen parasysh të efekteve të hapjes së tanishme apo të ardhshme. Një procedurë e tillë duhet të ofrojë siguri ligjore për subjektet në fjalë, si dhe një proces të përshtatshëm të vendimmarrjes, duke siguruar brenda afateve kohore të shkurtra, zbatimin e njëtrajtshëm të ligjit të Unionit në këtë fushë. Për hir të sigurisë juridike, duhet të sqarohet se të gjitha vendimet e miratuara para hyrjes në fuqi të kësaj Direktive miratuar në bazë të nenit 30 të Direktivës 2004/17/ EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit do të vazhdojnë të zbatohen.
- (43) Duke iu drejtuar shteteve anëtare, kjo direktivë nuk zbatohet për dhënien e koncesioneve nga organizatat ndërkombëtare në emër të tyre dhe për llogari të tyre. Megjithatë, është e nevojshme të sqarohet se në çfarë mase kjo direktivë duhet të zbatohet për vendimet e koncesionit që rregullohen nga rregulla të caktuara ndërkombëtare.
- (44) Dhënia e koncesioneve për disa shërbime audio-vizuale dhe radio nga ofruesit duhet të lejojë aspekte të rëndësishme kulturore ose sociale që do të merren në konsideratë, gjë që e bën zbatimin e rregullave për dhënien e koncesioneve të papërshtatshme. Për këto arsye, një përjashtim për këtë arsye duhet të bëhet për koncesionet e shërbimeve, akorduar nga vetë ofruesit e shërbimeve media, për blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e programeve dhe shërbime të tjera përgatitore, siç janë

ato që lidhen me Scripts apo shfaqje artistike të nevojshme për prodhimin e programit. Gjithashtu duhet të sqarohet se përjashtimi duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë, për të transmetuar shërbime mediatike dhe shërbime on-demand (shërbime jo-lineare). Megjithatë, përjashtimi nuk duhet të zbatohet për furnizimin e pajisjeve teknike të nevojshme për prodhimin, bashkë-prodhimin dhe transmetimin e programeve të tilla.

- (45) Kjo Direktivë nuk cenon kompetencën e Shteteve Anëtare për të siguruar financimin e transmetimit të shërbimit publik, për aq sa një financim i tillë i është dhënë organizatave të transmetimit për përmbushjen e kompetencave të shërbimit publik, të përcaktuara dhe të organizuara nga çdo Shtet Anëtar në përputhje me Protokollin Nr 29 mbi sistemin e transmetimit publik në shtetet anëtare aneksuar në TFBE dhe TEU.
- (46) Ka pasiguri të konsiderueshme ligjore për mënyrën se si kontratat e lidhura midis subjekteve në sektorin publik tani duhet të mbulohen nga rregullat për koncesionet. Jurisprudenca përkatëse e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian është interpretuar në mënyra të ndryshme ndërmjet shteteve anëtare, madje edhe ndërmjet autoriteteve ose subjekteve kontraktuese. Prandaj është e nevojshme për të sqaruar në cilat raste kontratat e lidhura në sektorin publik nuk janë subjekt i zbatimit të rregullave të përcaktuara në këtë Direktivë. Një sqarim i tillë duhet të udhëhiqet nga parimet e përcaktuara në jurisprudencën përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Vetëm fakti që të dy palët në një marrëveshje janë vetë autoritete publike, nuk e përjashton mundësinë e zbatimit të rregullave të përcaktuara në këtë Direktivë. Megjithatë, zbatimi i këtyre rregullave nuk duhet të ndërhyjë në lirinë e autoriteteve kontraktore për të kryer detyrat e shërbimit publik, duke përdorur burimet e tyre, ku përfshihet mundësia e bashkëpunimit me autoritetet e tjera kontraktore. Duhet të sigurohet se çdo bashkëpunim i përjashtuar publik-publik nuk rezulton në një shtrembërim të konkurrencës në lidhje me operatorët ekonomikë privatë për aq kohë sa vendoset një ofrues privat i shërbimeve në një pozitë avantazhi në raport me konkurrentët e tij.
- (47) Koncesionet që i jepen personave juridikë të kontrolluar nuk duhet të jenë subjekt i aplikimit të procedurave të parashikuara në këtë direktivë, nëse autoriteti kontraktues ose subjekti kontraktues siç referohet në pikën (a) të

nenit 7 (1) ushtron kontroll mbi personin juridik në fjalë, të ngjashëm me atë që ai ushtron mbi departamentet e veta me kusht që personi juridik i kontrolluar të kryejë më shumë se 80% të aktiviteteve që i janë besuar atij nga autoriteti kontraktues ose njësisia ekonomike kontrolluese apo nga persona të tjerë juridikë të kontrolluar nga autoriteti kontraktues ose entitet kontraktuese, pavarësisht nga përfituesit e performancës së kontratës. Përjashtimi nuk duhet të shtrihet në situatat ku ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë nga një operator ekonomik privat në kapitalin e personit juridik të kontrolluar, për dhënien e një koncesioni pa procedurë konkurruese, pasi do ti jepte operatorit ekonomik privat me pjesëmarrje kapitali në personin juridik të kontrolluar një avantazh të parregullt mbi konkurrentët e tij. Megjithatë, duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të organeve publike me anëtarësim të detyrueshëm, siç janë organizatat përgjegjëse për menaxhimin ose ushtrimin e shërbimeve të caktuara publike, kjo nuk duhet të zbatohet në rastet kur pjesëmarrja e operatorëve të veçantë ekonomike privatë në kapitalin e personit juridik të kontrolluar është bërë i detyrueshëm nga një dispozitë kombëtare legjislative në përputhje me Traktatet, me kusht që një pjesëmarrje e tillë është jo-kontrolluese, jo bllokuese dhe nuk jep një ndikim vendimtar në vendimet e personit juridik të kontrolluar. Duhet edhe më tej të qartësohet se elementi vendimtar është vetëm pjesëmarrja direkte private në personin juridik të kontrolluar.

(48) Prandaj, ku ka pjesëmarrje me kapital privat në autoritetin kontraktues apo njësinë ekonomike kontrolluese, nuk përjashtohet dhënia e kontratave publike personit juridik të kontrolluar, pa zbatuar procedurat e parashikuara nga kjo Direktivë, pasi një pjesëmarrje e tillë nuk do të ndikojë negativisht në konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë privatë. Gjithashtu duhet të qartësohet se autoritetet kontraktore ose subjekte të tilla si organet e rregulluara nga e drejta publike, që mund të kenë pjesëmarrje private në kapitalin kontraktues, duhet të jenë në gjendje të mbrojnë veten nga përjashtimi për bashkëpunim horizontal. Rrjedhimisht, kur të gjitha kushtet e tjera në lidhje me bashkëpunimin horizontal janë plotësuar, përjashtimi nga ky i fundit duhet të shtrihet në autoritete kontraktuese ose subjekte kontraktuese kur kontrata është lidhur ekskluzivisht mes tyre.

(49) Autoritetet apo subjektet kontraktuese të përmendur në pikën (a) të nenit 7 (1) duhet të jenë në gjendje të zgjedhin për të ofruar shërbimet e tyre publike

së bashku, me anë të bashkëpunimit, pa qenë të detyruar të përdorin ndonjë formë të veçantë ligjore. Një bashkëpunim i tillë mund të mbulojë të gjitha llojet e aktiviteteve që kanë të bëjnë me kryerjen e shërbimeve dhe përgjegjësitë e përcaktuara ose të marra nga autoritetet, të tilla si punët e detyrueshme ose vullnetare të autoriteteve lokale ose rajonale ose shërbimet e dhëna për organet e veçanta të së drejtës publike. Shërbimet e ofruara nga subjektet që marrin pjesë nuk duhet domosdoshmërisht të jenë identike; ata gjithashtu mund të jenë plotësues. Kontratat për ofrimin e përbashkët të shërbimeve publike nuk duhet të jenë subjekte të kësaj direktive me kusht që ato të jenë lidhur ekskluzivisht mes autoriteteve kontraktuese apo subjekteve kontraktuese, që zbatimi i këtij bashkëpunimi të jetë qeverisur vetëm nga konsiderata që kanë të bëjnë me interesin publik dhe se nuk ka ofrues të shërbimit privat që të jetë vendosur në një avantazh vis-à-vis me konkurrentët e tij. Për të përmbushur këto kushte, bashkëpunimi duhet të bazohet në një koncept bashkëpunues. Një bashkëpunim i tillë nuk kërkon që të gjitha autoritetet pjesëmarrëse të marrin përsipër përmbushjen e obligimeve kryesore të kontratës, me kusht që të ketë angazhime që kontribuojnë në drejtim të performancës të shërbimit publik në fjalë. Përveç kësaj, zbatimi i bashkëpunimit, duke përfshirë çdo transfertë financiare ndërmjet autoriteteve kontraktuese që marrin pjesë, duhet të qeveriset vetëm nga konsiderata që kanë të bëjnë me interesin publik.

- (50) Ekzistojnë disa raste kur një person juridik vepron sipas dispozitave përkatëse të ligjit kombëtar, si një instrument apo shërbim teknik për autoritetet e caktuara kontraktuese, dhe është i detyruar të kryejë urdhrat e dhënë nga ato autoritete pa pasur asnjë ndikim në shpërbllim për punën e tij. Duke pasur parasysh natyrën e saj jo-kontraktuale, një marrëdhënie e tillë thjesht administrative nuk duhet të rregullohet nga procedurat e dhënies së koncesionit.
- (51) Duhet sqaruar se nocioni i “operatorëve ekonomikë” duhet të interpretohet në mënyrë të gjerë, që të përfshijë çdo person dhe / ose subjekt, të cilët ofrojnë kryerjen e punimeve, furnizimin e produkteve ose ofrimin e shërbimeve në treg, pavarësisht nga forma juridike në të cilën ata kanë zgjedhur për të vepruar. Kështu, firmat, degët, filialet, partneritetet, bashkimet e shoqërive, kompanitë e kufizuara, universitetet, publike ose private, dhe forma të tjera të subjekteve duhet të gjitha të bien në nocionin e

operatorit ekonomik, pavarësisht nëse janë apo jo "persona juridikë" në të gjitha rrethanat.

- (52) Për të siguruar reklamat e duhura të punimeve dhe shërbimeve të koncesioneve të barabarta ose më lart se një prag i caktuar i dhënë nga subjektet kontraktuese, duhet që dhënia e koncesioneve të tilla të paraprihet nga publikimi i detyrueshëm i njoftimit të koncesionit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.
- (53) Në pikëpamje të efekteve të dëmshme për konkurrencën, dhënia e koncesioneve pa publikimin paraprak duhet të lejohet vetëm në rrethana shumë të jashtëzakonshme. Ky përjashtim duhet të jetë i kufizuar në rastet në të cilat është e qartë që nga fillimi se një botim nuk do të shkaktonte më shumë konkurrencë, në veçanti për shkak se nuk është objektivisht vetëm një operator ekonomik që mund të kryejë koncesionin. Pamundësia e dhënies me koncesion tek çdo operator tjetër ekonomik nuk duhet të ketë qenë e krijuar nga vetë autoriteti kontraktues në funksion të procedurës së prokurimit për të ardhmen. Për më tepër, disponueshmëria e zëvendësuesit të përshtatshëm duhet të vlerësohet tërësisht.
- (54) Kohëzgjatja e koncesionit duhet të kufizohet për të shmangur mbylljen e parakohshme dhe kufizimin e konkurrencës. Përveç kësaj, koncesionet me një kohëzgjatje shumë të gjatë kanë të ngjarë të rezultojnë në mbylljen e parakohshme të tregut, dhe në këtë mënyrë mund të pengojnë lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe lirinë e themelimit. Megjithatë, një kohëzgjatje e tillë mund të jetë e justifikuar në qoftë se ajo është e domosdoshme për ti mundësuar koncesionarit të mbledhë investimet e planifikuara për të kryer, si dhe për të marrë një kthim mbi kapitalin e investuar. Si pasojë, për koncesione me një kohëzgjatje më të madhe se pesë vjet, kohëzgjatja duhet të jetë e kufizuar në periudhën në të cilën koncesionari në mënyrë të arsyeshme pritet të mbledhë investimin e bërë për funksionimin e punëve dhe shërbimeve së bashku me një kthim mbi kapitalin e investuar në kushte normale të operimit, duke marrë parasysh objektivat specifike kontraktuale të ndërmarra nga ai, në mënyrë që të plotësojë kërkesat në lidhje me, për shembull, cilësinë ose çmimin për përdoruesit. Vlerësimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e dhënies së koncesionit. Duhet të jetë e mundur të përfshihen investime fillestare dhe të mëtejshme të konsideruara të

nevojshme për operimin e koncesionit, të shpenzimeve të veçanta në infrastrukturë, të drejtat e autorit, patentat, pajisje, logjistikë, punësim, trajnimin e personelit dhe shpenzimet fillestare. Kohëzgjatja maksimale e koncesionit duhet të tregohet në dokumentet e koncesionit nëse është përdorur si kriter për dhënien e kontratës. Autoritetet kontraktuese dhe entitetet kontraktuese duhet të jetë gjithmonë në gjendje për të dhënë një koncesion për një periudhë më të shkurtër se koha e nevojshme për të mbledhur investimet, me kusht që kompensimi i lidhur të mos eliminojë rrezikun operativ.

(55) Është e përshtatshme të përjashtohen nga zbatimi i plotë i kësaj Direktive vetëm ato shërbime të cilat kanë një dimension të kufizuar ndërkufitar, të tilla si shërbime të caktuara sociale, shëndetësore, apo arsimore. Këto shërbime janë ofruar në një kontekst të veçantë që ndryshon gjerësisht ndërmjet shteteve anëtare, për shkak të traditave të ndryshme kulturore. Prandaj, duhet të përcaktohet një regjim i veçantë për koncesionet për këto shërbime, i cili merr parasysh faktin se ata janë të rregulluar rishtazi. Detyrimi për të publikuar njoftimin paraprak të informacionit dhe njoftimin për dhënien e ndonjë koncesioni me vlerë të barabartë ose më të madhe se sa pragu vendosur në këtë Direktivë, është një mënyrë e përshtatshme për të siguruar informacionin e ofertuesve të mundshëm, si dhe për të dhënë informacion për të gjitha palët e interesuara për numrin dhe llojin e kontratave të dhëna. Për më tepër, Shtetet Anëtare duhet të vendosin masat e duhura në lidhje me dhënien e kontratave koncesionare për këto shërbime, që kanë për qëllim sigurimin e përputhshmërisë me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke lejuar autoritetet kontraktuese dhe entitetet kontraktuese që të marrin në konsideratë specifikat e shërbimeve në fjalë. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që autoritetet kontraktuese dhe subjektet kontraktuese janë të lejuara të marrin parasysh nevojën për të siguruar rrishtë dhe, në përputhje me nenin 14 të TFBE dhe Protokollin Nr 26, një nivel të lartë të cilësisë, sigurisë dhe përbalueshmërisë, trajtimit të barabartë dhe promovimit të aksesit universal dhe të drejtat e përdoruesve.

(56) Duke pasur parasysh rëndësinë e kontekstit kulturor dhe ndjeshmërinë e këtyre shërbimeve, Shteteve Anëtare duhet t'i jepet liri veprimi e gjerë për të organizuar zgjedhjen e ofruesve të shërbimeve në mënyrën që ata e

konsiderojnë më të përshtatshme. Kjo Direktivë nuk i pengon Shtetet Anëtare nga zbatimi i kriterëve specifike të cilësisë për zgjedhjen e ofruesit të shërbimeve, të tilla si kriteret e përcaktuara në Kuadrin Evropian të Cilësisë për Shërbime Sociale të Komitetit të Bashkimit Evropian për Mbrojtjen Sociale. Shtetet anëtare dhe / ose autoritetet publike janë të lirë për të ofruar këto shërbime vetë apo për të organizuar shërbimet sociale në një mënyrë që nuk shkakton përfundimin e koncesioneve, për shembull, përmes financimit të shërbimeve të tilla ose me dhënien e licencave ose autorizimeve të gjithë operatorëve ekonomikë që plotësojnë kushtet e përcaktuara paraprakisht nga subjekti kontraktues, pa ndonjë kufizim apo kuota, me kusht që sistemet e tilla të sigurojnë reklama të mjaftueshme dhe të përputhen me parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit.

- (57) Me synim integrimin e duhur të kërkesave mjedisore, sociale dhe të punës në procedurat e dhënies së koncesionit, është e një rëndësie të veçantë që shtetet anëtare dhe autoritetet kontraktuese ose subjektet kontraktuese të marrin masat përkatëse për të siguruar përputhshmërinë me detyrimet e legjislacionit mjedisor, social dhe të punës që zbatohet në vendin ku punimet ose shërbimet e ofruara janë ekzekutuar dhe të rezultojë nga ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative, në nivel kombëtar dhe të BE, si dhe nga marrëveshjet kolektive, me kusht që zbatimi i këtyre rregullave të bëhet në përputhje me ligjin e BE-së. Në mënyrë të barabartë, detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga të gjitha Shtetet Anëtare dhe të listuara në këtë Direktivë duhet të zbatohen gjatë kryerjes së koncesionit. Megjithatë, kjo nuk duhet në asnjë mënyrë të pengojë zbatimin e termave dhe kushteve të punësimit të cilat janë më të favorshme për punëtorët. Masat përkatëse duhet të zbatohen në përputhje me parimet themelore të ligjit të Unionit, në veçanti me synimin për të siguruar trajtim të barabartë. Këto masa përkatëse duhet të zbatohen në përputhje me Direktivën 96/71/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, dhe në një mënyrë që siguron trajtim të barabartë dhe nuk diskriminon drejtpërdrejtë ose tërthorazi operatorët ekonomikë dhe punëtorët e Shteteve të tjera Anëtare.
- (58) Shërbimet duhet të konsiderohen se do të ofrohen në vendin ku shfaqjet karakteristike janë ekzekutuar. Kur shërbimet ofrohen në distancë, për shembull shërbimet e ofruara nga qendrat e thirrjes, ato duhet të

konsiderohen që do të ofrohen në vendin ku shërbimet janë ekzekutuar, pavarësisht nga vendet dhe shtetet anëtare të cilave u janë drejtuar.

- (59) Detyrimet përkatëse mund të pasqyrohen në klauzolat e koncesionit. Duhet gjithashtu të jetë e mundur për të përfshirë klauzola që sigurojnë përputhshmërinë me marrëveshjet kolektive, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian në koncesione. Mosrespektimi i detyrimeve përkatëse mund të konsiderohet si shkelje e rëndë nga ana e operatorit ekonomik në fjalë, përgjegjës për përjashtimin e këtij operatori ekonomik nga procedura për dhënien e një koncesioni.
- (60) Kontrolli i respektimit të dispozitave ligjore mjedisore, sociale dhe të punës duhet të kryhet në fazat përkatëse të procedurës për dhënien e koncesionit, kur aplikohen parimet e përgjithshme që rregullojnë zgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave dhe kur zbatohen kriteret e përjashtimit.
- (61) Asgjë në këtë Direktivë nuk duhet të pengojë vendosjen ose zbatimin e masave të nevojshme për të mbrojtur politikat publike, jetën, moralin publik, sigurinë publike, shëndetin e njeriut dhe të kafshëve, ruajtjen e jetës bimore ose masa të tjera mjedisore, në mënyrë të veçantë me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm, me kusht që këto masa të jenë në përputhje me TFBE.
- (62) Për të siguruar konfidencialitetin gjatë procedurës, autoritetet dhe subjektet kontraktuese, si dhe operatorët ekonomik nuk duhet të japin informacion shpjegues që është përcaktuar si konfidencial. Mos respektimi i këtij detyrimi shkakton zbatimin e sanksioneve adekuate, si dhe ku parashikohet sipas ligjit civil apo administrativ të shteteve anëtare.
- (63) Në mënyrë që të luftohet mashtrimi, favorizimet dhe korrupsioni dhe për të parandaluar konfliktet e interesit, Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e duhura për të siguruar transparencën e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e barabartë të të gjithë kandidatëve dhe tenderuesve. Masa të tilla duhet të synojnë eliminimin e konfliktit të interesit dhe parregullsive të tjera të rënda.
- (64) Në mënyrë që të bëhet e mundur për të gjithë operatorët e interesuar të paraqesin aplikimet dhe tenderët, autoritetet kontraktuese dhe subjektet

kontraktuese duhet të jenë të detyruar të respektojnë një afat minimal kohor për pranimin e kërkesave dhe ofertave të tilla.

- (65) Zgjedhja e kriterëve proporcionale, jodiskriminuese dhe të drejta të përzgjedhjes, dhe zbatimi i tyre për operatorët ekonomikë është vendimtar për aksesin efektiv të këtyre operatorëve ndaj mundësive ekonomike që lidhen me koncesionet. Në veçanti, mundësia për një kandidat të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera mund të jetë vendimtare për të mundësuar pjesëmarrjen e BVM-ve. Prandaj, është e përshtatshme të sigurohet që kriteret e përzgjedhjes duhet të lidhen vetëm me aftësinë profesionale e teknike dhe gjendjen financiare dhe ekonomike të operatorëve, dhe të jenë të lidhura me objektin e kontratës, duhet të shpallen në njoftimin e koncesionit dhe nuk mund të ndalojnë një operator ekonomik, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve të tij me këto subjekte, nëse ky i fundit i rezulton autoritetit ose subjektit kontraktues që do të ketë në dispozicion të tij, burimet e nevojshme.
- (66) Për më tepër, me qëllim integrimin më të mirë të konsideratave sociale dhe mjedisore në procedurat e dhënies me koncesion, autoritetet kontraktuese ose subjektet kontraktuese duhet të lejohen të përdorin kriteret e dhënies apo kushtet e performancës në lidhje me punimet apo shërbimet që do të ofrohen sipas kontratës së koncesionit, në çdo aspekt dhe në çdo fazë të ciklit të tyre, nga nxjerrja e lëndëve të para për produktin deri në fazën e fundit të produktit, duke përfshirë faktorët e procesit të veçantë të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të këtyre punëve ose shërbimeve, ose një procesi të caktuar gjatë një fazë të mëvonshme të ciklit të tyre të jetës, edhe kur faktorë të tillë nuk do të formojnë një pjesë të substancës së tyre materiale. Kriteret dhe kushtet që i referohen një procesi të tillë prodhimi apo ofrimi janë për shembull shërbimet objekt i koncesionit që janë dhënë duke përdorur makina me energji-efektive. Në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, gjithashtu përfshihen kriteret e dhënies apo kushtet e performancës së koncesionit në lidhje me përdorimin e produkteve të tregtisë së drejtë gjatë rrjedhës së tij. Kriteret dhe kushtet në lidhje me tregtimin dhe kushtet e tij mund t'i referohen për shembull kërkesave për të paguar një çmim minimal dhe prim çmimesh për nënkontraktorët. Kushtet e

performancës në koncesion kanë të bëjnë me çështjet e mjedisit dhe mund të përfshijnë, për shembull, minimizimin e mbetjeve ose efikasitetin e burimeve.

- (67) Kriteret e dhënies ose kushtet e performancës së koncesionit në lidhje me aspektet sociale të procesit të prodhimit duhet të zbatohen në përputhje me Direktivën 96/71/EC, siç është interpretuar nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, dhe nuk duhet të zgjidhen ose zbatohen në një mënyrë që diskriminon direkt ose indirekt operatorët ekonomikë nga shtetet e tjera anëtare ose nga vendet palë të treta për Marrëveshjen e Organizatës Botërore të Tregtisë për Prokurimin Publik (të "GPA") ose të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë, me të cilat Bashkimi Evropian është palë. Kështu, kërkesat në lidhje me kushtet e punës të rregulluara në Direktivën 96/71/EC, të tilla si të paga minimale, duhet të mbeten në nivelin e përcaktuar nga legjislacioni kombëtar ose nga marrëveshjet kolektive të zbatuara në përputhje me të drejtën e Unionit, në kontekstin e kësaj Direktive. Kushtet e performancës së koncesionit mund të kenë si qëllim favorizimin e zbatimit të masave për promovimin e barazisë së grave dhe burrave në punë, rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës si dhe rakordimin e punës dhe jetës private, mbrojtjen e mjedisit apo kafshëve, mirëqenien dhe përputhjen në thelb me Konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), dhe rekrutimin e më shumë personave në nevojë se sa kërkohet sipas legjislacionit kombëtar.
- (68) Masat që synojnë mbrojtjen e shëndetit të personelit të përfshirë në procesin e kryerjes së koncesionit, favorizimin e integritit social të personave të pafavorizuar ose anëtarët e grupeve të rrezikuara ndërmjet personave të caktuar për kryerjen e koncesionit ose trajnimin për krijimin e aftësive të nevojshme për koncesionin në fjalë, mund të jenë subjekt i kriterëve për dhënien apo për kushtet e performancës me kusht që ato të kenë të bëjnë me veprat apo shërbimet që do të ofrohen në bazë të koncesionit. Për shembull, kritere apo kushte të tilla mund t'i referohen, ndër të tjera, punësimit afatgjatë të punëkërkesve, zbatimit të masave të trajnimit për personat e papunë apo të rinjtë përgjatë koncesionit. Në specifikimet teknike autoritetet kontraktore mund të sigurojnë kërkesa të tilla shoqërore të cilat karakterizojnë direkt produktin apo shërbimin në fjalë, të tilla si aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose për të gjithë përdoruesit.

- (69) Kërkesat teknike dhe funksionale të hartuara nga autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktuese duhet të lejojnë që dhënia me koncesion të jetë e hapur ndaj konkurrencës. Këto kërkesa duhet të përcaktojnë karakteristikat e kërkuara të punimeve dhe / ose shërbimet e mbuluara nga koncesioni, dhe mund t'i referohet procesit të veçantë të prodhimit ose sigurimit të punimeve ose shërbimeve të kërkuara, me kusht që ato të jenë të lidhura me objektin e koncesionit dhe në proporcion me vlerën dhe objektivat e tij. Procesi i veçantë i prodhimit mund të përfshijë kërkesat në lidhje me aksesin për personat me aftësi të kufizuara, ose nivelet e performancës mjedisore. Këto kërkesa teknike dhe funksionale duhet të përfshihen në dokumentet e koncesionit dhe duhet të jenë në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Ato duhet të hartohen të tilla që të shmangin ngushtimin artificial të konkurrencës, në veçanti përmes kërkesave që favorizojnë një operator të caktuar ekonomik duke pasqyruar karakteristikat kryesore të furnizimeve, shërbimeve ose punëve që ofrohen zakonisht nga ky operator ekonomik. Në çdo rast, tenderat e përbërë nga veprat dhe / ose shërbimet, duke përfshirë furnizimet, të cilat janë të rastësishme për punime dhe shërbime të tilla, që përputhen në mënyrë ekuivalente me karakteristikat e kërkuara, duhet të merren parasysh nga autoritetet ose subjektet kontraktuese.
- (70) Koncesionet janë zakonisht afatgjatë, marrëveshje komplekse ku koncesionari merr përgjegjësitë dhe rreziqet që lindin tradicionalisht nga autoritetet dhe entitetet kontraktuese dhe që normalisht bien brenda veprimtarisë së tyre. Për këtë arsye, në përputhje me këtë direktivë dhe me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë, autoritetet dhe entitetet kontraktuese duhet të lejojnë fleksibilitet të konsiderueshëm për të përcaktuar organizimin e procedurës që çon në zgjedhjen e koncesionarit. Megjithatë, për të siguruar trajtim të barabartë dhe transparencë gjatë procesit të dhënies së koncesionit, është e përshtatshme të sigurohet garanci themelore si në procesin e përzgjedhjes, duke përfshirë informacion mbi natyrën dhe objektin e koncesionit, kufizimin e numrit të kandidatëve, shpërndarjen e informacionit për kandidatët dhe ofertuesit dhe disponueshmërinë e të dhënave të duhura. Është gjithashtu e nevojshme të sigurohet se kushtet fillestare të njoftimit të koncesionit duhet të

respektohen, me qëllim parandalimin e trajtimit të padrejtë të ndonjë kandidati të mundshëm.

- (71) Koncesionet nuk duhet t'i jepen operatorëve ekonomikë që kanë marrë pjesë në një organizatë kriminale ose janë gjetur fajtorë për korrupsion, mashtrim në dëm të interesave financiare të BE, vepra terroriste, pastrim të parave, financim të terrorizmit apo trafikim të qenieve njerëzore. Megjithatë, Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje për të siguruar një përjashtim nga këto kushte të detyrueshme në situata të jashtëzakonshme, kur kërkesat thelbësore në interesin e përgjithshëm e bëjnë dhënien e kontratës të domosdoshme. Mospagesa e tatimeve ose e kontributeve të sigurimeve shoqërore duhet të sanksionohet me përjashtim të detyrueshëm në nivel Unioni.
- (72) Për më tepër, autoriteteve kontraktore dhe subjekteve kontraktuese duhet t'u jepet mundësia për të përjashtuar operatorët ekonomikë të cilët janë provuar si jo të besueshëm, për shembull për shkak të shkeljeve të rënda ose të përsëritura të detyrimeve mjedisore ose sociale, duke përfshirë rregullat mbi aksesin për personat me aftësi të kufizuara ose forma të tjera të sjelljes së keqe dhe të rëndë profesionale, të tilla si shkelje të rregullave të konkurrencës apo të drejtave të pronësisë intelektuale. Duhet sqaruar se një sjellje e gabuar profesionale mund ta vendosë integritetin e një operatori ekonomik në pikëpyetje dhe kështu e bën atë të papërshtatshëm për të marrë çmimin e një kontrate koncesioni pavarësisht nëse operatori ekonomik do ti kishte kapacitetet teknike dhe ekonomike për të realizuar kontratën. Duke pasur parasysh se autoriteti ose subjekti kontraktues është përgjegjës për pasojat e vendimeve të mundshme të gabuara, ata duhet të mbeten të lirë për të konsideruar nëse ka pasur shkelje të rëndë profesionale, atëherë kur përpara një vendimi përfundimtar dhe detyruet në prani të bazave të përjashtimit të detyrueshëm, ata mund të demonstrojnë me mjete të duhura që operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij, duke përfshirë detyrimet lidhur me pagimin e tatimeve ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, përveç kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni kombëtar. Autoritetet kontraktore dhe entitetet kontraktuese duhet gjithashtu të jenë në gjendje të përjashtojnë kandidatët ose ofertuesit, puna e të cilëve në koncesione të mëparshme apo kontrata të tjera me autoritetet kontraktore ka treguar mangësi të mëdha në lidhje me kërkesat thelbësore, për shembull dështimi

për të ofruar apo për të kryer, probleme madhore të produktit ose shërbimit të dorëzuar, duke e bërë të papërdorshëm për qëllimin e synuar, apo sjellje e keqe që hedh dyshime serioze për besueshmërinë e operatorit ekonomik. Legjislacioni kombëtar duhet të sigurojë një kohëzgjatje maksimale për përjashtime të tilla.

(73) Megjithatë, duhet të bëhet kompensimi për të krijuar mundësinë që operatorët ekonomikë të miratojnë masa të pajtueshmërisë që synojnë korrigjimin e pasojave të ndonjë vepre penale apo shkeljeje dhe parandalimin në mënyrë efektive të dukurive të tjera të sjelljes së keqe. Këto masa mund të përfshijnë në veçanti masa të personelit dhe organizative të tilla si përjashtimin e të gjitha lidhjeve me personat ose organizatat e përfshira në sjellje të keqe, masat e duhura të riorganizimit të stafit, zbatimin e raportimit dhe sistemeve të kontrollit, krijimin e një strukture të auditimit të brendshëm për të monitoruar pajtueshmërinë dhe miratimin e përgjegjësive dhe kompensimit të rregullave të brendshme. Kur masa të tilla ofrojnë garanci të mjaftueshme, operatori ekonomik në fjalë nuk duhet të përjashtohet vetëm mbi këto arsye. Operatorët ekonomikë duhet të kenë mundësi të kërkojnë që masat e përputhshmërisë të marra me qëllim pranimin e mundshëm në procedurën e dhënies me koncesion të shqyrtohen. Megjithatë, duhet t'u lihet Shteteve Anëtare të përcaktojnë kushtet e sakta procedurale dhe thelbësore të zbatueshme në raste të tilla. Në mënyrë të veçantë, ata duhet të jenë të lirë për të vendosur nëse do të lejojnë autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese të kryejnë vlerësimet përkatëse ose t'ia besojnë autoriteteve të tjera në nivel qendror ose të decentralizuar.

(74) Është e rëndësishme që respektimi nga nënkontraktorët i detyrimeve të aplikueshme në legjislacionin mjedisor, social dhe të punës, të përcaktuara me ligjin e Unionit, atë kombëtar, marrëveshjet kolektive ose nga dispozitat e legjislacionit ndërkombëtar mjedisor, social dhe të punës të listuar në këtë Direktivë, me kusht që rregulla të tilla, si dhe zbatimi i tyre, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian, të sigurohen me anë të veprimeve të duhura nga autoritetet kombëtare kompetente brenda fushëveprimit të përgjegjësive dhe kompetencave të tyre, të tilla si agjencitë e inspektoriatit të punës ose agjencitë e mbrojtjes së mjedisit. Është gjithashtu e nevojshme të sigurohet transparencë në zinxhirin e nënkontraktimit, pasi kjo i jep autoriteteve kontraktore informacione mbi ata që janë të pranishëm në vendet e

ndërtimit, cfarë pune janë duke kryer, ose se cilat ndërmarrje janë duke ofruar shërbime në ndërtesa, infrastruktura apo fusha, të tilla si bashkitë, shkollat komunale, objektet sportive, portet apo autostradat, për të cilat autoritetet kontraktore janë përgjegjëse, apo të cilat i kanë nën mbikëqyrje. Duhet sqaruar se detyrimi për të dhënë informacionin e kërkuar është në çdo rast detyrë e koncesionarit, qoftë në bazë të dispozitave të veçanta, që çdo autoritet kontraktor duhet të përfshijë në të gjitha procedurat e dhënies, ose në bazë të obligimeve që Shtetet anëtare do të vendosin mbi koncesionarin me norma përgjithësisht të aplikueshme.

- (75) Gjithashtu duhet të qartësohet se kushtet në lidhje me zbatimin e respektimit të detyrimeve në fuqi në fushën e legjislacionit mjedisor, social dhe të punës, të përcaktuara me ligjin e Unionit, atë kombëtar, marrëveshjet kolektive ose me dispozitat ndërkombëtare të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës të listuara në këtë direktivë, me kusht që rregullat të tilla dhe zbatimi i tyre në përputhje me të drejtën e Unionit, duhet të zbatohen sa herë që ligji kombëtar i një Shteti Anëtar parashikon një mekanizëm të përgjegjësishë së përbashkët midis nënkontraktorëve dhe koncesionarit. Për më tepër, duhet të shprehet në mënyrë të qartë se Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje për të shkuar më tej, për shembull duke zgjeruar detyrimet e transparencës apo duke bërë të mundur ose ti kërkojnë autoriteteve kontraktore të verifikojnë se nënkontraktuesit nuk janë në ndonjë nga situatat në të cilat përjashtimi i operatorëve ekonomikë është i garantuar. Kur këto masa zbatohen për nënkontraktorët, në koherencë me dispozitat e aplikueshme të koncesionarit duhet të sigurohet që ekzistenca e arsyeve të detyrueshme të përjashtimit do të pasohet nga një kërkesë që koncesionari të zëvendësojë nënkontraktorin në fjalë. Kur një verifikim i tillë tregon praninë e bazave jo të detyrueshme për përjashtim, duhet të sqarohet se autoritetet kontraktore mund të kërkojnë zëvendësimin. Megjithatë, po ashtu duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë se autoritetet kontraktore mund të jenë të detyruara të kërkojnë zëvendësimin e nënkontraktorit në fjalë, kur përjashtimi i koncesionarit është i detyrueshëm në raste të tilla. Gjithashtu duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë që Shtetet Anëtare mbeten të lira për të siguruar rregulla me përgjegjësi më të rrepta sipas ligjit kombëtar.

- (76) Autoritetet kontraktore apo subjektet kontraktuese duhet të vlerësojnë tenderat në bazë të një ose disa kriterëve të dhënies së kontratës. Për të

siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë, kriteret për dhënien e koncesioneve gjithmonë duhet të jenë në përputhje me disa standarde të përgjithshme. Këto standarde mund t'i referohen faktorëve që nuk janë thjesht ekonomikë, por që ndikojnë në vlerën e një tenderi nga pikëpamja e autoritetit kontraktor dhe të lejojnë atë për të identifikuar një avantazh të përgjithshëm ekonomik në subjektin kontraktues. Kriteret duhet të shpalosen paraprakisht për të gjithë kandidatët e mundshëm ose ofertuesit, të jenë të lidhura me objektin e kontratës dhe nuk duhet të ofrojnë për autoritetin kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato duhet të lejojnë konkurrencë efektive dhe të shoqërohen me kërkesat që lejojnë informatat e ofruara nga ofertuesit për t'u verifikuar në mënyrë efektive. Duhet të jetë e mundur të përfshihen në kriteret e dhënies, ndër të tjera, kriteret mjedisore, sociale apo risi relevante. Autoritetet kontraktore duhet të tregojnë kriteret e dhënies në rend zbritës sipas rëndësisë në mënyrë që të sigurojnë trajtimin e barabartë të ofertuesve të mundshëm, duke i lejuar ata të jenë të vetëdijshëm për të gjitha elementet që duhet të merren parasysh kur të përgatisin ofertat e tyre. Në raste të veçanta kur autoriteti kontraktor pranon një tender, i cili propozon një zgjidhje inovative me një nivel të jashtëzakonshëm performance funksionale që nuk mund të jenë parashikuar nga ai, autoriteti kontraktor duhet, përjashtimisht, të jetë në gjendje për të ndryshuar rendin e kriterëve të dhënies duke marrë parasysh mundësitë e reja të sjella nga kjo zgjidhje inovative, me kusht që një modifikim i tillë të sigurojë trajtim të barabartë të të gjithë tenderuesve aktualë apo të mundshëm, duke lëshuar një ftesë të re për tender ose, kur është e përshtatshme, duke botuar një njoftim të ri për koncesion.

- (77) Mjetet elektronike të informimit dhe komunikimit në masë të madhe mund të lehtësojnë publikimin e koncesioneve dhe të rrisin efektivitetin, shpejtësinë dhe transparencën e proceseve të dhënies me koncesion. Ato mund të bëhen mjetet standarde të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit në procedurat e dhënies së koncesionit, si dhe të rrisin mundësitë e operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në procedurat e dhënies së koncesionit në të gjithë tregun e brendshëm.
- (78) Kontratat e koncesionit zakonisht përfshijnë marrëveshje teknike dhe financiare komplekse dhe afatgjata, të cilat shpesh janë objekt i ndryshimit të rrethanave. Prandaj është e nevojshme për të sqaruar kushtet në të cilat

modifikimet e një koncesioni gjatë performancës së tij kërkojnë një procedurë të re për dhënien me koncesion, duke marrë parasysh jurisprudencën përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Një procedurë e re e koncesionit është e nevojshme në rastin e ndryshimeve materiale të koncesionit fillestar, në veçanti në fushën dhe përmbajtjen e të drejtave reciproke dhe detyrimeve të palëve, duke përfshirë shpërndarjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Ndryshime të tilla demonstronjë qëllimin e palëve për të ri-negociuar afatet ose kushtet thelbësore të atij koncesioni. Ky është rasti, kur kushtet e ndryshuara do të kishin një ndikim në rezultatin e procedurës, po të kishin qenë pjesë e procedurës fillestare. Ndryshimet e koncesionit që rezultojnë në një ndryshim të vogël të vlerës së kontratës deri në një vlerë të nivelit të caktuar duhet të jenë gjithmonë të mundura pa pasur nevojë për të kryer një procedurë të re koncesioni. Për këtë qëllim dhe për sigurinë juridike, kjo Direktivë duhet të ofrojë pragjet minimale, nën të cilët një procedurë e re nuk është e nevojshme. Ndryshimet e koncesionit mbi këto pragje duhet të jenë të mundura pa pasur nevojë për të kryer një procedurë të re, në atë masë që një modifikim i tillë të jetë në përputhje me kushte të caktuara. Ky mund të jetë, për shembull, rasti i modifikimeve, të cilat janë bërë të domosdoshme pas nevojës për të akomoduar kërkesat nga autoritetet kontraktore, në lidhje me kërkesat e sigurisë dhe duke marrë në konsideratë specifikat e aktiviteteve të tilla si, funksionimin e sportit malor dhe objekteve turistike, ku legjislacioni mund të zhvillohet për të adresuar rreziqet e lidhura, për aq sa ndryshime të tilla përputhen me kushtet përkatëse të përcaktuara në këtë Direktivë.

- (79) Autoritetet kontraktore mund të përballen me rrethana të jashtme që nuk mund të parashikohen kur japin një koncesion, në veçanti kur performanca e koncesionit mbulon një periudhë të gjatë. Në ato raste, një shkallë e caktuar fleksibiliteti është e nevojshme për t'iu përshtatur këtyre rrethanave, pa një procedurë të re koncesioni. Ky nocion i referohet rrethanave që nuk mund të ishin parashikuar, pavarësisht përgatitjes së arsyeshme nga subjekti kontraktor, duke marrë parasysh mjetet në dispozicion, natyrën dhe karakteristikat e projektit specifik, praktikën e mira në fushat në fjalë dhe nevojën për të siguruar një marrëdhënie të duhur midis burimeve të nevojshme për koncesionin dhe vlerën e parashikueshme të tij. Megjithatë, kjo nuk mund të zbatohet në rastet kur një modifikim rezulton në një

ndryshim të natyrës së koncesionit në përgjithësi, për shembull duke zëvendësuar punët që do të ekzekutohen ose shërbimet që do të ofrohen nga diçka tjetër, ose duke ndryshuar rrënjësisht llojin e koncesionit që, në një situatë të tillë, mund të supozohet një ndikim hipotetik në rezultat. Për koncesionet e dhëna me qëllim për të ndjekur një aktivitet tjetër nga ata të përmendur në Aneksin II, çdo rritje në vlerë që nuk kërkon një procedurë të re koncesioni, nuk duhet të jetë më e lartë se 50% e vlerës së koncesionit fillestar. Kur janë bërë disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të zbatohet për vlerën e çdo modifikimi. Një modifikim i tillë i njëpasnjëshëm nuk duhet të synojë shmangien nga kjo Direktivë.

- (80) Në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, ofertuesi i suksesshëm nuk duhet, për shembull kur një koncesion është ndërprerë për shkak të mangësive në performancë, të zëvendësohet nga një tjetër operator ekonomik pa rihapjen e koncesionit për konkurrentët. Megjithatë, ofertuesi i suksesshëm për kryerjen e koncesionit duhet të jetë në gjendje, në mënyrë të veçantë kur ai është akorduar për një grup operatorësh ekonomikë, të pësojë ndryshime strukturore gjatë kryerjes së koncesionit, të tilla si riorganizime të brendshme, sipërmarrje, bashkime dhe blerje ose paaftësi paguese. Këto ndryshime strukturore nuk kërkojnë automatikisht procedura të reja për dhënien me koncesion.
- (81) Autoritetet kontraktore dhe entitetet kontraktuese duhet të kenë mundësinë për të siguruar ndryshime në një koncesion me anë të shqyrtimit apo klauzolave, por klauzola të tilla nuk duhet ti japin atyre liri të pakufizuar. Kjo Direktivë duhet të përcaktojë deri në çfarë mase modifikimet mund të jepen në koncesionet fillestare. Duhet rrjedhimisht të sqarohet që hartimi në mënyrë të qartë i shqyrtimeve apo klauzolave mund të sigurojë për shembull indeksimin e çmimeve ose të sigurojë që pajisjet e komunikimit që do të dërgohen gjatë një periudhe të caktuar vazhdojnë të jenë e përshtatshme, edhe në rastin e ndryshimit të protokolleve të komunikimit ose ndryshimeve të tjera teknologjike. Duhet gjithashtu të jetë e mundur që nëpërmjet klauzolave mjaft të qarta të sigurohen përshtatje të koncesionit, të cilat janë bërë të nevojshme për shkak të vështirësive teknike që janë shfaqur gjatë operacionit apo mirëmbajtjes. Duhet të kujtojmë se koncesionet për shembull, mund të përfshijnë edhe mirëmbajtjen e zakonshme si dhe të

sigurojnë një ndërhyrje për mirëmbajtjen e jashtëzakonshme që mund të bëhet e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e një shërbimi publik.

- (82) Autoritetet kontraktore dhe entitetet kontraktuese mund të përballen me situata ku këto punime ose shërbime shtesë bëhen të nevojshme. Në raste të tilla, me kusht që kushtet e përcaktuara në këtë Direktivë të jenë plotësuar, një modifikim i koncesionit fillestar pa një procedurë të re për dhënien e koncesionit konsiderohet të jetë i justifikuar.
- (83) Autoritetet kontraktore dhe entitetet kontraktuese janë përballur edhe me rrethana që kërkojnë ndërprerjen e hershme të koncesionit në mënyrë që të zbatohen detyrimet ligjore të Bashkimit Evropian në fushën e koncesioneve. Prandaj, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që autoritetet kontraktore të kenë mundësi, nën kushtet e përcaktuara me legjislacionin kombëtar, për të përfunduar një koncesion gjatë mandatit të tij, nëse kërkohet nga ligji Unionit.
- (84) Për të siguruar mbrojtje adekuate gjyqësore të kandidatëve dhe tenderuesve në procedurat për dhënien e koncesionit, si dhe për të bërë efektiv zbatimin e kësaj Direktive dhe të parimeve të TFBE, Direktiva e Këshillit 89/665/EEC dhe Direktiva e Këshillit 92/13/EEC duhet të zbatohen për koncesionet e shërbimeve dhe punëve për koncesionet e dhëna nga autoritetet kontraktore. Direktivat 89/665/EEC dhe 92/13/EEC duhet, pra, të ndryshohen në përputhje me rrethanat.
- (85) Përpunimi i të dhënave personale në pajtim me këtë Direktivë duhet të rregullohet nga Direktiva 95/46/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit.
- (86) Shtetet anëtare duhet të monitorojnë vazhdimisht dhe sistematikisht zbatimin dhe funksionimin e rregullave për dhënien e kontratave të koncesionit për të siguruar zbatimin eficient dhe të njëtrajtshëm të ligjit të Unionit.
- (87) Komisioni duhet të vlerësojë efektet ekonomike në tregun e brendshëm, në veçanti për sa i përket faktorëve të tillë si dhënia e kontratave ndërkufitare, pjesëmarrja e NVM-ve dhe kostot e transaksionit, që rezultojnë nga zbatimi i pragjeve të përcaktuara në këtë direktivë, dhe nga përjashtimi i përcaktuar në nenin 12, duke marrë parasysh strukturat e veçanta të sektorit të ujit.

Komisioni duhet të raportojë mbi të në Parlamentin Evropian dhe Këshill deri më 18 prill 2019. Në përputhje me Nenin XXIV (7) të GPA, GPA do të jetë objekt i bisedimeve të mëtejshme tre vjet pas hyrjes në fuqi dhe periodikisht më pas. Në këtë kontekst, përshtatshmëria e nivelit të pragjeve duhet të shqyrtohet në kontekstin e negociatave nën GPA duke pasur parasysh ndikimin e shpenzimeve të inflacionit dhe të transaksioneve. Komisioni duhet, kur është e mundur dhe e përshtatshme, të konsiderojë sugjerimin e një rritje të pragjeve të aplikueshme nën GPA gjatë raundit të ardhshëm të bisedimeve. Në rast të ndonjë ndryshimi të këtyre pragjeve, raporti i bërë nga Komisioni duhet të pasohet nga një propozim legjislativ që modifikon prapun e përcaktuar në këtë Direktivë.

- (88) Në mënyrë që t'u përshtatet zhvillimeve të shpejta teknike, ekonomike dhe rregullatore, fuqia për të miratuar akte në përputhje me nenin 290 TFBE duhet t'i delegohet Komisionit në lidhje me rishikimin e listës së akteve të përcaktuara në Shtojcën III, rishikimin e procedurave teknike për metodat e llogaritjes në lidhje me prapun, si dhe rishikimin periodik të pragut, ndryshimin e referencave të nomenklaturës FPP dhe përshtatjen e listës së akteve të përcaktuara në Shtojcën X. Është me rëndësi të veçantë që Komisioni të kryejë konsultimet e duhura gjatë punës së tij përgatitore, përfshirë edhe në nivel ekspertësh. Komisioni, gjatë përgatitjes dhe hartimit të akteve të deleguara, duhet të sigurojë një transmetim të njëkohshëm, në kohën e duhur të dokumenteve përkatëse të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.
- (89) Në mënyrë që të sigurojë kushte të njëjta në lidhje me procedurën e hartimit dhe transmetimit të njoftimeve dhe dërgimin e publikimin e të dhënave të përmendura në Shtojcën V, VII dhe VIII, kompetencat zbatuese duhet ti akordohen Komisionit. Ato duhet të ushtrohen në përputhje me Rregulloren (BE) Nr 182/2011 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Procedura këshilluese duhet të përdoret për miratimin e akteve zbatuese, të cilat nuk kanë ndikim as në gjendjen financiare, as mbi natyrën dhe fushëveprimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Direktivë. Në të kundërt, këto akte karakterizohen nga një qëllim i thjeshtë administrativ dhe do të shërbejnë për të lehtësuar zbatimin e kësaj Direktive.

- (90) Duke qenë se objektivi i kësaj Direktive, përkatësisht koordinimi i ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare që zbatohen për procedurat e caktuara koncesionare nuk mund të arrihet mjaftueshëm nga Shtetet Anëtare, por mund që për shkak të shkallës dhe efekteve të tij, të arrihet më mirë në nivelin e Unionit, ky i fundit mund të miratojë masa, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të TEU. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, siç përcaktohet në këtë nen, kjo Direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për të arritur këtë objektivi.
- (91) Në përputhje me Deklaratën Politike të përbashkët të shteteve anëtare dhe Komisionit për dokumentet shpjeguese të 28 shtatorit 2011, Shtetet Anëtare kanë marrë përsipër për të shoqëruar, në raste të justifikuara, njoftimin e masave të zhvendosjes me një ose më shumë dokumente që të shpjegojnë marrëdhënien midis komponentëve të Direktivës dhe pjesëve përkatëse të instrumenteve nacionale të zhvendosjes. Në lidhje me këtë Direktivë, ligjvënësi e konsideron transmetimin e dokumenteve të tilla të justifikueshëm.

KANË ADOPTUAR KËTË DIREKTIVË

TITULLI I: LËNDA, FUSHA, PARIMET DHE PËRKUFIZIMET

KAPITULLI I: Qëllimi, parimet e përgjithshme dhe përkufizimet

SEKSIONI I: LËNDA, FUSHA, PARIMET E PËRGJITHSHME, PËRKUFIZIME DHE PRAGU

Neni 1: Lënda dhe fushëveprimi

Neni 2: Parimi i administratës së lirë nga autoritetet publike

Neni 3: Parimi i trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës

Neni 4: Liria për të përcaktuar shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik

Neni 5: Përkufizimet

Neni 6: Autoritetet kontraktore

Neni 7: Subjektet kontraktuese

Neni 8: Pragu dhe metodat për përcaktimin e vlerës së koncesioneve

Neni 9: Rishikimi i pragut

NENI II: PËRJASHTIMET

Neni 10: Përfjashtimet e zbatueshme për koncesionet e dhëna nga autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktuese

Neni 11: Përfjashtime specifike në fushën e komunikimeve elektronike

Neni 12: Përfjashtime specifike në fushën e ujërave

Neni 13: Koncesionet e dhëna për filialin e një kompanie

Neni 14: Koncesionet e dhëna për një sipërmarrje të përbashkët ose një subjekti kontraktues, pjesë e një sipërmarrjeje të përbashkët

Neni 15: Njoftimi i informacionit nga subjektet kontraktuese

Neni 16: Përfjashtimi i aktiviteteve të cilat janë të ekspozuara direkt ndaj konkurrencës

Neni 17: Koncesionet ndërmjet subjekteve brenda sektorit publik

NENI III: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 18: Kohëzgjatja e koncesionit

Neni 19: Shërbime sociale dhe shërbime të tjera të veçanta

Neni 20: Kontratat e përziera

Neni 21: Kontratat e përziera të prokurimit që përfshijnë aspekte të mbrojtjes ose të sigurisë

Neni 22: Kontratat që mbulojnë të dy aktivitetet e referuara në Aneksin II dhe aktivitete të tjera

Neni 23: Koncesionet që mbulojnë të dy veprimtaritë e referuara në Shtojcën II dhe aktivitetet që përfshijnë aspekte të mbrojtjes ose të sigurisë

PJESA IV: Situata të veçanta

Neni 24: Koncesionet e rezervuara

Neni 25: Hulumtimi dhe zhvillimi i shërbimeve

KREU II: Parimet

Neni 26: Operatorët ekonomikë

Neni 27: Nomenklaturat

Neni 28: Konfidencialiteti

Neni 29: Rregullat e zbatueshme për komunikim

TITULLI II: RREGULLAT E DHËNIES SË KONCESIONEVE: PARIMET E PËRGJITHSHME DHE GARANCITË PROCEDURALE**KAPITULLI I: Parimet e përgjithshme**

Neni 30: Parimet e përgjithshme

Neni 31: Njoftimet e koncesionit

Neni 32: Njoftimet për dhënie koncesioni

Neni 33: Forma dhe mënyra e publikimit të njoftimeve

Neni 34: Disponueshmëria elektronike e dokumenteve të koncesionit

Neni 35: Lufta kundër korrupsionit dhe parandalimi i konfliktit të interesit

KREU II: Garancitë procedurale

Neni 36: Kërkesat funksionale dhe teknike

Neni 37: Garancitë procedurale

Neni 38: Përzgjedhja dhe vlerësimi cilësor i kandidatëve

Neni 39: Afatet kohore për pranimin e kërkesave dhe ofertave për koncesion

Neni 40: Sigurimi i informacionit për kandidatët dhe tenderuesit

Neni 41: Kriteret e përzgjedhjes

TITULLI III: RREGULLAT PËR KRYERJEN E KONCESIONEVE

Neni 42: Nënkontraktimi

Neni 43: Ndryshimi i kontratave gjatë mandatit të tyre

Neni 44: Ndërprerja e koncesioneve

Neni 45: Monitorimi dhe Raportimi

TITULLI IV: Amendamentet e Direktivave 89/665/EEC dhe 92/13/EEC

Neni 46: Ndryshimet në Direktivën 89/665/EEC

Neni 47: Ndryshimet në Direktivën 92/13/EEC

TITULLI V: KOMPETENCAT E DELEGUARA, KOMPETENCAT ZBATUESE DHE DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 48: Ushtrimi i delegimit

Neni 49: Procedura urgjente

Neni 50: Procedura e Komitetit

Neni 51: Zhvendosja

Neni 52: Dispozita kalimtare

Neni 53: Monitorimi dhe raportimi

Neni 54: Hyrja në fuqi

Neni 55: Të adresuarit

SHTOJCAT:

SHTOJCA I: LISTA E AKTIVITETEVE TË PËRMENDURA NË PIKËN (7) TË NENIT 5

SHTOJCA II: AKTIVITETET E USHTRUARA NGA SUBJEKTET KONTRAKTUESE REFERUAR NË NENIN 7

SHTOJCA III: LISTA E AKTEVE JURIDIKE TË BASHKIMIT REFERUAR NË PIKËN (B) TË NENIT 7 (2)

SHTOJCA IV: SHËRBIMET REFERUAR NË NENIN 19

SHTOJCA V: INFORMACIONI PËR T'U PËRFSHIRË NË NJOFTIMET PËR KONCESION PËRMENDUR NË NENIN 31

SHTOJCA VI: INFORMACIONI PËR TU PËRFSHIRË NË NJOFTIMET PARAPRAKE NË LIDHJE ME KONCESIONET, PËR SHËRBIME SOCIALE DHE SHËRBIME TË TJERA TË VEÇANTA, SIÇ ËSHTË PARAQITUR NË NENIN 31 (3)

SHTOJCA VII: INFORMACIONI PËR T'U PËRFSHIRË NË NJOFTIMET PËR DHËNIEN ME KONCESION, SIÇ REFEROHET NË NENIN 32

SHTOJCA VIII: INFORMACIONI PËR T'U PËRFSHIRË NË NJOFTIMET PËR DHËNIEN ME KONCESION NË LIDHJE ME LËSHIMET PËR SHËRBIME SOCIALE DHE SHËRBIME TË TJERA TË VEÇANTA, SI ËSHTË PARAQITUR NË NENIN 32

SHTOJCA IX: KARAKTERISTIKA NË LIDHJE ME PUBLIKIMIN

SHTOJCA X: LISTA E KONVENTAVE NDËRKOMBËTARE MJEDISORE REFERUAR NË NENIN 30 (3)

SHTOJCA XI: INFORMACIONI PËR T'U PËRFSHIRË NË NJOFTIMET E MODIFIKIMEVE TË NJË KONCESIONI GJATË KOHËZGJATJES SË TIJ SIPAS NENIT 43

TITULLI I**LËNDA, FUSHËVEPRIMI, PARIMET DHE PËRKUFIZIMET****KAPITULLI I****Fushëveprimi, parimet e përgjithshme dhe përkufizimet****Seksioni I****Lënda, qëllimi, parimet e përgjithshme, përkufizimet dhe pragu****Neni 1****Objekti dhe qëllimi**

1. Kjo direktivë përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet kontraktore dhe subjektet nëpërmjet një koncesioni, vlera e të cilit është vlerësuar të jetë jo më pak se pragu i përcaktuar në nenin 8.

2. Kjo Direktivë zbatohet për dhënien e koncesioneve të punëve ose shërbimeve, të operatorëve ekonomikë nga:

(A) Autoritetet kontraktore; ose

(B) Subjektet kontraktuese, me kusht që punimet apo shërbimet të jenë të destinuar për ushtrimin e një prej aktiviteteve të përmendura në Shtojcën II.

3. Zbatimi i kësaj Direktive është subjekt i nenit 346 TFBE.

4. Marrëveshjet, vendimet apo instrumente të tjera ligjore që organizojnë transferimin e kompetencave dhe përgjegjësive për kryerjen e detyrave publike midis autoriteteve kontraktore ose subjekteve kontraktuese apo grupimeve të autoriteteve kontraktore, dhe të cilat nuk parashikojnë shpërblim, janë konsideruar si një çështje e organizimit të brendshëm të Shtetit Anëtar në fjalë dhe, si të tilla, nuk janë prekur në asnjë mënyrë nga kjo Direktivë.

Neni 2

Parimi i administratës së lirë nga autoritetet publike

1. Kjo Direktivë njuh parimin e administrimit të lirë nga autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale, në përputhje me ligjin kombëtar dhe të Bashkimit Evropian. Këto autoritete janë të lira të vendosin për të menaxhuar sa më mirë kryerjen e punimeve ose ofrimin e shërbimeve, për të siguruar në mënyrë të veçantë një nivel të lartë të cilësisë, sigurisë dhe përbalueshmërisë, trajtimin e barabartë dhe promovimin e qasjes universale dhe të të drejtave të përdoruesve të shërbimeve publike. Këto autoritete mund të zgjedhin për të kryer detyrat e tyre me interes publik me burimet e tyre, ose në bashkëpunim me autoritetet e tjera, ose t'ia japin ato operatorëve ekonomikë.
2. Kjo Direktivë nuk ndikon në sistemet e pronësisë së Shteteve Anëtare. Në mënyrë të veçantë ajo nuk kërkon privatizimin e ndërmarreve publike që ofrojnë shërbime për publikun.

Neni 3

Parimi i trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës

Autoritetet kontraktore dhe entitetet kontraktuese i trajtojnë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, pa i diskriminuar dhe veprojnë në mënyrë transparente dhe proporcionale. Dizajni i procedurës për dhënie të koncesionit, duke përfshirë vlerësimin e vlerës, nuk do të bëhet me qëllim për të përjashtuar atë nga objekti i kësaj Direktive ose favorizuar padrejtësisht ose dëmtuar operatorët ekonomikë të caktuar ose vepra të caktuara, furnizime apo shërbime.

Autoritetet kontraktore dhe entitetet kontraktuese do të synojnë sigurimin e transparencës së procedurës së prokurimit dhe të performancës së kontratës, në pajtueshmëri me nenin 28.

Neni 4

Liria për të përcaktuar shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik

1. Kjo Direktivë nuk ndikon në lirinë e Shteteve Anëtare për të përcaktuar, në përputhje me të drejtën e Unionit, atë që ata e konsiderojnë të jetë shërbim me

interes të përgjithshëm ekonomik, mënyrën se si duhet të organizohen dhe financuar këto shërbime, në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore, dhe obligimet specifike që duhet të ketë subjekti. Po ashtu, kjo Direktivë nuk ndikon në mënyrën, me të cilën Shtetet Anëtare organizojnë sistemet e tyre të sigurimeve shoqërore.

2. Shërbimet jo-ekonomike të interesit të përgjithshëm do të bien jashtë fushëveprimit të kësaj Direktive.

Neni 5

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Direktive zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

(1) "*koncesion*" do të thotë dhënie punimesh ose shërbimesh, siç është përcaktuar në pikat (a) dhe (b):

(A) "*koncesion pune*" është një kontratë me shpërblim, e lidhur me shkrim, me të cilën një ose më shumë autoritete kontraktore ose subjekte kontraktuese u besojnë kryerjen e punimeve një ose më shumë Operatorëve ekonomikë, e cila mund të konsistojë vetëm në të drejtën për të shfrytëzuar veprat që janë objekt i kontratës ose këtë të drejtë bashkë me pagesën;

(B) "*koncesion shërbimi*" është një kontratë me shpërblim, e lidhur me shkrim, me të cilën një ose më shumë autoritete kontraktore ose subjekte kontraktuese u besojnë sigurimin dhe menaxhimin e shërbimeve të tjera një ose më shumë operatorëve ekonomikë, shqyrtimi i të cilave mund të konsistojë vetëm në të drejtën për të shfrytëzuar shërbimet që janë objekt i kontratës ose këtë të drejtë bashkë me pagesën.

Çmimi i punëve ose shërbimeve të koncesionit do të përfshijë transferimin tek koncesionari të një rreziku operativ në shfrytëzimin e këtyre punëve apo shërbimeve që përfshijnë rrezikun e kërkesës apo të furnizimit ose të dyja bashkë. Koncesionari do të konsiderohet se merr përsipër riskun operativ, kur në kushte normale të operimit, ai nuk e ka të garantuar mbledhjen e investimit apo shpenzimeve të bëra në funksion të punimeve apo shërbimeve objekt koncesioni. Pjesa e rrezikut e transferuar tek koncesionari do të përfshijë ekspozimin e vërtetë

tek problemet e tregut, në mënyrë të tillë që çdo humbje potenciale e shkaktuar nga koncesionari nuk do të jetë thjesht nominale ose e papërfillshme;

(2) "*operator ekonomik*" nënkupton çdo person fizik ose juridik, ose organ publik, ose grup personash, duke përfshirë shoqatat e përkohshme të ndërmarrjeve, i cili ofron kryerjen e punëve, furnizimin e produkteve ose ofrimin e shërbimeve në treg;

(3) '*kandidat*' nënkupton një operator ekonomik që ka kërkuar të ftohet ose është ftuar të marrë pjesë në një procedurë koncesioni;

(4) "*Ofertuesi*" nënkupton operatorin ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin;

(5) "*Koncesionari*" nënkupton operatorin ekonomik të cilit i është dhënë një koncesion;

(6) "*shkruar*" ose "*me shkrim*" është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen, përfshirë informacionin i cili transmetohet ose ruhet në mënyrë elektronike;

(7) "*kryerja e punëve*" nënkupton ekzekutimin, projektimin apo të dyja, të punimeve në lidhje me një prej aktiviteteve të referuara në Shtojcën I ose realizimin, me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e specifikuar nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues dhe ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektimin e punës;

(8) "*një punë*" nënkupton rezultatin e ndërtimit ose veprat civile të marra në tërësi, gjë e cila është e mjaftueshme në vetvete për të përmbushur një funksion ekonomik ose teknik;

(9) "*mjet elektronik*" nënkupton një pajisje elektronike për përpunimin (duke përfshirë kompresimin shifror) dhe ruajtjen e të dhënave, të cilat janë transmetuar, përcjellë me telegraf, me radio, me mjete pamore, ose me mjete të tjera elektromagnetike;

(10) "*e drejtë ekskluzive*" nënkupton të drejtën e dhënë nga një autoritet kompetent i një Shteti Anëtar me anë të ligjit, rregulloreve apo dispozitave administrative të publikuara, e cila është në përputhje me Traktatet, efekti i të cilave synon të kufizojë ushtrimin e një aktiviteti të një operatori të vetëm

ekonomik dhe që në thelb ndikon në aftësinë e operatorëve të tjerë ekonomikë për të kryer një aktivitet të tillë;

(11) "*e drejtë e veçantë*" do të thotë një e drejtë e dhënë nga një autoritet kompetent i një Shteti Anëtar me anë të ligjit, rregulloreve apo dispozitave administrative të publikuara, e cila është në përputhje me Traktatet, efekti i të cilëve synon të kufizojë ushtrimin e një aktiviteti të dy ose më shumë operatorëve ekonomikë dhe që në thelb ndikon në aftësinë e operatorëve të tjerë ekonomikë për të kryer një aktivitet të tillë;

(12) "*dokument koncesioni*" është çdo dokument i prodhuar ose i referuar nga subjekti kontraktues ose autoriteti kontraktor për të përshkruar apo të përcaktuar elementet e koncesionit ose procedurës, duke përfshirë njoftimin e koncesionit, kërkesat teknike dhe funksionale, kushtet e propozuara të koncesionit, formatet për paraqitjen e dokumenteve nga kandidatët dhe ofertuesit, informacionin mbi detyrimet në fuqi dhe çdo dokument tjetër shtesë;

(13) "*risi*" do të thotë zbatimi i një produkti të ri ose të përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, shërbimi apo procesi, që përfshin prodhimin por jo vetëm, ndërtimin ose proceset e ndërtimit me një metodë të re marketingu, ose një metodë të re organizative në praktikat e biznesit, organizimit në vendin e punës ose marrëdhënieve me jashtë, ndër të tjera, me qëllim për të ndihmuar në zgjidhjen e sfidave shoqërore, ose për të mbështetur strategjinë Evropa 2020.

Neni 6

Autoriteti kontraktor

1. Për qëllim të kësaj Direktive, "*autoritet kontraktor*" do të thotë autoritet shtetëror, rajonal ose lokal, organ i cili rregullohet nga e drejta publike ose shoqatat e formuara nga një ose më shumë autoritete ose nga një ose më shumë organe të cilat rregullohen nga e drejta publike, përveç atyre autoriteteve, organe apo shoqata të cilat ndjekin një nga veprimtaritë e referuara në Aneksin II dhe marrin një koncesion për ndjekjen e një prej këtyre aktiviteteve.

2. “Autoriteti rajonal” përfshin të gjitha autoritetet e njësive administrative të listuara në mënyrë jo taksative në NUTS 1 dhe 2, të përcaktuara në Ligjin (EC) Nr 1059/2003 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit³.
3. “Autoriteti lokal” përfshin të gjitha autoritetet e njësive administrative të cilat bëjnë pjesë të NUTS 3 dhe njësitë më të vogla administrative, të cilat referohen në Ligjin (EC) Nr. 1059/2003.
4. “Organe që rregullohen nga e drejta publike” janë organet që kanë të gjithë karakteristikat e mëposhtme:
- janë krijuar për qëllime specifike në përputhje me nevojat e interesin e përgjithshëm, nuk kanë karakter tregtar;
 - kanë personalitet juridik;
 - pjesa më e madhe financohen nga autoritetet shtetërore, rajonale apo lokale, ose nga organe që rregullohen nga e drejta publike; ose janë subjekt i mbikëqyrjes nga këto organe ose autoritetet; ose kanë një bord administrativ, menaxherial, mbikëqyrës, më shumë se gjysma e anëtarëve të të cilit janë emëruar nga autoritetet shtetërore, rajonale ose lokale, ose nga organe të tjera të cilat rregullohen nga e drejta publike.

Neni 7

Subjekti Kontraktues

1. Për qëllim të kësaj direktive, “entitetet kontraktuese” janë subjekte të cilat ndjekin një nga aktivitetet e përmendur në Aneksin II dhe kanë marrë një koncesion për ndjekjen e një prej aktiviteteve, të cilat mund të jenë si më poshtë:
- autoritet shtetërore, rajonal ose lokal, organe të cilat rregullohen nga e drejta publike ose shoqatat e formuara nga një ose më shumë autoritete ose nga një ose më shumë organe të cilat rregullohen nga e drejta publike;
 - ndërmarrjet publike të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni;

³Ligji (EC) Nr 1059/2003 i Parlamentit Europian dhe i Këshillit, 26 maj 2003, mbi krijimin e një klasifikimi të përbashkët të njësive territoriale për statistikat (NUTS) (OJ L 154, 21.06.2013, fq.1).

c) subjekte të tjera nga ato të cilat përmenden në pikat a) dhe b) të këtij paragrafi, por që veprojnë mbi bazën e të drejtat ekskluzive, dhënë për ushtrimin e një prej aktivitetet të përmendura në Aneksin II.

2. Subjekteve të cilave u janë dhënë të drejta të veçanta ose ekskluzive me anë të një procedure në të cilën është garantuar publiciteti i mjaftueshëm dhe kur dhënia e këtyre të drejtave është bazuar në kritere objektive nuk do të konsiderohen 'subjekte kontaktuese në kuptimin e pikës c) të paragrafit 1. Procedura të tilla duhet të përfshijnë:

- a) procedurat e prokurimit me ftesë paraprake për konkurrim, në përputhje me Direktivën 2014/24/EU të Parlamentit Europian dhe të Këshillit⁴, Direktivën 2014/25/EU, Direktivën 2009/81/EC ose këtë Direktivë;
- b) procedurat bazuar në akte të tjera ligjore të Bashkimit listuara në Aneksin III, duke siguruar transparencë adekuate paraprake për dhënien e autorizimeve në bazë të kritereve objektive.

3. Komisioni duhet të jetë i autorizuar të miratojë akte nënligjore në pajtim me nenin 48 në lidhje me ndryshimet në listat e akteve ligjore të Bashkimit të përcaktuara në Aneksin III, kur është e nevojshme për shkak të shfuqizimit ose ndryshimit të këtyre akteve, ose për shkak të miratimit të akteve të reja.

4. "Ndërmarrje publike" do të thotë çdo ndërmarrje mbi të cilën autoritetet kontraktore mund të ushtrojnë, direkt ose indirekt, një ndikim dominues mbi bazë të pronësisë së tyre, pjesëmarrjes financiare në të apo për shkak të rregullave të cilat e rregullojnë ndërmarrjen në fjalë.

Një ndikim mbizotërues nga ana e autoriteteve kontraktore prezumohet në rastet e mëposhtme, në të cilat autoritetet, direkt ose indirekt:

- a) zotërojnë shumicën e kapitalit të ndërmarrjes;
- b) kontrollojnë shumicën e votave nga aksionet e emetuara nga ndërmarrja;

⁴Direktiva 2014/24/EU e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2014, mbi prokurimin publik (shih faqen 65 të kësaj Gazete Zyrtare).

- c) mund të emërojnë më shumë se gjysmën e administratorëve, menaxherëve ose mbikëqyrësve.

Neni 8

Pragu dhe metodat për llogaritjen e vlerës së parashikuar të koncesioneve

1. Kjo direktivë zbatohet për koncesionet vlera e të cilit është e barabartë ose më e madhe se 5,186,000 Euro.

2. Vlera e një koncesioni do të jetë totali i qarkullimve të koncesionarit të gjeneruar gjatë kohëzgjatjes së kontratës, pa TVSH, siç vlerësohet nga autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues, duke mbajtur në konsideratë punët dhe shërbimet që janë objekt i koncesionit, si dhe një rezervë për punimet apo shërbimet e pa planifikuara.

Ky vlerësim do të jetë i vlefshëm në momentin kur njoftimi për koncesionin është dërguar, ose në rastet kur ky njoftim nuk është i parashikuar, në momentin në të cilin autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues fillon procedurat për dhënien e koncesionit, për shëmbull duke kontaktuar operatorët ekonomikë në lidhje me koncesionet.

Për qëllim të paragrafit 1, në qoftë se vlera e koncesionit në kohën e dhënies së koncesionit është më e lartë se 20 % e vlerës së parashikuar, llogaritja e vlefshme do të jetë vlera në momentin e dhënies së koncesionit.

3. Vlera e parashikuar e koncesionit do të llogaritet duke përdorur një metodë objektive të specifikuar në dokumentet e koncesionit. Kur llogaritet vlera e parashikuar e koncesionit, autoritetet kontraktore dhe subjekti kontraktues duhet, ku aplikohet, të marrin në konsideratë në mënyrë të veçantë:

- a) vlerën e çdo forme të zgjedhur dhe çdo shtyrje të kohëzgjatjes së koncesionit;
- b) të ardhurat nga pagesa e tarifave dhe gjobave nga përdoruesit e punimeve apo shërbimeve, të ndryshme nga ato të mbledhura në emër të autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktues;
- c) pagesat ose çdo lloj avantazhi financiar i dhënë koncesionarit në çdo lloj forme nga ana e autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktues ose ndonjë autoritet tjetër publik për koncesionin, duke përfshirë edhe kompensimin për

përbushjen e një detyrimi të shërbimit publik dhe subvencionet e investimeve publike;

- d) vlerën e granteve apo ndonjë avantazh tjetër financiar, në çfarëdo forme, nga palët e treta për koncesionin;
- e) të ardhurat nga shitja e çdo aktivi të cilat janë pjesë e koncesionit;
- f) vlerën e të gjithë pajisjeve dhe shërbimeve që janë vënë në dispozicion të koncesionarit nga autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese, me kusht që ato të jenë të nevojshme për zbatimin e punimeve ose sigurimin e shërbimeve;
- g) çdo shpërbllim apo pagesë ndaj kandidatëve ose ofertuesve.

4. Zgjedhja e metodës së përdorur për të llogaritur vlerën e parashikuar të koncesionit nuk do të bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga objekti i kësaj Direktive. Një koncesion nuk mund të ndahet më qëllim për ta evituar atë që të hyjë në fushën e aplikimit të kësaj Direktive, përveç se kur justifikohet nga arsye objektive.

5. Kur një punë ose shërbim i propozuar në koncesion mund të rezultojë në formën e loteve të veçanta, duhet të merret parasysh shuma totale e vlerës së llogaritur për çdo lot.

6. Kur vlera agregate e loteve është e barabartë ose tejkalon pragun e përcaktuar në këtë nen, kjo Direktivë do të zbatohet për dhënien e çdo loti.

Neni 9

Rishikimi i pragut

1. Çdo dy vjet nga 30 Qershor 2013, Komisioni verifikon nëse pragu i përcaktuar në nenin 8 (1) korrespondon me pragun e përcaktuar nga Organizata Botërore e Marrëveshjeve të Tregtisë për Prokurimin Publik (të "GPA") për punët koncesionare dhe kur është e nevojshme, rishikojnë këtë prag në përputhje me këtë nen.

Në përputhje me metodën e llogaritjes të përcaktohet në GPA, Komisioni do të llogarisë vlerën e pragut mbi bazën e vlerës mesatare ditore të Euros, në terma të së drejtës speciale të tërheqjes (SDRs), gjatë një periudhe 24 mujore, ndërprerja më

31 gusht i paraprin rishikimit me efekt nga 1 janari. Vlera e rishikuar e pragut duhet, kur është e nevojshme, të rrumbullakoset deri në të mijtën më të afërt të Euros, në mënyrë që të sigurohet se pragu në fuqi parashikuar nga GPA, shprehur në SDR, është observuar.

2. Çdo dy vjet nga 1 Janari 2014, Komisioni do të përcaktojë vlerat, në monedhat kombëtare të Shteteve anëtare, monedha e të cilëve nuk është Euro, për pragun që referohet në nenin 8 (1), rishikuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Në përputhje me metodën e llogaritjes që përcaktohet në GPA, përcaktimi i vlerave të tilla duhet të bazohet në mesataren e vlerave ditore të këtyre monedhave, të cilat korrespondojnë me pragun e aplikueshëm të shprehur në euro përgjatë 24 muajve, pas 31 gushtit të mëparshëm dhe ndryshimi hyn në fuqi në 1 janar.

3. Komisioni do të publikojë pragun e rishikuar të përmendur në paragrafin 1, vlerën e tij në monedhat kombëtare të përmendura në nënparagrafin e parë të paragrafit të 2-të dhe vlera e përcaktuar në përputhje me nënparagrafin e dytë të paragrafit të 2-të, në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian* në fillim të muajit nëntor.

4. Komisioni do të autorizohet të miratojë akte në përputhje me nenin 48 për të zbatuar metodologjinë e përcaktuar në nënparagrafin e dytë të paragrafit 1 të këtij neni, për çdo ndryshim në metodologjinë e ofruar në GPA për rishikimin e pragut të përmendur në nenin 8 (1) dhe për përcaktimin e vlerave korresponduese në monedhat kombëtare të shteteve anëtare, monedha e të cilëve nuk është euro, siç referohet në paragrafin 2 të këtij neni.

Komisioni gjithashtu do të jetë i autorizuar të miratojë akte në përputhje me nenin 48, të rishikojë pragun e referuar në nenin 8 (1) në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

5. Kur është i nevojshëm ndryshimi i këtij pragu dhe kufizimet kohore nuk lejojnë përdorimin e procedurës së parashikuar në nenin 48, dhe arsye të rëndësishme urgjence e kërkojnë, procedura e parashikuar në nenin 49 zbatohet dhe aktet e deleguara e të adoptuara sipas paragrafit 4, nënparagrafit të dytë të këtij neni.

Seksioni II**Përfashtimet****Neni 10****Përfashtimet e zbatueshme për koncesionet e dhëna nga autoritetet kontraktore dhe subjekti kontraktues**

1. Kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet e shërbimeve të dhëna për një autoritet kontraktor ose për një subjekt kontraktues, të përmendur në pikën (a) të nenit 7 (1) ose për një shoqatë të organeve të mësipërme në bazë të një të drejte ekskluzive.

Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet e shërbimeve të dhëna për një operator ekonomik në bazë të një të drejte ekskluzive e cila është dhënë në përputhje me TFEU dhe aktet ligjore të Bashkimit që përcaktojnë rregullat e përbashkëta në lidhje me aksesin në tregun përkatës për aktivitetet e referuara në Aneksin II.

2. Duke anashkaluar nga nënparagrafi i dytë i paragrafit 1 të këtij neni, kur legjislati sektorial i Bashkimit i përmendur në atë nënparagraf nuk parashikon detyrime specifike sektoriale transparente, neni 32 do të zbatohet.

Kur një Shtet anëtar jep një të drejtë ekskluzive për një operator ekonomik për ushtrimin e një prej aktiviteteve të referuara në Aneksin II, ai duhet të informojë Komisionin brenda një muaji pas dhënies së kësaj të drejte ekskluzive.

3. Kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet e shërbimit të transportit ajror, të bazuara në dhënien e një licence operimi brenda kuptimit të Rregullores (EC) Nr 1008/2008 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit⁵ ose të koncesioneve për shërbimet e transportit publik të pasagjerëve sipas kuptimit të Rregullores (EC) Nr. 1370/2007.

4. Kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet, në të cilat autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues është i detyruar për të dhënë ose për tu organizuar në

⁵Rregullorja (EC) Nr 1008/2008 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 24 shtator 2008 mbi rregullat e përbashkëta për operimin e shërbimeve ajrore në Komunitet (OJ L 293 , 31.10.2008 , fq . 3)

përputhje me procedura të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë Direktivë, të përcaktuara nga:

- a) një instrument ligjor i cili krijon detyrime kombëtare ligjore, si një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar në përputhje me TFUE, midis një Shteti anëtar dhe një ose disa vendeve të treta ose në lidhje me punë, furnizime ose shërbime që kanë për qëllim realizimin e përbashkët ose drejtimin e përbashkët të një projekti nga ana nënshkruesve të tyre.
- b) një organizatë ndërkombëtare.

Kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet në të cilat autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues, në përputhje me rregullat e prokurimit të përcaktuara nga një organizatë ndërkombëtare apo institucion ndërkombëtar financimi, kur koncesionet në fjalë janë të financuara plotësisht nga ajo organizatë apo institucion. Në rastin e koncesioneve të bashkë-financuar në pjesën më të madhe nga një organizatë ndërkombëtare apo institucion ndërkombëtar financimi, palët do të bien dakord mbi procedurat e zbatueshme të prokurimit.

Shtetet anëtare duhet të komunikojnë të gjitha instrumentet ligjore të përmendura në pikën (a) të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi të Komisionit, i cili mund të konsultohet me Komitetin Këshillues për Prokurimin Publik të përmendura në nenin 50.

Ky paragraf nuk zbatohet për koncesionet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, siç parashikohet në Direktivën 2009/81/EC.

5. Kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, siç parashikohet në Direktivën 2009/81/EC, të cilat rregullohen nga:

- a) rregulla specifike procedurale në bazë të një marrëveshje ndërkombëtare ose marrëveshje të lidhur ndërmjet një ose më shumë Shtetesh anëtare dhe një ose më shumë vende të treta;
- b) rregulla specifike procedurale në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare apo marrëveshje në lidhje me stacionimin e trupave dhe në lidhje me ndërmarrjet e një Shteti anëtar ose një vendi të tretë ;

c) rregulla të veçanta procedurale të një organizate blerëse ndërkombëtare për qëllimet e veta, ose për koncesionet që duhet të jepen nga një Shtet Anëtar në përputhje me këto rregulla.

6. Kjo Direktivë do të zbatohet për dhënien e koncesioneve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, siç parashikohet në Direktivën 2009/81/EC, me përjashtim sa më poshtë vijon:

- a) koncesionet për të cilat aplikimi i kësaj Direktive do të detyrojë një Shtet anëtar të japë informacione, zbulimin e të cilit e konsideron në kundërshtim me interesat thelbësore të sigurisë së tij; ose kur prokurimi dhe performanca e koncesionit janë deklaruar të jenë të fshehta ose duhet të shoqërohet me masa të veçanta sigurie, në përputhje me ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative në fuqi të një Shteti anëtar me kusht që Shteti anëtar të ketë përcaktuar se interesat thelbësore në fjalë nuk mund të garantohen me masa më pak ndërhyrëse, të tilla si ato të përmendura në paragrafin 7;
- b) koncesionet e dhëna në kuadrin e një programi bashkëpunues të referuara në pikën (c), të nenit 13 të Direktivës 2009/81/EC;
- c) koncesionet e dhëna nga qeveria për një qeveri tjetër në lidhje me punët dhe shërbimet e lidhura drejtpërdrejtë me pajisjet ushtarake ose pajisjet sensitive, apo punët dhe shërbimet posaçërisht për qëllime ushtarake, ose punë sensitive dhe shërbimeve sensitive;
- d) koncesionet e dhëna në një vend të tretë, zbatohen kur forcat janë të vendosura jashtë territorit të Bashkimit, atje ku plotësohen nevojat operationale për vazhdimin e koncesionit bashkë me operatorët ekonomikë të vendosur në zonën e operacioneve; dhe
- e) në të kundërt koncesionet përjashtohen nga kjo Direktivë.

7. Kjo Direktivë nuk zbatohet mbi koncesionet, të cilat nuk përjashtohen sipas paragrafit 6, në masën kur një procedurë e dhënies së koncesionit, parashikuar nga kjo Direktivë nuk mund të garantojë mbrojtjen e interesave thelbësore të sigurisë së një Shteti anëtar me anë të masave më pak ndikuese si vendosja e kushteve që kanë për objekt mbrojtjen e informacioneve të rezervuara që autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues i bën të disponueshëm.

8. Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet e shërbimit për:

- a) blerjen ose marrjen me qira, me çfarëdo mjeti financiar, të tokës, ndërtesave ekzistuese apo pronave të tjera të paluajtshme ose të drejtat që lidhen me to;
- b) blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e programeve të rëndësishme të destinuara për shërbimet mediatike audiovizive apo shërbimet radiofonike, të cilat janë dhënë nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive apo radio, ose koncesionet për kohën e transmetimit ose ofrimit të programeve, të cilat janë dhënë nga ofertuesit e shërbimeve mediatike audiovizive apo radio. Për qëllim të kësaj pike, "shërbimet mediatike audiovizive" dhe "ofruesit e shërbimeve mediatike", respektivisht, do kenë të njëjtin kuptim si në pikat (a) dhe (d) të nenit 1 (1) të Direktivës 2010/13/EU të Parlamentit Europian dhe të Këshillit⁶. "Programi" ka të njëjtin kuptim si në pikën (b) neni 1 (1) të kësaj Direktive, por do të përfshijë edhe programet e radios dhe materialet e programeve të radios. Për më tepër, për qëllime të kësaj dispozite, "materiale të programit" do të kenë të njëjtin kuptim si "program";
- c) shërbime arbitrazhi dhe pajtimi;
- d) ndonjë nga shërbimet ligjore të mëposhtme:
 - i. përfaqësimi ligjor i një klienti nga një avokat brenda kuptimit të nenit 1 të Direktivës së Këshillit 77/249/EEC⁷ në:
 - një arbitrazh ose pajtim i cili mbahet në një Shtet anëtar, në një vend të tretë, ose para një arbitrazhi ndërkombëtar, ose

⁶Direktiva 2010/13/EU e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 10 mars 2010 mbi koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore apo veprime administrative në Shtetet anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizuale (Audiovisual Media Services Directive) (OJ L 95, 15.4.2010, f. 1).

⁷Direktiva e Këshilli 77/249/ EEC e 22 mars 1977 për të lehtësuar ushtrimin efektiv të lirisë për të siguruar shërbime nga avokatët (GZ L 78, 26.3.1977, fq. 17).

- procedurat gjyqësore para gjykatave, tribunaleve ose autoriteteve publike të një Shteti anëtar ose një vendi të tretë ose para gjykatave ndërkombëtare, tribunaleve apo institucioneve;
- ii. dhënien e këshillave ligjore në përgatitjen e ndonjë prej procedurave të përmendura në pikën (i) të kësaj pike, ose kur ka një tregues të prekshëm dhe probabilitet të lartë që çështja për të cilën këshillat do të jepen do të bëhet subjekt i procedurave të tilla, me kushtin që këshillimi të jepet nga një avokat sipas kuptimit të nenit 1 të Direktivës 77/249 / EEC;
- iii. certifikimi i dokumenteve dhe shërbimet e verifikimit që duhet të ofrohen nga noterët;
- iv. shërbimet ligjore të dhëna nga garantuesit ose kujdestarë të përcaktuar ose shërbime të tjera ligjore, dhënësit e të cilave janë përcaktuar nga një organ gjyqësor i Shtetit anëtar të interesuar, ose që janë të përcaktuar sipas ligjit për të kryer detyra konkrete nën mbikqyrjen e këtyre organeve gjyqësore;
- v. shërbime të tjera ligjore të cilat në një Shtet anëtar janë të lidhura, qoftë edhe rastësisht, me ushtrimin e autoritetit zyrtar;
- e) shërbime financiare në lidhje me emetimin, shitjen, blerjen ose transferimin e letrave me vlerë ose instrumenteve të tjera financiare në kuptimit të Direktivës 2004/39/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit⁸, shërbimet e dhëna nga bankat qendrore dhe operacionet e kryera me Fondin Evropian të Stabilizimit Financiar dhe Mekanizmin Evropian të Stabilitetit;
- f) kreditë, nëse janë apo jo, të lidhura me emetimin, shitjen, blerjen ose transferimin e letrave me vlerë ose instrumenteve të tjerë financiarë;
- g) mbrojtjen civile, si dhe shërbime që lidhen me parandalimin e rreziqeve që janë të ofruara nga organizatat jofitimprurëse ose shoqatat, të cilat kanë kodet CPV: 75250000- 3, 75251000-0, 75251100-1, 75251110-4, 75251120- 7,

⁸Direktiva 2004/390/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 prill 2004 në lidhje me tregjet e instrumentet financiarë, e ndryshuar me Direktivat e Këshillit 85/611/EEC dhe 93/6/EEC dhe Direktivën 2000/12/ EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe me Direktivën e shfuqizuar të Këshillit 93/22/EEC (J L 145, 30.04.2004, fq. 1)

75252000-7, 75222000-8, 98113100-9 dhe 85143000-3, përveç shërbimeve të transportit të pacientëve me ambulancë;

- h) shërbimet për fushatat politike, të cilat kanë kodet CPV 79341400-0, 92111230-3 dhe 92111240-6, kur ofrohen nga një parti politike në kontekstin e fushatës zgjedhore.

9. Kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet e shërbimit të llotarive, të cilat kanë kodin CPV 92351100-7, të ofruara nga një Shtet anëtar për një operator ekonomik në bazë të një të drejtë ekskluzive. Për qëllim të këtij paragrafi, nocioni i së drejtës ekskluzive nuk mbulon të drejtat ekskluzive, siç përmendet në nenin 7 (2) .

Dhënia e një të drejte ekskluzive do të bohet në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian*.

10. Kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet e dhëna nga subjekti kontraktues për ndjekjen e aktiviteteve të tyre në një vend në zhvillim, me kusht që nuk duhet të përfshihen në përdorimin fizik të një rrjeti ose zone gjeografike brenda BE-së.

Neni 11

Përfshirjet specifike në fushën e komunikimeve elektronike

Kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet me qëllimin kryesor për të lejuar autoritetet kontraktore të sigurojnë ose të shfrytëzojnë rrjetet e komunikimit publik, ose për ti siguruar publikut një apo më shumë shërbime të komunikimeve elektronike.

Për qëllime të këtij neni, "rrjeti i komunikimit publik" dhe "shërbimit të komunikimeve elektronike " kanë të njëjtin kuptim si në Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit⁹.

⁹Direktiva 2002/21/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 7 mars 2002 mbi një kuadër të përbashkët rregullator për rrjetet e komunikimeve elektronike dhe shërbimet (Framework Directive) (OJ L 108 , 24.4.2002,fq. 33).

Neni 12**Përjashtimet specifike në fushën e ujit**

1. Kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet e dhëna për:
 - a) sigurimin ose rrjete fikse të operimit të cilat kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve për publikun në lidhje me prodhimin, transportin ose shpërndarjen e ujit të pijshëm;
 - b) furnizimin me ujë të pijshëm në këto rrjete.
2. Kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet, për një ose të dyja çështjet më poshtë, kur ato janë të lidhura me një nga aktivitetet e përmendura në paragrafin 1:
 - a) projektet hidraulike inxhinierike, ujitjet apo kullimet e tokës, me kusht që uji i pijshëm të përfaqësojë më shumë se 20% të volumit total të ujit të prodhuar nga këto projekte apo të drenazhimit të instalimeve; ose
 - b) asgjësimin ose trajtimin e ujërave të zeza.

Neni 13**Koncesionet e dhëna për ndërmarrjet e konsoliduara**

1. Për qëllime të këtij neni, "ndërmarrje e lidhur" nënkupton çdo ndërmarrje llogaritë vjetore të të cilave konsolidohen me ato të subjektit kontraktues, në përputhje me kërkesat e Direktivës 2013/34/EU .
2. Në rastin e subjekteve, të cilat nuk janë subjekt i Direktivës 2013/3/EU, "sipërmarrje e lidhur" nënkupton çdo ndërmarrje që :
 - a) direkt ose indirekt, i nënshtrohet një ndikim dominues nga subjekti kontraktues;
 - b) mund të ushtrojë një ndikim mbizotërues mbi subjektin kontraktues; ose
 - c) së bashku me subjektin kontraktues, i nënshtrohen ndikimit mbizotërues të ndërmarrjes tjetër, i cili mund të vijë nga pronësia, pjesëmarrja financiare, ose rregullat të cilat drejtojnë kompaninë.

Për qëllim të këtij paragrafi, "ndikimi mbizotërues" ka të njëjtin kuptim si në nënparagrafin e dytë të nenit 7 (4).

3. Pavarësisht nenit 17 dhe me kusht që kriteret e paragrafit 4 të këtij neni të plotësohen, kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet e dhëna:

- a) nga një ent kontraktor për një ndërmarrje të konsoliduar; ose
- b) nga një ndërmarrje e përbashkët (joint venture), e formuar ekskluzivisht nga një numër subjektsh kontraktuese për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve të referuara në Aneksin II, të një ndërmarrje e cila është e lidhur me një nga këto subjekte kontraktuese.

4. Paragrafi 3 do të aplikohet për:

- a) koncesionet e shërbimeve me kusht që të paktën 80% e totalit të xhiros mesatare të ndërmarrjes së lidhur gjatë tre viteve të mëparshme, duke marrë parasysh të gjitha shërbimet e ofruara nga kjo ndërmarrje, që vijnë nga ofrimi i shërbimeve të subjektit kontraktues ose ndërmarrjeve të tjera me të cilat është e lidhur.
- b) koncesionet e investimeve me kusht që të paktën 80% e totalit të xhiros mesatare të ndërmarrjes së lidhur gjatë tre viteve të mëparshme, duke marrë parasysh të gjitha shërbimet e ofruara nga kjo ndërmarrje, të vijnë nga ofrimi i shërbimeve të subjektit kontraktues ose ndërmarrjeve të tjera me të cilat është e lidhur.

5. Kur, për shkak të datës në të cilën ndërmarrja e lidhur është krijuar ose fillimit të aktivitetit, të dhënat për qarkullimet (xhiron) nuk dispozicion për tre vitet e mëparshme, do jetë e mjaftueshme për ndërmarrjen të vërtetë se qarkullimi i referuar në pikat (a) ose (b) të paragrafit 4 është i besueshëm, veçanërisht me anë të parashikimeve të biznesit.

6. Kur më shumë se një subjekt janë të lidhur me subjektin kontraktues, me të cilën formojnë një grup ekonomik, ofrojnë shërbime ose punime të njëjta ose të ngjashme, përqindja e përmendur në paragrafin 4 do të llogaritet duke marrë parasysh qarkullimin e përgjithshëm që buron përkatësisht nga sigurimi i shërbimet apo punët në ato ndërmarrje me të cilat është i lidhur.

Neni 14**Koncesionet e dhëna për një sipërmarrje të përbashkët ose për një subjekt kontraktues që është pjesë e një sipërmarrje të përbashkët**

Pavarësisht nenit 17, me kusht që sipërmarrja e përbashkët të jetë ngritur për të kryer aktivitetet në fjalë, për një periudhë prej të paktën tre vjetësh dhe që instrumenti i ngritjes së ndërmarrjes së përbashkët përcakton se subjektet kontraktuese, të cilat formojnë atë, do të të jetë pjesë e saj për të paktën për të njëjtën periudhë, kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet e dhëna nga:

- a) një ndërmarrje e përbashkët, e formuar ekskluzivisht nga një numër subjektësh kontraktuese me qëllim kryerjen e aktiviteteve të referuara në Aneksin II, në një nga këto subjekte kontraktuese; ose
- b) një subjekt kontraktues, i cili është pjesë e ndërmarrjes së përbashkët.

Neni 15**Informacioni i njoftimit nga subjekti kontraktues**

Subjektet kontraktuese do të njoftojë Komisionin, në qoftë se kërkohet, për të dhënat e mëposhtme në lidhje me zbatimin e nenit 13 (2) dhe (3) dhe nenit 14:

- a) emrat e ndërmarrjeve ose sipërmarrjeve të përbashkëta;
- b) natyrën dhe vlerën e koncesioneve të përfshira;
- c) provat, që konsiderohen të nevojshme nga Komisioni, për marrëdhënien midis ndërmarrjes ose ndërmarrjes së përbashkët për të cilat është dhënë koncesioni dhe subjekti kontraktues, në përputhje me kërkesat e nenit 13 ose nenit 14 .

Neni 16**Përrjashtimi i aktiviteteve të cilat janë të ekspozuara direkt ndaj konkurrencës**

Kjo Direktivë nuk zbatohet për koncesionet e dhëna për subjektet kontraktuese ku, për Shtetin anëtar në të cilin ky koncesion do të kryhet, ai është themeluar në përputhje me nenin 35 të Direktivës 2014/25 EU, ky aktiviteti është i ekspozuar direkt ndaj konkurrencës në përputhje me nenin 34 të kësaj Direktive.

Neni 17

Koncesionet ndërmjet subjekteve brenda sektorit publik

1. Një koncesion i dhënë nga autoriteti kontraktor ose nga një subjekt kontraktues siç është përmendur në pikën (a) të nenit 7 (1) të një personi juridik, i cili rregullohet nga e drejta private ose publike, janë jashtë fushëveprimit të kësaj Direktive, kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues ushtron gjatë jetës juridike një kontroll i cili është i ngjashëm me atë që ai ushtron mbi departamentet e tij;
- b) më shumë se 80% e aktiviteteve të personit juridik janë kryer nga detyrat që i janë besuar nga autoritetet kontrolluese kontraktore ose subjekti kontraktues ose nga persona të tjerë juridikë të kontrolluar nga të njëjtat autoritete kontraktore apo subjekte kontraktuese; dhe
- c) nuk ka pjesëmarrje direkte të kapitalit privat në kontrollin e personit juridik me përjashtim të pjesëmarrjes jo kontrolluese private në kapital të kërkuar nga dispozitat ligjore kombëtare, në përputhje me Traktatet, të cilat nuk ushtrojnë një ndikim vendimtar mbi kontrollin e personit juridik.

Konsiderohet që autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues siç referohet në pikën (a) të nenit 7 (1) ushtron mbi personin juridik një kontroll të ngjashëm me atë të kryer mbi shërbimet e veta sipas pikës (a) të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi, ku ai ushtron një ndikim vendimtar mbi objektivat strategjike dhe vendimet e rëndësishme të kontrolluara nga personit juridik. Kontrolli mund të ushtrohet nga një person tjetër juridik, i cili në vetvete është i kontrolluar në të njëjtën mënyrë nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues.

2. Paragrafi 1 zbatohet edhe kur një person juridik kontrollues është një autoritet kontraktor ose subjekt kontraktues si referohet në pikën (a) të nenit 7 (1) jep një koncesion për autoritetin kontrollues kontraktor ose subjektin kontraktues, ose për një personi tjetër juridik të kontrolluar nga vetë autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues, me kusht që të mos ketë pjesëmarrje direkte në kapitalin e personit juridik, të cilit i jepet koncesioni me përjashtim të formave të pjesëmarrjes të kapitaleve private të cilat nuk sjellin kontroll ose të drejtë vote sipas dispozitave ligjore kombëtare në përputhje me Traktatet, të cilat nuk ushtrojnë një ndikim vendimtar mbi personin juridik të kontrolluar.

3. Autoriteti kontraktor ose një subjekt kontraktues si referohet në pikën (a) të nenit 7 (1), i cili nuk ushtron kontroll në më shumë se një person juridik që rregullohen nga e drejta private ose publike në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, mundet të japin një koncesion për atë person juridik pa zbatimin e kësaj Direktive, kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë përmbushur:

- a) autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues si referohet në pikën (a) të nenit 7 (1) ushtron bashkërisht me autoritetet e tjera kontraktuese ose subjektet kontraktuese një kontroll mbi atë person juridik, i cili është i ngjashëm me atë që ata ushtrojnë mbi departamentet e tyre;
- b) më shumë se 80% e aktiviteteve të personit juridik janë kryer nga detyrat që i janë besuar nga autoritetet kontrolluese kontraktore ose subjektet kontraktuese ose nga persona të tjerë juridikë të kontrolluar nga të njëjtat autoritete kontraktore apo subjekte kontraktuese; dhe
- c) nuk ka pjesëmarrje direkte të kapitalit privat në kontrollin e personit juridik me përjashtim të pjesëmarrjes jo kontrolluese private në kapital të kërkuar nga dispozitat ligjore kombëtare, në përputhje me Traktatet, të cilat nuk ushtrojnë një ndikim vendimtar mbi kontrollin e personit juridik.

Për qëllimet e pikës (a) të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi, autoritetet apo subjektet kontraktuese të përmendura në pikën (a) të nenit 7 (1) ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi një person juridik, kur të gjitha kushtet e mëposhtme përmbushen:

- i. organet vendimmarrëse të personit juridik përbëhen nga përfaqësues nga të gjithë autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese. Përfaqësuesit individualë mund të përfaqësojnë disa ose të gjitha autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese që marrin pjesë;
- ii. këto autoritete kontraktore ose subjekte kontraktuese janë në gjendje të ushtrojnë bashkërisht ndikim vendimtar mbi objektivat strategjike dhe vendimet e rëndësishme të personit juridik të kontrolluar; dhe
- iii. personi juridik i kontrolluar nuk ndjek ndonjë interes, i cili është në kundërshtim me ato të autoriteteve kontrolluese kontraktore apo subjekteve kontraktuese;

4. Kontrata e lidhur ekskluzivisht mes dy ose më shumë autoritetesh kontraktore ose subjektsh kontraktuese të përmendur në pikën (a) të nenit 7 (1) do jenë jashtë fushëveprimit të kësaj Direktive, kur të gjitha kushtet e mëposhtme plotësohen:

- a) kontrata përcakton ose zbaton një bashkëpunim mes autoriteteve pjesëmarrëse kontraktore ose subjekteve kontraktuese me qëllim për të siguruar se shërbimet publike që do kryhen janë dhënë me qëllim për të arritur objektivat e përbashkëta;
- b) zbatimi i këtij bashkëpunimi është i udhëhequr vetëm nga elementët që lidhen me interesin publik; dhe
- c) autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese pjesëmarrëse kryejnë në tregun e hapur më pak se 20% të aktivitetit që lidhet me bashkëpunimin.

5. Për përcaktimin e përqindjes së aktiviteteve të përmendur në pikën (b) të nënparagrafit të parë të paragrafit 1, pikën (b) të nënparagrafit të parë të paragrafit 3 dhe pikën (c) të paragrafit 4, mesatarja e xhiros totale ose një aktiviteti alternativ të përshtatshëm bazuar në matje, siç janë shpenzimet e bëra nga personi juridik përkatës, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues, si referohet në pikën (a) të nenit 7 (1) në lidhje me shërbimet, furnizimet dhe punët, për tre vitet e mëparshme para dhënies së koncesionit, do të merren në konsideratë.

Nesë për shkak të datës së themelimit ose fillimit të aktivitetit të personit juridik, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues në fjalë, ose për shkak të riorganizimit të aktivitetit të tij, xhiro ose masa alternative e bazuar mbi aktivitetin, si kostot, nuk është e disponueshme për tre vitet e mëparshme është e mjaftueshme të tregohet, mbi bazën e aktiviteteve të projektit që masa e aktivitetit është e besueshme.

Seksioni III**Dispozitat e përgjithshme****Neni 18****Kohëzgjatja e koncesionit**

1. Kohëzgjatja e koncesioneve do të jetë e kufizuar. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues duhet të vlerësojnë kohëzgjatjen në bazë të punëve ose shërbimeve të kërkuara.

2. Për koncesionet që zgjasin më shumë se pesë vjet, kohëzgjatja maksimale e koncesionit nuk duhet të tejkalojë kohën që koncesionari mund të presë në mënyrë të arsyeshme ti kthehen investimet e bëra në operimin e punimeve ose shërbimeve së bashku me një kthim të kapitalit të investuar për të arritur objektivat specifike kontraktuale.

Investimet duhet të marrin parasysh për qëllimet e llogaritjes investimet fillestare dhe investimet gjatë jetës së koncesionit.

Neni 19**Shërbimet sociale dhe të tjera specifike**

Koncesionet për shërbimet sociale dhe shërbime të tjera specifike të listuara në Aneksin IV janë brenda fushës së veprimit të kësaj Direktive, do t'u nënshtrohen vetëm atyre detyrimeve që rrjedhin nga neni 31 (3) dhe nenet 32,46 dhe 47.

Neni 20**Kontratat mikse**

1. Koncesionet të cilat kanë për objekt si punime dhe shërbime do të jepen në përputhje me dispozitat e aplikueshme mbi llojin e koncesionit që karakterizojnë objektin kryesor të kontratës në fjalë.

Në rastin e koncesioneve mikse që konsistojnë pjesërisht në shërbime sociale dhe shërbime të tjera të listuara në Aneksin IV, objekti kryesor është i përcaktuar mbi bazën e vlerës më të lartë të llogaritur midis vlerave të shërbimeve respektive.

2. Kur pjesë të ndryshme të një kontratë të caktuar janë të ndara objektivisht, do të zbatohen paragrafët 3 dhe 4. Kur ndarja e pjesëve të ndryshme nuk është bërë objektivisht zbatohet paragrafi 5.

Ku një pjesë e një kontratë të caktuar mbulohet nga neni 346 TFEU ose Direktiva 2009/81/EC zbatohet neni 21 i kësaj Direktive.

Në rastin e kontratave që synojnë të përmbushin disa aktivitete, ku një prej tyre i nënshtrohet Aneksit 22 të kësaj Direktive ose Direktivës 2014/25/EU, dispozitat e aplikueshme do të përcaktohen respektivisht në përputhje me nenin 22 të kësaj Direktive dhe nenin 6 të Direktivës 2014/25/EU.

3. Në rastin e kontratave që kanë element përkatës që preken nga kjo Direktivë, autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktuese mund të bejnë kontrata të veçanta për pjesë të veçanta. Kur autoritetet kontraktore ose subjekti kontraktues e zgjedhin dhënien e kontratave të veçanta për pjesë të veçanta, vendimi se cili regjim ligjor do të zbatohet në këto kontrata, do të merret duk u bazuar në karakteristikat e veçanta të pjesëve.

Kur autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese zgjedhin për të dhënë një kontratë të vetme, kjo Direktivë, do të zbatohet për kontratën që solli përzjerjen, përveç kur parashikohen ndryshe në paragrafin 4 të këtij neni, ose në nenin 21, pavarësisht nga vlera e pjesëve që në të kundërt do të binin nën një regjim të ndryshëm ligjor.

4. Në rastin e kontratave të përziera që përmbajnë elemente të koncesioneve, si dhe elementë të kontratave publike që mbulohen nga Direktiva 2014/24/EU ose kontratat e mbuluara nga Direktiva 2014/25/EU, kontrata e përzier do të jepet në përputhje me Direktivën 2014/24/EU ose Direktivën 2014/25/EU, respektivisht.

5. Kur pjesë të ndryshme të një kontratë të caktuar nuk janë objektivisht të ndashme, regjimi ligjor i zbatueshëm do të përcaktohet duke u bazuar në subjektin kryesor të kontratës.

Në disa raste kontrata të tilla përfshijnë dy elemente të një koncesioni të shërbimeve dhe një kontratë furnizimi, objektivi kryesor do të përcaktohet sipas vlerave të vlerësuar të shërbimeve përkatëse ose furnizimeve.

Neni 21**Kontratat e prokurimit të përziera që përfshijnë aspektet e mbrojtjes dhe sigurisë**

1. Në rastin e kontratave të përziera, të cilat kanë si subjekt kryesor elementë të një koncesioni të mbuluar nga kjo Direktivë dhe prokurim apo elemente të tjera të mbuluara nga neni 346 i TFEU ose Direktivës 2009/81/EC, ky nen do të zbatohet.

Në rastin e kontratave që kanë për qëllim të mbulojnë disa aktivitete, ku njëri prej tyre i nënshtrohet Aneksit II të kësaj Direktive ose Direktivës 2014/25/EU, dhe një tjetër mbulohet nga Neni 346 TFEU ose Direktiva 2009/81/EC, hyn në fuqi dispozita që do të përcaktohet respektivisht sipas nenit 23 të kësaj Direktive dhe nenit 26 të 2014/25/EU.

2. Kur pjesë të ndryshme të një kontratë të caktuar janë objektivisht të ndashme, autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese mund të zgjedhin të bëjnë kontrata të veçanta për pjesët e veçanta, ose për të dhënë një kontratë të vetme.

Kur autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese zgjedhin të bëjnë kontrata të veçanta për pjesë të veçanta, vendimi i regjimit ligjor në fuqi për çdo një nga këto kontrata të veçanta, do të merret në bazë të karakteristikave të pjesëve të veçanta të secilës kontratë.

Kur autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese zgjedhin për të dhënë një kontratë të vetme, do të zbatohen kriteret e mëposhtme për të përcaktuar regjimin ligjor që do të zbatohet:

- a) kur një pjesë e një kontrate të caktuar është e mbuluar nga neni 346 i TFEU, ose pjesë të ndryshme janë të mbuluara respektivisht nga neni 346 i TFEU dhe Direktiva 2009/81/EC, kontrata mund të jepet pa zbatimin e kësaj Direktive, me kusht që dhënia e një kontrate të vetme të justifikohet për arsye objektive;
- b) kur një pjesë e një kontrate të caktuar është e mbuluar nga Direktiva 2009/81/EC, kontrata mund të jepet në përputhje me këtë Direktivë, ose në përputhje me Direktivën 2009/81/EC, me kusht që dhënia e një kontrate të vetme të justifikohet me arsye objektive.

Vendimi i dhënies së një kontrate të vetme, megjithatë nuk duhet të merret me qëllim përjashtimin e kontratave nga zbatimi i kësaj Direktive ose Direktivës 2009/81/EC.

3. Kur pjesë të ndryshme të një kontratë të caktuar nuk janë objektivist të ndashme, kontrata mund të jepet pa zbatuar këtë Direktivë, kur përfshihen elementë ndaj të cilëve zbatohet Neni 346 i TFEU-së. Në rast të kundërt, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues mund të zgjedhë të japë një kontratë në përputhje me këtë Direktivë, ose në përputhje me Direktivën 2009/81/EC.

Neni 22

Kontratat që mbulojnë të dy aktivitetet e referuar në Aneksin II dhe aktivitete të tjera

1. Sipas mënyrës së derogimit nga neni 20, në rastin kur kontratat synojnë të mbulojnë disa aktivitete, palët kontraktore mund të zgjedhin të nënshkruajnë kontrata të ndara për qëllimet e çdo aktiviteti ose të nënshkruajnë një kontratë të vetme. Kur palët zgjedhin të nënshkruajnë një kontratë të ndarë, rregullat që do të zbatohen do bazohen në aktivitetin e posacëm që do të kryejnë.

Pavarësisht nga neni 20, ku subjektet kontraktuese zgjedhin për të nënshkruar një kontratë të vetme, do të zbatohen paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni. Megjithatë, kur një prej aktiviteteve në fjalë rregullohet nga neni 346 TFBE, Direktiva 2009/81/EC, neni 23 i kësaj Direktive do të zbatohet.

Zgjedhja ndërmjet nënshkrimit të një kontrate të vetme ose një numri të kontratave të veçanta nuk bëhet me qëllim për të përjashtuar kontratën ose kontratat nga objektivi i kësaj Direktive ose, sipas rastit, nga fushëveprimi i Direktivës 2014/24/EU ose Direktivës 2014/25/EU.

2. Një kontratë e cila ka për qëllim të mbulojë disa veprimtari do t'i nënshtrohet rregullave në fuqi për aktivitetin për të cilin është destinuar.

3. Në rastin e kontratave për të cilat është objektivist e pamundur të përcaktohet për cilin aktivitet do të zbatohet kontrata, rregullat e zbatueshme përcaktohen në përputhje me pikat në vijim:

a) koncesioni do të jepet në përputhje me dispozitat e Direktivës në fuqi për koncesionet e dhëna nga autoritetet kontraktore, në qoftë se një nga aktivitetet për të cilat është synuar kontrata, i nënshtrohet dispozitave të kësaj Direktive;

b) kontrata do të jepet në përputhje me Direktivën 2014/24/EU, në qoftë se një nga aktivitetet për të cilat është synuar kontrata, i nënshtrohet kësaj Direktive.

c) kontrata do të jepet në përputhje me këtë Direktivë, në qoftë se një nga aktivitetet për të cilat është synuar kontrata i nënshtrohet kësaj Direktive dhe pse aktiviteti tjetër nuk i nënshtrohet kësaj Direktive, Direktivës 2014/24/EU apo të Direktivës 2014/25/EU.

Neni 23

Koncesionet që mbulojnë të dyja aktivitetet e përmendura në Aneksin II dhe aktivitetet që përfshijnë çeshtjet e mbrojtjes ose të sigurisë

1. Në rastin e kontratave të destinuara për të mbuluar disa aktivitete, subjektet kontraktuese mund të zgjedhin të nënshkruajnë kontrata të veçanta për qëllime të çdo aktiviteti të veçantë, ose për të nënshkruar një kontratë të vetme. Kur subjektet kontraktuese zgjedhin të nënshkruajnë kontrata të veçanta për pjesë të veçanta, vendimi për regjimin juridik të aplikueshëm do të bazohet në karakteristikat e vetë aktivitetit në fjalë.

Ndryshe nga neni 21, ku subjektet kontraktuese zgjedhin për të nënshkruar një kontratë të vetme, do të aplikohet paragrafi 2 i këtij neni.

Zgjedhja ndërmjet dhënies së një kontrate të vetme ose dhënies së një numri të kontratave të veçanta nuk do të bëhet me qëllim për të përjashtuar kontratën ose kontratat nga fusha e zbatimit të kësaj Direktive ose Direktivës 2009/81/EC.

2. Në rastin e kontratave të destinuara për të mbuluar një aktivitet i cili është subjekt i kësaj Direktive dhe një tjetër që:

a) mbulohet nga neni 346 TFBE; ose

b) i nënshtrohet Direktivës 2009/81/EC, subjekti kontraktues mund të:

- i. lidhë një kontratë pa e zbatuar këtë Direktivë në rastet e përcaktuara në pikën (a); ose kur
- ii. lidhja e një kontrate në përputhje me këtë Direktivë nuk është në përputhje me Direktivën 2009/81/EC, në rastet e përcaktuara në pikën (b). Nënparagrafi i parë i këtij paragrafi është pa paragjykim ndaj pragjeve dhe përjashtimeve të parashikuara nga Direktiva 2009/81/EC.

Kontratat e përmendura në pikën (b), të cilat gjithashtu përfshijnë prokurimin apo elemente të tjera të cilat janë të mbuluara nga neni 346 TFBE, mund të jepen pa zbatuar këtë Direktivë.

Megjithatë, ajo do të jetë një kusht për zbatimin e këtij paragrafi sipas të cilit lidhja e një kontrate të vetme të jetë e justifikuar për arsye objektive dhe vendimi për lidhjen e saj nuk është marrë me qëllim për të përjashtuar kontratat nga fuqia e zbatimit të kësaj Direktive.

Seksioni IV

Situata specifike

Neni 24

Koncesionet e rezervuara

Shtetet anëtare mund të rezervojnë të drejtën për të marrë pjesë në procedurat për dhënien e koncesionit për qendrat e punës dhe operatorëve ekonomikë, qëllimi kryesor i të cilave është integrimi social dhe profesional i personave me aftësi të kufizuara ose të pa favorizuar, ai mund të sigurojë koncesione për të kryer programe në kontekstin e punësimit të mbrojtur, me kusht që të paktën 30% e punonjësve të këtyre operatorëve ekonomikë të jenë punëtorë me aftësi të kufizuara apo të pa favorizuar. Njoftimi i koncesionit ose, në rastin e koncesioneve të shërbimeve, siç përcaktohet në nenin 19, njoftimi paraprak i referohen këtij neni.

Neni 25

Shërbimet Kërkimore dhe Zhvillimet e Shërbimeve

Kjo Direktivë zbatohet vetëm për koncesionet e shërbimit, për kërkimin dhe zhvillimin e shërbimeve të cilat janë të mbuluara nga kodet CPV 73120000-9 73000000-2, 73300000-5, 73420000-2 dhe 73430000-5 me kusht që të përmbushen të dy kushtet e mëposhtme:

- a) përfitimet i përkasin ekskluzivisht autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktues për përdorimin e tij në kryerjen e punëve të veta; dhe
- b) shërbimi i ofruar të shpërblehet plotësisht nga autoriteti kontraktor ose subjektit kontraktues.

KREU II**Parimet****Neni 26****Operatorët ekonomikë**

1. Operatorët ekonomikë që, sipas ligjit të Shtetit anëtar në të cilin janë themeluar, kanë të drejtë të sigurojnë shërbimin përkatëse, nuk do t'u refuzohet vetëm për arsye se, sipas ligjit të anëtarit Shtetit në të cilin jepet kontrata, ata do të kërkohet që të jenë persona ose fizikë ose juridikë.

Personave juridikë mund t'u kërkohet për të treguar, në tender ose në aplikim, emrat dhe kualifikimet profesionale të stafit që do të jetë përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë.

2. Grupet e operatorëve ekonomikë, përfshirë shoqatat e përkohshme, mund të marrin pjesë në procedurat për dhënien e koncesionit. Atyre nuk do t'u kërkohet nga Autoritetet kontraktore, ose subjektet kontraktuese që të kenë një formë të veçantë ligjore për të paraqitur një ofertë ose një kërkesë për pjesëmarrje.

Kur është e nevojshme, autoritetet apo subjektet kontraktuese mund të sqarojnë në dokumentet e koncesionit mënyrën si grupet e operatorëve ekonomikë duhet të plotësojnë kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 38, me kusht që kjo të justifikohet nga shkaqe objektive dhe proporcionale. Shtetet Anëtare mund të vendosin kushte standarde për mënyrën se si grupet e operatorëve ekonomikë do të përmbushin këto kërkesa.

3. Pavarësisht nga paragrafët 1 dhe 2, autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese mund t'u kërkojnë grupeve e operatorëve ekonomikë të marrin një formë të veçantë ligjore pasi të jetë lidhur kontrata, në atë masë që ndryshimi është i nevojshëm për përmbushjen e mjaftueshme të saj.

Neni 27

Nomenklatura

1. Çdo referencë ndaj nomenklaturave në kontekstin e dhënies së koncesioneve do të bëhet duke përdorur “prokurimin e përbashkët” miratuar me Rregulloren (EC) Nr. 2195/2002 të Parlamentit European dhe të Këshillit¹⁰.

2. Komisioni do të fuqizohet për të miratuar akte të deleguara në përputhje me nenin 48 duke i përshtatur me kodet FPP te referuara në këtë direktivë, ku ndryshimet në Emër FPP duhet të pasqyrohen në këtë Direktivë dhe nuk nënkuptojnë një modifikim të fushës së kësaj Direktive.

Neni 28

Konfidencialiteti

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Direktivë ose në ligjin kombëtar të cilit autoriteti kontraktor i nënshtrohet, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues nuk duhet të bëjë publik informacionet nga operatorët ekonomikë të cilat janë përcaktuar si konfidenciale, duke përfshirë por jo kufizuar në, sekretet teknike apo tregtare dhe aspektet konfidenciale të tenderit.

Ky nen nuk pengon publicitetin e pjesëve jo-konfidenciale te kontratave të lidhura, duke përfshirë çdo ndryshim të mëvonshëm.

2. Autoriteti ose subjekti kontraktues mund të vendosin mbi kërkesat e operatorëve ekonomikë që kanë për qëllim mbrojtjen e natyrës konfidenciale të informacionit gjatë gjithë procedurës për dhënie të koncesionit.

Neni 29

Rregullat e zbatueshme për komunikim

1. Përveç kur përdorimi i mjeteve elektronike është i detyrueshëm në pajtim me nenin 33 (2) dhe nenin 34, shtetet anëtare ose autoritetet kontraktore dhe entitetet

¹⁰Rregullorja (EC) Nr 2195/2002 e Parlamentit European dhe e Këshillit e datës 5 nëntor 2002 mbi Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (FPP) (OJ L 340, 16.12.2002 , fq. 1) .

kontraktuese mund të zgjedhin një ose më shumë mjete të komunikimit për të gjithë komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit:

- a) mjetet elektronike;
- b) postë ose faks;
- c) komunikimin me gojë duke përfshirë telefonin.

Shtetet Anëtare mund ta bëjnë të detyrueshëm përdorimin e mjeteve elektronike të komunikimit për koncesione, duke shkuar përtej detyrimeve të përcaktuara në nenin 33 (2) dhe nenin 34.

2. Mjetet e komunikimit përgjithësisht nuk duhet të jenë diskriminuese dhe nuk duhet të kufizojnë aksesin e operatorëve ekonomikë në procedurën e dhënies së koncesionit. Mjetet dhe pajisjet që do të përdoren për të komunikuar duhet të sigurojnë ndërveprimin dhe komunikimin e përgjithshëm.

Në të gjitha komunikimet, shkëmbimet dhe ruajtjen e informacionit, subjektet kontraktuese dhe autoritetet kontraktore duhet të sigurojnë ruajtjen e integritetit të të dhënave dhe konfidencialitetit të aplikimeve dhe të tenderave. Ata do të shqyrtojnë përmbajtjen e aplikacioneve dhe tenderave vetëm pas afati kohor i përcaktuar për paraqitjen e tyre ka skaduar.

TITULLI II**RREGULLAT E DHËNIES SË KONCESIONEVE:**

Parimet e përgjithshme dhe garancitë procedurale

KREU I**Parimet e Përgjithshme****Neni 30****Parimet e Përgjithshme**

1. Autoriteti kontraktor do të ketë lirinë për të organizuar procedurën që çon në zgjedhjen e subjektit koncesionar në pajtim me këtë Direktivë.
2. Hartimi i procedurës për dhënien e koncesionit do të respektojë parimet e përcaktuara në nenin 3. Në veçanti, gjatë procedurës për dhënie të koncesionit, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues nuk duhet të marrë informacione diskriminuese të cilat mund t'u japin disa kandidatëve ose ofertuesve përparësi mbi të tjerët.
3. Shtetet Anëtare sigurohen të marrin masat e duhura gjatë procedurës së koncesionit në përputhje me detyrimet e zbatueshme në fushën e ligjit mjedisor, social dhe të punës themeluar me ligjet e Bashkimit, ligjin kombëtar, marrëveshjet kolektive ose ndërkombëtare mjedisore, sociale, ligjin dhe dispozitat e punës të listuara në Aneksin X.
4. Komisioni ka fuqi për të miratuar aktet e deleguara në përputhje me nenin 48 për ndryshimin e listës në Aneksin X, kur është e nevojshme, për të shtuar marrëveshje të reja ndërkombëtare që janë ratifikuar nga të gjitha shtetet anëtare ose kur marrëveshjet ekzistuese ndërkombëtare të ratifikuara nga të gjitha vendet anëtare, kanë pësuar ndryshime, për shembull në lidhje me fushën, përmbajtjen apo emërtimin.

Neni 31**Njoftimet e koncesionit**

1. Autoritetet dhe subjektet kontraktuese që dëshirojnë të realizojnë një koncesion do të bëjnë të njohur qëllimet e tyre.

2. Njoftimet e koncesionit duhet të përmbajnë informacionin e përmendur në Aneksin V dhe ku është e përshtatshme për të, çdo informacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga autoriteti ose subjekti kontraktues, në përputhje me formatin e formularëve standard.

3. Autoritetet dhe subjektet kontraktuese që dëshirojnë të japin një koncesion për shërbime të veçanta sociale dhe të tjera të listuara në Aneksin IV do të bëjnë të njohur qëllimin e tyre dhe vullnetin për dhënie të koncesionit me anë të publikimit të njoftimit të informacionit paraprak. Këto njoftime do të përmbajnë informacionin e përcaktuar në Shtojcën VI.

4. Si përjashtim nga paragrafi 1, autoritetet ose subjektet kontraktuese nuk do t'u kërkohet të publikojnë njoftime koncesioni ku punimet apo shërbimet mund të furnizohen vetëm nga një operator ekonomik të caktuar për ndonjë nga arsyet e mëposhtme:

- a) qëllimi i koncesionit është krijimi apo marrja e një punë të veçantë të artit apo performancës artistike;
- b) mungesa e konkurrencës për arsye teknike;
- c) ekzistenca e një të drejte ekskluzive;
- d) mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe të drejtat ekskluzive të tjera nga ato të përcaktuara në pikën (10) të nenit 5.

Përjashtimet e parashikuara në pikat (b), (c) dhe (d) të nënparagrafit të parë zbatohen vetëm kur nuk ekziston ndonjë alternativë e arsyeshme apo zëvendësues dhe mungesa e konkurrencës nuk është rezultat i një ngushtimi artificial të çmimit të koncesionit.

5. Me përjashtim nga paragrafi 1, autoriteti ose subjekti kontraktues nuk do të kërkohet të publikojë një njoftim të ri për koncesionin aty ku nuk ka aplikacione,

tendera, oferta të përshtatshme ose nuk ka aplikacione të përshtatshme të paraqitura në procedurën paraprake të koncesionit, me kusht që kushtet fillestare të kontratës së koncesionit nuk janë ndryshuar dhe Komisionit ti dërgohet një raport, nese kerkohet;

Për qëllime të nënparagrafit të parë, një tender duhet të mos konsiderohet i papërshtatshëm kur:

- a) aplikanti mund të përjashtohet në bazë të nenit 38 (5) deri (9) kur nuk ka përmbushur kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti ose subjekti kontraktues në pajtim me nenin 38 (1);
- b) nëse ofertat për aplikimet e përshtatshme nuk përfshihen brenda kuptimit të nënparagrafit të dytë.

Neni 32

Njoftimet për dhënie të koncesionit

1. Jo më vonë se 48 ditë pas dhënies së koncesionit, autoritetet dhe subjektet kontraktuese, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 33, duhet të dërgojnë njoftimin për dhënien e koncesionit në bazë të rezultateve të arrira. Për shërbime të veçanta sociale dhe të tjera të listuara në Aneksin IV, mund të bëhen njoftime të tilla në baza tremujore. Në këtë rast ata do të dërgojnë njoftimet e grupuara brenda 48 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori.

2. Njoftimet për dhënien e koncesionit sipas informacionit të përcaktuar në Aneksin VII, lidhjet me koncesionet për shërbimet sociale dhe të tjera të veçanta të renditura në Aneksin IV, informacioni i përcaktuar në Aneksin VIII, do të publikohen në përputhje me nenin 33.

Neni 33

Forma dhe mënyra e publikimit të njoftimeve

1. Njoftimet për dhënien e koncesionit dhe njoftimi i përmendur në nënparagrafin e dytë të nenit 43 (1) duhet të përfshijnë informacionin e përcaktuar në Aneksin VI, VII dhe VIII dhe në formatin standard, duke përfshirë edhe formularët standard.

Komisioni do të krijojë forma standarde me anë të akteve zbatuese. Zbatimi i këtyre akteve duhet të miratohet në përputhje me procedurën këshillimore, siç përmendet në nenin 50.

2. Njoftimet e përmendura në paragrafin 1 do të hartohen, transmetohen në mënyrë elektronike në Zyrën e Publikimeve të Bashkimit Evropian dhe në përputhje me Aneksin IX. Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian do t'i japë Autoritetit kontraktor ose njësisë konfirmimin e marrjes së njoftimit dhe të publikimit të informacionit të dërguar, duke treguar datën e publikimit të cilat do të përbëjnë prova të publikimit. Njoftimet duhet të publikohen jo më vonë se pesë ditë pasi janë dërguar. Shpenzimet e publikimit të njoftimeve nga Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian do të mbulohen nga Bashkimi.

3. Njoftimet e koncesionit do të publikohen të plota në një ose më shumë nga gjuhët zyrtare të Institucioneve të Bashkimit, të zgjedhur nga autoriteti kontraktor. Një përmbledhje e elementeve të rëndësishme të çdo njoftimi duhet të publikohen në gjuhët e tjera zyrtare të Institucioneve të Bashkimit.

4. Njoftimet e koncesionit dhe njoftimet për dhënie e koncesionit nuk do të publikohen në nivel kombëtar para publikimit nga Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, përveç nëse publikimi në nivel të Unionit nuk bëhet pas 48 orësh në Zyrën e Publikimeve të Bashkimit Evropian që të konfirmojë pranimin nga autoriteti ose subjekti kontraktues të njoftimit, referuar në paragrafin 2. Njoftimet e koncesionit dhe ato për dhënie koncesioni të publikuara në nivel kombëtar nuk do të publikohen përveç njoftimeve të dërguara në Zyrën e Publikimeve të Bashkimit Evropian, por do të tregojnë datën e dërgimit të njoftimit në Zyrën e Publikimeve të Bashkimit Evropian.

Neni 34

Disponueshmëria elektronike e dokumenteve të koncesionit

1. Autoritetet dhe subjektet kontraktuese do të ofrojnë nëpërmjet pajisjeve elektronike akses të drejtpërdrejtë e pa pagesë të dokumenteve të koncesionit nga data e publikimit të fitimit të koncesionit ose kur njoftimi i koncesionit nuk përfshin ftesa për të dorëzuar tenderat, nga data në të cilën është dërguar një ftesë për të dorëzuar tenderat. Teksti i njoftimit të koncesionit apo i ftesave do të specifikojë adresën e internetit në të cilën dokumentet e koncesionit janë të aksesueshme.

2. Kur, në raste të justifikuar për shkak të sigurisë së jashtëzakonshme, ose arsye teknike ose për shkak të natyrës veçanërisht të ndjeshme të informacionit tregtar që kërkon një nivel shumë të lartë të mbrojtjes, të pakufizuar dhe qasje të plotë të drejtpërdrejtë pa pagesë me mjete elektronike të caktuara të dokumenteve të koncesionit, autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese do të tregojnë në njoftimin ose ftesën e tenderit se dokumentet e koncesionit në fjalë do të transmetohen me mjete të tjera përveç mjeteve elektronike dhe afatit kohor për pranimin e tenderave do të zgjatet.

3. Autoritetet dhe subjektet kontraktuese ose departamentet kompetente duhet të ofrojnë për të gjithë aplikuesit ose ofertuesit që marrin pjesë në procedurën e dhënies së koncesionit informacion shtesë në lidhje me dokumentet e koncesionit jo më vonë se gjashtë ditë para afatit të fundit, caktuar për pranimin e tenderëve me kusht që kjo të jetë kërkuar brenda afatit.

Neni 35

Lufta kundër korrupsionit dhe parandalimit të konfliktit të interesit

Shteteve anëtare do të kërkojnë që autoritetet dhe entitetet kontraktuese të marrin masa për të luftuar mashtrimin, favorizimin e korrupsionit në mënyrë efektive, për të identifikuar dhe korrigjuar konfliktet e interesit që lindin në kryerjen e procedurave të dhënies së koncesionit, në mënyrë për të shmangur shtrembërim të konkurrencës dhe të sigurojë transparencën e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e barabartë të të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve.

Koncepti i konfliktit të interesit do të mbulojë çdo situatë ku anëtarët e stafit të autoritetit ose subjektit kontraktues, të cilët janë të përfshirë në kryerjen e procedurës së dhënies me koncesion ose mund të ndikojnë në rezultatin e kësaj procedure kanë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, përfitime financiare, ekonomike ose interesa të tjera personale që mund të çenojnë paanshmërinë dhe pavarësinë e tyre në kuadër të procedurës për dhënie të koncesionit.

Në lidhje me konfliktet e interesit, masat e miratuara nuk do të shkojnë përtej asaj që është rreptësisht parandaluese ose e nevojshme për të eliminuar një konflikt të mundshëm interesi apo konflikt interesi që është identifikuar.

KREU II**Garancitë procedurale****Neni 36****Kërkesat teknike dhe funksionale**

1. Kërkesat teknike dhe funksionale duhet të përcaktojnë karakteristikat e kërkuara të punëve apo shërbimeve që janë objekt i koncesionit. Ato duhet do të përcaktohen në dokumentet e koncesionit.

Këto karakteristika mund t'i referohen procesit të veçantë të prodhimit ose sigurimit të punëve ose shërbimeve të kërkuara me kusht që ato të jenë të lidhura me objektin e kontratës dhe në proporcion me vlerën e tij. Karakteristikat për shembull mund të përfshijnë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore, në projektimin për të gjitha kërkesat (përfshirë qasjen për persona me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancës, sigurinë ose dimensionet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat e testimit, duke shënuar dhe etiketimin, ose udhëzimet e përdoruesit.

2. Përveçse kur përcaktohet nga objekti i kontratës, kërkesat teknike dhe funksionale nuk i referohen një burimi të veçantë, ose një procesi të veçantë, i cili karakterizon produktet apo shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik i veçantë ose për markat tregtare, patentat, llojet ose një prodhim të veçantë me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve të caktuara. Një referencë e tillë lejohet, në kushte të jashtëzakonshme, kur në mënyrë të mjaftueshme përshkrimi i saktë dhe i kuptueshëm i çështjes në përmbajtjen e kontratës nuk është i mundur. Një referimi i tillë duhet të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent".

3. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues nuk mund të refuzojnë një ofertë me arsyetimin se punët dhe shërbimet nuk përputhen me kërkesat teknike dhe funksionale, në momentin kur ofertuesi provon me çdo mënyrë të mundshme se zgjidhja e propozuar plotëson në mënyrë ekuivalente kërkesat teknike dhe funksionale.

Neni 37**Garancitë procedurale**

1. Koncesionet do të jepen në bazë të kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues në përputhje me nenin 41, me kusht që të gjitha kriteret e mëposhtme të plotësohen:

- a) oferta plotëson kriteret minimale të përcaktuara sipas rastit, nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues;
- b) ofertuesi përmbush kushtet për pjesëmarrje të përmendura në nenin 38 paragrafi 1; dhe
- c) ofertuesi nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, në përputhje me nenin 38, paragrafi 4 deri te paragrafi 7, dhe në bazë të nenit 38, paragrafi 9.

Kërkesat minimale të përmendura në pikën (a) duhet të përmbajnë kushtet për pagesat dhe karakteristikat (veçanërisht teknike, fizike, funksionale dhe ligjore) që çdo ofertë duhet të plotësojë ose të posedojë.

2. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues duhet të sigurojë:

- a) në njoftimin e koncesionit, një përshkrim të koncesionit dhe të kushteve të pjesëmarrjes;
- b) në njoftimin e koncesionit, në ftesën për të paraqitur ofertat ose në dokumente të tjera të koncesionit, një përshkrim të kriterëve dhe kur është e aplikueshme, kërkesat minimale që duhet të përmbushen.

3. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues mund të kufizojë numrin e kandidatëve ose ofertuesve në një nivel të përshtatshëm, me kusht që kjo të bëhet në mënyrë transparente dhe në bazë të kriterëve objektive. Numri i kandidatëve ose ofertuesve të ftuar duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar konkurrencë të mirëfilltë.

4. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues duhet të komunikojë përshkrimin e organizimit të procedurës si dhe t'ju komunikojë pjesëmarrësve afatin kohor përfundimtar. Çdo modifikim i komunikohet të gjithë pjesëmarrësve, në masën që

ato kanë të bëjnë me elementet e paraqitura në njoftimin e koncesionit, duhet të njoftohen të gjithë operatorët ekonomikë.

5. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues duhet të sigurojë regjistrimin në fazat e procedurës duke përdorur mjetet dhe jurinë e përshtatshme, në pajtueshmëri me nenin 28 (1).

6. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues mund të kryejë negociata me kandidatët dhe ofertuesit. Objekti i koncesionit, kriteret e dhënies dhe kërkesat minimale nuk duhet të ndryshohen gjatë negociatave.

Neni 38

Përzgjedhja dhe vlerësimi i kandidatëve

1. Autoritetet kontraktore dhe subjekti kontraktues duhet të verifikojnë nëse kushtet për pjesëmarrjen lidhen me aftësitë profesionale dhe teknike, gjendjen financiare dhe ekonomike të kandidatëve ose ofertuesve, në bazë të vetë-deklarimet, referencës ose referencave që do të paraqitet si provë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e koncesionit, i cili duhet të jetë jodiskriminues dhe në proporcion me çështjen e objektit të koncesionit. Kushtet për pjesëmarrje duhet të jenë të lidhura proporcionalisht me nevojën për të siguruar aftësinë e koncesionerit për të kryer koncesionin, duke marrë parasysh objektin e koncesionit dhe qëllimin për të siguruar konkurrencë të ndershme.

2. Me qëllim që të plotësohen kushtet për pjesëmarrje, të përcaktuar në paragrafin 1, një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një koncesion të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve të tyre. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet te kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet ti provojë autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktues që do të ketë në dispozicion, gjatë gjithë periudhës së koncesionit, burimet e nevojshme, për shembull, duke prodhuar një angazhim nga këto subjekte për këtë qëllim. Në lidhje me gjendjen financiare, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjektet të jenë bashkërisht përgjegjës për zbatimin e kontratës.

3. Sipas të njëjtave kushte, një grup operatorësh ekonomikë, siç përmendet në nenin 26 mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëtarëve të grupit ose subjekteve të tjera.

4. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktuese të përmendur në pikën (a) të nenit 7 (1) mund të përjashtojnë një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurën e dhënies me koncesion, kur ata kanë vërejtur se operatori ekonomik ka qenë subjekt i një vendimi të formës së prerë për një nga arsyet e mëposhtme:

- a) pjesëmarrja në një organizatë kriminale, siç përcaktohet në nenin 2 në Kuadrin e Vendimeve të Këshillit 2008/841/JHA;¹¹
- b) korrupsionit, siç përcaktohet në nenin 3 të Konventës mbi luftën kundër korrupsionit që përfshin zyrtarët e Komuniteteve Evropiane ose zyrtarët e Shteteve anëtare të Bashkimit European¹² dhe Nenit 2 (1) të Kuadrin të Vendimeve të Këshillit 2003/568/JHA¹³, si dhe korrupsioni, siç përcaktohet në ligjin kombëtar të autoritetit ose subjektit kontraktues apo të operatorit ekonomik;
- c) mashtrimi brenda kuptimit të nenit 1 të Konventës për mbrojtjen e interesave financiare të Komunititit European¹⁴;
- d) vepra terroriste apo vepra penale lidhur me veprimtaritë terroriste, siç përcaktohet në nenet 1 dhe 3 të Kuadrin të Vendimeve të Këshillit 2002/475/JHA¹⁵, ose nxitjen, ndihmën, mbështetjen ose tentativat për të kryer një vepër penale, siç përmendet në nenin 4 të Kuadrin të vendimeve;
- e) pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, siç përcaktohet në nenin 1 të Direktivës 2005/60/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit¹⁶;
- f) punësimin e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet në nenin 2 të Direktivës 2011/36/EU të Parlamentit European dhe të Këshillit¹⁷.

¹¹Kuadri i Vendimeve të Këshillit 2008/841/JHA, 24 tetorit 2008, mbi luftën kundër krimit të organizuar (OJ L 300, 11.11.2008, fq. 42).

¹²OJ C 195, 25.06.1997, fq. 1

¹³ Kuadri i Vendimeve të Këshillit 2003/568/JHA, 22 korrik 2003 mbi luftimin e korrupsionit në sektorin privat (OJ L 192, 31.7.2003, fq.54)

¹⁴OJ C 316, 27.11.1995, fq. 48.

¹⁵ Kuadri i Vendimeve të Këshillit 2002/475/JHA të datës 13 qershor 2002, për luftën kundër terrorizmit (OJ L 164, 22/06/2002, fq. 3).

¹⁶Direktiva 2005/60/EC e Parlamentit European dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2005 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (OJ L 309, 25.11.2005, fq. 15)

Detyrimi për të përjashtuar një operator ekonomik mund të zbatohet edhe kur personi i dënuar me vendim të formës së prerë është anëtar i administratës, menaxher ose mbikëqyrës i atij operatori ekonomik ose nëse ka kompetencat e përfaqësimit, vendimmarrjes ose ka kontroll mbi të.

Subjekte kontraktuese të tjera nga ato të përmendura në pikën (a) të nenit 7 (1) mund të përjashtojë një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurën e dhënies me koncesion, kur ata janë të vetëdijshëm se operatori ekonomik ka qenë subjekt i një dënimi me vendim të formës së prerë për ndonjë nga arsyet e renditura në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi.

5. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktuese të përmendur në pikën (a) të nenit 7 (1) mund të përjashtojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në një procedurë për dhënien e koncesionit, kur janë të vetëdijshëm se operatori ekonomik është në shkelje të detyrimeve që kanë lidhje me pagesat e taksave ose me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kur kjo është përcaktuar me vendim gjyqësor apo administrativ të formës së prerë dhe kanë efekt detyrues në përputhje me dispozitat ligjore të vendit në të cilin është marrë vendimi, ose me ato të Shtetit anëtar të autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktues.

Për më tepër, autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktuese të përmendura në pikën (a) të nenit 7 (1) mund të përjashtojnë ose mund t'u kërkojnë Shteteve anëtare për të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e dhënies me koncesion një operator ekonomik, kur autoriteti ose subjekti kontraktor mund të demostrojë me çdo mjet të përshtatshëm se operatori ekonomik është në shkelje të detyrimeve që lidhen me pagimin e tatimeve ose kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Ky paragraf nuk do të zbatohet, kur operatori ekonomik ka përmbushur detyrimet e tij duke paguar apo ka nënshkruar një marrëveshje detyruese me qëllim për të paguar tatimet ose kontributet e sigurimeve shoqërore, duke përfshirë, kur është e zbatueshme, çdo interes të përlllogaritur apo gjoba.

¹⁷Direktiva 2011/36/ EU e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, duke zëvendësuar Kornizën e Vendimeve të Këshillit 2002/629/ JHA (OJ L 101,15.04.2011, fq. 1).

6. Shtetet anëtare mund të parashikojnë një përjashtim nga përjashtimi i detyrueshëm të parashikuar në paragrafët 4 dhe 5, në kushte të jashtëzakonshme, për arsye thelbësore që kanë të bëjnë me interesin publik, si shëndeti publik ose mbrojtja e mjedisit.

Shtetet anëtare mund të parashikojnë një përjashtim nga përjashtimi i detyrueshëm i parashikuar nga paragrafi 5, në rastet kur një përjashtim do të jetë qartësisht në shpërpjestim, në veçanti kur nuk janë paguar vetëm shuma të vogla taksash apo kontributesh shoqërore ose kur operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë, e cila duhet të paguhet për shkak të shkeljes së detyrimeve mbi pagesat e taksave apo kontributeve shoqërore në momentin kur nuk kishte mundësinë të ndërmernte masat e parashikuara nga paragrafi 5, nënparagrafi i tretë, përpara mbarimit të afatit mbi paraqitjen e kërkesës.

7. Autoritetet kontraktore apo subjektet kontraktuese mund të përjashtojnë ose mund të jenë të detyruar nga Shtetet anëtare të përjashtojnë nga pjesëmarrja në koncesion një operator ekonomik, nëse verifikohet një prej kushteve në vijim:

- a) kur mund të parashatrojnë me çdo lloj mjete shkeljen e detyrimeve të parashikuara nga paragrafi 3 i nenit 30;
- b) nëse operatori ekonomik është në gjëndje falimentimi ose është objekt i një procedure mospërbushje apo likuidimi, është në gjëndjen e administrimit të kontrolluar, nëse ka nënshkruar një kontratë paraprake me kreditorët, nëse ka pushuar aktivitetin e tij apo gjendet në çdo lloj gjëndje analoge e ardhur për shkak të një procedure të ngjashme sipas ligjit apo rregulloreve kombëtare; megjithatë autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues mund të vendosin të mos përjashtojnë ose Shtetet anëtare mund të kërkojnë që autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues të mos përjashtojnë një operator ekonomik, i cili ndodhet në kushtet e mësipërme, kur kanë vendosur që operatori ekonomik në fjalë do të jetë në gjëndje të përmbushë koncesionin, duke marrë parasysh dhe rregullat apo masat kombëtare të aplikueshme në lidhje me vazhdimin e aktivitetit në këto situata;
- c) nëse autoriteti kontraktor mund të tregojë me mjete të përshtatshme se operatori ekonomik është përgjegjës për shkelje të rënda profesionale, e cila sjell dyshime mbi integritetin e tij;

- d) nëse një konflikt interesi sipas nenin 35 paragrafi 2, nuk mund të zgjidhet në mënyrë efikase me masa më pak shtrënguese;
- e) nëse autoriteti kontraktor ka të dhëna të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se operatori ekonomik ka nënshkruar marrëveshje me operatorë të tjerë ekonomikë me qëllim për të shmangur konkurrencën;
- f) nëse operatori ekonomik ka konstatuar mangësi të rënda dhe të vazhdueshme mbi përmbushjen e kushteve thelbësore në kuadrin e një koncesioni të mëparshëm apo të një kontrate të mëparshme me një autoritet kontraktor apo një subjekt kontraktues sipas përkufizimit të kësaj Direktive apo të Direktivës 2014/25/EU, të cilat kanë shkaktuar prishjen e parakohshme të kontratës së mëparshme, një shpërblim mbi dëmet apo dhe të sanksioneve të ngjashme;
- g) nëse operatori ekonomik është përgjegjës për deklarime të rreme në lidhje me dhënien e informacioneve të kërkuara mbi verifikimin e mosekzistencën e arsyeve të përjashtimit apo respektimin e kriterëve seleksionuese, nuk ka dhënë këto informacione apo nuk është në gjendje të paraqesë dokumente mbi të cilat mbështeten këto informacione;
- h) nëse operatori ekonomik ka tentuar të ndikojë në mënyrë të padrejtë mbi procesin vendimarrës të autoritetit kontraktor apo të subjektit kontraktues, ka tentuar të marrë informacione të rezervuara të cilat mund ti japin avantazhe të padrejta në lidhje me procedurën e dhënies së koncesionit, ose ka dhënë për shkak neglizhence informacione, të cilat mund të kenë një ndikim të madh mbi vendimarrjen, mbi përjashtimin, seleksionimin apo dhënien e koncesionit;
- i) në rastet e koncesioneve në sektorët e mbrojtjes apo të sigurisë sipas Direktivës 2009/81/EC, ku behët verifikimi paraprak duke u mbështetur në çdo lloj mjeti dhe procedure, përfshirë edhe burimet e provave të mbrojtura për operatorin ekonomik, ka rezultuar se nuk ka besueshmëri e nevojshme për të përjashtuar rreziqet mbi sigurinë e shtetit anëtar.

8. Autoriteti kontraktor apo subjektet kontraktuese të parashikuar nga neni 7, paragrafi 1, gërma a), përjashtojnë një operator ekonomik në çdo kohë nga procedura kur rezulton se operatori ekonomik ndodhet, për shkak të veprimeve të kryera apo të pakryera gjatë procedurës, në një prej situatave të parashikuara nga paragrafi 4 i këtij neni dhe paragrafi 5, nënparagrafi i parë i këtij neni.

Autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese mund të përjashtojnë ose Shtetet anëtare mund të kërkojnë që autoritetet kontraktore apo subjektet kontraktuese të përjashtojnë një operator ekonomik në çdo moment nga procedura kur rezulton se operatori ekonomik në fjalë ndodhet, për shkak të veprimeve të kryera apo të pakryera përpara ose gjatë procedurës, në një prej situatave të parashikuara nga paragrafi 5, nënparagrafi 2, dhe të paragrafit 7.

9. Një operator ekonomik, i cili ndodhet në një prej situatave të parashikuara nga paragrafët 4 dhe 7 mund të paraqesë prova mbi faktin se masat e ndërmarrë prej tij kanë qenë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë, pavarësisht ekzistencës së një motivi përjashtimi. Nëse këto prova konsiderohen të mjaftueshme, operatori ekonomik në fjalë nuk përjashtohet nga procedura.

Për këtë qëllim operatori ekonomik duhet të tregojë se ka dëmshpërblyer apo se ka ndërmarrë veprime mbi dëmshpërblimin e çdo dëmi të shkaktuar nga vepra penale, ka qartësuar faktet dhe rrethanat në mënyrë të plotë duke bashkëpunuar me autoritetet ligjzbatuese edhe se ka ndërmarrë masa konkrete të karakterit teknik dhe organizativ, në lidhje me personelin e aftë për të shmangur kryerjen e veprave të tjera. Masat e adoptuara nga operatorët ekonomikë vlerësohen duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe rrethanat e veçanta të kryerjes së veprës penale. Nëse vlerëson se masat janë të pamjaftueshme, operatori ekonomik i interesuar njihet me arsyet e këtij përjashtimi.

Një operator ekonomik i përjashtuar me vendim të formës së prerë nga pjesëmarrja në procedurën e tenderit apo të dhënies së koncesionit nuk është i autorizuar të përdorë mundësinë e parashikuar sipas këtij paragrafi gjatë periudhës së përjashtimit e shkaktuar nga ky vendim në Shtetet anëtare, ku vendimi gjyqësor është i formës së prerë.

10. Bazuar në dispozitat ligjore, rregulloret apo aktet administrative dhe në respekt të së drejtës së Bashkimit, Shtetet anëtare përcaktojnë kushtet e zbatimit të këtij neni. Në veçanti ato përcaktojnë kohën maksimale të përjashtimit, në rastin kur operatori ekonomik nuk ndërmerr asnjë masë nga ato të parashikuar nga paragrafi 9 për të treguar besueshmërinë e tij. Nëse afati i përjashtimit nuk është përcaktuar me vendim të formës së prerë, afati nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet nga data kur është nxjerrë vendimi i dënimit në rastet e parashikuara nga paragrafi 4 dhe 3 vjet nga data e kryerjes së veprimit në fjalë sipas paragrafit 7.

Neni 39

Afati i marrjes së kërkesave për pjesëmarrje në koncesion dhe ofertave

1. Në përcaktimin e afateve të marrjes së kërkesave për pjesëmarrje apo dhe të ofertave, autoritetet kontraktore apo subjektet kontaktuese, duhet të kenë në konsideratë, në veçanti, kompleksitetin e koncesionit dhe kohën e nevojshme për të përgatitur ofertat dhe kërkesat, përveç afateve minimale të përcaktuar nga ky nen.
2. Në rastet kur kërkesat apo ofertat mund të paraqiten vetëm pasi janë kontrolluar vëndet, apo pasi janë këqyrur dokumentet bashkëngjitur për tenderin, afatet për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje në koncesion ose për marrjen e ofertave përcaktohen në mënyrë të tillë që operatorët ekonomikë të interesuar të mund të njihen me të gjithë informacionin e nevojshëm për të paraqitur kërkesat dhe ofertat dhe janë megjithatë më të gjatë se afatet minimale të përcaktuar nga paragrafët 3 dhe 4.
3. Afati minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje në koncesione, përfshirë eventualisht dhe ofertat, shkon deri në 30 ditë nga data e shpalljes së koncesionit.
4. Nëse procedura zhvillohet në faza të mëvonshme, afati minimal për marrjen e ofertave fillestare është 22 ditë nga data e shpalljes së njoftimit mbi paraqitjen e ofertave.
5. Afati për marrjen e ofertave mund të reduktohet në pesë ditë nëse autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues pranon se ofertat mund të paraqiten në rrugë elektronike bazuar në nenin 29.

Neni 40

Komunikimi i kandidatëve dhe ofertuesit

1. Autoriteti kontraktor dhe subjekti kontraktues u komunikon sa më parë kandidatëve dhe ofertuesve vendimet e marra në lidhje me dhënien e koncesionit, ku përfshihen emri i ofertuesit i cili është shpallur fitues i kontratës, arsyet e rrëzimit të kërkesës për pjesëmarrje dhe ofertës, si dhe arsyet për të cilat kanë vendosur të mos vendosin fitues për një kontratë, për të cilën është publikuar shpallja e koncesionit ose shtyrja e procedurës.

Gjithashtu, mbi kërkesën e personit të interesuar, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues komunikon sa më parë dhe në çdo rast brënda 15 ditëve nga marrja e kërkesës me shkrim, çdo ofertuesi i cili ka paraqitur një ofertë të pranueshme, karakteristikat dhe avantazhet në lidhje me ofertën e seleksionuar.

2. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues mund të vendosin të mos shpallin informacione të veçanta sipas paragrafit 1 në lidhje me kontratën, në rastet kur nga shpallja mund të pengohet zbatimi i ligjit dhe është në kundërshtim me interesin publik, dëmton interesat e ligjshme tregtare të operatorëve ekonomikë publikë apo privatë ose mund të shkaktojë dëmtim të interesave të ligjshëm midis këtyre operatorëve.

Neni 41

Kriteret e fituesit

1. Koncesionet jepen mbi bazën e kriterëve objektive të cilat janë në përputhje me parimet e nenit 3 dhe garantojnë një vlerësim të ofertave në kushtet e konkurrencës efektive, në mënyrë që të individualizojnë një avantazh ekonomik të përgjithshëm për autoritetin kontraktor apo subjektin kontraktues.

2. Kriteret e fituesit janë të lidhura me objektin e koncesionit dhe nuk nënkuptojnë liri të pakufizuar zgjedhjeje të autoritetit kontraktor. Ato mund të përfshijnë midis të tjerash, kriteret ambientale, sociale apo në lidhje me inovacionin.

Këto kriteret shoqërohen me kushtet të cilat lejojnë verifikimin me efektivitet të informacioneve të dhëna nga ofertuesit.

Autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues verifikon përputhjen me efektivitet të ofertave me kriteret e fituesit.

3. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues duhet të përcaktojë një listë me kriteret të renditura sipas rëndësisë së tyre.

Pavarësisht nga sa përcaktohet në paragrafin e parë, nëse autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues merr një ofertë, e cila propozon një zgjidhje inovative me një nivel të jashtëzakonshëm të shërbimeve funksionale të cilat nuk mund të parashikoheshin nga autoriteti kontraktor, autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues, mundet që në raste të jashtëzakonshme të ndryshojë rendin e kriterëve përcaktues në mënyrë që të marrë parasysh atë zgjidhje inovative. Në

këtë rast autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues informon të gjithë ofertuesit në lidhje me ndryshimin e kriterëve të rëndësishë dhe nxjerr një ftesë të re për të paraqitur oferta duke respektuar afatet minimale të përcaktuara nga neni 39, paragrafi 4. Nëse kriteret përcaktuese janë publikuar në momentin e njoftimit të konçensionit, autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues publikon një njoftim të ri duke respektuar afatet minimale të përcaktuara nga neni 39 paragrafi 3.

Ndryshimet në rëndësinë e kriterëve nuk duhet të jenë diskriminuese.

TITULLI III

RREGULLAT MBI ZBATIMIN E KONCENSIONEVE

Neni 42

Nënkontraktimi

1. Përbushja e detyrimeve të përcaktuara në nenin 30 paragrafi 3, nga ana e nënkontraktorëve duhet të jetë e garantuar, me anë të veprimeve të përshtatshme nga autoritetet kombëtare kompetente, të cilat veprojnë sipas përgjegjësisë dhe kompetencave respektive.

2. Në dokumentet e konçensionit, autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues mund ti kërkojnë ose mund të jenë të detyruar nga një shtet anëtar që ti kërkojnë ofertuesit apo kandidatit, që ky i fundit të përcaktojë në ofertën e tij, pjesët eventuale të konçensionit, të cilat ka ndërmend që ti nënkontrakttojë tek të tretët, si dhe nënkontraktorët e mundshëm.

3. Në rastet e konçensioneve për punime dhe për shërbime të ofruara pranë impiantit nën supervizionin e autoritetit kontraktor apo të subjektit kontraktues, pas dhënies së konçensionit e deri tek momenti i fillimit të zbatimit të konçensionit, autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues, i vendosin konçensionarit detyrimin për të përcaktuar emrin, adresën si dhe përfaqësuesit ligjorë të nënkontraktorëve të cilët marrin pjesë në kryerjen e punimeve apo ofrimin e shërbimeve, në atë masë sa mund të identifikohen në kohën e kërkesës. Autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues i vendosin detyrimin konçensionarit që të njoftojë në lidhje me ndryshimet e mundshme të këtyre informacioneve të cilat mund të ndryshojnë

gjatë zbatimit si dhe informacionet e kërkuara për nënkontraktorë të mundshëm që mund të përfshihen në kryerjen e punimeve apo ofrimin e shërbimeve.

Pavarësisht nga sa parashikon paragrafi i parë, Shtetet anëtare mund ti vendosin drejtpërdrejt koncesionarit detyrimin që të japë informacionet e kërkuara.

Paragrafi i parë dhe i dytë nuk aplikohen për furnizuesit.

Autoritet kontraktore dhe subjektet kontraktuese mund të detyrohen nga Shtetet anëtare që të përfshijnë detyrimet e parashikuara nga paragrafi i parë, për shembull:

- a) koncesioneve për shërbime të ndryshme nga ato që kanë lidhje me shërbimet e ofruara pranë impianteve nën supervizionin e autoritetit kontraktor apo subjektit kontraktues, si dhe për furnizuesit e përfshirë në koncesionet për punime apo shërbime;
- b) për nënkontraktorët e nënkontraktorëve si dhe për nënkontraktorët e mëtejshëm në zinxhirin e nënkontraktiveve.

4. Me qëllim për të evituar shkeljet e detyrimeve të parashikuara nga paragrafi 3 i nenit 30, mund të ndërmerren masat e nevojshme si në vijim:

- a) nëse legjislacioni kombëtar i një Shteti anëtar parashikon një mekanizëm të përgjegjësisë solidare midis nënkontraktorit dhe koncesionarit, Shteti anëtar i interesuar merr masa që rregullat përkatëse të aplikohen në përputhje me paragrafin 3, të nenit 30.
- b) autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktuese mund të verifikojnë ose të jenë të detyruar nga Shtetet anëtare, që të verifikojnë nëse ekzistojnë arsye për përjashtimin e nënkontraktorëve, sipas parashikimeve të paragrafëve nga 4 deri 10 të nenit 38. Në këto raste autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktuese detyrojnë operatorin ekonomik që të zëvendësojë nënkontraktorin për të cilin është verifikuar ekzistenca e një shkakut për përjashtimin e tij. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues mund të vendosin ose të jenë të detyruar nga Shteti anëtar, që të detyrojnë operatorin ekonomik për të zëvendësuar nënkontraktorin për të cilin, pas verifikimit ka dalë se ekzistojnë arsye jo të detyrueshme mbi përjashtimin.

5. Shtetet anëtare mund të krijojnë ligje të brendshme më të ashpra në lidhje me përgjegjësinë.

6. Shtetet anëtare të cilat kanë vendosur të parashikojnë masa sipas paragrafëve 1 dhe 3, sipas ligjeve, rregulloreve dhe në përputhje me të drejtën e Bashkimit, kushtet e zbatimit të këtyre masave. Në këtë kontekst Shtetet anëtare mund të kufizojnë aplikueshmërinë, për shembull në lidhje me lloje të veçanta të kontratave, të përcaktojnë kategori të autoriteteve kontraktore, subjekteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë si dhe për shumën të përcaktuar.

Neni 43

Ndryshimet e kontratave gjatë periudhës së zbatimit

1. Konkensionet mund të ndryshohen pa pasur nevojën e procedurës së konkensionit sipas kësaj direktive në rastet e mëposhtëme:

- a) nëse ndryshimet, pavarësisht vlerës monetare, janë të parashikuara në dokumentat fillestare të tenderit në klauzola të qarta, të sakta, të cilat mund të përfshijnë klauzola të ndryshimit të çmimeve apo opsioneve. Këto klauzola përcaktojnë masën dhe natyrën e këtyre modifikimeve apo alternativave, si dhe kushtet për të cilat mund të përdoren. Ato nuk sjellin ndryshime apo alternativa, të cilat do të ndryshonin natyrën e përgjithshme të konkencionit.
- b) Për punime apo shërbime mbështetëse nga ana e konkensionarit të parë, të cilat janë bërë të nevojshme e të cilat nuk ishin të përfshira në konkensionin fillestar, apo një ndryshim të konkensionarit:

 - i) rezulton e papraktikueshme për shkaqe ekonomike apo teknike si respektimi i kushteve të këmbimit apo ndërveprimit midis aparaturave, shërbimeve apo impianteve ekzistuese të dhëna gjatë konkensionit fillestar;
 - ii) sjell për autoritetin kontraktor apo subjektin kontraktues probleme të mëdha ose një dyfishim të kostove.

Megjithatë në rastet e konkensioneve të dhëna nga autoriteti kontraktor me qëllim kryerjen e një aktiviteti të ndryshëm nga ai i parashikuar në Aneksin II, rritja eventuale e vlerës nuk duhet të kalojë 50% të vlerës së konkensionit

fillestar. Në rastet e ndryshimeve të mëtejshme, ky kufizim do të aplikohet në vlerën e çdo ndryshimi. Këto ndryshime të mëtejshme nuk kanë për qëllim të anashkalojnë këtë Direktivë.

- c) ku të jenë përmbushur kushtet e mëposhtme:
- i) nevoja e ndryshimeve është përcaktuar nga rrethana të cilat nuk janë parashikuar nga autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues;
 - ii) modifikimet nuk sjellin ndryshime të natyrës së përgjithshme të koncensionit;
 - iii) në rastet e koncensioneve të dhëna nga autoriteti kontraktor me qëllim kryerjen e një aktiviteti të ndryshëm nga ai i parashikuar në Aneksin II, rritja eventuale e vlerës nuk duhet të kalojë 50% të vlerës së koncensionit fillestar. Në rastet e ndryshimeve të mëtejshme, ky kufizim do të aplikohet në vlerën e çdo ndryshimi. Këto ndryshime të mëtejshme nuk kanë për qëllim të anashkalojnë këtë direktivë.
- d) nëse një koncensionar i ri zëvendëson koncensionarin fillestar për një nga rrethanat e mëposhtme:
- i) një klauzolë apo opion ndryshimi në përputhje me germën a);
 - ii) koncensionarit fillestar i krijohet, në tërësi apo në pjesë të tij, për shkak të ristrukturimit të shoqërive, përfshirë dhe përthithjet, blerjet, apo mospagesat, një operator tjetër ekonomik i cili përmbush kriteret e përcaktimit të cilësisë të përcaktuar në fillim, me kusht që kjo të mos sjellë ndryshime të tjera thelbësore të kontratës e që nuk ka për qëllim të shmangë zbatimin e kësaj Direktive; ose
 - iii) në rastin kur autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues marrin përsipër detyrimet e koncesionarit kryesor në drejtim të nënkontraktorëve, ose kjo mundësi të jetë parashikuar nga legjislacioni kombëtar;
- e) nëse ndryshimet, pavarësisht nga vlera e tyre, nuk janë thelbësore sipas paragrafi 4.

Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktues, të cilët kanë ndryshuar një koncension në rastet e parashikuara nga ky paragraf, gërmat b) dhe c), publikojnë

njoftim në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Ky njoftim përmban informacione sipas Aneksit XI dhe është publikuar në përputhje me sa parashikohet në nenin 33.

2. Gjithashtu dhe pa pasur nevojë për verifikimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 4, gërmat nga a) tek d), janë përmbushur, koncesionet gjithashtu mund të ndryshohen pa pasur nevojën e një procedure të dhënies së një koncensionit sipas kësaj Direktive nëse vlera e ndryshimeve është më poshtë se vlerat e mëposhtëme:

- i) Pragu minimal është përcaktuar në nenin 8; dhe
- ii) 10% e vlerës së koncensionit fillestar.

Megjithatë, ndryshimet nuk mund të alternojnë natyrën e përgjithshme të koncensionit. Në rastet e ndryshimeve të mëtejshme, vlera e përcaktuar mbi bazën e vlerës kumulative neto të ndryshimeve të mëtejshme.

3. Me qëllim llogaritjen e vlerës sipas paragrafit 2 dhe paragrafit 1, gërmat b) dhe c), vlera e azhornuar është vlera e referimit kur koncensionit parashikon një klauzolë treguese. Nëse koncensionit nuk parashikon një klauzolë referimi, vlera e azhornuar llogaritet duke pasur parasysh inflacionin mesatar në Shtetin anëtar.

4. Ndryshimi i një koncensionit përgjatë periudhës së zbatimit konsiderohet thelbësor sipas paragrafit 1, gërma e), ndryshon në mënyrë thelbësore natyrën e koncensionit në krahasim me atë fillestare. Në çdo rast, përveç sa parashikojnë paragrafët 1 dhe 2, një ndryshim do të konsiderohet thelbësor nëse ekzistojnë një ose më shumë nga kushtet e mëposhtëme:

- a) modifikimi sjell kushte të cilat, nëse do të ekzistonin në procedurën fillestare të seleksionimit të koncensionarit, do të sillnin kandidatë të ndryshëm nga ata të seleksionuar apo dhe pranimin e një oferte të ndryshme nga ajo e paraqitur fillimisht, apo do të tërhiqnin pjesëmarrës të tjerë në procedurën e koncensionit;
- b) modifikimi ndryshon ekuilibrin ekonomik të koncensionit në favor të koncensionarit në mënyrë të paparashikuar në koncensionin fillestar;
- c) modifikimi zgjeron hapësirën e zbatimit të koncensionit;

- d) nëse një koncesionar zëvendëson atë të cilin autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues kishin përcaktuar fillimisht si fitues, në rastet e ndryshme nga ato të parashikuara në paragrafin 1, gërma d)
5. Një procedurë e re e përcaktimit të koncesionit në përputhje me këtë Direktivë kërkohet për ndryshime të dispozitave të një koncesioni përgjatë periudhës së vlefshmërisë, të ndryshme nga ato të parashikuara në paragrafët 1 dhe 2.

Neni 44

Përfundimi i koncesioneve

1. Shtetet anëtare garantojnë që autoritetet kontraktore apo subjektet kontraktuese të kenë mundësi, që me kushtet e përcaktuara nga e drejta e brendshme e zbatueshme, të mund të vendosin përfundimin e koncesionit në fuqi, nëse përmbushet një ose më shumë prej kushteve të mëposhtëme:
- a) koncesioni ka pësuar një ndryshim, i cili kërkon një procedurë të dhënies së koncesionit sipas parashikimit në nenin 43;
 - b) koncesionari në kohën e marrjes së koncesionit është gjendur në një prej rasteve të parashikuara nga paragrafi 4 i nenit 38, dhe duhej të përjashtohej nga procedura e marrjes së koncesionit;
 - c) Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, ka vendosur në një proces, sipas parashikimeve të nenit 258 TFUE, se një prej shteteve anëtare nuk ka përmbushur një prej detyrimeve, të përcaktuara në Traktatet, për faktin se autoriteti kontraktor apo subjekti kontraktues që i përket Shtetit anëtar në fjalë, ka dhënë koncesionin pa përmbushur detyrimet e parashikuara në Traktatet si dhe në këtë Direktivë.

Neni 45

Monitorimi dhe raportimi

1. Me qëllim garantimin korrekt dhe efektiv të zbatimit, Shtetet anëtare marrin masa që detyrat e përcaktuara në këtë nen të jenë përmbushur nga një apo më shumë autoritete apo struktura dhe i japin Komisionit të gjithë autoritetin ose strukturat kompetente për këto detyra.

2. Shtetet anëtare garantojnë kontrollin e zbatimit të rregullave mbi dhënien e kontratave koncesionare. Nëse autoritetet apo strukturat e kontrollit gjejnë shkelje të veçanta si mashtrime, korrupsion, konflikt të interesit si dhe parregullsi të tjera të rënda apo probleme sistemike, kanë të drejtën të sinjalizojnë këto shkelje apo probleme tek autoritetet kombëtare të kontrollit, organet gjyqësore apo autoritetet e tjera apo struktura të përshtatshme si ndërmjetësi, parlamentet kombëtare apo dhe komisionet përkatëse.

3. Rezultatet e kontrolleve sipas paragrafit 2, u vendosen në dispozicion të publikut me anë të mjeteve të informimit.

Komisioni mund t'u kërkojë Shteteve anëtare, maksimumi çdo tre vjet, një raportim mbi kontrollin në lidhje me parashtrimin e shkaqeve më frekvente të mos-palikimit korrekt të rregullave mbi dhënien e kontratave të koncesionit, duke përfshirë probleme të mundshme strukturore apo që lidhen me aplikimin e rregullave, shkaqe të mundshme të mashtrimit apo dhe sjellje të tjera të kundërligjshme.

4. Shtetet anëtare marrin masat që të jenë të disponueshme falas, orientimet dhe informacionet që lidhen me interpretimin dhe zbatimin e të drejtës së Bashkimit në lidhje me dhënien e kontratave të koncesionit, me qëllim që të ndihmojnë administratën, e cila vendos mbi koncesionin, entitetet dhe operatorët ekonomikë, për aplikimin korrekt të normativës së Bashkimit.

KREU IV

AMENDAMENTET E DIREKTIVËS 89/665/EEC DHE 92/13/EEC

Neni 46

Amendamentet e Direktivës 89/665/EEC

Direktiva 89/665/EEC është amenduar si më poshtë:

1) Në Nenin 1, paragrafi 1 është zëvendësuar me paragrafin e mëposhtëm:

Kjo direktivë zbatohet në kontrata referuar në Direktivën e BE 2014/24/EU për prokurimet publike përjashtuar ato kontrata të cilat janë të përjashtuara nga Nenet 7, 8, 9, 10, 11, 12, 15, 16, 17 dhe 37 të kësaj direktive.

Kjo direktivë zbatohet në ato koncesione të dhëna nga autoritetet kontraktore referuar Direktivës 2014/23/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, përjashtuar rastet kur këto koncesione janë të përjashtuara në përputhje me Nenin 10, 11, 12, 17 dhe 25 të kësaj direktive.

Kontratat të cilat janë në fushën e veprimit të kësaj Direktive përfshijnë kontrata publike, marrëveshje të ndryshme, koncesione shërbimesh dhe Proceset Dinamike të Prokurimit¹⁸.

Shtetet anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që kontratat të cilat janë në fushën e veprimit të Direktivës 2014/24/EU ose Direktivës 2014/23/EU dhe vendimet e marra nga autoritetet kontraktore mund të rishikohen në mënyrë efektive, të veçantë dhe sa më shpejt të jetë e mundur, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Nenin 2-2f të kësaj Direktive, në qoftë se këto vendime janë bërë në kundërshtim me ligjet e BE në fushën e prokurimeve publike ose ligjeve dhe rregullave kombëtare.

(1) Neni 2a, paragrafi 2 është amenduar si më poshtë:

(a) Nënparagrafi i parë është zëvendësuar me paragrafin e mëposhtëm:

Një kontratë nuk mund të lidhet pas vendimit për dhënien e një kontratë që ndodhet në fushën e veprimit të Direktivës 2014/24/EU ose Direktivës 2014/23/EU përpara përfundimit të një periudhe të paktën prej 10 ditëve kalendrike me efekt nga dita pasardhëse deri në ditën kur vendimi për dhënien e kontratës është dërguar tek kandidatët e interesuar, në qoftë se fax-i ose mjete të tjera komunikimi janë përdorur, përpara përfundimit të periudhës ose të paktën 15 ditëve kalendrike me efekt nga dita pas datës në të cilën është marrë vendimi për dhënien e kontratës kandidatëve të interesuar ose të paktën 10 ditë kalendrike nga dita pas datës së marrjes së vërtetimit bashkëngjitur vendimit për dhënien e kontratës.

¹⁸ Lloj procedure prokurimi e cila është e hapur për një periudhë 4 vjecare (maksimumi) dhe mund të marrin pjesë brenda kësaj periudhe, operatorët ekonomike të ftuar në varësi të shërbimit që do të kryhet në periudha të caktuara të zbatimit të kontratës.

(b) Nënparagrafi i katërt, pika e parë është zëvendësuar nga:

Përmbledhja e disa arsyeve kryesore të përcaktuara në Nenin 55(2) të Direktivës 201/24/EU, i nënshtruar Nenit 55(3) të asaj Direktive, ose në nënparagrafin e dytë të Nenit 40(1) të Direktivës 2014/23/EU, i nënshtruar Nenit 40(2) të asaj Direktive.

(2) Neni 2 b është amenduar si më poshtë:

(c) Në paragrafin e parë pika (a) është zëvendësuar si më poshtë:

Në qoftë se Direktiva 2014/24/EU ose Direktiva 2014/23/EU nuk kërkon publikim paraprak të shpalljes së kontratës në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

(a) Pikat (c) është zëvendësuar si më poshtë:

Në rast se një kontratë është e bazuar në një marrëveshje paraprake sipas Nenit 22 të Direktivës 2014/24/EU dhe në raste të kontratave specifike të bazuara në Procedura Dinamike Prokurimi sipas Nenit 34 të Direktivës.

(b) Në paragrafin e dytë, pjesa e parë dhe e dytë janë zëvendësuar si më poshtë:

Ka një shkelje të pikës (c) të Nenit 33 (4) ose të Nenit 34(6) të Direktivës 2014/24/EU dhe,

Vlera e kontratës është parashikuar të jetë e njëjtë ose të tejkalojë kufirin e përcaktuar në Nenin 4 të Direktivës 2014/24/EU.

(3) Në Nenin 2c, fjalët “Direktivë 2004/18/EC” janë zëvendësuar me fjalët ‘Direktivë 2014/24/EU ose Direktivë 2014/23/EU’;

(4) Neni 2d është amenduar si më poshtë:

(a) Në paragrafin e parë

Pika (a) është zëvendësuar me paragrafin e mëposhtëm:

Në qoftë se autoriteti kontraktor ka dhënë një kontratë pa njoftim paraprak në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, pa qënë e lejueshme nga Direktiva 2014/24/EU ose Direktiva 2014/23/EU’.

Pika (b) fjalët “Direktivë 2004/18/EC” janë zëvendësuar me fjalët ‘Direktivë 2014/24/EU ose Direktivë 2014/23/EU’

(b) Në paragrafin 4, pjesa e parë është zëvendësuar si më poshtë:

Autoriteti kontraktor konsideron që dhënia e një kontrate pa njoftim paraprak në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian është e lejueshme në përputhje me Direktivën 2014/24/EU dhe Direktivën 2014/23/EU.

(c) Në paragrafin 4, pjesa e parë është zëvendësuar si më poshtë:

Autoriteti kontraktor konsideron që dhënia e një kontrate në përputhje me pikën (c) të Nenit 33(4) ose Nenit 34(6) të Direktivës 201/24/EU.

(5) Në Nenin 2d(1), pika (a) është zëvendësuar si më poshtë:

(a) Përpara përfundimit të afatit 30 ditor me efekt nga dita që ndjek datën në të cilën:

Autoriteti kontraktor publikon një njoftim kontrate në përputhje me Nenin 50 dhe 51 të Direktivës 2014/24/EU ose me Nenin 31 dhe 32 të Direktivës 2014/23/EU, sjell që ky njoftim përfshin arsyetimin e vendimit të autoritetit kontraktor për të dhënë një kontratë pa shpallje paraprake në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, ose

Autoriteti kontraktor informon kandidatët në lidhje me përfundimin e kontratës, nëse ky informacion përmban arsye të rëndësishme në përputhje me Nenin 55(2) dhe Nenin 55(3) të Direktivës 2014/24/EU, nënparagrafin e dytë të Nenit 40(1) dhe Nenin 40(2) të Direktivës 2014/23/EU. Ky opinion aplikohet në rastet të cilat i referohen pikës (c) të paragrafit të parë të Nenit 2b të kësaj Direktive.

(b) Neni 3, paragrafi i parë zëvendësohet si më poshtë:

Komisioni Evropian mund të kërkojë procedurën parashikuar në paragrafet nga 2 deri në 5, përpara se një kontratë të përfundojë, ajo konsideron që një shkelje e rëndë e ligjeve të BE në fushën e prokurimeve publike është konstatuar gjatë një procedure të dhënies së një kontrate e cila është nën veprimin e Direktivës 201/24/EU dhe Direktivës 2014/23/EU.

Neni 47**Amendamenti i Direktivës 92/13/EEC**

Direktiva 92/13/EEC është amenduar si më poshtë:

(1) Kjo direktivë zbatohet në kontrate referuar Direktivës 2014/25/EU të Parlamentit Europian dhe Këshillit, përveç rasteve kur janë të përjashtuara në përputhje me Nenin 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 27, 28, 29, 30, 34 dhe 55 të kësaj Direktive.

Kontratat nën veprimin e kësaj Direktive përfshijnë furnizim, punë, shërbime, marrëveshje paraprake dhe procedura dinamike prokurimi. EN 28.3.2014 Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian.

Kjo Direktivë zbatohet për koncesione të dhëna nga autoritetet kontraktore referuar Direktivës 2014/23/EU të Parlamentit Europian dhe Këshillit, përveç rasteve kur këto kontrata janë të përjashtuara sipas Nenit 10, 12, 13, 14, 16, 17 dhe 25 të kësaj Direktive.

Vendet anëtare të BE duhet të ndërmarrin masat e nevojshme që të sigurojnë për kontratat nën veprimin e Direktivës 2014/25/EU dhe Direktivës 2014/23/EU, vendimet e marra nga autoritetet kontraktore mund të rishikohen në mënyrë efektive, sa më shpejt të jetë e mundur në përputhje me kushtet e vendosura në Nenin 2 dhe 2(f) të kësaj Direktive, për arsye se vendime të tilla kanë shkelur ligjet e BE në fushën e prokurimeve publike dhe ligjet kombëtare të cilat janë rrjedhim i ligjeve të BE.

(2) Neni 2 a, paragrafi i dytë amendohet si më poshtë:

(a) Nënparagrafi i parë zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

Një kontratë mund të mos përfundojë pas vendimit për të dhënë një kontratë e cila është nën veprimin e Direktivës 201/25/EU ose Direktivës 2014/23/EU përpara se të përfundojë periudha e 10 ditëve kalendarike, duke filluar nga data në të cilën i është dërguar kandidatëve vendimi për dhënien e kontratës me fax ose mënyra të tjera komunikimi, përpara se të përfundojë periudha e 15 ditëve kalendarike, duke filluar nga data kur i është dërguar kandidatëve vendimi për dhënien e kontratës, ose 10 ditëve kalendarike nga data kur është marrë njoftimi për vendimin e dhënies së kontratës.

(b) Në nënparagrafin e katërt, pjesa e parë është zëvendësuar si më poshtë:

Një përmbledhje e arsyeve të rëndësishme të përcaktuara në Nenin 75(2) të Direktivës 2014/25/EU, subjekti dispozitive të Nenit 40(2).

(3) Neni 2 b amendohet si më poshtë:

(a) Në paragrafin e parë

Pika (a) zëvendësohet nga:

Në qoftë se Direktiva 2014/25/EU, Direktiva 2014/23/EU nuk kërkojnë njoftim paraprak në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Pika (c) zëvendësohet nga:

Në rastet e kontratave specifike të bazuara në prokurim dinamik siç parashikohet në Nenin 52 të Direktivës 2014/25/EU

(a) Në paragrafin e dytë, pjesa e parë dhe e dytë zëvendësohen si më poshtë:

Ka një shkelje të Nenit 52(6) të Direktivës 2014/25/EU, dhe

Vlera e kontratës llogaritet të jetë e njëjtë ose të kalojë kufirin monetar të përcaktuar në Nenin 15 të Direktivës 2014/25/EU.

(4) Në Nenin 2c fjalët ‘Direktivë 2004/17/EC’ zëvendësohet nga fjalët ‘Direktivë 2014/25/EU ose Direktivë 2014/23/EU’.

(5) Neni 2 d amendohet si më poshtë:

(a) Në paragrafin e parë

Pika (a) zëvendësohet nga:

Në qoftë se autoriteti kontraktor ka dhënë një kontratë pa njoftim paraprak në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, kur nuk është e lejueshme sipas Direktivës 2014/25/EU ose Direktivës 2014/23/EU’.

Në pikën (b), fjalët ‘Direktivë 2004/17/EC’ janë zëvendësuar me fjalët ‘Direktivë 2014/25/EU ose Direktivë 2014/23/EU’.

(b) Në paragrafin e katërt, pjesa e parë është zëvendësuar nga:

Autoriteti kontraktor konsideron që dhënia e një kontratë pa njoftim paraprak në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian është e lejueshme sipas Direktivës 2014/25/EU ose Direktivës 2014/23/EU, EN L 94/44 botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian datë 28.3.2014.

(6) Në Nenin 2 f (1), pika (a) zëvendësohet si më poshtë:

Përpara se të përfundojë periudha e 30 ditëve kalendarike, duke filluar nga dita më pas në të cilën:

-Autoriteti kontraktor ka publikuar një lajmërin për dhënie kontrate në përputhje me Nenin 70 dhe 71 të Direktivës 2014/25/EU ose Nenin 31 dhe 32 të Direktivës 2014/23/EU, me kusht që ky njoftim përfshin arsyetimin e vendimit për të dhënë një kontratë, i marrë nga autoriteti kontraktor pa shpallje paraprake në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, ose

-Autoriteti kontraktor informon ofertuesit/kandidatët në lidhje me përfundimin e kontratës, nëse ky informacion përmban një përmbledhje të arsyeve të përcaktuara në Nenin 75(2) dhe Nenin 75(3) të Direktivës 2014/25/EU, ose në nënparagrafin e dytë të Nenit 40(1) dhe 40(2) të Direktivës 2014/23/EU. Ky opsion aplikohet dhe në rastet referuar pikës (c) të paragrafit të parë të Nenit 2b të kësaj Direktive.

(7) Në Nenin 8, paragrafi i parë është zëvendësuar si më poshtë:

Komisioni Evropian mund të kërkojë procedurën e specifikuar në paragrafin 2,3,4 dhe 5, përpara se kontrata të mbyllet, në qoftë se konsideron që ka ndodhur një shkelje e rëndë e ligjeve të BE në fushën e prokurimeve gjatë procedurës së dhënies së një kontrate e cila është nën veprimin e Direktivës 2014/25/EU dhe Direktivës 2014/23/EU, ose në lidhje me Nenin 26(1) të Direktivës 2014/25/EU.

KREU V**Delegimi i kompetencave të tyre dhe dispozitat e fundit****Neni 48****Ushtrimi i kompetencave**

1. Kompetenca për të adoptuar aktet e delegimit jepet nga Komisioni, duke u bazuar në kushtet e përcaktuar në këtë nen.
2. Kompetencat për të adoptuar aktet referuar Nenet 7(3), Neni 9(4), Neni 27(2) dhe Neni 30(4) të dhëna nga Komisioni për një periudhë të pacaktuar kohore nga 17 Prill 2014.
3. Delegimi i kompetencave referuar Nenet 7(3), Neni 9(4), Neni 27(2) dhe Neni 30(4) mund të revokohen në çdo moment nga Parlamenti Evropian ose Këshilli. Vendimi për të revokuar vendos përfundimin e delegimit të kompetencave të përcaktuara në atë vendim. Ai merr efekt ditën pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar. Ai nuk mund të ndikojnë në vlefshmërinë e ndonjë akti delegimi i cili ndodhet në fuqi.
4. Sa heqë që vendos për të adoptuar një akt delegimi, Komisioni duhet të lajmërojë njëkohësisht Parlamentin Evropian dhe Këshillin.
5. Një akt delegimi i adoptuar në përputhje me Nenin 7(3), Nenin 9(4), Nenin 27(2) dhe Nenin 30(4) hyn në fuqi vetëm kur nuk është shprehur ndonjë kundërshti nga Parlamenti Evropian ose Këshilli brenda 2 muajëve nga njoftimi i këtij akti në Parlamentin Evropian dhe Këshilli ose në qoftë se përpara përfundimit të këtij afati, Parlamenti Evropian dhe Këshilli kanë informuar së bashku Komisionin që nuk do ta kundërshtojnë. Kjo periudhë mund të zgjatet me 2 muaj me iniciativë të Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

Neni 49**Procedurat e përshpejtuara**

1. Aktet e delegimit të adoptuara në këtë nen hyjnë në fuqi pa asnjë shtyrje dhe duhet të aplikohen deri në momentin që shprehet ndonjë kundërshtim në

përputhje me paragrafin e dytë. Njoftimi i një akti delegimi në Parlamentin Evropian dhe Këshill duhet të shoqërohet me arsyen e përdorimit të një procedure të përshpejtuar.

2. Si Parlamenti Evropian dhe Këshilli mund të kundërshtojnë një akt delegimi në përputhje me procedurën referuar Neni 48(5). Në të tilla raste, Komisioni duhet të anulojë aktin në mënyrë të menjëhershme, duke e shoqëruar me një lajmërinë në lidhje me vendimin të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për ta refuzuar atë.

Neni 50

Procedurat e Komitetit Këshillues për Prokurimet Publike

1. Komisioni duhet të asistojë Komitetin Këshillues për Prokurimet Publike (i vendosur me Vendimin Nr 71/306/EEC të Këshillit). Ky komitet duhet të menaxhohet brenda Regullores EU Nr.182/2011.
2. Kur është bërë një referencë në lidhje me këtë nen, Neni 4 i Rregullores EU Nr.182/2011 duhet të aplikohet.

Neni 51

Implementimi i direktivës në vendet anëtare

1. Një vend anëtar duhet të nxjerrë ligje, rregullore dhe akte demonstrative në përputhje me këtë Direktivë nga data 18 Prill 2016. Ata duhet të komunikojnë Komisionit aktet e mësipërme.
2. Kur vendi anëtar adopton këto masa, ai duhet të përmbajë referenca të kësaj Direktive. Vendi anëtar duhet të përcaktojë si bëhen këto referenca.
3. Vendi anëtar duhet të komunikojë Komisionit ligjet që nxjerrin të cilat mbulohen nga kjo Direktivë,

Neni 52**Dispozitat kalimtare**

Referuar pikave (a) dhe (b) të Nenit 1(3) të Direktivës 2004/17/EC dhe Nenit 1(3-4) dhe Kreut III të Direktivës 2004/18/EC, këto direktiva duhet të interpretohen si referencë e kësaj Direktive.

Neni 53**Monitorimi dhe raportimi**

Komisioni duhet të vlerësojë efektet ekonomike në tregjet e brendshme, në mënyrë të veçantë faktorët si: kontrata ndërkufitare dhe kostot e transaksioneve, që rezultojnë nga aplikimi i kufirit monetar të përcaktuar në Nenin 8, dhe ta raportojnë atë në Parlamentin Evropian dhe Këshill nga data 18 Prill 2019. Përshtatja e nivelit të kufirit monetar duhet të ekzaminohet në kontekstin e negociimit duke iu nënshtruar Marrëveshjes për Prokurimet Qeveritare (GPA), duke konsideruar impaktin e inflacionit dhe kostot e transaksioneve. Komisionit, kur është e mundur dhe e përshatshme, të konsiderojë sugjerimet që mund të bëhen për të rritur kufirin monetar në negociatat e ardhshme.

Në rast të ndonjë ndryshimi të kufirit monetar, raporti duhet të përmbajë propozimet ligjore për ndryshimin e kufirit monetar të përcaktuar në këtë Direktivë.

Komisioni duhet të vlerësojë efektin ekonomik në tregjet e brendshme, të përjashtimeve të përcaktuara në Nenin 12, duke marrë në konsideratë strukturat specifike në sektorin e ujit, dhe ta raportojnë ata në Parlamentin Evropian dhe në Këshill brenda datë 18 Prill 2019.

Komisioni duhet të rishikojë funksionimin e kësaj direktive dhe duhet të raportojë në Parlamentin Evropian dhe Këshill brenda datës 18 Prill 2021, dhe çdo 5 vjet, bazuar në informacionin që çdo vend anëtar sjell në përputhje me Nenin 45(3).

Komisioni duhet të paraqes rezultatet e rishikimeve të bëra, në përputhje me paragrafin e katërt.

Neni 54

Hyrja ne fuqi

Kjo Direktivë hyn në fuqi 28 ditë pas publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Kjo direktivë nuk duhet të aplikohet për kontrate koncesionesh të dhëna përpara datës 17 Prill 2014.

Neni 55

Veprimtaria

Kjo direktivë i adresohet të gjitha vendeve anëtare.

Strasbourg, 16 Shkurt 2014, Për Parlamentin Evropian

Presidenti

Martin Schulz

Për Këshillin

Presidenti

D. KOURKOULAS

ANEKSI I

LISTA E AKTIVITETEVE TE CILAT U REFEROHET PIKA 7 E NENIT 5;

1. Veprimtari ndërtimore- Ndërtimi i veprave të reja inxhinierike, rikonstruksioni dhe restaurimi; CPV code 45000000
 - a. Prishjet dhe gërmimet.
 - b. Punimet e pilotave.
 - c. Ndërtimi i elementëve strukturorë.
 - d. Ndërtimi i veprave rrugore dhe sportive (stadiume, pallate sporti etj.).
 - e. Ndërtimi i veprave ujore (porte, vepra në lumenjt, liqene etj.).
 - f. Ndërtimi i sistemeve elektrike, telekomunikacionit, internet, hidraulike, kondicionimit, ajrimit, ngrohjes dhe të lidhura me to.
 - g. Rifiniturat, punime të brendshme ose fasadave.

ANEKSI II

**LISTA E AKTIVITETEVE TË CILAT MUND TË JEPEN (PROKUROHEN) NGA
AUTORITETET KONTRAKTORE SIPAS NENIT 7;**

1. Shërbimet e furnizimit me gaz dhe ngrohja.
2. Furnizimi me energji elektrike.
3. Aktivitete të lidhura me shërbimet e transportit:
 - a) Transport urban.
 - b) Transport hekurudhor.
 - c) Tramvaj.
4. Zona të caktura të cilat mund të shërbejnë për ndërtimin e porteve, aeroporteve.
5. Eksplorimi dhe shfrytëzimi i zonave të caktuara gjeologjike të cilat janë të pasura me gaz natyror, naftë, minerale etj.
6. Shërbimi postar, të përcaktura në Nenin 34(1) të Direktivës 2014/25/EU.

ANEKSI III

LISTA E AKTEVE LIGJORE TË BE QË I REFEROHET PIKA B E NENIT 7(2);

Të drejtat që janë të garantuara me anë të procedurës më të përshtatshme të publikimit, ku dhënia e këtyre të drejtave është bazuar në kritere objektive dhe nuk duhet të përbëjë “ të drejtë ekskluzive” në kuadër të kësaj Direktive.

Lista e procedurave, që siguron transparencë për të dhënë autorizime duke u bazuar në akte të tjera legislative të BE të cilat nuk përbëjnë “të drejta ekskluzive” në kuadër të kësaj Direktive:

- a) Dhënia e autorizimeve për të kryer shpime dhe instalime për nxjerrjen e gazit natyror në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas Nenit 4 të Direktivës 2009/73/EC;
- b) Autorizimet ose ftesat për të marrë pjesë në tender për ndërtimin e impianteve të reja elektrike në procedurat e përcaktuara në Direktivën 2009/72/EC;
- c) Dhënia e autorizimeve në përputhje me procedurat e përcaktuara në Nenin 9 të Direktivës 97/67/EC për autorizimet në lidhje me shërbimin postar e cila nuk është dhe nuk do të jetë e rezervuar;
- d) Një procedurë e dhënies së autorizimeve e cila përfshin kërkimet për hidrokarbon në përputhje me Direktivën 94/22/EC;
- e) Kontrata për shërbime publike në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. 1370/2007 për sigurimin e transportit të pasagjerëve me autobus, tramvaj, tren, metro, të cilat janë dhënë në bazë të një procedure tenderi të hapur në përputhje me Nenin 5(3), ku afati i saj është në përputhje me Nenin 4(3) ose (4) të kësaj Rregulloreje.

ANEKSI IV

SHËRBIMET TË CILAT I REFEROHEN NENIT 19;

1. Shërbime mjeksore dhe kujdesit ndaj shëndetit.
2. Shërbime administrative, social-kulturore.
3. Shërbimet e sigurisë.
4. Shërbime të tjera të kryera nga organizatat politike, qendrat rinore.
5. Shërbime të lidhura me aktivitete fetare.
6. Shërbime hotelerie.
7. Shërbime hotelerie dhe katering.
8. Shërbime të tjera të pushtetit vendor ose qendror.
9. Qendrat e vuajtjes së dënimeve ose rehabilitimit të personave të dënuar.
10. Shërbime postare.
11. Shërbime të ndryshme ndërkombëtare.

ANEKSI V

INFORMACIONI QË DUHET TË PËRFSHIHET NË NJOFTIMIN E NISJES SË PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E NJË KONCESIONI DUKE IU REFEREUAR NENIT 31;

1. Emri, numri i identifikimit, adresa, kodi NUTS, numri i telefonit, faksit, adresa e e-mailit dhe adresa e internetit e autoritetit kontraktor.
2. Lloji i autoritetit kontraktor (institucion qendror, lokal, etj.) dhe aktiviteti kryesor i këtij institucioni.
3. Adresa e internetit në të cilën ndodhen dokumentet e procedurës së dhënies së koncesionit.
4. Përshkrimi i koncesionit: natyra, llojet e shërbimeve ose punimeve që do të kryhen (të detajuara), vlera e koncesionit, kohëzgjatja e koncesionit. Kur koncesionet janë të ndara në lote, ky informacion duhet të jetë i specifikuar për çdo lot.
5. Kodet CPV. Kur koncesionet janë të ndara në lote, informacioni duhet të jepet për çdo lot.
6. Kodi NUTS për vendndodhjen kryesore e zhvillimit të shërbimit ose punimeve. Kur koncesionit janë të ndara në lote atëherë ky informacion duhet të jepet për çdo lot.
7. Kushtet për pjesëmarrëje, të cilat përfshijnë:
 - a) Ku është e nevojshme të tregohet nëse koncesionit është i kufizuar nga programe punësimi.
 - b) Ku është e nevojshme të tregohet nëse dhënia e shërbimeve është e mbrojtur me ligj, rregullore ose dispozita administrative për profesione të caktuara.
 - c) Lista dhe përshkrimi i kriterëve për përzgjedhjen e kandidatëve, kërkesat minimale për kualifikim.
1. Afati dhe data e dorëzimit të dokumenteve dhe ofertave nga kandidatët.

2. Kriteret të cilat do të aplikohen për dhënien e koncesionit kur ato nuk janë në dokumentet e tjera të koncesionit.
3. Data e dërgimit të njoftimit.
4. Emri dhe adresa e njësisë/organit i cila do të merret me procedurën e apelimit. Informacion i saktë dhe afati kohor për dorëzimin e ankesave.
5. Kur është e nevojshme, kushtet e veçanta në lidhje me performancën që duhet të ketë koncesioni.
6. Adresa ku kandidatët/ofertuesit duhet të adresohen.
7. Kur është e nevojshme, informacione në lidhje me mënyrën e përdorimit të mjeteve elektronike për aplikim ose komunikim.
8. Informacion nëse koncesioni është i lidhur me ndonjë program ose projekt të financuar nga Bashkimi Evropian.
9. Për koncesione të cilat konsistojnë në ndërtimin e veprave, të tregohet nëse është nën efektin e Marrëveshjes për Prokurimet Qeveritare (GPA).

ANEKSI VI

INFORMACION I CILI DUHET TË PËRFSHIHET NË NJOFTIMIN E NJË KONCESIONI PËR SHËRBIME SOCIALE DHE SHËRBIME TË TJERA REFERUAR NENIN 31(3);

1. Emri, numri i identifikimit, adresa, kodi NUTS, numri i telefonit, faksit, adresa e emailit dhe adresa e internetit e autoritetit kontraktor.
2. Adresa e internetit në të cilën ndodhen dokumentet e procedurës së dhënies së koncesionit.
3. Lloji i autoritetit kontraktor (institucion qendror, lokal, etje) dhe aktiviteti kryesor i këtij institucioni.
4. Kodet CPV. Kur koncesionet janë të ndara në lote, informacioni duhet të jepet për çdo lot.
5. Kodi NUTS për vendndodhjen kryesore e zhvillimit të shërbimit ose punimeve. Kur koncesionit janë të ndara në lote atëhere ky informacion duhet të jepet për çdo lot.
6. Përshkrimi i koncesionit: natura, llojet e shërbimeve ose punimeve që do të kryhen (të detajuara), vlera e koncesionit, kohëzgjatja e koncesionit. Kur koncesionet janë të ndara në lote, ky informacion duhet të jetë i specifikuar për çdo lot.
7. Kriteret për pjesëmarrësit.
8. Kur e mundur të aplikohet, afati kohor për të kontraktuar shërbimin.
9. Ku është e nevojshme, një përshkrim i shkurtër për kriteret kryesore që do të aplikohen në procedurën e vlerësimit dhe dhënies së kontratës së koncesionit.
10. Informacion tjetër që mund të konsiderohet i rendësishëm.

ANEKSI VIII

INFORMACION I CILI DUHET TË PËRFSHIHET NË SHPALLJEN E FITUESIT, DUKE IU REFERUAR NENIT 32;

1. Emri, numri i identifikimit, adresa, kodi NUTS, numri i telefonit, faksit, adresa e e-mailit dhe adresa e internetit e autoritetit kontraktor.
2. Lloji i autoritetit kontraktor (institucion qendror, lokal, etj.) dhe aktiviteti kryesor i këtij institucioni.
3. Kodet CPV. Kur koncesionet janë të ndara në lote, informacioni duhet të jepet për çdo lot.
4. Kodi NUTS për vendndodhjen kryesore e zhvillimit të shërbimit ose punimeve. Kur koncesionit janë të ndara në lote atëhere ky informacion duhet të jepet për çdo lot.
5. Përshkrimi i koncesionit: natyra, llojet e shërbimeve ose punimeve që do të kryhen (të detajuara), vlera e koncesionit, kohëzgjatja e koncesionit. Kur koncesionet janë të ndara në lote, ky informacion duhet të jetë i specifikuar për çdo lot.
6. Përshkrimi i procedurës së përdorur, në raste kur është bërë pa publikim paraprak dhe justifikim.
7. Kriteret referuar Nenit 41 të cilat janë përdorur për të dhënë kontratën e koncesionit.
8. Data e shpalljes së fituesit.
9. Numri i ofertave të marra për çdo procedurë:
 - a) Numri i ofertave të marrë nga operatorët ekonomike të cilët janë ndërmarrje (biznese) të vogla ose të mesme.
 - b) Numri i ofertave të marra nga jashtë.
 - c) Numri i ofertave të marra elektronikisht.

10. Për çdo procedurë të mbyllur të shkruhet, emri, adresa përgjithëse dhe kodin NUTS, në qoftë se është e mundur, telefonin, faksin, adresën e e-mailit, adresën e internetit për operatorin fitues (informacion në qoftë se është konsorcium ose ndërmarrje e vogël).
11. Vlerën dhe kushtet financiare kryesore të kontratës së dhënë, përgjithëse:
 - a) Tarifat dhe penalitete nëse ka;
 - b) Çmimet dhe pagesat nëse ka;
 - c) Detaje të tjera të rëndësishme të cilat lidhen me vlerën siç janë përcaktuar në Nenin 8(3);
12. Informacion në qoftë se koncesioni është i lidhur me ndonjë projekt ose program të financuar nga fondet e BE.
13. Emri dhe adresa e njësisë/organit e cila do të merret me procedurën e apelimit. Informacion i saktë dhe afati kohor për dorëzimin e ankesave.
14. Data dhe referenca e publikimit të mëparshëm të koncesioneve në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.
15. Data e dërgimit të njoftimit.
16. Metodatat e përdorura për të llogaritur vlerën e kontratës së koncesionit, në qoftë se nuk është e specifikuar në dokumenta të tjera në përputhje me Nenin 8.
17. Ndonjë informacion tjetër me rëndësi i cili është specifikuar EN L 94/60 të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian të datës 28.03.2014.

ANEKSI VIII

INFORMACION I CILI DUHET TË PËRFSHIHET NË SHPALLJEN E FITUESIT TË NJË KONTRATE KONCESIONI PËR SHËRBIME SOCIALE OSE SHËRBIME TË TJERA SPECIFIKE DUKE IU REFERUAR NENIT 32;

1. Emri, numri i identifikimit, adresa, kodi NUTS, numri i telefonit, faksit, adresa e e-mailit dhe adresa e internetit e autoritetit kontraktor.
2. Lloji i autoritetit kontraktor (institucion qendror, lokal, etje) dhe aktiviteti kryesor i këtij institucioni.
3. Kodet CPV. Kur koncesionet janë të ndara në lote, informacioni duhet të jepet për çdo lot.
4. Një përmbledhje e qëllimit të koncesionit.
5. Numri i ofertave të marra.
6. Vlera e ofertave fituese, ku përfshihen dhe tarifat dhe çmimet.
7. Emri, adresa, kodi NUTS, telefoni, faksi, adresa e e-mail, website i operatorit/operatorëve ekonomik fitues.
8. Ndonjë informacion tjetër që konsiderohet i rendësishëm.

ANEKSI IX

TË DHËNA NË LIDHJE ME PUBLIKIMIN;

1. Njoftimi i publikimit

Njoftimi i cili i referohet nenit 31 dhe 32 duhet të dërgohet nga autoritetet kontraktore në Zyrën e Publikimeve të Bashkimit Evropian dhe të publikohet sipas rregullave të mëposhtme:

Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian duhet të dërgojë konfirmimin e publikimit autoritetit kontraktor duke iu referuar Nenit 33(2).

2. Formatimi dhe procedura e njoftimeve duhet të niset edhe elektronikisht.

ANEKSI X

LISTA E KONVENTAVE SOCIALE DHE MJEDISORE TË CILAT I REFEROHET NENI 30(3)

Konventa ILO 87 "Freedom of Association and the Protection of the Right to Organise".

Konventa ILO 98 "Right to Organise and Collective Bargaining".

Konventa ILO 29 " Forced Labour".

Konventa ILO 105 " The Abolition of Forced Labour".

Konventa ILO 138 " Minimum Age".

Konventa ILO 111 "Discrimination (Employment and Occupation)".

Konventa ILO 100 "Equal Remuneration".

Konventa ILO 182 "Worst Forms of Child Labour".

Gjithashtu konventat e mëposhtme si:

Konventa e Vienës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit dhe Protokolli i Montrealit për Substancat të cilat zvogëlojnë shtresën e ozonit.

Konventa e Bazelit për Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme.

Konventa e Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm.

Konventa në lidhje me Procedurën e Autorizimeve dhe Trajtimeve të Mbetjeve Kimike të Rrezikshme dhe Pesticideve në tregjet botërore (UNEP/FAO) dhe tre protokolle rajonale.

Përktheu:Krisi Anastasi

Helena Solis

Idlir Dervishi



Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit

Iniciativë e përbashkët e Bashkimit European dhe Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), financuar kryesisht nga BE

III. BOTIME TË SIGMA MBI PROKURIMET PUBLIKE



Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit

Iniciativë e përbashkët e Bashkimit European dhe Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), financuar kryesisht nga BE

III. 1 UDHËZUES NR. 1

PROKURIMI PUBLIK NË BE

STRUKTURA LIGJORE, PARIMET BAZË DHE INSTITUCIONET

Përmbajtja

- Konteksti i përgjithshëm: Traktati i Romës, Parimet e Përgjithshme Ligjore, Udhëzimet e BE^{së}
- Qëllimi i Udhëzimeve
- “Efektet ligjore” të Udhëzimeve
- Parimet bazë të prokurimit publik: Konkurimi, trajtimi i barabartë dhe mos-diskriminimi, transparenca
- Roli i Institucioneve Evropiane

Për të kuptuar bazën e prokurimit publik në BE, është e nevojshme njohja jo vetëm e Udhëzimeve të prokurimit, por edhe kontekstit ku ato janë përdorur. Edhe me përdorimin e duhur të Udhëzimeve, shumë dispozita të Traktatit të Romës përdoren, ashtu si dhe më shumë parime të përgjithshme të ligjit, që do të drejtojnë interpretimin e Udhëzimeve. Është gjithashtu e rëndësishme për të kuptuar rolin e Institucioneve të ndryshme.

Traktati i Romës: Traktati i Romës 1957 (dhe traktatet e mëvonshme që ndryshuan traktatin e Romës) nuk përfshijnë ndonjë dispozitë të saktë në lidhje me prokurimin publik. Megjithatë Traktati, gjithsesi, përcakton një numër parimesh të rëndësishme që përforcojnë BE. Për këto parime të rëndësishme, termat kryesore të prokurimit publik janë:

- Ndalesa e diskriminimit në lidhje me kombësinë
- Lëvizja e lirë e mallrave
- Liria në sigurimin e shërbimit
- Liria në krijim

Parimet e përgjithshme të ligjit: Në shtesë të parimeve bazë të këtij Traktati, vijnë disa parime

të përgjithshme ligjore nga rastet ligjore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (ECJ). Këto parime të përgjithshme janë të rëndësishme sepse ato përdoren gjithmonë nga ECJ për të mbushur hapësirat boshe të legjislacionit, si dhe të sigurojnë zgjidhje për situatat, që shpesh janë shumë komplekse. Parimet më të rëndësishme ligjore në kontekstin e prokurimit janë të mëposhtmet:

- Barazia e trajtimit
- Transparenca
- Njohja e dyanshme
- Proporcionaliteti

Këto parime të përgjithshme aplikohen në mënyrë të pavarur nga Udhëzimet, kështu në qoftë se Udhëzimet nuk zbatohen, parimet mund të zbatohen nga autoriteti kontraktor për prokurimet dhe fitimin e kontratës.

Udhëzimet e BE^{-së}: Për të përforcuar parimet e Traktatit në fushën e prokurimeve publike dhe për të siguruar orientimin e duhur të vendeve anëtare, Komuniteti Evropian adoptoi një seri Udhëzimesh për prokurimin.

Udhëzimet e prokurimit që mbulojnë çështjet procedurale janë Udhëzimi 2004/18/EC i sektorit publik dhe Udhëzimi 2004/17/EC i sektorit të shërbimeve.

Ka dhe dy Udhëzime të tjerë “shërues”, të cilat aplikohen gjatë ankesave dhe bëjnë një rishikim të Udhëzimeve të mësipërme dhe janë Udhëzimi 89/665/EC i sektorit publik dhe Udhëzimi 92/12/EC i sektorit të shërbimeve. Këto Udhëzime “shëruese” janë amenduar nga një Udhëzim i ri 2007/66/EC, i cili është implementuar nga vendet anëtarë në 20 Dhjetor 2009.

Në shtesë të tyre ka tani një Udhëzim të ri, i cili zbaton një mënyrë më fleksibile dhe konfidenciale në prokurimet e blerjeve ushtarake dhe punëve e shërbimeve të ngjashme – Udhëzimi 2009/81/EC.

Komisioni Evropian ka shtuar këto Udhëzime procedurale dhe “shëruese” nga legjislacione të tjera që i përkasin aspekteve të ndryshme të procesit të prokurimit.

Cili është qëllimi i Udhëzimeve?

Udhëzimet nuk kërkojnë të imponojnë një regjim të *zakonshëm* rregullator në Shtetet Anëtare të BE në fushën e prokurimit, dhe shtetet anëtare mund të vazhdojnë të aplikojnë procedurat e tyre kombëtare *përshtatur* me Udhëzimet. Kjo lejon që vendet anëtare të mbajnë ose adoptojnë rregulla procedurale dhe të pavarura me kushtin që këto të mos jenë në konflikt me Udhëzimet apo dispozitat e Traktatit. Si rrjedhojë, shtetet anëtare mbeten të lira për të rregulluar disa çështje, sidomos çështjet praktike.

Rregullat e zakonshme të Udhëzimeve konsistojnë në aplikimin e parimeve bazë, mosdiskriminimin, trajtimin e barabartë dhe transparencën në:

- Publikimin e propozimeve të kontratave të prokurimit
- Dizenjimi i specifikimeve teknike
- Zgjedhjet e procedurës së prokurimit
- Kualifikimi dhe zgjedhja e kandidatëve dhe tenderuesve
- Përzgjedhja e kontratës fituese

Në vend që të kërkojë të rregullojë me saktësi të gjitha kontratat e prokurimeve publike brenda BE, legjislativi i Komunitetit ka zgjedhur të rregullojë me Udhëzime vetëm ato kontrata që kishin më shumë mundësi për të realizuar tregtinë midis vendeve anëtare. Ato që janë brenda kufijve të këtij përcaktimi përfshijnë:

- kontratat që janë me vlera mjaftueshmërisht të larta, për të tërhequr operatorë ekonomikë nga shtetet e tjera anëtare (p.sh. kur përfitimi i mundshëm nga fitimi i kontratës i tejkalon kostot e sigurimit të mallrave, punëve apo shërbimeve nga një distancë më e largët); dhe/ose
- kontratat për mallrat apo shërbimet që mund të tregtohen jashtë kufijve.

Çfarë janë “Efektet Ligjore” të Udhëzimeve?

Shtetet anëtare janë të detyruara të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar plotësimin e detyrimeve që lindin jashtë Traktatit ose nga veprimet e ndërmarra nga institucionet e Komunitetit. Udhëzimet e prokurimit, si çdo Udhëzim, janë me përkufizim jo direkt të zbatueshme apo të aplikueshme automatikisht.

Në mënyrë që të japin efekte brenda vendeve anëtare, ato duhet të implementohen apo shtohen në ligjin kombëtar. Vendeve anëtare u kërkohet kështu, të marrin masat e nevojshme të nxjerrin efektin e plotë të dispozitave të Udhëzimeve në ligjin përkatës dhe të sigurojnë që dispozitat e tjera të vendit anëtar të mos zvogëlojnë aplikueshmërinë e tij. Kjo normalisht merr formën e sjelljes së Udhëzimit në ligjin e vendit dhe shfuqizimin e gjithë dispozitave ligjore që bien ndesh me të.

Udhëzimet detyrojnë vetëm në arritjen e rezultatit, por lënë në dorë të autoriteteve kombëtare zgjedhjen e formës dhe metodës. Kështu është e nevojshme për Shtetet Anëtare të BE të krijojnë një kopje të plotë të Udhëzimeve në legjislacionin e tyre, megjithëse disa vende anëtare e kanë zbatuar saktësisht atë.

Dështimi në implementimin korrekt të Udhëzimeve ose jo në kohën e duhur, nuk do të thotë që Udhëzimet nuk kanë më efekt. Shtetet anëtare nuk duhet t’u heqin subjekteve ato (kontraktimi i autoriteteve dhe operatorëve ekonomikë) të drejta që ato mund të gëzojnë nga këto Udhëzime. Në përputhje me doktrinën e ECJ^{së} mbi “efektin e drejtpërdrejtë”, individët mund të imponojnë në gjykatat e vendit të tyre, të drejtat që vijnë prej Udhëzimeve, aty ku kushtet e duhura plotësohen.

Kushtet e nevojshme që mundësojnë arritjen e efektit të drejtpërdrejtë të një Udhëzimi të veçantë janë si më poshtë:

- detyrimi i imponuar në vendet anëtare është i qartë dhe i saktë
- detyrimi është pa kushte
- në kushtet e implementimit të masave, shtetet anëtare ose Institucionet e Komunitetit Evropian nuk kanë liri veprimi.

ECJ^{të} kanë parë që shumë prej dispozitave të Udhëzimeve nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë, por secila prej tyre duhet të merret parasysh më vete.

Cilat janë parimet bazë të prokurimit publik?

Fillimisht, një nga objektivat kryesore të BE ka qenë krijimi i një tregu të përbashkët që eliminon barrierat në tregtimin e mallrave dhe shërbimeve midis Shteteve Anëtare të BE^{së}. Krijimi i një tregu të zakonshëm të prokurimeve do të thotë heqja e çdo barriere të tregtisë në kontekstin e prokurimeve.

Barrierat për tregtinë mund të ngrihen nga ligjet, nga veprimet e autoritetit kontraktor apo operatorit ekonomik. Ligjet krijojnë barrierë nga imponimi i “blerjes brenda vendit”. Autoritetet kontraktore mund të vendosin barrierë gjatë dhënies së kontratës në mënyrë diskriminuese. Operatorët ekonomikë mund të krijojnë barrierë gjatë bashkëpunimeve midis tyre për të manipuluar me çmimet e tenderave. Të gjitha këto veprime ndikojnë në përkeqësimin e konkurrencës në një treg normal prokurimi. Një nga qëllimet kryesore të legjislacionit të prokurimeve publike është eliminimi i barrierave dhe parandalimi i shtimit të mëtejshëm të tyre. Këtë e bën nëpërmjet zbatimit të parimeve bazë në legjislacion.

Ndërsa të gjitha janë në lidhje me njëra-tjetrën, parimet e mëposhtme mund të konsiderohen si parime bazë:

- **Konkurrenca**

Nga një perspektivë ekonomike, “konkurrenca” vepron si një procedurë zbulimi duke lejuar operatorë të ndryshëm ekonomikë të komunikojnë mbi çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve. Ato çmime shërbejnë si referencë dhe pasqyrojnë kërkesën dhe ofertën në një moment kohe të caktuar. Kjo realizohet me aplikimin e parimeve bazë në legjislacion.

Reklamimi është shumë i rëndësishëm. Reklamimi garanton publikimin më të madh të mundshëm dhe konkurrencën, duke përfshirë në pjesëmarrje operatorë ekonomikë nga gjithë Komuniteti Evropian, duke siguruar zgjedhjen më të mirë të mundshme.

Duke mbajtur konkurrimin të ndershëm (ose ruajtjen e “nivelit të fushës së lojës”) është një çështje kyçe për arritjen e rezultateve eficiente dhe ekonomike gjatë prokurimit. Legjislacioni i prokurimit kërkon të parandalojë çdo shmangie apo ngushtim të konkurrencës brenda Komunitetit Evropian, dhe çdo përpjekje për të ndaluar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë nuk është e lejueshme.

Këto përpjekje mund të jenë të formave të ndryshme dhe mund të ndikojnë në mallrat, shërbimet ose vetë operatorin ekonomik. Si rrjedhojë, legjislacioni ndalon barrierat e qarkullimi të lirë të mallrave si kufizimet në import, politikën e “blerjes brenda vendit” dhe barrierat në lirinë e sigurimit të shërbimeve si përpjekje për të kufizuar operatorë ekonomikë të huaj nga tenderimi nëpërmjet plotësimit të kërkesave lokale gjatë regjistrimit.

Mbrojtja e konkurrencës është gjithashtu një kërkesë për mbajtjen e barazisë në trajtim, ndalimin e diskriminimit, zbatimin e parimeve të njohura të dyanshme (të mallrave ekuivalente dhe kualifikimeve) dhe sigurimit që përjashtimet janë proporcionale.

- **Trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi**

Koncepti i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit nuk janë e njëjta gjë. Në terma të përgjithshëm, gjithë legjislacioni i prokurimit publik kërkon të mbajë një barazi midis operatorëve ekonomikë. Në kontekstin Evropian, barazia do të bazohet përsëri në “kombësi”.

Trajtimi i barabartë është një koncept që zakonisht kërkon që situatat identike të trajtohen në mënyrë të njëjtë ose situatat e ndryshme të mos trajtohen në të njëjtën mënyrë, dhe kjo kërkon trajtim identik për njerëz identikë. Në njëfarë kuptimi, kjo kërkon që autoriteti kontraktor të mos marrë parasysh aftësitë e ndryshme ose vështirësitë e hasura nga operatorët e ndryshëm, por t’i gjykojë ata në bazë të rezultateve të përpjekjeve të tyre, p.sh. në bazë të tenderave në të cilët ata aplikojnë. Kjo ndihmon për një vlerësim objektiv të çmimit të tenderit dhe cilësive të tenderuesit dhe injoron çdo lloj konsiderimi tjetër, jo të rëndësishëm në lidhje me zbulimin e ekonomicitetit dhe efijencës së tenderave.

Në kontekstin Evropian, koncepti i trajtimit të barabartë kërkon dhe një përcaktim tjetër, përderisa, në këtë kontekst, koncepti i barazisë, është i bazuar në kombësinë ose në origjinën e mallrave, operatorët ekonomikë të Komunitetit Evropian dhe ofertat e mallrave brenda Komunitetit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë (ky është parimi i mosdiskriminimit).

Ky është më shumë se një shtim i konceptit të trajtimit të barabartë. Kjo kërkon që çdo kusht i pranueshmërisë ose origjinës (i bazuar në kombësinë apo prejardhjen lokale) do të rrisë automatikisht trajtimin e jo – barazisë, dërsa këto kushte do të diskriminojnë një grup të caktuar të huaj operatorësh ekonomikë ose të favorizojë të tjerë. Megjithatë, ndërsa diskriminimi prodhon një trajtim të pabarabartë, trajtimi i pabarabartë nuk sjell domosdoshmërisht rritje të diskriminimit.

• **Transparenca**

“Transparenca” vetëm së fundmi është evidentuar si një parim më vete, megjithëse është më mirë të mendohet si një mënyrë për t’u përdorur për arritjen e objektivave të tjerë. Për shembull:

- Publikimi dhe aksesimi në legjislacion sjell qartësi dhe siguri për gjithë grupet e interesit dhe lejon autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë të mbrohen nga rregullat e lojës.
- Kërkesa të shpalljes së garancisë në procesin e zbulimit
- Publikimi i specifikimeve teknike, përzgjedhjes dhe kriterit të fitimit të kontratës, u jep mundësi palëve të interesuara të kontrollojnë nëse këto janë të vërteta dhe jodiskriminuese.
- Regjistrimi dhe raportimi i kërkesave siguron që veprimet e autoritetit kontraktor mund të verifikohen kur është e nevojshme.

Objektivat e fundit janë gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i “përgjegjësisë”, e cila është shpesh një objektiv i qartë i sistemit të prokurimit kombëtar dhe dispozitat e transparencës e përforcojnë atë.

Rëndësia e një parimi të transparencës në kontekstin Evropian, është aplikueshmëria e tij në mënyrë të pavarur nga legjislacioni. Kështu, nëse një kontratë e veçantë prokurimi del jashtë qëllimit të Udhëzimeve, atëherë është e mundur që parimi i transparencës do të vazhdojë të zbatohet për të imponuar kërkesat e publikimit. ECJ konfirmon që ky është rasti praktik.

Disa nga parimet e mësipërme janë të veçuara ose të kombinuara në legjislacionin e një vendi. Kështu mund të gjenden parime si : “ekonomiciteti dhe efienca”, “vlera e parasë” dhe “ndershmëria” ose “integriteti”.

Vlera e parasë

Një faktor ekonomik i rëndësishëm gjatë procesit të prokurimit është nevoja e sigurisë që të gjitha blerjet të paraqesin vlerë të parasë. Udhëzimet nuk e specifikojnë këtë çështje, por është e rëndësishme të mos humbasë objektivi i vlerës së parasë, si më kryesori në procesin e prokurimit. Termi vlerë e parasë nënkupton kombinimin më të mirë, të faktorëve të lidhur apo jo të lidhur me koston, që së bashku plotësojnë kërkesat e autoritetit kontraktor. Elementet që përbëjnë kombinimin më të mirë të këtyre faktorëve ndryshojnë nga njëri prokurim në tjetrin dhe varen nga rezultatet e kërkuara nga autoriteti kontraktor për prokurimin konkret.

Cili është roli i Institucioneve Evropiane ?

Një numër organizatash të ndryshme janë përfshirë në prokurim në nivelin Evropian. Këto organizata janë:

Roli i Legjislativit të Komunitetit: Megjithëse Traktati (Traktati i Romës 1957 dhe traktatet e ndryshmeve të tij) përdorin terminologji të ndryshme, Legjislativi i Komunitetit është faktikisht Këshilli i Komunitetit Evropian, që vepron vetëm apo në bashkëpunim me Parlamentin Evropian. Të gjitha Udhëzimet e fundit të prokurimit u adoptuan nga këto dy institucione së bashku, nëpërmjet përdorimit të procedurës së “vendimarrjes së përbashkët”.

Këshilli i është caktuar roli i koordinimit të politikave të përgjithshme ekonomike të vendeve anëtare, fuqia për të marrë vendime dhe fuqia për të diskutuar në Komision për aktet që ai adopton dhe implementimin e rregullave të vendosura nga Këshilli.

Këshilli nuk ka të drejtën e inisiativës. Ai nuk ka fuqinë të ndryshojë legjislacionin, nëse nuk është propozuar më parë nga Komisioni.

Roli i Shteteve Anëtare të BE^{së}: Në funksion të qëllimit të BE, vendet anëtare janë të detyruar të marrin të gjitha masat e nevojshme për të plotësuar të gjitha

detyrimet që lindin nga Traktati apo nga veprimet e ndërmarra nga Institucionet e Komunitetit Evropian. Ato duhet të lehtësojnë arritjen e detyrave të Komunitetit dhe nuk duhet të pranojnë asnjë masë që mund të rrezikojë arritjen e objektivave të Traktatit.

Në lidhje me Udhëzimet, shtetet anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të zbatuar dispozitat kombëtare ligjore dhe të sigurojnë se asnjë dispozitë tjetër kombëtare nuk zvogëlon zbatueshmërinë e tyre. Kjo normalisht merr formën e një zhvendosjeje të Udhëzimeve në ligjet kombëtare dhe në shfuqizimin e dispozitave që bien në kundërshtim me to.

Është i rëndësishëm nënvizimi i faktit se megjithëse Udhëzimet janë efektive në mënyrë të drejtpërdrejtë kur kushte të caktuara plotësohen, në lindjen e të drejtave edhe kur nuk implementohen, ato nuk mund të zbatohen direkt, por duhet të bëhen pjesë e ligjeve të vendit.

Roli i Komisionit Evropian: Përveç propozimit të legjislacionit, Komisioni Evropian ka gjithashtu rolin e mbrojtjes së tij, të dhënë nga Traktati. Ai duhet të sigurojë që dispozitat e traktatit dhe masat e marra nga institucionet pjesëmarrëse të zbatohen.

Përveçse vepron si krijuesi i politikave primare në fushën e prokurimit, Komisioni është gjithashtu përgjegjës për zbatimin dhe përforcimin e përgjithshëm të Udhëzimeve. Në rastin e prokurimeve, drejtoria përgjegjëse është DG-Markt. Masat e ndërmarra nga DG-Markt përfshijnë adoptimin e legjislacionit dytësor.

Përforcimi në gjykatat e vendeve i moskontraktimit të subjekteve që nuk i janë përmbajtur detyrimeve të tyre, është i përshtatshëm për operatorët ekonomikë të interesuar, shkeljet nga autoritetet kontraktore, si pjesë e të qenit shtet anëtar, do të çojnë në dështimin e vendeve anëtare, në plotësimin e detyrimeve që sjell Traktati. Ky dështim do të trajtohet më parë nga Komisioni, dhe më pas nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

Roli i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë: Ka dy gjykata të Komunitetit, secila me pushtetin e vet: Gjykata e Përgjithshme (më parë Gjykata e Shkallës së Parë{CFI}), e cila merret me veprimet e bëra kundër institucioneve të komunitetit dhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë (ECJ). Në shumicën e rasteve gjatë prokurimit, ECJ është më e interesuar.

ECJ garanton bazimin në ligj gjatë interpretimit dhe zbatimit të Traktatit dhe rregullave të tij. Disa fuqi i janë dhënë ECJ, të cilat i japin asaj mundësi të gjykojë veprimet dhe joveprimet e institucioneve, vendeve anëtare në përputhje me ligjet e Komunitetit dhe të sigurojë njëtrajtshmërinë e interpretimit të ligjeve të komunitetit dhe zbatimin e tyre nga gjykatat kombëtare.

Janë tre fusha të rëndësishme në fushën e prokurimit, ku ECJ punon:

- **Diskutimet e mundësive**

ECJ dëgjon diskutimet midis Komisionit, mbrojtëse të Traktatit, dhe vendeve anëtare që mbrojnë dështimet e tyre në plotësimin e detyrimeve të këtij Traktati. Këto njihen shpesh si shkeljet e procedurave të Komisionit.

- **Rregullat paraprake**

ECJ ka fuqinë e të qënurit kritike në lidhje me rregullat paraprake gjatë interpretimit të Traktatit dhe në vlefshmërinë dhe interpretimin e veprimeve të institucioneve të Komunitetit, nëse një çështje e tillë lind para një gjyqi.

Kështu diskutimet që mund të lindin midis shteteve anëtare dhe personave privatë ose midis vetëm personave privatë, çështje rreth interpretimit, zbatimit dhe vlefshmërisë së ligjeve të Komunitetit Evropian gjatë kontekstit të veprimeve kombëtare, trajtohen nga ECJ. Kur çështje të tilla lindin gjatë prokurimit dhe janë çuar në procese gjyqësore, procesi gjyqësor përkatës do të përcaktojë faktet dhe të formulojë pyetje që i drejtohen ECJ, përgjigjet e të cilave duhen për zgjidhjen e çështjeve.

- **Parimet e përgjithshme të ligjit**

Gjatë ushtrimit të pushtetit, ECJ ka detyrim të zbatojë dhe interpretojë ligjin e Komunitetit, duke plotësuar kështu boshllëkun e ligjit të Komunitetit nëpërmjet referimit në parimet e përgjithshme të ligjit. Këto janë rregulla të pashkruara, që nuk përfshihen në Traktat, por të krijuara nga ato parime të përgjithshme, të zakonshme ligjore, të njohura në sistemet ligjore kombëtare të Vendeve Anëtare të BE^{së}.

Përktheu: Irma Idrizaj



Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit

Iniciativë e përbashkët e Bashkimit European dhe Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), financiar kryesisht nga BE

III. 2 UDHËZUES NR. 10

PROKURIMI PUBLIK

Cilat janë procedurat e prokurimeve publike dhe kur mund të përdoren ato?

Përmbajtja

- Llojet kryesore të procedurave të prokurimit
- Kur mund të përdoren procedurat kryesore të prokurimit?
- Procedura e negociimit pa shpallje
- Përjashtimet

Supozimi bazë në prokurimin publik është që kontratat e një lloji dhe vlere të caktuar duhet të prokurohen me një procedurë konkurruese prokurimi, të shpallur, të hapur, të ndershme dhe transparente, që siguron barazi në trajtimin e kandidatëve apo tenderuesve. Ekzistojnë vetëm pak situata ku lejohet një procedurë pa shpallje.

Procedurat kryesore konkurruese të prokurimit të mundshme në udhëzimet e prokurimit janë procedura e hapur, procedura e kufizuar, kërkesa për propozim dhe procedura me negociim me shpallje paraprake.

Procedura e hapur dhe procedura e kufizuar janë procedurat më të preferuara dhe mund të përdoren pa plotësimin e kushteve të vecanta. Kërkesa për propozim dhe procedura me negociim me shpallje paraprake mund të përdoren vetëm kur plotësohen disa kushte specifike. Ekzistojnë gjithashtu procedura të vecanta, që mund të përdoren në prokurimin publik të kontratave të punës, së subvencionimit të skemave të strehimit, koncensioneve publike dhe projektimit.

Dispozitat e prokurimit nxjerrin proceset që duhet të ndiqen nga autoriteti kontraktor, gjatë secilës prej procedurave të prokurimit. Niveli i detajimit ndryshon në varësi të llojit të procedurës.

Udhëzimet gjithashtu përfshijnë dispozita të prokurimit që një autoritet kontraktues mund të zgjedh për përdorim shtesë në një procedurë konkurimi, kur kjo është e mundur, si marrëveshjet, ankandet elektronike dhe sistemet dinamike të blerjes.

Kur një autoritet kontraktor zgjedh si fituese një kontratë pa konkurim, duke përdorur çfarë është e njohur si 'procedurë negociimi pa shpallje paraprake', atëherë mund ta zgjedh këtë procedurë kur kushtet e vendosura nga dispozitat ligjore të prokurimit janë plotësuar. Gjykata Europiane e Drejtësisë (ECJ) ka konfirmuar se këto kushte nuk duhen interpretuar dhe se kontrata pa konkurim duhet të ndodhë vetëm në kushte të jashtëzakonshme.

Cilat janë llojet kryesore të procedurave të prokurimit të mundshme për autoritetin kontraktor?

Janë katër procedura kryesore prokurimi:


Procedura e hapur: Kjo është një procedurë me një fazë të vetme. Autoriteti kontraktues boton njoftimin e kontratës dhe pastaj vlerëson dokumentet e plota të tenderit, duke përfshirë specifikimet dhe kontratën, të të gjithë operatorëve ekonomikë që pranojnë të marrin pjesë. Operatorët ekonomikë plotësojnë informacionin e kërkuar për kualifikim. Autoriteti kontraktor mund të marrë oferta nga shumë operatorë, nuk mund të kontrollojë numrin e ofertave që mund të marrë, jo domosdoshmërisht të gjithë operatorët mund të merren në konsideratë, por vetëm ata operatorë që plotësojnë specifikimet dhe kriterin e vlerësimit të vendosur nga autoriteti kontraktor. Tenderuesit mund të vlerësohen në bazë të cmimit më të ulët ose tenderit më avantazhues ekonomikisht. Nuk lejohen negocimet me operatorët ekonomikë, pasi autoriteti kontraktor mund të sqarojë aspekte të tenderit me një tenderues të caktuar.

Procedura e kufizuar: Është një procedurë me dy faza. Autoriteti kontraktor boton njoftimin e kontratës dhe operatorët ekonomikë kërkojnë të marrin pjesë dhe më vonë të sigurojnë kalimin në fazën tjetër të kualifikimit në të cilën autoriteti kontraktor përcakton cili operator ekonomik kualifikohet për mundshmërinë e zbatimit të kontratës dhe të zgjedh operatorët ekonomikë që do të ftohen në tender. Autoriteti kontraktor mund të kufizojë numrin e operatorëve ekonomikë që ftohen në tender dhe të nxjerrë një listë të operatorëve ofertues. Kjo do të thotë që jo të gjithë operatorët ekonomikë që kualifikohen mund të ftohen në tender. Autoriteti kontraktor vlerëson dokumentacionin e plotë të tenderit, që përfshin specifikimet dhe kontratat e secilit operator ofertues. Kjo do të thotë se, ndryshe nga procedura e hapur, procedura e kufizuar lejon kufizimin e numrit të tenderuesve. Tenderuesit mund të vlerësohen ose në bazë të cmimit më të ulët ose në bazë të ofertës më avantazhuese ekonomikisht. Nuk lejohen negocimet me operatorët ekonomikë, megjithëse lejohet sqarimi i aspekteve të caktuara me tenderuesit.

Kërkesa për propozim: Është një procedurë me dy faza. Autoriteti kontraktor boton njoftimin e kontratës dhe pas pranimit të ofertave të operatorëve të ndryshëm, bën vlerësimin paraprak të ofertave për të parë nëse operatorët janë të kualifikuar për të plotësuar kontratën dhe të zgjedhë operatorët që duhen ftuar në tender.

Autoriteti kontraktor lejohet të kufizojë numrin e operatorëve ekonomikë që fton të marrin pjesë në tender dhe të bëjë një listë të tenderuesve. Autoriteti kontraktues u dërgon ftesë për ofertë vetëm operatorëve ekonomikë që ka vendosur në listë dhe më pas kalohet në fazën e konkurimit midis këtyre operatorëve. Gjatë fazës së konkurimit të gjitha aspektet e projektit mund të diskutohen me operatorët dhe numri i zgjidhjeve mund të zvogëlohet në varësi të procesit. Prej momentit që autoriteti kontraktues është i kënaqur me propozimet e marra, ai deklaron fazën e dialogimit të mbyllur dhe fton tenderuesit. Sipas kësaj procedure, tenderuesit mund të vlerësohen vetëm në bazë të ofertës më të mirë ekonomike.

Procedura negocim me shpallje paraprake: Është një procedurë me dy faza. Autoriteti kontraktor boton njoftimin e kontratës dhe operatorët ekonomikë fillimisht hyjnë në fazën e parë të kualifikimit dhe të përzgjedhjes, ku autoriteti kontraktor vendos nëse operatorët mund të klasifikohen apo jo për realizmin dhe zbatimin e kontratës, si dhe përcakton operatorët ekonomikë që do të ftojë në tender. Autoriteti kontraktor mund ta kufizojë numrin e operatorëve që përzgjedh për ti bërë ftesë për pjesëmarrje në tender dhe krijon listën e operatorëve pjesëmarrës. Ai mund të negociojë vetëm me operatorët që ka në listë. Nga ata, autoriteti merr propozimet fillestare dhe më pas hyn në negociata, në përputhje me ofertën e paraqitur. Tenderat mund të vlerësohen në bazë të çmimit më të ulët apo ofertës më të mirë ekonomike.



Procedura të tjera: Ekzistojnë procedura të tjera prokurimi që kërkojnë përdorues më të specializuar. Këto kërkojnë një njoftim në një gazetë zyrtare të Bashkimit Europian në fillim të procesit dhe parimet e rregullat e përgjithshme duhet të plotësohen në:

- **Procedurat e kontratave të subvencioneve të skemave të strehimit:** është një procedurë, që mund të përdoret vetëm për kontrata specifike që lidhen me subvencionimin e banesave sociale. Autoriteti kontraktor ka më shumë fleksibilitet se në procedurën e hapur, për të përzgjedhur operatorin ekonomik me të cilin do të punojë ngushtë për ndërtimin dhe shpërndarjen e shtëpive sociale.
- **Procedurat e koncensionit të punës:** është një procedurë konkurimi e cila mund të përdoret vetëm për kontratat koncensionare. Ajo krijon një procedurë më fleksibël dhe konkuese për caktimin e koncensionit dhe ka kërkesa specifike të detajuara në lidhje me nënkontraktorët.
- **Procedura në kushtet e projektimit (dizenjimit):** është një procedurë që përfshin pjesëmarrjen e një jurie për përzgjedhjen e projektit. Përfitimi i procedurës mund të jetë kontrata, cmimi ose të dyja së bashku. Nuk ka kritere të detajuara në lidhje me numrin e fazave që duhen përdorur, kohëzgjatja apo procesi, por ka rregulla për mënyrën në të cilën juria formohet dhe operon. Kjo është procedurë që mund të përdoret vetëm për dizenjimin e punëve publike dhe përdoret zakonisht në planifikimin, arkitekturën dhe inxhinierinë e ndërtimit në qytete dhe fshatra.

Kur mund të përdoret secila prej procedurave të konkurimit ?

Procedura e hapur dhe e kufizuar : Autoriteti kontraktor është i lirë të zgjedhë midis procedurës së hapur dhe të kufizuar. Nuk vendosen detyrime ligjore në situatat kur është zgjedhur ndonjëra nga këto procedura, dhe autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të zgjedhë njëren apo tjetrën, por është në liri të plotë për të zgjedhur procedurën që preferon.

E hapur apo e kufizuar? Zgjedhja e procedurës

Si pjesë e procesit të prokurimit, autoriteti kontraktor duhet të konsiderojë me kujdes cilën procedurë duhet të zgjedhë për një prokurim të caktuar. Në shumicën e rasteve bëhet një përzgjedhje midis procedurës së hapur dhe procedurës së kufizuar. Për prokurime më komplekse, autoriteti kontraktor mund të konsiderojë

procedurën me negociim me shpallje paraprake apo kërkesë për propozim. Për prokurimet e vecanta, procedurat e tjera të prezantuara në këtë seksion janë më të përshtatshme.

Avantazhet e procedurës së hapur: Procedura e hapur siguron një konkurim maksimal. Ajo është procedura më transparente në përzgjedhjen e operatorit fitues. Mundësia për korrupsion, apo për favorizimin e një operatori të vetëm, është e ulët. Zakonisht, bashkëpunimi midis operatorëve të ndryshëm nuk ndodh dhe kohëzgjatja është më e shkurtër se procedura e kufizuar.

Disavantazhet e procedurës së hapur: Kur përdoret procedura e hapur, kostoja totale e autoritetit kontraktues mund të jetë e lartë, pasi autoriteti kontraktues duhet të shikojë dokumentacionin e plotë të tenderit të të gjithë pjesëmarrësve (megjithëse këto kosto mund të reduktohen dukshëm, nëse dokumentet mundësohen në mënyrë elektronike). Autoriteti kontraktues mund të duhet të vleresojë shumë oferta, nëse është një numër i madh i operatorëve ekonomikë të interesuar, të cilët mund të shtojnë koston dhe harxhimin e kohës. Veç kësaj, operatorët ekonomikë mund të jenë më pak të interesuar për pjesëmarrjen në procedurën e hapur, ku kontrata është shumë e komplikuar pasi dokumentat e tenderit nuk mund të përgatiten me thjeshtësi por kërkojnë nivele të detajuara të të dhënave.

Avantazhet e procedurës së kufizuar: Duke kufizuar numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender, kostot e autoritetit kontraktues dhe koha e harxhuar për vlerësim mund të jenë më të ulta në krahasim me procedurën e hapur. Kufizimi në numrin e tenderuesve mund të ndikojë në shmangien e kostove lidhur me operatorët ekonomikë që nuk janë të përshtatshëm. Kjo mund të sjellë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë më të interesuar dhe që plotësojnë më mirë specifikimet e tenderit, duke rritur efektivitetin e konkurimit.

Disavantazhet e procedurës së kufizuar: Ka më shumë mundësi për korrupsion në këtë procedurë për shkak të ushtrimit më të madh të fshehtësisë dhe të marrëveshjeve të fshehta që mund të krijohen. Limitet e kohës të percaktuara sipas dispozitave, janë më të gjata sesa për procedurën e hapur.

Praktikat e mira

Procedura e hapur përgjithësisht është e përshtatshme për t'u përdorur për

blerjet rutinë dhe të produkteve të zakonshme.

Procedura e kufizuar gjithashtu mund të përdoret për blerje rutinë dhe të produkteve të zakonshme, por kur autoriteti kontraktues është i mendimit se do të ketë përfitim nga kufizimi i numrit të tenderuesve. Procedura e kufizuar është vecanërisht e përshtatshme për prokurimet më komplekse dhe për blerjet jo rutinë.

Në përcaktimin se cila procedurë duhet përdorur, autoriteti kontraktor duhet ti japë rëndësi shumë faktorëve, përfshirë kostot në funksion të procedurës, të gjitha përfitimet e konkurimit të hapur, avantazhet e konkurimit të kufizuar dhe riskun e korrupsionit dhe marrëveshjeve të fshehta.

Kërkesa për propozim dhe procedurat e negocimit me shpallje paraprake: Kërkesa për propozim dhe procedurat e negocimit me shpallje paraprake, mund të përdoren në kushte të vecanta. Nuk ka dispozita ligjore apo udhëzime ku ti kërkohet autoritetit kontraktues të përdorë një nga këto procedura në vend të tjetrës.

Kur mund të përdoret procedura e kërkesës për propozim? Për t'u përdorur procedura e kërkesës për propozim, duhet të plotësohen dy kushte të percaktuara në dispozitat e prokurimit, të cilat janë: (1) kontrata që do të jepet duhet të ketë përcaktimin "kontratë vecanërisht komplekse" dhe (2) autoriteti kontraktues vlerëson që si procedura e hapur ashtu dhe procedura e kufizuar nuk do të mundësojnë dhënien e kontratës.

Kur mund të përdoret procedura e negocimit me shpallje paraprake? Dispozitat e prokurimit përcaktojnë rrethanat kur kjo procedurë mund të përdoret si dhe kushtet që aplikohen. Këto rrethana janë: (1) ka pasur procedurë prokurimi paraprake të dështuar, dhe (2) nuk ka pasur procedure konkurruese prokurimi paraprake. Rrethanat dhe kushtet mund të permbliidhen si vijon:

- *Ka pasur procedurë prokurimi paraprake ku janë paraqitur tendera të parregullt dhe të papranueshëm.* Kjo procedurë, aplikohet në kontrata punimesh, furnizimesh dhe shërbimesh kur janë paraqitur tendera të parregullt dhe të papranueshëm si rezultat i aplikimit të një procedure prokurimi të hapur, të

kufizuar ose kërkesë për propozim dhe kur procedura në fjalë nuk i ndryshon në thelb termat origjinal të kontratës.

Shembull

Një autoritet kontraktor në sektorin shëndetësor përdor një procedurë prokurimi të kufizuar për blerjen e një makine me rreze X. Janë paraqitur dhe vlerësuar katër tenderues, por të katërta ofertat kanë variacion të vogël, gjë e cila nuk lejohet.

Autoriteti kontraktor vendos të njoftojë një procedurë negocimi, dhe të ftojë të katër operatorët ekonomikë që janë paraqitur në tende për të sjellë oferta të reja, por përsëri duke përdorur termat origjinal të kontratës.

- *Nuk ka pasur procedura konkurimi paraprake, pasi çmimi paraprak i kontratës nuk është e mundur të përcaktohet. Kjo aplikohet në kontratat e punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve ku çmimi i përgjithshëm paraprak nuk mund të përcaktohet, si rezultat i natyrës së punimeve, furnizimeve, shërbimeve apo riskut që mund të mbartin ato. Kjo procedurë mund të përdoret vetëm në raste të vecanta.*

Shembull

Një autoritet lokal dëshiron të lidhë një kontratë për ndërtimin e një godine zyrash në qendër të qytetit, ku dihet se mund të ketë mbetje të ndërtimeve të hershme arkeologjike, të cilat duhen mbrojtur gjatë procesit të ndërtimit. Autoriteti lokal nuk e di se sa risk mund të marrin përsipër operatorët ekonomikë në lidhje me mbrojtjen e mbetjeve arkeologjike, që ndikon në koston dhe kohën e ndërtimit. Kjo çështje kërkon negociata me operatorët ekonomikë.

- *Specifikimet e kontratës së shërbimeve nuk mund të përgatiten me saktësi të mjaftueshme. Kjo aplikohet tek kontratat e shërbimeve, atëherë kur specifikimet e tyre nuk mund të përgatiten me saktësinë e mjaftueshme për të bërë të mundur përdorimin e procedurës së hapur apo të kufizuar.*

- *Kontrata është një kontratë punimesh me qëllim kërkimi, testimi ose zhvillimi.* Kjo aplikohet për kontratat e punimeve, që realizohen vetëm për qëllime kërkimi, testimi apo zhvillimi dhe jo për qëllim fitimi, apo mbulimi të kostove të kërkim-zhvillimit.


Rregullat në procedurat e prokurimit: Dispozitat e prokurimit përmbajnë rregulla të detajuara në lidhje me përdorimin e procedurave të prokurimit, që mbulojnë çështje si: botimi i njoftimit, procesi i përzgjedhjes, përmbajtja e dokumenteve të tenderit, kriteret e vlerësimit të tenderuesve si dhe afatet kohore ligjore të cilat aplikohen në secilin nga proceset.

Afatet kohore ligjore: afatet kohore ligjore kryesore lidhen me afatin e lejuar prej botimit të njoftimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, datës së mbylljes për marrjen e ofertave, kohës së nisjes së ftesës për ofertë dhe deri tek zgjedhja e kontratës fituese. Ka gjithashtu afate kohore ligjore të cilat aplikohen nga operatori ekonomik në situata specifike. Një shembull se si koha ndikon në një proces prokurimi mund të shihet në diagramën e mëposhtme, të procedurës së kufizuar. Në situata të caktuara është e mundur të zvogëlohen afatet kohore ligjore, në varësi të kushteve të cilat përcaktohen në dispozitat e prokurimit.

Mundësia e botimit të njoftimit: Përdoruesit mund të bëjnë një zgjedhje të lirë midis tre formave kryesore të procedurave të prokurimit: procedura e hapur, procedura e kufizuar, dhe procedura e negocimit me shpallje paraprake të kontratës. Përdoruesit zakonisht janë fleksibel në mënyrën se si ata botojnë njoftimin, që njihet në dispozitat e prokurimit si “ftesa për ofertë”.

Sjellje gjatë procesit të prokurimit: Parashikimet në dispozitat e prokurimit në lidhje me proceset e prokurimit janë përgjithësisht më pak të detajuara dhe më pak përshkruese sesa rregullat dhe ligjet që përdoren në gjithë sektorin publik. Për shembull, nuk ka listë shteruese të kriterëve në fazën e përzgjedhjes dhe ka limite të kohës gjatë prokurimit.

Procedura e kufizuar – afatet kohore ligjore: përmbledhje



Procedurat e negocimit pa shpallje paraprake

Autoritetet kontraktuese duhet të pranojnë që procedurat e prokurimit me negocim *me shpallje paraprake* te njoftimit te kontrates në OJEU janë të detyrueshme. Ka shumë pak situata, kur një kontratë e një lloji dhe vlere të caktuar, të përcaktuar në dispozitat e prokurimit, mund të jepet pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe pa përdorimin e procesit të konkurimit.

Kujdes! Gjykata e Drejtësisë Europiane (ECJ) sqaron se përjashtimet nga kërkesat për shpallje, gjatë njoftimit të kontratës në OJEU dhe drejtimin e një procesi konkurses nuk lejojnë shumë vend për interpretime. Autoriteti kontraktor duhet të shpjegojë rastet e përdorimit të procedurave të prokurimit pa shpallje paraprake.

Cilat janë përjashtimet nga detyrimi për të publikuar njoftimin e kontratës dhe përdorimit të procedurës së prokurimit?

Përjashtimet ndryshojnë sipas tipit të kontratës dhe rrethanave.

E përmbledhur:

Përjashtimet për kontratat e punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve publike :

- *Kur janë paraqitur vetëm tendera të parregullt dhe të papranueshëm:* Në rastet kur është ndjekur një procedurë e hapur apo e kufizuar dhe janë paraqitur vetëm tendera të parregullt apo të papranueshëm, kur kushtet e kontratës nuk ndryshojnë në thelb.
- *Për arsye teknike apo artistike ose mbrojtje të të drejtave të ekskluzivitetit:* Kur për arsye teknike apo artistike ose të lidhura me mbrojtjen e të drejtave të ekskluzivitetit, kontrata mund ti jepet një operatori ekonomik të vecantë.
- *Për urgjencat ekstreme:* Si pasojë e ngjarjeve të paparashikuara nga autoriteti kontraktor, ku afati kohor për procedurat e hapura apo të kufizuara nuk mund të realizohet dhe kur gjykohet të jetë vërtet e nevojshme.

Përjashtimet për kontratat e furnizimeve publike:

- *Për produktet e prodhuara vetëm për qëllime kërkimi apo zhvillimi:* Kur produktet e përfshira në kontrata janë prodhuar posacërisht për qëllim kërkimi, eksperimentimi, studimi apo zhvillimi dhe jo kur janë prodhuar për të realizuar fitime tregtare apo për të mbuluar kostot e kërkim - zhvillimit.
- *Për kontratat shtesë me një furnizues fillestar:* Për kontratat shtesë nga një furnizues fillestar ku përfshihet si zëvendësimi i një pjese të furnizimit normal dhe shtimi i sasisë së furnizimeve ekzistuese dhe kur (1) ndryshimi i furnizuesit do të detyronte autoritetin kontraktor të marre materiale me karakteristika teknike të tjera, që mund të rezultojnë të papërshtatshme apo me vështiresi teknike dhe (2) kohëzgjatja e këtyre kontratave si edhe e çdo kontrate të përsëritur, si rregull i përgjithshëm, nuk duhet të kalojë tre vite.
- *Për blerjet e kuotuar në bursë*

- *Për blerjet e mallrave në kushte vecanërisht favorizuese:* Kur mallrat mund të blihen në kushte vecanërisht favorizuese nga (1) një furnizues që po likujdon aktivitetin e tij, ose (2) nga përfituesit e një procedure falimentimi, si pasojë e marrëveshjeve me kreditorët, në bazë të ligjeve apo rregullave kombëtare.

Përfshirjet për kontratat e shërbimeve publike:

- *Gjatë konkursit të projektimit:* Kur kontrata i jepet, në përputhje me rregullat e konkursit të projektimit, kandidatit më të suksesshëm, me kusht që, kur ka më tepër se një kandidat të suksesshëm, negociatat do të ndërmerren me të gjithë këta kandidatë.

Përfshirjet për kontratat e punimeve dhe shërbimeve publike:

- *Për kontratat shtesë:* Për punime apo shërbime shtesë, që s'janë të përfshira në projektin apo kontratën fillestare, kur kushtet realizohen plotësisht.
- *Gjatë përsëritjes së punimeve apo shërbimeve:* Për punime apo shërbime të reja, por që konsistojnë në përsëritjen e punëve të ngjashme apo shërbimeve të marra nga i njëjti operator ekonomik i kontratës fillestare, kur kushtet realizohen plotësisht.

Përktheu: Irma Idrizaj



Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit

Iniciativë e përbashkët e Bashkimit European dhe Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), financuar kryesisht nga BE

III. 3 UDHËZUES NR. 28

AUDITIMI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Përmbajtja

- Objektivat dhe kriteret e auditimit
- Fazat kryesore të prokurimit dhe çështjet e tyre kryesore
 1. Përkufizimi i nevojave
 2. Procedurat për dhënien e kontratës
 3. Menaxhimi i kontratës
- Çështje të tjera auditimi (përveç kontratave individuale)
- Për më tepër informacion

Hyrje

Fusha e prokurimeve publike është e gjerë dhe përfshin një gamë të gjerë aktivitetesh, të cilat kanë si qëllim të përbashkët sigurimin e burimeve për kryerjen e detyrave. Në të gjitha rastet, autoritetet kontraktuese duhet të zgjedhin një furnizues dhe të paguajnë për mallrat ose shërbimet e ofruara. Në shumicën e shteteve anëtare të BE-së, prokurimet përfaqësojnë deri në 30% të shpenzimeve publike.

Institucionet Supreme të Auditimit (ISA) auditojnë mbi mënyrën e përdorimit të burimeve publike, por mandatet e tyre të auditimit dhe aktivitetet ndryshojnë, ashtu si ndryshojnë edhe sistemet kombëtare të buxhetit dhe rregullat e sistemit të prokurimeve publike. Ky udhëzues synon të japë udhëzime të cilat janë të përshtatshme dhe të zbatueshme nga audiuesit kur auditohen prokurimet publike, edhe pse veprohet në kuadër të kornizave të ndryshme dhe kanë objektiva dhe procedura të ndryshme. Ky udhëzues nuk do të përfshijë të gjithë hapat e detajuar të procedurës së prokurimeve. Duke u bazuar në përvojën e auditimit, kontrollohen proceset më të rëndësishme duke shpjeguar arsyet e përzgjedhjes dhe duke vënë në dukje ato aspekte të cilat rekomandohen të shqyrtohen në detaje. Gjithashtu i jep audituesit këshilla sugjeruese për dokumentet që këshillohen të shqyrtohen me vëmendje për gjetjen e evidencave. Rastet e studimit dhe pyetjet (check list) të trajtuara në këtë udhëzues ilustrojnë aspektet kryesore ku duhet të fokusohen audituesit.

Ilustrimet përqendrohen në procedurat individuale të prokurimit, me një theks të veçantë në kontratat e rregullta të blerjes për mallra dhe shërbime. Koncesionet dhe partneriteti publik-privat (PPPs) konsiderohen si alternativa ligjore dhe janë të trajtuara në fund të udhëzuesit.

Objektivat dhe kriteret e auditimit

Në fokusin e auditimit është i gjithë procesi i prokurimit, i cili mund të ndahet në tre faza kryesore:

- Përcaktimi (planifikimi) i nevojave;
- Procedura e përzgjedhur për dhënien e kontratës;

- Menaxhimi i kontratës deri në përmbushje të saj.

Auditimi mund të kryhet kur procedurat e prokurimit janë në proces zbatimi ose pasi procedurat të kenë përfunduar. Disa SAI në mandatin e tyre kryejnë auditimin e proceduarve të prokurimit në të dy këto fazat. Është e vetëkuptueshme, sa më shpejt të fillojë auditimi, aq më i madh do të jetë impakti. Megjithatë, duhet të shmangët çdo risk i përfshirjes së auditimit në procesin e prokurimeve.

Auditimi i procedurave të prokurimit në shumicën e rasteve përfshin auditimin e përputhshmërisë dhe auditimin e performancës. Kriteret e përputhshmërisë, ndaj të cilave proceset do të vlerësohen, janë të bazuara në bazën ligjore që aplikohet nga çdo vend. Ky kontekst ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në vende të ndryshme, udhëzuesi konsiderohet të jetë në përputhje me regjimet e prokurimeve të BE-së.

Në drejtim të performancës, audituesi duhet të vlerësojë nëse procedura dhe vendimet e marra plotësojnë kriteret e "tre E"-ve, -ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit. Ekonomicieti fokusohet në gjetjen e një çmimi më të lirë për mallra dhe shërbime të ngjashme, ndërsa efijenca është arritja e maksimizimit të prodhimit të të mirave dhe shërbimeve për një nivel të caktuar burimesh të administratës publike (jo vetëm të burimeve financiare) ose minimizimi i burimeve duke siguruar të njëjtë sasi të produkteve dhe shërbimeve. Efektiviteti vlerëson nëse rezultatet e të mirave dhe shërbimeve janë në përputhje me objektivat e vendosura.

Auditimi përgjithësisht është i projektuar për të shqyrtuar nëse:

- Procesi për përcaktimin(planifikimin) e nevojës për prokurim të veçantë, është i vlefshëm;
- Procedura e përzgjedhur e prokurimit është e ligjshme dhe burimet publike po shpenzohen në përputhje me kriteret e përcaktuara.

Në praktikë qëllimet konkrete dhe fusha e veprimit të auditimit mund të jenë shumë të ndryshme. Në disa raste qëllimi i auditimit mund të jetë, verifikim nëse autoriteti publik ka arsyetuar si duhet në shpenzimin e parave publike për një prokurim të caktuar. Disa SAI përpiqen të verifikojnë nëse janë ndjekur praktika më të mira për prokurimin publike, ndërsa disa të tjera përqendrohen në çështjet e përputhshmërisë formale. Në përputhje me rrethanat, audituesi mund të shikojë

funksionin e prokurimit si pjesë e një kontrolli të llogarive të caktuara të autoritetit publik; të zbuloje nëse po kryhen punimet në mënyrë efçente; të shikojë të gjitha ose disa procedura prokurimi për të nxjerrë përfundime nëse institucionet kanë siguruar konkurrencën e pastër ose në qoftë se ato sjellin vlerë shtesë për autoritetin publik; të kërkojnë garanci për parandalim e mashtrimeve dhe korrupsionit; ose do t'i duhet të bëj një procedurë prokurimi të re që të sjell prova për rregullshmërinë, përshtatshmërinë e saj me nevojat dhe pagesën e bërë.

Në shumicën e rasteve kriteret e përputhshmërisë janë të qarta në parim, dyshimi shpesh mbetet nëse auditimi ka arritur rezultate më të mira të mundshme në rrethanat e dhëna, në veçanti në lidhje me çmimet më të mira. Natyrisht, treguesit e çmimeve aktuale të tregut ose të çmimeve të arritur në procedurën e mëparshme mund të shërbejë si pikë referimi. Megjithatë, çdo konkurrimi është një ngjarje e veçantë që ndodh në rrethana shumë të veçanta gjatë kohës së prokurimit -sasi të ndryshme, burimet e disponueshme në treg, zhvillimi teknologjik. Kështu, është e vështirë për të matur rezultatet e një procesi të prokurimit ndaj shifrave të përcaktuara. Rrjedhimisht, auditimi mund të përqendrohet në atë se si procedura e ndjekur kishte mundësi të arrinte rezultate ekonomike më të mira. Si rregull, një rezultat i tillë arrihet nëse procedurat kanë qenë në të njëjtën kohë, konkurruese, transparente dhe kanë siguruar trajtimi të barabartë.

Fazat kryesore të prokurimit dhe çështjet e tyre kryesore

1. Përcaktimi i nevojës për prokurimi

Përcaktimi i nevojave përgjithësisht duhet të bazohet në identifikimin e një ose disa mangësive në aftësinë e autoritetit publik, për të përmbushur detyrën e tij në përputhje me qëllimet për ofrimin e shërbimeve ose përmirësimin e performancës. Prokurimi ka për qëllim të mbulojë boshllëqe të tilla.

Karakteristikat kryesore të përcaktimit (planifikimit) të nevojave:

- Prosesi i brendshëm;
- Nuk ka kufizime në ligjin e prokurimit;
- Fokusimi në aspekte të performancës.

Në çdo rast, audituesi duhet të vlerësojë nëse autoriteti kontraktor e ka justifikuar prokurimin në aspektin e sasisë dhe specifikeve të mallrave apo shërbimeve dhe nëse i ka konsideruar si duhet alternativat krahasuese.

Për të arritur në këtë vlerësim, audituesi mund të shikojë dokumentet mbështetëse në dosjen e prokurimit:

- Arsyet dhe karakteristikat e prokurimit;
- Në rastet e prokurimeve me risk të lartë politik ose ndonjë risk tjetër dhe vlerë të lartë, konsiderimin e alternativat për zgjidhjen e parashikuar;
- Krahasimin e aspekteve ekonomike të këtyre alternativave nën një vlerë respektive monetare¹, nëse një vlerësimi i tillë është objekt i auditimit.

Duhet theksuar se autoriteti kontraktor është përgjegjës për dhënien dhe dokumentimin e shkakut dhe llogaritjen e çdo aspekti që do bënte të mundur vlerësimin nëse prokurimi është i justifikuar dhe i suksesshëm.

Raste Studimi

- 1) Një departament ka prokuruar 250 kompjuterë (PC) për të zëvendësuar pajisjet ekzistuese që ende nuk ishin amortizuar. Kjo blerje ishte e nevojshme për shkak se software i ri që ishte duke u implementuar, kërkonte kapacitet më të lartë hardware-ve në krahasim me kapacitetet e PC-ve ekzistuese. SAI shqyrtoi ketë arsye dhe zbuloi se software i ri mund të përdorej në PC ekzistuese, pa kufizime. Prokurimi ishte i pajustificuar.*
 - 2) Mirëmbajtja e rrugëve publike ishte kryer nga zyrat rajonale të cilat ofronin stafin dhe pajisjet. Departamenti kishte blerë makineri të reja për një nga këto zyra, ndër të tjera një rul për 50,000 euro. Në kërkim të alternativave të tjera për këtë blerje, audituesit kontrolluan sa rula në total ishin duke punuar si dhe kapacitetin optimale të përdorimit. Ata mësuan se disa rula në zyrat e tjera kishte vetëm disa orë në funksionimi, sipas të dhënave u arrit në përfundimin se për të përmbushur nevojat e vendit, mund të përdorej një prej makinerive ekzistuese në vend të blerjes së një makinerie të re.*
- A kanë vepruar autoritetet publike për këtë prokurim në përputhje me kriteret e ekonomicitetit dhe efektivitetit?

¹ Ky koncept shpjegohet në Udhëzuesin Nr.1 të Prokurimeve, Prokurimi Publik në BE: Kuadri Ligjor, Parime Themelore dhe Institucione, fq. 6

- A është numri/lloji i nevojshëm i makinerive apo do ishte i mjaftueshëm një numër më i vogël/më i madh?
- A janë përdorur specifikimet e duhura teknike apo edhe një nivel më i ulët do ishte i mjaftueshëm?
- A i konsideroi departamenti të gjitha alternativat?
- A i krahasoi departamenti të gjitha alternativa, a aplikoi shifra të sakta, duke përfshirë të gjitha aspektet e përshtatshme si dhe standardet e paracaktuara dhe a arriti në një rezultat optimal?

2. Proceduat për dhënien e kontratës

Tiparet kryesore të procesit të dhënies së kontratës:

- Procesi i jashtëm;
- Qeverisja në përputhje me ligjin e prokurimit;
- Fokusimi tek rregullshmëria, por duke konsideruar edhe aspekte të performancës.

Kur auditohen prokurimin publike audituesit duhet të kenë parasysh natyrën dhe qëllimet e sistemit të prokurimit publik të BE-së. Edhe pse është ende i rrënjosur në ligjin e buxhetit, megjithatë sistemi i BE-së është i ndërtuar jo vetëm për të kursyer para publike, por edhe për krijimin e tregut të përbashkët europian. Tre parimet themelore që kanë rezultuar nga legjislacioni themelor janë: **konkurrenca, mos diskriminimin / trajtimit i barabartë dhe transparenca.**

Për audituesin është shumë e rekomandueshme të verifikojë në radhë të parë nëse autoritetet kontraktuese janë mbështetur në këto parime e më pas në formulimin e rregullave të hollësishëm. Megjithatë, kjo detyrë nuk është një justifikim për të anashkaluar rregullat e hollësishme. Edhe pse shkeljet e këtyre rregullave duken si një problem i vogël, në praktik shpesh çon në përjashtimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme. Është e nevojshme të theksohet se përmbushja e këtyre kërkesave shpesh formale, kontribuon në trajtim të barabartë të ofertuesve.

Përpara se autoriteti kontraktues të mund të shpallë synimin e tij për të lidhur një kontratë, ai duhet të bëjë një sërë përgatitjesh. Kjo kërkon një proces të brendshëm, që udhëhiqet nga parimet e lartpërmendura si dhe nga dispozita pak më shumë ose pak më pak të detajuara dhe që sigurojnë bazat për të gjithë procedurat e dhënies së kontratës të ardhshme. Sistemi i kushton një vëmendje të veçantë aspekteve të trajtuara më poshtë:

- Përshkrimet e performancës;
- Llogaritja e vlerës së kontratës;
- Dokumentet e tenderit;
- Kriteret e përzgjedhjes;
- Proceduarat e përzgjedhjes;
- Njoftimi;
- Vlerësimi i tenderave.

a. Përshkrimet e performancës

Përshkrimet e performancës janë zemra e procedurës së prokurimit. Këtu autoritetet publike përshkruajnë nevojat e tyre dhe kërkesat (specifikimet) që tenderi duhet të plotësojë. Ky përshkrim duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe të plotë në mënyrë që të sigurojë që të gjithë ofertuesit e kuptojnë atë në të njëjtën mënyrë.

Përshkrimi i performancës duhet të përputhet në mënyrë të veçantë me parimet e trajtimit të barabartë, transparent dhe rrjedhimisht nuk duhet të diskriminojë ndonjë produkt. Kjo kërkesë do të thotë se autoriteti publik nuk ka të drejtë të kërkojë ndonjë markë të caktuara të produktit, përveç raste kur arsyetohet në objektin e kontratës. Çështja e specifikimeve teknike është veçanërisht e ndjeshme, sepse kërkesa teknike të pajustificuara, bëhen pengesë për konkurrencën dhe trajtimi në mënyrë preferenciale i një ofertuesi ndaj një tjetri mund të bëhet shumë lehtë.

Që nga momenti i njoftimit, përshkrimet e performancës duhet të mbeten në thelb të pandryshuara dhe ato do të jenë pjesë e kontratës që do të lidhet. Vetëm në procedurat me negociim mundet të ketë përshtatje, me kusht që karakteri i performancës së kërkuar të mbetet i pandryshuar.

Përshkrimet e performancës duhet të bazohen në përcaktimin e nevojave dhe në qëllimin ekonomik- këto komponentë përbejnë vetëm kërkesat e nevojshme.

Raste studimi

- 1) *Specifikimet për ndryshimin e përbërjes së sfungjerit të karriges së zyrës, kërkonin ndryshimin e strukturës së karriges duke shtuar një pllake bazë prej kompesate, të paktën një rimeso dhe rrota në diametër 55 mm. Pjesa më e*

madhe e ofertave të dorëzuara nuk i përmbushnin këto specifikime, por edhe nga autoritetet kontraktuese nuk pati nxitje për shkak se këto ndryshime nuk ndikonin në funksionimin normal të karrigeve.

- 2) *Specifikimet për kompjuterët kërkonin veshjen e tyre të jashtme me metal të bardhë. Në parim, këto specifikime ishin ligjërish të pranueshme. Megjithatë ato përjashtonin në mënyrë të panevojshme çdo produkt tjetër të ngjashëm, përveçse rasteve kur jepeshin argument, duke zvogëluar në këtë mënyrë konkurrencën. Për më tepër, nëse autoriteti publik përjashton të gjitha ofertat që nuk plotësojnë kërkesat dhe më pas vlerëson ofertat e mbetura ose fillon procedurën nga e para me specifikimet e reja të kërkuara, ai do të jetë duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe me parimin e ekonomicitetit.*

Përveç çështjeve ligjore, audituesi mund të zgjedhë që të verifikoj nëse autoriteti publik i ka konsideruar aspektet e performancës të përmendura më poshtë, që mund të kenë qenë të përshtatshme për të rritur mundësinë e marrjes së ofertave të favorshme nga ana ekonomike:

- **Grumbullimi i kërkesës** për ta bërë tenderin tërheqës dhe për të rritur konkurrencën;
- **Kohëzgjatja e shkurtër e kontratës** - duhet të jetë sa më e shkurtër që të jetë e mundur, në mënyrë që të ruhet konkurrenca mes ofertuesve të pasuksesshëm (por ftesa të reja për tender duhet të bëhen gjatë kohës);
- **Mundësia e lidhjes së kontratës nga shumë ofertues (ndarja në lote)** –duke dhënë mundësi biznesit të vogël dhe të mesëm të lidhin kontrata në mënyrë që të rritet konkurrenca.

Sidoqoftë, audituesi duhet të marrë në konsideratë se këto masa mund të bien ndesh me njëra-tjetrën dhe mund të mos jenë të dobishme në të gjitha rastet; psh. avantazhet e mundshme të një kontrate me kohëzgjatje të shkurtër shkaktojnë disavantazhe që lidhen me rritjen e kostos administrative për shkak se do të kryhet procesi më shpesh.

- A ishte përshkrimi i performancës i qartë dhe gjithëpërfshirëse, duke dhënë përkufizime të sakta të karakteristikave të mallrave që do të furnizohen, duke bërë të mundur që të gjithë të interesuarit ta kuptojnë në të njëjtën mënyrë?

- A ishin kërkesat teknike mjaftueshëm të rrepta për të garantuar performancën e dëshiruar pa qenë të ngurta, duke përjashtuar rrezikun e përfshirjes së ofertave që nuk përputhen me kërkesat?
- A janë përdorur referenca të pa justifikuara për një ose disa çështje të veçanta që lidhen me markën tregtare, patentën, llojin, apo ndonjë origjinën e veçantë ose të prodhimit të përjashtuar nga specifikimet teknike, duke parandaluar autoritetin publik nga favorizimi ose eliminimi i ndërmarrjeve të caktuara ose produkteve?

b. Llogaritja e vlerës së kontratës (Fondi limit)

Autoritetet publike shpesh kanë tendencë të llogarisin vlerën e parashikuar të një kontrate në mënyrë të tillë që të jetë nën fondin limit të BE-së dhe në këtë mënyrë të mbetet jashtë nga Direktivat e BE-së ose ligjet kombëtar. Prandaj duhet të theksohet që qëllimi i llogaritjes së vlerës së parashikuar është të marrë parasysh shumën totale, duke përfshirë çdo lloj opsioni (dmth furnizime ose shërbime shtesë) ose rinovimin dhe se autoritetet publik nuk duhet të ndajnë kontratën në mënyrë që të mbeten nën fondin limit.

Rast Studimi

Një auditues dyshon se shuma totale e nevojave për prokurim është ndarë padrejtësisht. Për të verifikuar këtë dyshim, ai ka nevojë të investigojë përtej dokumenteve të lidhjes së kontratës. Ai mund të vëzhgojë përpilimin e faturave për vitin aktual për të përcaktuar nëse ka patur blerje të ngjashme. Një mënyrë tjetër mund të jetë verifikimi i përcaktimit të nevojave. Një qasje e përshtatshme për të vlerësuar nevojat të përgjithshme të një institucionit të veçantë mund të jetë krahasimi i tyre me prokurime konkrete për të verifikuar qëndrueshmërinë e tyre.

- A ka identifikuar tërësisht autoriteti kontraktor shumën e kërkuar, duke marrë parasysh të gjitha aspektet e performancës, përfshirë opsionet dhe dispozitat për rinovim?
- A ishte performanca e ndarë për arsye të vlefshme apo thjesht për të qëndruar poshtë shumës limit të lejuar?
- A ishte bërë vlerësimi bazuar në çmime reale?

c. Dokumentet e tenderit

Përveç përshkrimit të performancës, dokumentet e tenderit tregojnë të gjitha kushtet e përshtatshme për konkurrim. Ato informojnë ofertuesin mbi përmbajtjen dhe formën e dokumenteve që ata janë të detyruar të paraqesin, në mënyrë që vërtetojnë aftësinë e tyre profesionale dhe financiare, si dhe për të gjitha deklaratat që autoriteti publik kërkon. Autoriteti kontraktor ka disa liri veprimi në lidhje me dokumentet e kërkuara dhe dëshmitë që kërkon, me kusht që kjo liri të jetë e justifikuar me objektin e kontratës. Për më tepër, autoritetet publik duhet të jenë të vetëdijshëm se kërkesat e panevojshme strikte kufizojnë konkurrencën. Ata gjithashtu duhet të kuptojnë se është e detyrueshme, duke përfshirë edhe vetë autoritetin kontraktor, t'u përmbahen rregullave të vendosura.

Audituesi mund të zgjedhë për të kontrolluar veçanërisht nëse kërkesat në lidhje me përshtatshmërinë e ofertuesve janë të justifikuara dhe të mjaftueshme në mënyrë që të përjashtojë vetëm ofertuesit e papërshtatshëm dhe se kushtet e caktuara lejojnë një procedurë të shpejtë, të qetë, transparente dhe jo-diskriminuese.

Një mënyrë për të rritur shanset e ofertave të vlefshme është që të lejohet varietetet i ofertave që do të përfshihen në procedura, kur autoriteti kontraktor nuk ka një qëllim të veçantë teknik.

- A e kanë kuptuar plotësisht ofertuesit, pa asnjë nënkuptim, se cilat dokumente dhe deklarata duhet të paraqesin në tender?
- A mundet ofertuesit të mësojnë të gjitha informacionet relevante direkt nga dokumentet e tenderit ose a i janë referuar informatave në dispozicion nga burime të tjera, përveç dokumenteve të tenderit të autoritetit kontraktor?
- A rregullojnë dokumentet e tenderit kërkesat për përshtatshmërinë e ofertuesve në lidhje me gjendjen e tyre, nivelet e kapacitetit minimal në drejtim të gjendjes ekonomike dhe financiare, si dhe aftësinë teknike dhe / apo profesionale?

d. Kriteret për dhënien e kontratës.

Oferta më e favorshme nga ana ekonomike duhet të përcaktohet në bazë të kriterëve objektive. Për më tepër, çdo kriter duhet të krahasohet nga rëndësia me

të gjitha kriteret e tjera në mënyrë që të sigurojë një tregues të rëndësisë së tij relative. Autoriteti kontraktues është i detyruar të përcaktojë këto kriteret dhe rëndësinë e tyre, të cilat janë botuar ose në njoftimin ose, siç ndodh shpesh, në dokumentet e tenderit. Kriteret e qarta, objektive dhe të pranueshme janë mjaft të rëndësishme për vendosjen e çmimeve të paanshme dhe transparente, duke minimizuar hapësirën për vendime arbitrare dhe të korruptuara. Ligjërisht janë të pranueshme të gjitha kriteret që janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivat e kontratës. Si rregull, kjo nuk është asnjëherë e vërtetë për kriteret që lidhen me përshtatshmërinë e ofruesve, të cilat rrjedhimisht nuk duhet të konsiderohen si kriteret të pranueshmërisë.

Rast Studimi

Rëndësia relative e kriterëve për dhënien e një kontrate blerje, siç është përcaktuar në dokumentet e tenderit, është si më poshtë: 50% -Çmimi; 25%- përvoja e kompanisë dhe 25%-gjendja financiare. Përvoja dhe gjendja financiare si rregull nuk janë Kriteret të dhënies së kontratës, por tregojnë përshtatshmërinë (besueshmërinë) e ofertuesve.

Audituesi mund të zgjedhë të verifikoj nëse kriteret janë të dizenuara për të rritur vlerën në para të pjesevë të veçanta të kontratës. Për këtë qëllim, metodat e kriterëve, rëndësisë dhe vlerësimit përfshijnë:

- **Kriteret**

- Në mënyrë eksplicite të tregojnë performancën e dëshiruar;
- Lidhur me aspektet ekonomike;
- Transparente dhe lehtësisht të kuptueshme për ofertuesit.

- **Rëndësia**

- Korrespondon me rëndësinë relative të aspektit të veçantë të autoritetit publik;
- Gjithëpërfshirja e elementeve të çmimeve.

- **Metoda e vlerësimit**

- E menaxhueshëm

- E saktë dhe e drejtë
- E ekuilibruar, duke lejuar një ndarje të saktë të pikëve

Rast studimi

Kriteret dhe pikëzimi për blerjen e fotokopjes ishin si më poshtë: 50% çmimi i blerjes, 30% specifikimet teknike përtej parametrave minimale dhe 20% aspektet mjedisore. Megjithatë, ligjërisht fotokopjet mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme përsa i përket jetëgjatësisë së tyre, pjesëve të këmbimit, konsumit (psh tonerat), disponueshmërinë dhe kostos së mirëmbajtjes. Këto aspekte duhet të merren parasysh dhe të dokumentohen siç duhet nga autoriteti publik.

Një lidhje e përshtatshme midis përcaktimit të nevojave, përshkrimit të performancës dhe kriterëve të dhënies, është shumë e rëndësishme për përfitimin e vlerës monetare. Specifikimet legjitime të nevojshme për këtë detyrë duhet të theksohen në kërkesat minimale të përshkrimit të performancës dhe të pasqyrohen në përputhje me kriterëve e kontratës dhe peshën e tyre relative.

- A i ka përcaktur qartë kriteret e prokurimit autoriteti kontraktor?
- Në rastin kur kriteret kanë si objektiv tenderin ekonomikisht më të favorshëm, janë nën-kriteret (a) të ndryshme nga ato të përcaktuara për kualifikimin e ofertuesve; dhe (b) të lidhura me lëndën e kontratës, duhet reflektuar fokusin kryesor dhe rëndësinë e elementeve të performancës?
- A janë koeficientët e rëndësisë koherentë, bindës dhe konciz, duke mos lënë hapësirë për vlerësim arbitrar?
- A janë kriteret dhe nënkriteret e përshtatshëm për të zgjedhur tenderin që ofron vlerën më të mirë për paratë? A e marrin çmimin në konsideratë në mënyrë të arsyeshme?

e. Procedurat e vlerësimit

Zgjedhja e procedurës së vlerësimit ka ndikim në konkurrencë.

Autoritetet publike mund të ndjekin një procedurë të hapur ose të kufizuar, por veprimet e ndjekura prej tyre nuk duhet të çojnë në një procedurë të negociueshme, duke përjashtuar këtu rastet e veçanta që parashikohen nga

legjislacioni. Në praktikë, procedurat e negociueshme janë përdorur shpesh, pa marrë parasysh faktin se kushtet e tyre nuk janë verifikuar. Kjo praktikë sjell pasoja negative si kufizimin e konkurrencës, negociata për performancë dhe për çmimin. Kjo e bën më të vështirë për autoritetin kontraktor të garantojë trajtim të barabartë dhe transparent. Autoritetet publike kanë dhënë shpesh kontrata pa nisur asnjë lloj procedure, gjë e cila është një shkelje e rëndë e rregullave të prokurimit të BE-së dhe mund të çoj deri në pavlefshmërinë e kontratave. Audituesi mund të zbulojë raste të tilla duke verifikuar plotësimin e faturave dhe duke kërkuar dokumentacionin përkatës për çmimin.

Çdo kufizim i ofruesit mund të tregojë:

- Përjashtimin e ofertave potencialisht të favorshme;
- Rritjen e riskut të ndikimit të tepruar në vlerësim;
- Lehtësimin e bashkëpunimit të paautorizuar mes ofertuesve;

Duke pasur parasysh treguesit e mësipërm, audituesi mund të bëjë këto pyetje:

- A morri autoriteti publik një vendim të mirë mbi zgjedhjen e procedurës së prokurimit duke u bazuar në dokumentacionin e duhur?
- Duke marrë parasysh rrethanat, a bëri autoriteti publik konkursin më të drejtë dhe më transparent?
- Kur janë përdorur procedurat me negociim të veçantë? A ka dhënë autoriteti kontraktues mjaftueshëm arsye dhe prova të përshtatshme për zgjedhjen e bërë? A shpjegoi pse një procedurë e hapur ose e kufizuar nuk ishte e mundur?
- A ekzistonin në të vërtetë kushtet që justifikuan vendimin?

f. Njoftimi

Njoftimi për dhënien e një kontrate të re dhe publikimi i rregullave të procedurës janë shumë të rëndësishme për të pasur një konkurrencë të drejtë. Direktivat e BE-së përfshijnë një sërë rregullash në lidhje me formën e njoftimit dhe kuadrin kohor për procedurat. Këto rregulla krijojnë kushtet për të siguruar konkurrencë të drejtë, kohë të mjaftueshme për përgatitjen e tenderëve të rëndësishëm dhe trajtim të barabartë dhe transparent. Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) konsideron, se

shkelja e tyre do të ketë pasoja serioze për legjitimitetin e procedurës. Prandaj është e rëndësishme që audituesi gjithashtu të verifikoj vendimet përkatëse të marra në këtë drejtim.

g. Vlerësimi i tenderave (ofertave).

Procedurat e dhënies së tenderit zakonisht kryhen në katër hapa:

- Shqyrtimi formal i ofertave;
- Vlerësimi i përshtatshmërisë së ofruesve;
- Konfirmimi i shkaqeve përjashtuese për tender;
- Vlerësimi i tenderave.

Analiza e hapave duhet të bëhet në kuadër të çdo procedure të veçantë.

Përpara se të bëhet vlerësimi i ofertave duhet të bëhet një **verifikim formal** i përputhshmërisë së kandidatëve me kërkesat themelore, siç janë afatet e takimit dhe dorëzimi i informacionit.

- A ka vlerësuar autoriteti kontraktues vetëm ato oferta që plotësojnë kërkesat formale?
- A janë arsyet për pranimin dhe refuzimin e tenderëve në përputhje me dokumentet e tenderit dhe të dokumentuara si duhet?

Autoriteti kontraktues duhet të pranojë vetëm ata **ofertues** që tregojnë **përputhshmëri**, duke përfshirë nivelet minimale të kapacitetit të përcaktuara në dokumentet e prokurimit.

Kur bëhet vlerësimi i përshtatshmërisë së ofertuesve sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, duhet të respektohet gjithashtu parimi i trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Autoriteti kontraktues duhet të dokumentojë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, duke deklaruar arsyet për zgjedhjen ose refuzimin e tyre.

- A ishte vlerësimi i kandidatëve cilësor, i pavarur dhe a ndodhi para vlerësimit të ofertave?

- A është procesi i përzgjedhjes së kandidatëve i dokumentuara, duke përfshirë edhe arsyet për zgjedhjen e tyre ose refuzimin?
- A e vlerësoi autoriteti kontraktues përshtatshmërinë e ofruesve duke u bazuar të kërkesat dhe në mënyrë jo diskriminuese?

Eksperienca në praktikë ka treguar se është e rëndësishme që këto hapa të kryhen veç e veç, pasi fokusi ndahet mes ofertuesve dhe vetë tenderave. Është shumë e rëndësishme që të mos ngatërrohen kriteret që janë të rëndësishme në çdo fazë. Kjo shpesh nuk ka marrë rëndësinë e duhur nga autoritetet kontraktuese.

Pasi është verifikuar përshtatshmëria e ofertuesve, hapat e mëpasëm të procesit të dhënies së kontratës (shpalljes së fituesit) lidhen vetëm me tenderat dhe jo më me ofertuesit. Që nga ai moment, vetëm ofertat që kanë përmbushur të gjitha kërkesat e shpallura janë të pranueshme për vlerësim.

Për të kryer vlerësimin autoriteti kontraktor mund të përjashtoj më parë të gjitha tenderat që nuk mund të pranohen për arsye të ndryshme të tilla si, mos përmbushja e kushteve të performancës. Në rastin kur çmimet janë të ulëta ofertuesit duhet t'i jepet mundësia për të shpjeguar vlerësimet e kostos para përjashtimit.

- A e verifikoi autoriteti kontraktues nëse tenderat i përmbushin kriteret e performancës?
- A ka raste të çmimeve (ofertave) anomalisht të ulëta?

Procesi i vlerësimit dhe vendimi përfundimtar duhet të jetë dukshëm objektiv dhe transparent si dhe të bazohet **vetëm në kriteret e publikuara**. Variantet e pranueshme që i plotësojnë kushtet duhet të vlerësohen në të njëjtën mënyrë dhe pa diferencime mes tyre.

Vendimi për fitimin e kontratës është i bazuar në rezultatin e vlerësimit të ofertave.

Gjatë procedurave të hapura dhe të kufizuara, çdo dialog me kandidatët që mund të interpretohet si një negociatë në çmim apo elemente të tjera të tenderit është e ndaluar.

- A është dokumentuar procesi i vlerësimit?

- A vlerësoi autoriteti kontraktues vetëm tenderat që u pranuan në mënyrë të rregullt në tre hapat e mëparshëm?
- A vlerësoi autoriteti kontraktues vetëm ofertat që përmbushnin të gjitha kriteret duke bërë renditjen e bazuar në peshën relative që ishin publikuar në dokumentet e prokurimit?

3. Menaxhimi i kontratës

Pasi kontrata është lidhur, rregullat e prokurimit publik nuk janë më të zbatueshme. Në këtë fazë audituesi mund të përqendrohet nëse kontrata është ekzekutuar në mënyrë të rregullt, duke ruajtur të drejtat e autoritetit publik. Në këtë rast audituesi mund të kontrollojë si autoriteti kontraktor menaxhon angazhimet e pagesës, mangësitë e kontratave dhe dëmet. Ky verifikim shpesh kontrollon aspektet e pajtueshmërisë, madje edhe auditimin financiar përsa i përket respektimit të rregullave buxhetore për pagesën.

Megjithatë, në fazën e ekzekutimit autoritetet kontraktuese shpesh kanë nevojë për mallra ose shërbime të kontraktuara shtesë, veprim që ngre pyetjen nëse për këto mallra ose shërbime shtesë duhet të hapet një procedurë e re prokurimi.

Ndryshimet mund të kenë shkaqe të tilla si:

- Arsye të paparashikuara si kërkesa të reja ligjore, ngjarje të paparashikuara natyrore;
- Sugjerime për zëvendësimin e materialeve, ose zgjedhjeve teknike;
- Nevoja suplementare pasi autoriteti publik ka bërë pagesë për një sasi më të madhe.

Mundësia e ofruar për të modifikuar performancën pa bërë një procedurë prokurimi të re ndihmon në përmbushjen e nevojave të autoritetit publik si dhe në reduktimin e kostove, por nga ana tjetër ky fleksibilitet i mundësuar shikohet dhe si një kërcenim për rregullat e vendosura siç janë: vendime për favorizime ose shpërblime kundrejt furnizuesit, shmangia e bërjes së një procedure prokurimi të re, mundësia për të kaluar limitin buxhetor. Kontratat shtesë mund të kryhen vetëm në raste të mirë përcaktuara.

- Shërbimet/Mallrat shtesë a shkaktuan ndryshime të vogla në performancën që ishte përshkruar në dokumentet e kontratës?
- A ndodhën ndryshimet si pasojë e situatave të paparashikuara?
- A ishin ndryshimet të domosdoshme për arritjen e plotësisimit të performancës?

Subjekte të tjera të auditimit (përveç kontratave publike individuale)

Edhe pse ky udhëzues përqendrohet në procedurat individuale të prokurimit që çojnë në një kontratë individuale, auditimi mund të fokusohet gjithashtu në strukturën e marrëveshjes, koncesioneve dhe partneriteteve publike private (PPP), por mund të përqendrohet edhe në aspekte të tjera të sistemit të prokurimit.

Për sa i përket strukturës së marrëveshjes, audituesi zakonisht kontrollon tre aspekte:

- A u dha marrëveshja në bazë të rregullave të përshkruara më lart?
- A kishte të drejtë autoriteti publik të përdorte marrëveshjen?
- A përputhej kontrata me qëllimet e marrëveshjes?

Koncesionet për shërbimet nuk janë njohur² nga regjimi i BE-së, i cili mbulon vetëm koncesione për punë. Megjithatë parimet bazë të koncesioneve të tilla janë rrjedhime nga Traktati i BE-së, dhe këto parime duhet të zbatohen dhe respektohen. Konkurrenca, njoftimet dhe një trajtim i drejtë dhe transparent i ofertuesve është e domosdoshme.

Partneritetet Publike Private përfaqësojnë një çështje delikate në ekonomi. Dyshimi është nëse PPP krahasuar me kontratat publike ka më shumë favorizime nga autoriteti kontraktues duke patur parasysh situatën e tyre financiare. Për të krahasuar dy zgjedhjet e mundshme audituesi mund të bëjë vlerësimin e tyre duke shqyrtuar dokumentet e autoritetit publik, për të parë nëse i është dhënë rëndësia e duhur çdo elementi të koston, veçanërisht atyre që kanë lidhje me periudhat afatgjata dhe kanë një risk më të lartë. Kjo gjë është e vështirë për tu bërë nga ana e audituesit është autoriteti publik që duhet të justifikoj veprimet dhe të paraqesë dëshmi të mjaftueshme në qoftë se ai nuk e realizon këtë, në raportin e auditimit,

² *Kjo ndryshoi me aplikimi e Direktivës së re të Koncesionit, publikuar më 28 mars 2014.*

audituesi shpesh e thekson këtë dështim si një mangësi të konsiderueshme. Në kushtet e pajtueshmërisë, regjimi i prokurimit është i zbatueshëm për PPP-të, duke ofruar rregulla të veçanta për çështje të përgjithshme dhe të komplikuara, të tilla si dialogu konkurrues.

Për më shumë informacion:

Për informacion të detajuar në lidhje me aspektet ligjore të trajtuara më lart, referohuni tek Udhëzuesit në vijim:

- Vendosja e kriterëve të kontratës (SIGMA, Prokurimet Publike, Udhëzuesi 8, 2011);
- Çfarë janë procedurat e prokurimeve publike dhe kur mund të përdoren? (SIGMA, Prokurimet Publike, Udhëzuesi 10, 2011);
- Zbulimi dhe korrigjimi i gabimeve në prokurimet publike (SIGMA, Prokurimet Publike, Udhëzuesi 29, 2013);
- Zgjedhja e operatorëve ekonomik (SIGMA, Prokurimet Publike, Udhëzuesi 7, 2011);
- Procedura e prokurimit publik në BE, kuadri rregullator, parimet bazë, institucionet (SIGMA, Prokurimet Publike, Udhëzuesi 1, 2011);
- Matja e performancës (SIGMA, Prokurimet Publike, Udhëzuesi 21, 2011);
- Monitorimi i procedurave të prokurimit (SIGMA, Prokurimet Publike, Udhëzuesi 27, 2011);
- Vlerësimi i tenderave dhe dhënia e kontratës (SIGMA, Prokurimet Publike, Udhëzuesi 8, 2011);
- Kuptimi i pragjeve financiarë të BE-së (SIGMA, Prokurimet Publike, Udhëzuesi 5, 2011).

Përktheu: Helena Solis



Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit

Iniciativë e përbashkët e Bashkimit European dhe Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), financuar kryesisht nga BE

III. 4 UDHËZUES NR. 29

Korrik 2013

PROKURIMI PUBLIK

Zbulimi dhe korrigjimi i gabimeve të zakonshme në prokurimin publik

Përmbajtja

1. Çfarë konsiderohet gabim në prokurimin publik?
2. Si zbulohen dhe korrigjohen gabimet?
3. Klasifikimi i gabimeve dhe impakti i tyre në rezultatet e procedurave të prokurimit
4. Cilat janë gabimet më të zakonshme në prokurimin publik?

Si përkufizohen “gabimet” në prokurimin publik?

Për qëllimet e këtij udhëzuesi, gabimet në prokurimin publik kuptohen si shkelje të rregullave(parimeve) të prokurimit publik, pavarësisht fazës së procedurës apo pasojave të tyre në fondet publike.

Gabimet në prokurime mund të ndodhin:

- para çeljes zyrtare të procedurës së prokurimit (në fazën e planifikimit të një prokurimi specifik: për shembull, gjatë procesit të vlerësimit të shumës së prokurimit apo të vendimmarrjes mbi zbatimin e një procedure përkatëse) – vendimet e marra jashtë apo para procedurës formale të prokurimit, pa dyshim kanë një impakt në kursin e veprimeve të ndërmarra nga autoriteti kontraktor; ose
- në vazhden e një procedure prokurimi (për shembull, gjatë vlerësimit të gabuar të kriterëve kualifikuese të operatorit ekonomik, keqzbatimi i rregullave në përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë apo gabimeve në vlerësimin e ofertave); ose
- pas përfundimit të procedurës dhe lidhjes së kontratës (për shembull, mos publikimi i njoftimit të kontratës fituese, modifikimi i paligjshëm i një kontrate të lidhur ose prokurimi i punimeve dhe shërbimeve shtesë pa plotësimin e kushteve përkatëse).

Si zbulohen gabimet?

Gabimet në prokurimin publik zakonisht zbulohen dhe korigjohen duke ndjekur mekanizmat (procedurat) e mëposhtëm:

- **Rishqyrtim të procedurave**, për shkak të ankesave të operatorëve ekonomikë kundër vendimeve të autoriteteve kontraktore (ankesa që nisin një rishqyrtim nga gjykata apo një tjetër organ i pavarur);
- **Auditime** të kryera nga zyrat shtetërore të auditimit (auditime të jashtme) dhe auditime të kryera nga një njësi e specializuar brenda subjektit (auditime të brendshme);
- **Inspektime** të kryera nga një organ i specializuar (për shembull, zyra e prokurimit publik ose ministria e Financave) ose nga një tjetër organ kompetent

me kërkesë (ankesave të palëve të interesuara) ose *ex officio* me iniciativën e tyre;

- **Kontrolle** – të kryera nga agjencitë e inspektimit administrativ apo financiar dhe të sundimit të ligjit.

Si mund të klasifikohen gabimet në prokurime?

Lloje të ndryshme gabimesh mund të identifikohen përgjatë procesit të prokurimit publik, në varësi të kriterit që zbatohet. Për qëllime të këtij udhëzimi, ndryshimi midis gabimeve është bazuar mbi kriterin e **impaktit të gabimit mbi rezultatet e procedurës së prokurimit**. Kësisoj, gabimet mund të klasifikohen në:

- Materiale(**të rëndësishme**);
- Jo materiale (të parëndësishme).

Audituesit e Gjykatës Europiane të Audituesve (ECA) bëjnë të njëjtin klasifikim. Në broshurën e saj të titulluar “Përkufizimi dhe Trajtimi i Gabimeve DAS¹”, ECA shtjellon se gabimet janë të rëndësishme për qëllimet e DAS “*nëse ato, individualisht ose tok me gabimet e tjera, do të cenonin vendimet e përdoruesve të opinionit të auditimit*”. Sipas politikës së ECA-s, është jorealiste supozimi se në praktikë nuk ndodh asnjë gabim dhe “*për pasojë, duhet të konsiderohet e pranueshme një shkallë tolerance për nivelin e përshtatshëm të saktësisë*”.

Për qëllimin e këtij udhëzimi, **gabimet e rëndësishme (materiale)** janë ato që kanë një impakt mbi rezultatet e një procedure prokurimi. Me fjalë të tjera, rezultatet e procedurës do të kishin qenë të ndryshme nëse nuk do të kishte ndodhur një gabim. Për shembull, refuzimi i pajustificuar, për arsye formale, i një oferte që ndodh të jetë më e favorshme që i është nënshtruar procedurës së prokurimit ka një impakt mbi rezultatet e procedurës, nëse ndodh që të zgjidhet një ofertë më pak e favorshme (ose me e shtrenjtë).

¹ DAS është akronim francez i përdorur për një deklaratë sigurie (në frëngjisht, *Déclaration d'Assurance*).

I referohet opinionit vjetor të botuar nga Gjykata Europiane e Audituesve, në përputhje me artikullin 287 (1) të Traktatit për Funkcionimin e BE-së, referuar të ardhurave dhe shpenzimeve të Bashkimit Europian.

Gabimet e parëndësishme(jo materiale) janë të gjitha gabimet e tjera që ndodhin gjatë zbatimit të rregullave të prokurimit, të cilat **nuk kanë impakt mbi rezultatet e procedurave të prokurimit** (për shembull, sërish e njëjta ofertë do të zgjidhej si me e favorshmeja, nëse nuk do të ndodhte ndonjë gabim ose operatori ekonomik i refuzuar gabimisht, në çdo rast, nuk do të kishte qenë fitues i prokurimit). Me fjalë të tjera, mungesa e publikimit të njoftimit të një kontrate (thirrjen për tender), nëse një gje e tillë do të ishte kërkesë e ligjit, dhe publikimi me vonesë i njoftimit të lidhjes së kontratës përbëjnë të dyja shkelje të dispozitave specifike të prokurimit publik, megjithatë ato kanë pasoja të ndryshme mbi prokurimin në fjalë. Ngjashëm, një autoritet kontraktues që nuk i ka kërkuar ofertuesit të paraqesë dokumentacionin e plotë ose që mungon (ndërkohë që këto dokumente ua ka kërkuar pjesmarrësve të tjerë) shkel rregulla formale që kërkojnë bërjen e kësaj kërkesë.

Sidoqoftë, këto pasoja bëhen të parëndësishme nëse oferta e paraqitur nga ky ofertues, për shkak të çmimit të lartë, nuk kishte asnjë shans të fitonte kontratën, meqenëse rezultatet e procedurës së prokurimit do të kishin qenë po të njëjtat, pavarësisht se autoriteti kontraktor nuk ka përmbushur detyrimet e tij.

Megjithatë, **ndryshimi mes gabimeve të rëndësishme dhe jo të rëndësishme nuk është një ndarje e qartë** dhe kërkon një qasje rast-pas-rasti dhe një vlerësim të kujdesshëm mbi rrethanat e vecanta. Gabimet e parëndësishme, edhe kur nuk kanë një impakt mbi rezultatet e procedurës, duhet të zbulohen dhe t'i bëhen të ditura autoritetit kontraktor për arsye edukative dhe parandaluese (në një kohë tjetër, në rrethana të ndryshme, gabime të tilla mund të kenë pasoja në rezultatet e procedurës së prokurimit). Ky udhëzim paraqet një listë me gabimet më të zakonshme në prokurimin publik, me një shpjegim të shkurtër të rregullave kryesore që shkelen, medotave të zbulimit, pasojave të shkeljes dhe të teknikave të korigjimit. Lista e prezantuar më poshtë nuk është një listë shteruese e gabimeve potenciale (të cilat variojnë në legjislacione të ndryshme kombëtare për shkak se rregullat janë të ndryshme). Përkundrazi, lista është e kufizuar tek gabimet universalisht më të zakonshme. Duhet të kihet parasysh se sa më të komplikuar dhe normative të jenë rregullat e vendosura, aq më shumë gjasë ka të ndodhin shkelje të hershme apo të mëvonshme të këtyre rregullave.

Gabimet e mëposhtme janë grupuar në bazë të fazës së procedurës së prokurimit.

Cilat janë gabimet më të zakonshme në prokurimin publik?

1. Gabime të fazës së planifikimit, përgatitjes dhe çeljes së procedurës

a) *Moszbatimi i rregullave të prokurimit*

Rregullat e prokurimit publik përcaktojnë kategoritë (tipet) e institucioneve, organeve apo personave që janë të detyruar të zbatojnë rregulla specifike kur hyjnë në tenderë që përfshijnë kontrata me shpërblim (i.e. kontrata të shprehura me kushte monetare) si furnizimet me ushqim, ofrimin e shërbimeve apo kryerjen e punëve. Nëse institucioni (organi) që përkufizohet nga këto rregulla si autoriteti kontraktor përfundon një kontratë pa zbatuar rregullat që duhet të ndiqen, kemi shkelje të rregullave të prokurimit. Kjo lloj shkeljeje mund të ndodhë për shembull në situatat si më poshtë:

- Autoriteti Kontraktor lidh (me një ofertues specifik) një kontratë që duhej të përfundohej duke ndjekur një procedurë transparente dhe konkurruese.
- Autoriteti Kontraktor, në mënyrë të paligjshme, refuzon zbatimin e rregullave të prokurimit, bazuar në një përjashtim të rregullave të prokurimit, kur nuk gjendet në kushtet e këtij moszbatimi (për shembull, objekti i kontratës ose kushtet e lidhjes së saj nuk ekzistojnë ose kur vlera e prokurimit kalon kufirin monetar, të cilat sjellin zbatimin e këtyre rregullave).
- Ndonjëherë, por rrallë, ka raste ku autoriteti kontraktor përfundon një kontratë duke ndjekur një procedurë që në vetvete mund të jetë transparente dhe konkurruese, por e cila nuk është procedura e duhur që kërkohet nga ligji për prokurimin publik (për shembull, kur thirrja për tender publikohet, jo në vendin e përcaktuar nga ligji, si publikimi në një nivel lokal apo kombëtar në vend të Gazetës Zyrtare të BE-së).

Moszbatimi i rregullave të prokurimit publik që kërkohen nga ligji i prokurimit përbën një nga shkeljet më serioze.

Ky është veçanërisht rasti kur, si rezultat i moszbatimit të këtyre rregullave, kontrata në fjalë i jepet një kontraktori specifik, pa u mundësuar operatorëve të tjerë ekonomikë të drejtën për të shprehur interesin e tyre. Jo vetëm që ky moszbatim shkon në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, por është i dëmshëm për financat publike, në rastin kur autoriteti kontraktor paguan më shumë për mallra dhe shërbime që do të kushtonin më pak, nëse do të zbatoheshin procedurat e konkurrencës dhe transparencës. Një gabim i këtillë, nëse kontrata është përfunduar, mund të korrigojë vetëm duke e deklaruar kontratën jo efektive (në përputhje me

dispozitat e Direktivës së Kompensimeve 2007/66/EC) dhe duke hapur një procedurë të re konkurruese prokurimi.

b) Zgjedhja a gabuar e procedurës së prokurimit

Sipas rregullave të BE-së për Prokurimin Publik të përcaktuara nga Direktiva e Sektorit Publik 2004/18, ka dy procedura vlerësimi: e hapur dhe e kufizuar. Këto trajtohen si procedura “bazë”, që do të thotë se ato gjithmonë mund të aplikohen dhe zgjedhja se cila procedura do të zbatohet lihet në diskrecionin e autoritetit kontraktor. Sipas Direktivës së Shërbimeve Publike(2004/17), entitetet kontraktuese mund të zgjedhin lirisht midis procedurave të hapur, të kufizuar dhe të negociuar, po qe se është bërë një thirrje për konkurrim (i.e publikimi i kontratës ose i një forme tjetër të thirrjes për konkurrim). Të gjitha procedurat e tjera janë atipike dhe mund të zbatohen vetëm në kushte të veçanta, që përcaktohen në mënyrë strikte nga direktivat përkatëse të Bashkimit Europian, siç mund të jetë një nevojë urgjente dhe e paparashikuar për dhënien e një kontrate dhe për arsye objektive vetëm një ofrues specifik është i aftë për të përmbushur kontratën, si dhe kur plotësohen kushte të tjera që janë përcaktuar dhe interpretuar në mënyrë strikte. Autoriteti kontraktor që nuk respekton rregullat e duhura në lidhje me zgjedhjen e përshtatshme të procedurës kryen një shkelje të rregullave të prokurimit publik, në vecanti kur lidh një kontratë pa ndonjë thirrje për konkurrim.

Siç u theksua më sipër në pikën 1a), kjo shkelje mund të korrigjohet vetëm duke e konsideruar kontratën të paefektshme dhe duke hapur një procedurë të re dhe konkurruese prokurimi.

c) Moszbatimi i rregullave lidhur me vlerësimin e shumës së prokurimit

Zbatimi si i rregullave të BE-së dhe atyre kombëtare në prokurimin publik zakonisht varet nga vlera e kontratës në fjalë. Për shembull, direktivat e BE-së zbatohen vetëm ndaj atyre vlerave të kontratës që i tejkalojnë kufijtë specifikë financiarë. Një numër parimesh të përgjithshme si dhe disa rregulla të vecanta zbatohen në përlllogaritjen e shumës së vlerësuar të kontratave publike. Shkeljet e rregullave të prokurimit ndodhin nëse autoriteti kontraktor:

- **nënvlerëson vlerën e kontratës** në mënyrë që të shmangë zbatimin e rregullave specifike; rrjedhimisht, në kontekstin e prokurimit të BE-së, kontrata njoftohet në një nivel kombëtar (ose nuk njoftohet hiç), duke kufizuar ndjeshëm aksesin e kompanive të huaja ndaj informacionit rreth mundësisë ofertuese.

- **copëton artificialisht kontratën** në pjesë të vogla dhe zbaton procedura më pak konkurruese dhe transparente; copëzimi i një kontratë në pjesë të vogla është i lejueshëm (madje është e rekomandueshme si mjet për të rritur pjesmarrjen e bizneseve të vogla dhe të mesme-SME), por vetëm nëse nuk bëhet qëllimisht për të shmangur zbatimin e rregullave të duhura.

Rast Studimi

Autoriteti Kontraktor lidh drejtpërdrejt një kontratë për zhvillimin e një sistemi të ri IT (që i referohet si version “demo” apo testimi) me një vlerë të përlllogaritur nën kufirin e ulët monetar kombëtar prej 14,000 eurosh (për pasojë, nuk bëhet njoftimi i kontratës). Autoriteti Kontraktor nuk parashikoi në kontratë se e drejta e autorit lidhur me sistemin do të transferohej tek autoriteti kontraktor. Si pasojë, duke pretenduar se kontraktori kishte të drejta ekskluzive në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit IT, Autoriteti Kontraktor lidhi me të njëjtin kontraktues një seri kontratash mbi modernizimin dhe zhvillimin e software-it. Në këtë mënyrë, AK hapi fillimisht një kontratë me vlerë tepër modeste dhe më pas lidhi me të njëjtin kontraktues, pa konkurrencë, ofrimin e shërbimeve me vlerë prej 18,000,000 eurosh.

- **Nuk i grupon furnizimet, shërbimet dhe punimet identike** apo të ngjashme në një periudhë të caktuar dhe zbaton procedura më pak transparente dhe konkurruese në vend që të aplikojë rregullat përkatëse për totalin e plotë të të gjithë pjesëve të kombinuara

Dispozitat e grupimit përcaktojnë se një numër i ngjashëm kontratash, ku secila mund të jetë nën kufirin përkatës monetar, duhet të trajtohen si një e tërë dhe dispozitat që janë të aplikueshme mbi kufirin monetar duhet të zbatohen edhe mbi ato kontrata që, nëse merren veçmas, nuk e arrijnë kufirin monetar. Autoriteti Kontraktor, nëse lidh një kontratë të ndarë në pjesë, duhet të marrë parasysh vlerën respektivë të pjesëve dhe të zbatojë ato dispozita (procedura) që i përkasin vlerës së kontratës të marrë si e tërë. Shkelja e rregullave në lidhje me vlerësimin e shumës së kontratës dhe copëtimi artificial përbën një shkelje thelbësore, veçanërisht nëse rezulton se janë zbatuar procedura pa transparencë dhe pa konkurrencë (lidhje e drejtpërdrejt me një kontraktor).

Sërish, nëse në vend të procedurave konkurruese dhe transparente, Autoriteti Kontraktor, për shkak të copëtimit të kontratave, zbaton procedura jo konkurruese dhe jo transparente, kjo shkelje mund të korrigjohet duke anuluar

procedurën e prokurimit(nëse kontrata nuk është lidhur) ose duke e deklaruar kontratë të paefektshme (nëse është lidhur).

Rast Studimi

Autoriteti Kontraktor ka lidhur katër kontrata për punë të ngjashme për ndërtimin e një sistemi kanalizimi të ujërave të zeza. Vlerat e kontratave respektive janë: 1) 1,525,649 Euro; 951,368 euro; 3)1,260,502 euro; dhe 4) 1,490,807 Euro. Vlera totale e të gjitha loteve shkon 5,228,326. Në përputhje me rregullat e BE-së, të gjitha lotet duhet të njoftohen në Gazetën Zyrtare të BE-së(OJEU), edhe nëse ato janë dhënë me procedura të ndarë (si në rastin konkret), meqenëse vlera e akumuluar e prokurimit tejkalon kufirin e 5,000,000 eurove. Megjithatë, autoriteti kontraktor aplikoi rregulla prokurimi sikur secili lot të ishte objekt i një prokurimi krejt të ndryshëm dhe nuk bëri një njoftim kontrate në gazetën zyrtare, duke shkelur kështu rregullat e përmendura më sipër të grupimit.

d) Përshkrimi i gabuar i objektit të prokurimit

Rregullat e prokurimit të transparencës dhe konkurrencës do të ishin të kota nëse objekti i prokurimit do të përcaktohej në mënyrë të njëanshme, duke kufizuar kështu aksesin në një formë të tillë saqë vetëm një furnizues do të kishte mundësi të ofronte mallrat ose shërbimet e kërkuara. Prandaj, objekti i prokurimit duhet të përshkruhet në termat e specifikimeve teknike, për t'i ofruar akses të barabartë ofertuesve dhe për të parandaluar krijimin e pengesave të pajustificuara për konkurrencën në një prokurim publik. Objekti i kontratës së prokurimit duhet të përshkruhet në një mënyrë të qartë dhe shteruese, me një formulim sintaksor gjuhësor të saktë dhe të kuptueshëm, duke marrë parasysh të gjitha kërkesat dhe rrethanat që mund të kenë një impakt në përgatitjen e një tenderi.

Autoriteti Kontraktor shkel ligjin nëse e përshkruan objektin e prokurimit në një formë që mund të kufizojë pa të drejtë konkurrencën; në veçanti, shkel ligjin kur e përshkruan objektin e prokurimit duke iu referuar markave, patentave të origjinës, me përjashtim të rasteve kur referenca është e justifikuar nga natyra e objektit të kontratës ose kur Autoriteti Kontraktor nuk mundet ndryshe ta përshkruajë objektin me precizion të saktë me kusht që referenca të shoqërohet me togfjalëshin “ose e barabartë”.

Gabime lidhur me njëanshmërinë, specifikimet e “qepura” qëllimisht janë nga më të vështirat për t'u zbuluar. **Megjithatë, operatorët ekonomikë zakonisht i sjellin në**

vemendjen e institucioneve përkatëse këto gabime duke bërë ankesa rreth masave që kufizuan shanset e tyre për të ofruar mallra dhe shërbime. Për t'i provuar autoritetit kontraktor se rregullat e prokurimit janë shkelur, mund të jetë e nevojshme përfshirja e ekspertëve të jashtëm dhe të pavarur të fushës për të shprehur opinionet e tyre.

e) Kushtet për pjesëmarrje që nuk përputhen me parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe konkurrencës së sigurtë

Qëllimi i kriterëve kualifikuesë konsiston në identifikimin e atyre operatorëve ekonomikë që janë **të aftë** për të kryer dhe përfunduar kontratën që do të lidhet. Autoriteti Kontraktor duhet të vendosë kriteret që janë të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë. Kur vendosen kushtet për pjesëmarrje, autoriteti kontraktor mund të përcaktojë minimumin e **niveleve të kapacitetit** që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë (vetëm, ose aty ku është e përshtatshme, në varësi të kapaciteteve të palëve të treta). Këto kushte duhet të jenë të lidhura dhe **proporcionale me objektin e prokurimit**. Aktualisht, ligji i BE-së kërkon që kriteret e kualifikimit të kufizohen në një vlerësim, nëse baza për përjashtim (e detyrueshme apo fakultative) është përmbushur si dhe një vlerësim të aftësisë së operatorit ekonomik për të kryer shërbime, të gjendjes financiare dhe ekonomike si dhe të kapaciteteve teknike ose profesionale.

Kriteret kualifikuesë të mëposhtme janë konsideruar të paligjshme nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtësisë:

- Favorizimi i operatorëve ekonomikë që kryejnë shumicën e aktivitetit në një rajon ku do të zhvillohen punimet e objektit të prokurimit;
- Pjesëmarrja në procedura publike është e kufizuar për ofertuesit, shumica e kapitalit të cilëve është pronësi publike;
- Kërkesa për vërtetim se dizenjuesi është anëtar i shoqatës së arkitektëve të vendit të autoritetit kontraktor;
- Përjashtimi i ofertuesve nga procedura për arsyen e vetme se kanë marrë subvencion nga fondet publike;
- Kushti se ofertuesi duhet të ketë në kohën e paraqitjes së ofertës një zyrë të hapur për publikun në kryeqendrën e rajonit ku do të ofrohet shërbimi.

Gabimet e mëposhtme mund të ndodhin gjatë zbatimit të kriterëve të kualifikimit

- Kriteret diskriminuese në lidhje me kualifikimin ose kritere që shtrembërojnë konkurrencën.

Rast studimi

Në procedurën e prokurimit publik për shërbimet e mbikëqyrjes së punimeve në një sistem të kanalizimeve të ujërave të zeza, autoriteti kontraktor kërkon vërtetim nga operatorët ekonomikë se kanë përvojë në shërbime të ngjashme të fituara nga procedura prokurimi dhe të financuar nga fonde të jashtme ndihmëse (si fondet e BE-së, Mekanizmi Financiar Norvegjez ose Banka Botërore). Kjo kërkesë u konsiderua diskriminuese dhe që cënonte konkurrencën.

- Kërkesa që nuk janë të lidhura me produktet, shërbimet dhe punët që përbëjnë objektin e prokurimit dhe/ose kërkesa që janë disproporcionale dhe të plotësueshme vetëm nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Rast studimi

Autoriteti Kontraktor lidh një kontratë për shërbime mbikëqyrjeje lidhur me ndërtimin e një sistemi kanalizimi të ujërave të zeza. Vlera e Shërbimeve u vlerësua me një shifër modeste prej 60,000 Euro. Autoriteti Kontraktor kërkoi, ndër kushte të tjera, që operatorët ekonomikë të interesuar në ofrimin e këtyre shërbimeve të kishin një siguracion prej 2,5 milionë eurosh. Konkluzioni i audituesve që kishin kontrolluar procedurën ishte se autoriteti kontraktues kishte vendosur një kërkesë të lartë disproporcionale.

Në një tjetër procedurë, lidhur me rikonstruksionin e një stacioni hekurudhor, operatorëve ekonomikë iu kërkua të vërtetonin që kishin përvojë në punime të ndryshme (ndërtime të parkingjeve, rrjete të energjisë elektrik, hekurudha, etj) të përfituar gjatë zbatimit të një projekti të vetëm. Operatorëve ekonomikë iu ndalohej të vërtetonin kapacitetin e tyre teknik me përvoja të përfituara në projekte të ndryshme. Edhe këtu, audituesit konstatuan se ky kriter lidhur me atë sesi duhej të dëshmohej kapaciteti teknik, ishte në kundërshtim me ligjin e prokurimit.

Kërkesa nga operatorët ekonomikë për dokumente irrelevante për procedurën: në përputhje me rregullat e sipërpërmendura, autoriteti kontraktor kryen një gabim nëse kërkon dokumente që nuk janë të nevojshme për të provuar se operatori ekonomik është i besueshëm dhe i aftë për të përmbushur kontratën, si dokumente

që nuk janë të lidhura me kërkesat apo kushtet e imponuara nga autoriteti kontraktor.

- Shkeljet e lidhura me përshkrimin e objektit të procedurës mund të korigjohen nëse zbulohen dhe goditen me ankesë nga operatorët ekonomikë mjaftueshëm herët në procedurën e prokurimit. Për të korigjuar këtë shkelje do të ishte e mjaftueshme heqja ose ndryshimi në dokumentet e tenderit të të gjitha kriterëve ose kërkesave diskriminuese që nuk janë të lidhura me objektin e prokurimit. Përpos kësaj, autoriteti kontraktor me shumë gjasë i duhet të ndryshojë njoftimin e kontratës, nëse këto modifikime prekin informacionin e përfshirë në këtë njoftim.

f) Zbatimi i gabuar i kriterit të përzgjedhjes së fituesit të tenderit

Kriteri fitues përbën bazën me të cilën autoriteti kontraktor zgjedh ofertën më të mirë dhe për pasojë lidh kontratën. Ky kriter duhet të paracaktohet nga autoriteti kontraktor dhe nuk duhet të paragjykojë konkurrencën e drejtë. Zbatimi i duhur i kriterit fitues është element kyç për procesin e lidhjes së kontratave publike – nëse nuk zbatohen drejtë, procesi i tenderit, vlerësimi i tenderave dhe vendimi i lidhjes së kontratës mund të jenë me të meta. Kjo do të thotë se procesi i tenderit duhet të anulohet dhe rifillohet, pasi nuk është zgjedhur oferta më e mirë.

Ndërkohë që vendos kriterin fitues, autoriteti kontraktor pikësëpari duhet të respektojë parimin themelor të mosdiskriminimit (sidomos mbi bazën e shtetësisë). Së dyti, kriteri fitues nuk duhet të jetë paragjykues ndaj konkurrencës së drejtë. Së treti, në përputhje me parimin e transparencës, të gjitha kriteret fituese (dhe nënkriteret në kushtet kur autoriteti kontraktor vendos të ndajë vlerësimin e kriterit në elementë të ndryshëm përbërës) duhet të publikohen paraprakisht për ofertuesit potencialë nëpërmjet dokumenteve të kontratës ose njoftimit të kontratës. Së katërti, kriteri fitues duhet të formulohet në një formë të tillë sa që të lejojë **të gjithë ofertuesit e mirëinformuar dhe të kujdesshëm** që t'i interpretojnë në të njëjtën mënyrë. Së fundmi, **autoriteti kontraktor** duhet ta interpretojë kriterin fitues në të njëjtën mënyrë përgjatë gjithë procedurës.

Si në rastin e sipërpërmendur të kriterit të përzgjedhjes, Gjykata Europiane e Drejtësinë në jurisprudencën e saj i ka cilësuar të paligjshme këto kritere fituese:

- Marrja e një liste dokumentesh që provojnë shërbimet e mëparshme të ofertuesit (ky kriter mund të zbatohet vetëm si kriter kualifikimi, meqenëse i referohet kapacitetit, (i.e eksperiencës së operatorit ekonomik);
- Kriteria që nuk shoqërohen me dokumente që mundësojnë verifikimin efektiv të saktësisë së informacionit të ofruar në tender;
- Kërkesa që produkti që është objekt i tenderit të jetë i aksesueshëm për inspektim nga autoritetit kontraktor brenda një rreze specifike kilometrash;
- Kriter që vlerëson, me pikë shtesë, ekzistencën, në kohën e hapjes të tenderit, të kantierëve apo qendrave të ofertuesve brenda 1000 km nga kryeqyteti i provincës ose nga zyrat e tjera të hapura për publikun në qytete të tjera specifike.

Autoriteti kontraktor mund të bëjë gabim në zbatimin e kriterit fitues nëse :

- Zbaton kriteret që janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik, në veçanti me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë, si lejimi i preferencave të çmimit për kompanitë e lokalizuara në të njëjtën zonë me autoritetin kontraktor;
- Aplikon kriteret që nuk janë të lejueshme në një procedurë specifike prokurimi – për shembull, në dialogun konkurrues autoriteti konkurrues zbaton kriterin e çmimit më të ulët, në përputhje me rregullin përkatës, kur në rastin konkret duhet të aplikojë kriterin e ofertës më të favorshme ekonomike.
- Aplikon kriteret që nxisin pasiguri mbi atë sesi do të vlerësohen ofertuesit.

Rast studimi

Në një procedurë prokurimit lidhur me një kontratë për projektimin dhe ndërtimin e prodhuesve të energjisë nga era (eolieneve), Autoriteti Kontraktor vuri si kriter vlerësimin e “kushteve të ofruara nën garanci” mbi bazën e opinionit të ekspertit.

Shkeljet lidhur me zbatimin e kriterit të vlerësimit mund të korrigjohen duke hequr ose ndryshuar kriteret që nuk janë në përputhje me dispozitat përkatëse. Nëse publikohen në njoftimin e kontratës, është i nevojshëm korrigjimi i gabimeve në njoftim, shoqëruar me një shtyrje të përshtatshme të kohës së pritjes së ofertuesve.

2. Gabimet e kryera përgjatë zbatimit të procedurës

a) Mosrepektimi i afateve kohore të përcaktuara në rregullat e prokurimit

Qëllimi i dispozitave që rregullojnë periudhat minimale të kohës së pritjes së ofertave është që t'u lejojë operatorëve ekonomikë, veçanërisht atyre të huaj, të përgatiten dhe të dërgojnë ofertat që plotësojnë kërkesat e autoritetit kontraktor.

Parregullsitë e mëposhtme mund të ndodhin në vazhden e procedurës së prokurimit:

- Periudha kohore që janë tepër të shkurtra për pritjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje, në veçanti nëse janë më të shkurtra se limitet kohore të kërkuara nga ligji i prokurimit.
- Pranimi në procedurë dhe vlerësimi i ofertave që janë marrë pas kalimit të periudhës kohore; oferta të këtilla duhe t'u rikthehen të pahapura ofertuesve përkatës, me përjashtim kur vonesa në dorëzimin e ofertës vjen për faj të autoritetit kontraktor (për shembull, nëse nuk ka përcaktuar qartë vendin e pritjes së ofertave ose nëse ka pasur defekte në sistemet e IT, të cilat kanë pamundësuar dorëzimin elektronik në kohë); në përgjithësi, pranimi i ofertave që janë marrë pas kufirit përkatës kohor është i barasvlershëm me shkeljen e parimit të trajtimit të barabartë.
- Shkeljet e lidhura me zbatimin e dispozitave referuar periudhave kohore mund të korrigjohen në procesin e prokurimit. Zgjatja e përshtatshme e afatit kohor dhe njoftimi i këtij fakti do të mjaftonte për operatorët ekonomikë.

b) Vlerësimi i gabuar i kualifikimeve të operatorëve ekonomike, që rezulton në skualifikimin e tyre

Kur Autoriteti Kontraktor vlerëson ofertat e dorëzuara apo kërkesat për pjesëmarrje, ai duhet të kontrollojë nëse ofertuesit ose kandidatët do të përjashtohen dhe më pas të vijojë për të kontrolluar nëse plotësojnë kriterin lidhur me kualifikimin e tyre. Kësisoj, një gabim ndodh kur autoriteti kontraktor skualifikon gabimisht një operator ekonomik, i cili në fakt plotëson të gjitha kriteret ose, në të kundërtën, autoriteti kontraktor pranon në procedurë një operator ekonomik që duhej të përjashtohej ose që nuk duhej të ftohej për të paraqitur ofertë. Kjo çështje është ngushtësisht e lidhur me interpretimin e saktë të dokumenteve që paraqiten nga pjesëmarrësit(këto dokumente ose deklarata mund të mungojnë, të jenë të paplota ose të paqarta). Në rast dyshimi, autoriteti kontraktor duhet të kërkojë qartësi nga ofertuesi në fjalë(kandidati), por duke respektuar partimin e trajtimit

të barabartë (të gjithë pjesmarrësit të gjendur në situatë të njëjtë, duhet të trajtohen njësoj).

c) Vlerësimi i gabuar i ofertuesve që rezulton në refuzimin e një ofertuesi të saktë ose mungesa e refuzimit për një ofertues jo të saktë

Ofertat duhet të vlerësohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike që paraqiten në njoftimin e kontratës ose dokumentet e tenderit. Ofertat që nuk janë të sakta duhet të refuzohen. Lejimi i ofertuesve që të korigjojnë tenderat do të ishte në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë. Nga ana tjetër, ofertuesit që nuk janë në përputhje me kërkesat jo themelore të Autoriteti Kontraktor nuk duhet të refuzohen menjëherë.

Shkeljet lidhur me vlerësimin e ofertave mund të korigjohen duke përsëritur procesin e vlerësimit, pasur me zgjedhjen e ofertuesit më të mirë.

d) Modifikimi i kriterit fitues në azhdën e procesit të prokurimit

Kriteri i publikuar në njoftimin e kontratës (dosjen e tenderit) në përgjithësi duhet të jetë kriteri i zbatueshëm. Megjithatë, gjatë procesit të tenderit, autoriteti kontraktor mund të marrë në konsideratë rrethana të reja që kanë një impakt në kriterin fitues të njoftuar, ose mund t'i nevojitet ta ndryshojë një mosveprim ose gabim. Ndryshimet në kriterin fitues mund të ndahen në ndryshime materiale ose jo materiale. Një ndryshim është material kur ka gjasë të sjellë pasojë në identitetin e operatorëve ekonomikë që do të marrin pjesë në procesin e tenderit. Në përgjithësi, kur ndodh një ndryshim që është material, është e nevojshme të shkohet prapa në fazën ku ka ndodhur ndryshimi. Për shembull, ndryshimi i lidhur me zbatimin e kriterit fitues ekonomikisht më të favorshëm në vend të çmimit më të ulët është material, meqenëse prek një nga elementët që ofron bazën mbi të cilën operatorët ekonomikë vendosën të marrin pjesë ose jo në një procedurë prokurimi. Për më tepër, ndryshimi lidhet me një element që duhet të ishte i publikuar në kontratën e njoftimit.

Një ndryshim jo material, nga ana tjetër, parimisht është i lejueshëm. Në këtë rast, do të ishte e mjaftueshëm një korigjim i njoftimit të kontratës dhe/ose dokumenteve të kontratës, të cilat duhet të shoqërohen me një shtyrje adekuate dhe publike të periudhës kohore për pritjen e dorëzuesve të ofertave. **Shqyrtimi nëse një ndryshim është material ose jo material duhet të marrë parasysh rrethanat e veçanta për secilin rast. Në asnjë rrethanë nuk duhet të ndryshohet**

kriteri fitues (përfshirë peshën relative të kriterëve të ndryshme, aplikimin e nën-kritereve dhe peshën përkatëse të tyre dhe një vlerësim i detajuar i metodologjisë) gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Në këtë fazë, të gjithë kriteret (dhe çdo nën-kriter) duhet të aplikohen ashtu siç janë.

Nëse autoriteti kontraktor dëshiron të ndryshojë kriterin fitues në një mënyrë të tillë që e bën ndryshim material sipas përkufizimit të mësipërm, ky ndryshim zakonisht kërkon ri-publikim të njoftimit të kontratës dhe një shtyrje të përshtatshme të përiudhës së kohës për pranimin e ofertave. Nga ana tjetër, nëse autoriteti kontraktor ndryshon kriterin fituese me të përfunduar periudha e dorëzimit të ofertave, një shkelje e tillë mund të korrigjohet vetëm me anulimin e të gjithë procedurës dhe ripublikimit të saj.

e) Anulimi i procedurës pa arsye të justifikueshme

Procedurat e prokurimit publik, në veçanti ato që janë hapur me një thirrje publike për konkurrencë, nuk duhet të anulohen pa arsye të justifikueshme. Qëllimi i këtij rregulli është se operatorët ekonomikë të interesuar që i përgjigjen një tenderi dhe që marrin pjesë në prokurim, investojnë kohë dhe burime në përgatitjen e ofertave të tyre, të cilat nuk mund të konsiderohen të papërfillshme. Rregullat e prokurimit publik zakonisht lejojnë anulimin e procedurës për arsye të rëndësishme dhe të paparashikueshme, në veçanti nëse lidhja e një kontrate, për shkak të rrethanave të papritura, nuk përbën më një interes publik. Nevoja për të anuluar kontratën mund të jetë gjithashtu rezultat i veprimeve të paligjshme të ofertesve, për shembull nëse rezulton se kanë vepruar në bashkëpunim me njëri-tjetrin. Po ashtu, mund të bëhet e nevojshme anulimi i një procedurë për të korrigjuar procedurën që është me të meta të tilla saqë parregullsitë e kryera nga autoriteti kontraktor nuk mund të korrigjohen ndryshe. Për shembull, nëse nuk bëhet njoftim për ftesë për konkurrim, në kundërshtim me rregullat e prokurimit, dhe autoriteti kontraktor bëhet i vetëdijshëm për këtë shkelje, do të ishte i preferueshëm anulimi i procedurës sesa vijimi deri në lidhjen e kontratës, e cila si pasojë mund të deklarohet jo efektive nga gjykata apo një organ tjetër i pavarur.

Në çdo rast, vendimi i autoritetit kontraktor për të anuluar procedurën e tenderit duhet të jetë plotësisht i justifikuar, veçanërisht kur anulimi ka ardhur për shkak të ndryshimit të rrethanave për të cilat u hap procedura e tenderit ose për arsye të tjera të pa parashikura.

Anulimi i pabazuar i procedurës së kontratës mund të korrigohet duke revokuar vendimin që solli anulimin e procedurës dhe lidhjen e kontratës në fjalë.

f) Gabime të tjera gjatë procedurës

- **Zbatimi i gabuar i rregullave të komunikimit** –për shembull, autoriteti kontraktor nuk informon pjesmarrësit mbi vendimet e veçanta të marra në vazhden e procedurës;
- **Mungesa e publikimit** të një shtojce të njoftimit të kontratës në një situatë ku ka pasur ndryshime në procedurë, lidhur me elementët e publikuar më parë në njoftimin e kontratës – për shembull, autoriteti kontraktor shtyn afatin kohor për pritjen e aplikimeve ose ofertave por nuk publikon një njoftim për këtë ndryshim;
- Pjesëmarrja, nga autoritetit kontraktor, i një personi i cili është në kushtet e **konfliktit të interesit** – për shembull, personi është i lidhur me ose ka qenë i punësuar në operatorin ekonomik që merr pjesë në procedurën e prokurimit. Në përputhje me parimin e paanshmërisë, me t'u hapur kërkesat për pjesëmarrje ose ofertat, të gjithë anëtarët e komisionit të tenderit duhet të deklarojnë çdo konflikt interesi potencial; ata duhet të përjashtohen nga komisioni i tenderit dhe nuk duhet të kenë tagrin e përzgjedhjes së ofertës më të mirë. Kjo shkelje është substanciale pasi ka impakt në rezultatet e procesit të prokurimit.

Në mënyrë që të merret një vendim për anulimin e të gjithë procedurës së prokurimit ose për korigjimin e shkeljeve të përmendura më sipër, duhet të analizohet rasti përkatës dhe impakti i gabimit mbi rezultatet e prokurimit.

3. Gabime të kryera pas zgjedhjes së ofertës më të mirë ose përmbylljes së kontratës së prokurimit

Rregullat e prokurimit publik, përfshirë direktivat e Bashkimit Europian, imponojnë disa kërkesa që duhet të përmbushen nga autoriteti kontraktor edhe pasi procedura është përmbjllur. Disa nga parregullsitë e listuara më poshtë, në përgjithësi mund të kualifikohen si parregullsi substanciale ndërsa të tjerat, në varësi të rrethanave, mund ose jo të konsiderohen si substanciale.

a) Mosrepektimi i afatit të ankesave

Autoritetet kontraktuese janë të detyruara të presin përfundimin e një afati kohor mes vendimit të shpalljes së fituesit dhe përmbjlljes së kontratës me ofertuesin

fitues. Kjo periudhë “pushimi” i lejon ofertuesit që uk është përzgjedhur për t’u ankuar ndaj vendimin të autoritetit kontraktor e të ndalë lidhjen e një kontrate që mund të jetë dhënë mbi një vendim të gabuar. Autoriteti Kontraktor që nuk respekton këtë afat (përfshihet në kontratë para skadimit të afatit) shkel rregullat e prokurimit publik. Sipas rregullave të Bashkimit Europian, kjo shkelje trajtohet si e rëndësishme dhe për pasojë kontrata duhet të shpallet e paefektshme, meqenëse kjo shkelje e ka privuar ofertuesin nga përdorimi i mjeteve juridike para kontraktore dhe meqenëse është e kombinuar me shkeljen e rregullave procedurale në sektorin publik. Me fjalë të tjera, thyerja e rregullave të ankimimit në vetvete nuk është e mjaftueshme për të shpallur një kontratë të paefektshme.

Vetëm nëse shoqërohet me thyerje të rregullave të prokurimit(për shembull, përzgjedhja e një ofertë të pasaktë ose të një ofertë jo më të mirë) dhe ofertuesit të dëmtuar (të cilit nuk iu përzgjedh oferta, në kundërshtim me dispozitat ligjore) i privohet e drejta për t’u ankuar ndaj vendimit të autoritetit kontraktor dhe që për pasojë humbet shansin për të fituar kontratën.

Nëse kontrata është lidhur para përfundimit të afatit të ankesave, ky gabim i autoritetit kontraktor nuk mund të korrigjohet ndryshe përveçse duke e shpallur kontratën të paefektshme. Anulimi i kontratës varet nëse kjo shkelje i përmbush të dyja kushtet e mësipërme.

b) Mos informimi i pjesmarrësve mbi rezultatet e procedurës

Sapo merret vendimi për përzgjedhjen e fituesit, autoriteti kontraktor është i detyruar të njoftojë të gjithë operatorët ekonomikë mbi rezultatet e procedurës. Ky detyrim ka si qëllim t’u ofrojë pjesmarrësve një mundësi për t’u ankuar ndaj vendimit të autoritetit kontraktor, nëse e konsiderojnë atë të gabuar. Sipas Direktivës së Kompensimeve të BE-së, autoriteti kontraktor është i detyruar të komunikojë vendimin për fituesin tek secili ofertues dhe kandidat i interesuar, duke u ofruar atyre një përmbledhje të arsyeve kryesore që çuan në përzgjedhjen e fituesit në mesin e ofertuesve të tjerë, shoqëruar me një deklaratë të saktë lidhur me zbatimin e afatit të ankesave. Mungesa e komunikimit të rezultateve të procedurës përbën një shkelje të rëndë të rregullave të prokurimit, pasi privon të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit të autoritetit kontraktor, në veçanti kur kjo parregullsi shoqërohet me mosrespektimin e afatit kohor të ankesave. Megjithatë, nëse parregullsia ka impakt mbi rezultatet e procedurës, kjo varet nga rrethanat specifike të secilit rast.

Kjo lloj shkeljeje mund të korrigojohet duke kryer veprimin e kërkuar (i.e njoftimin e pjesmarrësve mbi rezultatet e procedurës). Është në fakt në interes të autoritetit kontraktor të informojë pjesmarrësit mbi rezultatet e procedurës, meqenëse afati kohor për paraqitjen e ankesave fillon në momentin kur informacioni (në varësi të ligjit të zbatueshëm) u dërgohet ose merret nga operatorët ekonomikë.

c) Mos publikimi i kontratës fituese

Rregullat e Bashkimit Europian kërkohen që Autoriteti Kontraktor të komunikojë vendimin për dhënien e kontratës publike duke e shpallur atë në Gazetën Zyrtare të BE-së(OJEU). Kjo kërkesë është e përcaktuar edhe në ligjin kombëtar mbi prokurimin publik. Njoftimi zakonisht duhet të bëhet menjëherë dhe jo më vonë se numri i ditëve të përcaktuara nga përmbyllja e kontratës. Meqenëse ky njoftim nuk është pjesë e procedurës së prokurimit (që përfundom me vendimin e përzgjedhjes së fituesit), autoritetet kontraktore shpesh e shpërfillin atë. Megjithatë, është një element që garanton transparencë më të madhe dhe rëndësia e saj nuk duhet të mohohet, pavarësisht se impakti i saj në funksionimin e sistemit të prokurimit nuk është i njëjtë për shembull me mungesën e publikimit të njoftimit të kontratës.

Ky lloj gabimi mund të korrigojohet lehtë duke publikuar njoftimin e kërkuar. Është në fakt në interes të autoritetit kontraktues të publikojë një njoftim të tillë meqenëse afati kohor i ankesave fillon nga momenti i publikimit.

d) Publikimi i paplotë i informacionit në njoftimin e kontratës fituese ose publikim pas afatit të kërkuar

Autoriteti kontraktor mund të kryejë gabim edhe kur publikon kontratën fituese, por në një mënyrë të tillë që vonohet komunikimi i këtij informacioni (njoftimi publikohet, por më vonë nga afati që parashikon ligji) ose nuk përmban të gjithë informacionin e kërkuar. Në të dyja rastet, ky gabim përbën një shkelje të rregullave të transparencës, pasi i privon operatorët ekonomikë, institucionet publike – përfshirë organet audituese dhe monitoruese – si dhe publikun nga kryerja e funksioneve mbikëqyrëse. Mund të ndodh që autoriteti kontraktor të mos japë informacion, për shembull për identitetin e operatorëve ekonomikë të përzgjedhur, arsyet e zgjedhjes së ofertës fituese, numrin e ofertave të pranuar dhe të refuzuara, çmimin më të ulët të ofruar dhe cmimim fitues të tenderit. Megjithëse kjo është një shkelje e rregullave të prokurimit, zakonisht nuk ka një impakt mbi rezultatet e procedurave të përfunduara të prokurimit, në veçanti ndaj procedurës transparente dhe konkurruese e për rrjedhim kjo shkelje është më shumë formale

sesa substanciale. Me shumë gjasë, rezultatet e procedurës do të kishin qenë të njëjta nëse autoriteti kontraktor do të kishtë përmbushur plotësisht kërkesat e publikimit. Është tjetër situatë kur publikimi i kontratës fituese shoqërohet me një procedurë që nuk është transparente apo konkurruese, si procedura me negociim pa njoftim paraprak. Një njoftim i këtillë duhet të përmbajë veçanërisht informacion mbi arsyet e zbatimit të kësaj procedure (baza ligjore që justifikon mungesën e konkurrencës). Mungesa e informacionit jo domosdoshmërisht do të thotë se është shkelur ligji, por duhet të tërheqë vëmendjen e organeve përkatëse në lidhje me zbatimin e drejtë të përjashtimeve nga parimet e përgjithshme.

e) Lidhja e një kontrate që nuk është në përputhje me kushtet e ofertës fituese

Autoriteti kontraktor duhet të lidhë një kontrate me palën fituese në përputhje me kushtet e ofertës së paraqitur. Me fjalë të tjera, kushtet e kontratës duhet të reflektojnë angazhimet e bëra në ofertën që u përzgjedh si më e mira. Autoriteti Kontraktor do të shkelte parimin e trajtimit të barabartë nëse do të lejonte që ofertuesi fitues të përfitonte më shumë para ose të lidhte një kontratë me kushte më të favorshme për ofertuesin. Në anën tjetër, modifikimi i kontratës krahasuar me ofertën lejohet në raste përjashtimore dhe tepër të justifikuar, nëse një nevojë e tillë lind nga rrethana të cilat nuk mund të parashikoheshin në momentin e përzgjedhjes së ofertuesit më të mirë dhe në rrethana të tjera tepër strikte. Megjithatë, këto ndryshime nuk duhet të prekin angazhimet e operatorit ekonomik të përfshirë në tender, të cilat ishin vlerësuar përgjatë procedurës së prokurimit.

f) Modifikimi i kontratës gjatë ekzekutimit, në kundërshtim me rregullat që e lejojnë një modifik të tillë

Sapo lidhet kontrata me ofertuesin fitues, ajo duhet të përmbushet ashtu siç është dhe nuk mund të ndryshohet përveçse në raste përjashtimore, për shembull nëse nevoja për ndryshim rezulton nga ngjarje të paparashikuara. Në përgjithësi, **modifikimi substancial i kontratës është i ndaluar**. Kjo kuptohet se ky rregull zbatohet ndaj një ndryshimi që e bën kontratën substancialisht të ndryshme nga ajo që është dakortësuar. Për shembull, modifikime të tilla do të:

- alternonin balancën ekonomike në favor të kontraktorit;
- përfshinin mallra, shërbime dhe punime që s'ishin pjesë të procesit origjinal të prokurimit;
- rezultonin, nëse do të zbatoheshin në procedurën orgjinale të prokurimit, në përzgjedhjen e një tjetër operatori ekonomik.

Modifikimet substanciale të kontratave janë të ndaluara, përveç rasteve kur zbatohen duke u përfshirë në një proces të ri prokurimi (transparent dhe konkurrues), me një thirrje të re për konkurrim.

Në anën tjetër, ndryshimet në kontratë nuk konsiderohen substanciale nëse:

- prekin ato elementë të kontratës që nuk ndryshojnë natyrën e përgjithshme të saj; ose
- janë parashikuar në dokumentet e prokurimit origjinal, në formë të qartë, precize dhe pa ekuivoke në klauzola; këto klauzola duhet të specifikojnë natyrën dhe qëllimin e modifikimeve potenciale si dhe kushtet në të cilat këto ndryshime mund të bëhen.

Modifikimet substanciale të kontratave që zbatohen pavarësisht kufizimeve të sipër përmendura përbëjnë parregullësi të rëndë për procesin e prokurimit publik. Modifikimet substanciale në kontratë, në kundërshtim me rregullat përkatëse, mund të korrigjohen vetëm duke e shpallur të paefektshme modifikimin e kontratës.

g) Dhënia e shërbimeve apo punimeve shtesë pa zbatimin e procedurave transparente dhe konkurruese

Legjislacioni i BE dhe ligjet kombëtare që zbatojnë legjislacionin e komunitetit europian lejojnë në kushtet të caktuara lidhjen e kontratës pa njoftim paraprak të thirrjes për tender. Një rast i tillë është dhënia e punimeve dhe shërbimeve shtesë ndaj operatorit ekonomik që ishte pjesë e kontratës origjinale dhe për punime apo shërbime të reja që përbëjnë një përsëritje të shërbimeve apo punimeve të përfshira në prokurimin origjinal. Si një përjashtim nga parimet e transparencës dhe konkurrencës, ky opsion mund të përdoret vetëm nën disa kushte strikte dhe të mirëpërcaktuara (për shembull, në lidhje me vlerën e punimeve apo shërbimeve shtesë ose me periudhën gjatë të cilës mund të ketë avantazhe për kryerjen e tyre). Shkelje e rregullave të prokurimit ndodh kur autoriteti kontraktor kryen një prokurim për shërbime apo punime pa plotësimin e këtyre kushteve. Lidhja e kontratave në lidhje me punimet apo shërbimet shtesë në kundërshtim me dispozitat ligjore përbën një prokurim të paligjshëm. Një kontratë e tillë duhet të deklarohet e paefektshme, sic është shtjelluar në pikat 1a) dhe 1b).

Përktheu: Redi Ametllari



Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit

Iniciativë e përbashkët e Bashkimit European dhe Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), financuar kryesisht nga BE

III. 5 UDHËZUES NR. 31

Korrik 2015

DIREKTIVA 2014/23 E BE-SË: KONTRATAT KONCESIONARE

Përmbajtja

- Hyrje
- Struktura dhe përmbajtja e Direktivës së Koncesioneve
- Objekti, fushëveprimi dhe përkufizimet
- Përjashtimet
- Njoftimet e koncesioneve
- Performanca e koncesioneve

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit SIGMA

Ky udhëzim është botuar nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të OECD-së. Opinionet e shprehura dhe argumentet e paraqitura jo domosdoshmërisht reflektojnë qëndrimet zyrtare të Bashkimit Europian ose të shteteve anëtare të OECD-së ose të përfituesve pjesëmarrës në programin SIGMA.

Ky dokument dhe çdo hartë e përfshirë në të nuk paragjykon statusin, sovranitetin mbi çdo territor, kufijtë dhe emrin e territorit, qytetit apo zonës.

Hyrje

Miratimi i një Direktive për Koncesionet: Më 28 mars 2014, pas një periudhe tre vjeçare me negociata intensive, direktiva e re 2014/23/EU mbi kontratat koncesionare (Direktiva e Koncesioneve)¹ u botua në Gazetën Zyrtare të Bashkimi Europian (OJEU) si pjesë e një “paketë legislative” për reformimin e rregullave të prokurimit publik në Bashkimin Europian. Në të njëjtën ditë, u botuan edhe direktivat 2014/24/EU (Direktiva e Sektorit Publik) dhe 2014/25/BE (Direktiva e Shërbimeve Publike)², në lidhje me prokurimin nga autoritetet kontraktore të sektorit publik e entiteteve të shërbimeve publike dhe që zëvendësuan direktivat e BE-së së vitit 2004³ mbi prokurimin publik.

Aktet e Direktivës së Koncesioneve dhe dy direktivat e tjera mund të shkarkohen në linkun e mëposhtëm:

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=OJ:L:2014:094:TOC>

Afati i zbatimit: Për shtetet anëtare të BE-së, afati për inkorporimin në legjislacionin e brendshëm të direktivës së koncesioneve është data 18 prill 2016. Në parim, dispozitat e Direktivës së Koncesioneve nuk janë të detyrueshme para datës së inkorporimit (ose para datës në të cilën duhet të inkorporoheshin, pra 18 prill 2016). Para kësaj date, lidhja e kontratave koncesionare i nënshtrohet parimeve të përgjithshme të vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit

¹ Direktiva 2014/23/EU e Parlamentit Europian dhe të Këshillit e 26 shkurtit 2014 mbi kontratat koncesionare (OJEU L 94, 28/03/2014, fq. 1).

² Direktiva 2014/24/EU e Parlamentit Europian dhe Këshillit të 26 shkurtit 2014 mbi prokurimin publik dhe direktiva e shfuqizuar 2004/18/EC (OJEU L 94, 28/03/2014, faqe. 65); Direktiva 2014/25/EU e Parlamentit Europian dhe Këshillit të 26 shkurtit 2014 mbi prokurimin nga entitetet që operojnë me kontrata sektoriale, në fushën e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe direktiva e shfuqizuar 2004/17/EC (OJEU, L 94, 28/03/2014, fq. 243).

³ Direktiva 2004/18/EC mbi koordinimin e procedurave të dhënies së kontratave për punë publike, kontratave furnizuese dhe kontratave të shërbimeve publike (31 mars 2004); Direktiva 2004/17/EC mbi koordinimin e procedurave të prokurimit të entiteteve që operojnë në sektorët e ujësjellësve, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare (31 mars 2014)

European (CJEU) dhe dhënia e koncesioneve për punët publike realizohet në bazë të Direktivës 2004/18/EC (2004 Direktivës së Sektorit Publik).

Ky udhëzues mbi prokurimin ofron një panoramë rreth kornizës së re ligjore mbi kontratat koncesionare. Nuk synon të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse mbi të gjitha dispozitat e Direktivës së Koncesioneve. Një udhëzues tjetër (Nr.30) fokusohet mbi Direktivën 2014 të Sektorit Publik dhe Direktivën 2014 të Shërbimeve Publike.

Arsyet e miratimit të një direktive për lidhjen e kontratave koncesionare: Prokurimi Publik një instrument i bazuar në tregun e lirë që vjen në kuadër të Strategjisë EU 2020⁴ të Europës për një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, me synimin për të :

- krijuar kushte të reja për t'i mundësuar biznesit që të ripërtërihet ekonomikisht
- inkurajuar përdorimin e gjerë të prokurimit “jeshil” (në mbrojtje të mjedisit)
- siguruar një përdorim sa më eficient të fondeve publike
- zgjeruar tregun e përbashkët të BE-së

Në këtë kontekst, kontratat koncesionare konsiderohen si instrumente të rëndësishme në zhvillimin afatgjatë të infrastrukturës dhe shërbimeve strategjike, në forcimin e konkurrencës në tregun e brendshëm, duke mundësuar kështu që qytetari të përfitojë nga ekspertiza e sektorit privat dhe duke e ndihmuar këtë të fundit të arrijë eficientë dhe të zhvillohet. Mungesa e rregullave të qarta në nivelin e BE-së mbi kontratat koncesionare krijonte pengesa dhe pasiguri ligjore për ofrimin e lirë të shërbimeve, duke shkaktuar çrregullime në funksionimin e tregut të brendshëm. Për këtë arsye, Komisioni European synoi të krijonte një kornizë ligjore të përshtatshme, fleksibël dhe të balancuar, për dhënien e kontratave koncesionare, për t'u siguruar operatorëve ekonomikë, në veçanti bizneseve të vogla dhe të mesme, një akses më të thjeshtë thjeshtë dhe jodiskriminues në tregjet europiane të koncesioneve.

⁴ Shih Komisionin European (3 mars 2010)“ Komunikatë nga Komisioni-Europë 2020- një strategji për një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Ndonëse dhënia e koncesioneve për punë publike i nënshtrohet ende rregullave bazë të Direktivës 2004/18/EC (Direktiva e Sektorit Publik, 2014), dhënia e koncesioneve për shërbimet i nënshtrohej “vetëm” parimeve të Traktatit mbi Funksionimin e BE-së. Risqet e përfshira në këtë kuadër rregullator të koncesioneve interpretoheshin ndryshe nga legjislacioni kombëtar, siç konfirmohet edhe nga jurisprudenca e gjatë e Gjykatës Europiane në disa nga aspektet e lidhjes së kontratave koncesionare.

Direktiva e Koncesioneve synon të forcojë sigurinë ligjore duke krijuar një bazë solide rregullatore për një zbatim uniform të parimeve të Traktatit nga shtetet anëtare. Qëllimi i legjislatorit të BE-së ishte që të miratonte rregulla të qarta dhe të thjeshta për dhënien e kontratave mbi një kufi të caktuar monetar, që njëkohësisht do të reflektonte veçantinë e koncesioneve krahasuar me kontratat e tjera publike.

Rregullat kanë si synim të ofrojnë një nivel dysHEME koordinimi të procedurave kombëtare në lidhjen e kontratave koncesionare. Po aq e rëndësishme ishte se këto rregulla do të siguronin një mbrojtje të përshtatshme ligjore të kandidatëve ose operatorëve ekonomikë në procedurat koncesionare, duke i projektuar nën juridiksionin e mjeteve juridike të direktivave 89/665/EEC dhe 92/13/EEC.

Direktiva e Koncesioneve thekson lirinë e shteteve anëtare për të strukturuar ofrimin e punëve apo shërbimeve sipas nevojave të tyre, ose duke përdorur burimet e tyre, ose duke bashkë-operuar me autoritete të tjerë, ose duke ia transferuar këto detyra palëve të treta. Kësisoj, direktiva nuk përfshin liberalizimin e atyre shërbimeve me interes të madh ekonomik, që u rezervohen vetëm entiteteve publike dhe private, apo privatizimin e entiteteve publike që ofrojnë këto shërbime.

Duhet të theksohet se Direktiva e Koncesioneve nuk merret me kërkesën që Partneriteti Publik Privat të marrë formën ligjore të një kontrate publike, siç parashikohet nga Direktiva e Sektorit Publik ose të një koncesioni, që mund të jetë subjekt i Direktivës së Koncesioneve.

Struktura dhe përmbajtja e Direktivës së Koncesioneve.

Direktiva e Koncesioneve është e strukturuar sipas rendit të mëposhtëm:

- Dispozitat e përgjithshme

- Lista e përmbajtjes
- Krerë që përmbajnë nene, të ndara në kapituj që nëndahen në seksione
- Anekset

Dispozitat e përgjithshme nuk janë dispozita vepruese të direktivës. Ato ofrojnë kontekstin dhe shpjegime për dispozitat vepruese, të cilat janë parashikuar në nene. Dispozitat e përgjithshme ofrojnë një burim të dobishëm informacioni për të interpretuar nenet.

Anekset përmbajtën informacion dhe kërkesa shtesë e përplotësuese rreth atyre që parashikojnë nenet, të tilla si aktivitetet e ushtruara nga entitetet kontraktues dhe përmbajtjen e njoftimit të koncesionit.

Dispozitat detyruese dhe fakultative në Direktivën e Koncesioneve: Shumica e neneve janë detyruese, e si rrjedhim shtetet anëtare janë të detyruara t'i zbatojnë ato. Ky është veçanërisht rasti që ka të bëjë me përkufizimet dhe fushëveprimin e direktivës. Disa nene janë fakultative, që do të thotë se një shtet anëtar ka diskrecionin të zgjedhë mbi zbatueshmërinë e tij ose mbi mënyrën sesi do ta zbatojë. Kjo zgjedhje aplikohet, për shembull, ndaj rregullave të procedurave për dhënien e një koncesioni⁵ ose rregullave në lidhje me komunikimin⁶.

Për më shumë informacion, kërkonit në linkun:

http://ec.europa.eu/internal_market/publicprocurement/modernising_rules/reform_prop_osals/index_en.htm

Përmbajtja e Direktivës së Koncesioneve

Neni 1- Objekti, fushëveprimi, përkufizimet dhe kufiri monetar

Direktiva e Koncesioneve rregullon dhënien e koncesioneve për punë publike dhe të shërbimeve nga (i) autoritetet kontraktore ose (ii) entitetet kontraktore, me kushtin që këto punime apo shërbime t'i referohen aktiviteteve të parashikuara në Aneksin II të direktivës (për shembull, aktiviteteve në sektorë të veçantë, si të energjisë,

⁵ Shih nenin 30

⁶ Shih nenin 29

shërbimeve të transportit, shfrytëzimin e zonave gjeografike dhe shërbimeve postare⁷).

Nocioni i “autoriteteve kontraktore” i korrespondon kuptimit të përdorur në direktivat për sektorin publik (2004/18/EC dhe (2014/24/EU), dhe si rrjedhim zbatohet po ashtu për lidhjen e kontratave koncesionare nga organet publike.

Direktiva e Koncesioneve rregullon dhënien e koncesioneve nga “entitetet kontraktore” që ndjekin një aktivitet ekonomik, në referim të Aneksit II të direktivës. Këto entitete kontraktore mund të jenë autoritete shtetërore, ndërmarrjeve publike ose në mënyrë të veçantë, shoqëri private që operojnë mbi bazën e një ekskluziviteti ose të drejtave të veçanta. Të tilla “ekskluzivitete” apo “të drejta të veçanta” janë ato që jepen nga një autoritet i kompetent së një shteti anëtar nëpërmjet një ligji, rregulloreje ose një akti administrativ që është në përputhje me Traktatin për Funkcionimin e BE-së. Këto të drejta e kufizojnë ushtrimin e një aktiviteti nga dy ose më shumë operatorë ekonomikë, e për pasojë ndikojnë në aftësinë e operatorëve të tjerë ekonomikë për të kryer aktivitetin në fjalë⁸. Entitetet kontraktore që kryejnë një nga aktivitetet e përmendura në Aneksin II nuk mbulohen nga Direktiva e Koncesioneve, nëse të drejta të tilla janë dhënë, në përputhje me Traktatin, nëpërmjet një procedurë bazuar në një kriter objektiv dhe që janë publikuar në formën e duhur.

Aktivitetet e listuara në Aneksin II përfshijnë aktivitete në lidhje me:

- operimin e rrjeteve fikse që synojnë të ofrojnë një shërbim publik në lidhje me prodhimin, transportimin ose shpërndarjen e elektricitetin, gazit dhe me furnizimin me energji, gaz të këtyre rrjeteve fikse ;
- operimin e rrjeteve fikse që ofrojnë një shërbim publik në transportin hekurudhor, sisteme të automatizuara, tramvaje, autobusë ose teleferikë;
- shfrytëzimin e zonave gjeografike për ndërtimin e aeroporteve, porteve, ose terminale për transportuesit ajror dhe ujor;
- ofrimin e shërbimeve postare;

⁷ *Shih Nenin 1*

⁸ *Shih nenin 5, paragrafët 10 dhe 11*

- shfrytëzimin e një zone gjeografike për nxjerrjen e naftës ose gazit apo për shfrytëzimin e burimeve minerare ose të lëndëve të ngurta djegëse.

Direktiva e Koncesioneve përmban një numër përkufizimesh, përfshirë përkufizimet e koncepteve “koncesioni për punë publike” dhe “koncesioni për shërbime publike”⁹. Këto koncesione përcaktohen si kontrata me interes financiar, ku një ose më shumë autoritete ose entitete kontraktore ia besojnë kryerjen e punimeve/shërbimeve një ose më shumë operatorëve ekonomikë, shpërblimi i të cilëve përbëhet vetëm nga e drejta për të shfrytëzuar punimet objekt të kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën.

Direktiva qartëson se koncepti i koncesionit kërkon transferimin e një risku operacional tek koncesionari në shfrytëzimin e punimeve ose shërbimeve, përfshirë riskun e kërkesës ose ofertës, ose të dyjave bashkë.

Koncesionari konsiderohet se e ka marrë riskun operacional kur, nën kushtet e operimit normal, nuk i garantohet se do t'i rikthehet investimi i bërë ose do t'i mbulohen kostot e kryerjes së punimeve ose ofrimit të shërbimeve që janë objekt i kontratës koncesionare. Direktiva nuk e përkufizon atë se çka do të kuptohet me “kushte normale të operimit”. Megjithatë, pjesa e riskut që i transferohet koncesionarit duhet të rezultojë në atë që koncesionari duhet të jetë i ekspozuar ndaj rreziqeve të tregut. Risqet e lidhura me menaxhimin e keq, mospërmbushjen e detyrimeve kontraktore nga koncesionari ose me faktorë si forcat madhore, nuk janë vendimtare për qëllimin e klasifikimit të punimeve/shërbimeve si një koncesion, meqenëse këto risqe janë pjesë e çdo kontrate.

Si pasojë, aty ku një kuadër rregullator për një sektor specifik eliminon riskun duke ofruar një garanci për koncesionarin, madje edhe në prishjen e kushteve të investimeve dhe mosmbulimin e kostove për operimin e koncesionit, kontrata nuk mund të cilësohet si koncesion. Po ashtu, një kontratë ku kontraktori shpërblehet mbi bazën e tarifave të rregullta që përlllogariten në një mënyrë të tillë që mbulojnë të gjitha kostot dhe investimet e kontraktorit në ofrimin e shërbimeve, nuk kualifikohet si koncesion por si një kontratë publike.

Gjithashtu, Direktiva e Koncesioneve sqaron se disa marrëveshje, për shembull kur të gjithë operatorët ekonomikë plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe kanë të drejtë

⁹ Shih Nenin 5, paragrafin 1

të kryejnë një detyrë të caktuar pa selektivitet (si sistem i përzgjedhjes së klientit¹⁰), nuk mund të kualifikohen si koncesione. Për të shtuar, ushtrimi i një aktiviteti ekonomik, ku një shtet anëtar ose një nga autoritetet publike të saj vendos kushte si autorizime apo licenca, kur ushtrimi i aktivitetit garantohet me kërkesë të operatorit ekonomik dhe jo me iniciativën e autoritetit kontraktor dhe kur operatori ekonomik është i lirë të tërhiqet nga punimet apo shërbimet, nuk konsiderohet një koncesion¹¹.

E njëjta gjë vlen edhe për marrëveshjet që kanë si objekt të drejtën e një operatori ekonomik për të shfrytëzuar pronën apo burimet publike në bazë të së drejtës publike apo private, si truall apo çdo pronë publike, dhe ku shteti apo autoriteti kontraktor vendos kushte të përgjithshme për përdorimin e tyre, pa prokuruar shërbime apo punime specifike¹².

Këto rregulla zbatohen, për shembull, ndaj një prone publike apo kontrate qiraje, e cila përgjithësisht përfshin kushte lidhur me posedimin nga qiramarrësi, mënyrën e përdorimit të pronës, të drejtat dhe detyrime respektive mes qiradhënësit dhe qiramarrësit, afatin kohor të qirasë dhe dorëzimin e pronës tek pronari, qiranë dhe detyrimet që duhet t'i paguhen pronarit.

Direktiva e Koncesioneve zbatohet vetëm ndaj punëve dhe shërbimeve publike që kanë një vlerë të barabartë ose më të lartë se 5,186,000 Euro¹³. Vlera e një koncesioni përlllogaritet mbi bazën e xhiros totale neto që koncesionari gjeneron përgjatë afatit të kontratës, që vlerësohet nga autoriteti apo entiteti kontraktor, në shqyrtim të punimeve dhe shërbimeve që janë objekt i kontratës si dhe të furnizimeve që kërkohen për kryerjen e punëve dhe shërbimeve. Vlera relevante është vlera e momentit të njoftimit të koncesionin e për pasojë autoriteti

¹⁰ Shembuj të tjere mund të jenë aktivitete ekonomike që janë të hapura ndaj çdo personi që ka interes, me kushtin që ky person të plotësojë disa kritere të caktuara që rregullojnë ushtrimin e këtyre aktiviteteve, si inxhinierët e ndërtimit e avokatët (në varësi të ligjit kombëtar).

¹¹ Ky rregull zbatohet tek shërbimet që, në përputhje me ligjin kombëtar, mund të kryhen pas marrjes së një licensë nga autoriteti shtetëror por që i licensuari është i lirë për të vendosur nëse do ta mbajë licensën për aq kohë sa ushtron aktivitetin ose të tërhiqet nga biznesi, për shembull taksisti ose farmacisti.

¹² Për shembull, zhvilluesit e tokës

¹³ Shih nenin 8 për më shumë detaje rreth metodës së përlllogaritjes

kontraktor është i detyruar të kryejë një vlerësim paraprak të vlerës së kontratës koncesionare.

Megjithatë, nëse vlera e koncesionit në kohën e lidhjes së kontratës është më shumë se 20 % e vlerësimit fillestar, merret në konsideratë vlera në kohën e dhënies së koncesionit. Ky parashikim e bën më të vështirë që “t’ia hedhesh” rregullimit ligjor. Por, kjo dispozitë duket se zbatohet vetëm në rastet kur vlera e kontratës së koncesioneve në kohën e dhënies së koncesionit jo vetëm që kalon vlerën fillestare me më shumë se 20%, porse edhe kur kapërcen kufirin monetar prej 5,186,000 euro. Përveçse kur njoftimi i dhënies së koncesionit është publikuar në përputhje me kushtet e Direktivës së Koncesioneve, ajo duhet të anulohet dhe publikohet sërish, kësaj herë konform Direktivës së Koncesioneve. Siç është rasti i kontratave publike, përlllogaritja e vlerës së kontratës së koncesionit nuk duhet të bëhet me qëllim për të shmangur kuadrin rregullator.

Nëse vlera e koncesionit nuk arrin këtë prag, dhënia apo lidhja e kontratës i nënshtrohet parimeve të Traktatit, pra të lëvizjes së lirë të mallrave, lirisë së aktivitetit tregtar dhe lirisë për të ofruar shërbime, si dhe parimeve të tilla si trajtim i barabartë, mosdiskriminimi, njohje reciproke, proporcionaliteti dhe transparencja.

Përfshirjet

Direktiva e Koncesioneve përmban një numër të lartë përfshirjesh të fushëveprimit të saj, shumica prej tyre i korrespondojnë përfshirjeve të përfshira në dy direktiva të tjera të 2014. Nuk zbatohet, ndër të tjera, për koncesionet e dhëna:

- mbi bazën e të drejtës ekskluzive, në përputhje me Traktatin;
- për shërbimet e transportit ajror, bazuar në lëshimin e një licence operimi;
- nga një organizatë ndërkombëtare ose institucion ndërkombëtar financimi dhe që financohet plotësisht nga organizata/institucioni;
- në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë¹⁴ ;

¹⁴ Shih nenin 10, paragrafët 4 -7, për më shumë detaje mbi përfshirjet në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, referuar Direktivës së Mbrojtjes 2009/81/EC.

- për shërbime të lidhura me një numër aktivitete që janë gjithashtu të përjashtuara nga fushëveprimi i Direktivës 2014 për Sektorin Publik, si blerja apo dhënia me qera e pronës, ndërtesave ekzistuese ose pronave të tjera të paluajtshme; blerja, zhvillimi, prodhimi ose bashkëprodhimi i një programi për shërbime audio-vizuale ose radiofonike; shërbimet e arbitrazhit dhe pajtimit; shërbimet të veçanta financiare dhe ligjore; kreditë, shërbimet e mbrojtjes civile dhe mbrojtjes nga rreziku që ofrohen nëpërmjet organizatave jofitimprurëse; fushatat politike¹⁵;
- në lidhje me shërbimet e lotarisë dhënë një operatori ekonomik nga një shtet anëtar, bazuar në të drejtën ekskluzive;

Përpos rasteve të sipër përmendura, Direktiva e Koncesioneve parashikon përjashtime bazuar në sektorë të veçantë, si në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të ujësjellësve. Përjashtimi i fundit iu nënshtrua diskutimeve intensive përgjatë procedurës legjislative të shteteve anëtare të BE-së. Direktiva e bën të qartë se koncesionet e dhëna me qëllim ofrimin nga rrjetet fikse të një shërbimi publik në lidhje me prodhimin, transportimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm, dhe për furnizimin e këtij rrjeti, nuk përfshihen në fushëveprimin e Direktivës së Koncesioneve. Në disa rrethana, koncesionet për trajtimin e ujërave të zeza, për projekte inxhinierike hidraulike, për ujitjen dhe kullimin e tokave janë të përjashtuara nga Direktiva e Koncesioneve¹⁶.

Një tjetër përjashtim i rëndësishëm lidhet me koncesionet e dhëna nga një entitet kontraktor tek një bashkim operatorësh, ku 80% e xhiros mesatare vjetor gjatë tre viteve të fundit ka ardhur nga shërbimet apo punimet e ofruara nga njëra prej kompanive të bashkimit¹⁷.

Koncesionet mes entiteteve brenda sektorit publik janë gjithashtu të përjashtuara. Ky përjashtim shtrihet si në prokurimin brenda entit(in-house procurement: me burime të brendshme, ku tenderi i jepet një personi juridik shtetëror e jo një pale të tretë) ashtu edhe në bashkëpunimin “publik-publik” mes enteve të ndryshme. Që prokurimi i brendshëm të përjashtohet, autoriteti kontraktor duhet të ushtrojë një

¹⁵ Shih listën në nenin 10, paragrafin 8, për më shumë detaje rreth këtyre përjashtimeve.

¹⁶ Shih nenin 12 për më shumë detaje mbi përjashtimet specifike të sektorit të ujit.

¹⁷ Shih nenin 13 për më shumë detaje rreth këtij përjashtimi.

kontroll mbi personin juridik që ka marrë koncesionin, një kontroll ky i ngjashëm me atë që autoriteti ushtron mbi departamentet e veta. Për të shtuar, më shumë se 80% e aktiviteteve të personit juridik të kontrolluar duhet të jenë dhënë nga entiteti kontraktor. Gjithashtu, personi juridik nuk duhet të ketë asnjë kapital privat në personin juridik të kontrolluar, me përjashtim të kapitaleve private jo kontrolluese, siç kërkohet nga legjislacioni kombëtar në përputhje me Traktatin për Funkcionimin e BE-së¹⁸.

Për të konkluduar, në përputhje me jurisprudencën e fundit të CJEU¹⁹, kontratat koncesionare për ofrimin e përbashkët të shërbimeve publike janë jashtë fushëveprimit të Direktivës së Koncesioneve, me kushtin që (i) janë lidhur ekskluzivisht mes autoriteteve apo entiteteve kontraktore; (ii) zbatimi i këtij bashkëpunimi udhëhiqet nga interesi publik; dhe (iii) asnjë ofrues privat i shërbimit s'është në një pozicion favorizues ndaj konkurrentëve të tij²⁰.

Kontratat e Përziera

Direktiva e Koncesioneve përcakton rregulla specifike mbi mënyrën e trajtimit të kontratave të përziera²¹, bazuar në vendimin e CJEU dhe rregullat e zbatueshme për kontratat e përziera, siç janë përcaktuar në Direktivën 2014 të Sektorit Publik dhe Direktivën 2015 për Shërbime Publike. Në rastin e kontratave të përziera që mund të ndahen, autoritetet dhe entitetet kontraktore janë të lira për të dhënë koncesione të ndara për pjesët përkatëse të kontratës së përzier. Megjithatë, nëse pjesët që përbëjnë kontratën janë objektivisht²² të pandashme, rregullat e zbatueshme duhet të përcaktohen në lidhje me objektin e kontratës. Si rrjedhim,

¹⁸ Shih nenin 17 për më shumë detaje mbi këtë përjashtim.

¹⁹ Vendimi C-480/06 *Stadtreinigung Hamburg*.

²⁰ Shih nenin 17 dhe dispozitat e përgjithshme 45-47.

²¹ Janë kontrata që përmbajnë më shumë se një element, për shembull kontrata që lidhet për punë dhe shërbime publike ose furnizime dhe shërbime, ose kontrata që lidhen pjesërisht me aktivitetet e mbuluara nga direktiva dhe pjesërisht me aktivitete që nuk mbulohen nga direktiva.

²² Sipas jurisprudencës së CFEU-së, përcaktimi nëse një kontratë është e pandashme apo jo shqyrtohet rast pas rasti, duke marrë parasysh qëllimet e shprehura apo të prezumuara të autoritetit kontraktor mbi aspektet e ndryshme që e bëjnë të pandashme një kontratë të përzier, mbështetur kjo në evidenca objektive që justifikojnë këto qëllime dhe që e bëjnë të nevojshme lidhjen e një kontrate të vetme.

një koncesion që ka për objekt si punë publike ashtu edhe shërbime duhet të jepet në përputhje me dispozitat e zbatueshme për punët publike, nëse këto të fundit përbëjnë thelbin e kontratës dhe anasjelltas.

Ndryshimi mes koncesioneve të punëve publike dhe atyre të shërbimeve publike ka rëndësi ligjore, pasi për secilën përdoret një regjim ligjor i ndryshëm.

Për shembull, të tjera përjashtime janë parashikuar për koncesionet e shërbimeve ndërsa për koncesionet e punëve publike parashikohen rregulla të ndryshme për nënkontratat.

Në rastin e një kontrate që përfshin të dy elementët, koncesion shërbimi dhe koncesion furnizimi, objekti kryesor i kontratës duhet të përcaktohet në përputhje me vlerën e llogaritur për secilin element, ku koncesioni me vlerën më të lartë do të përbëjë objektin kryesor të kontratës²³.

Një kontratë që synon të mbulojë disa aktivitete, të përcaktuara në Aneksin II të Direktivës së Koncesioneve (lidhur me aktivitetet e shërbimeve) i nënshtrohet rregullave të zbatueshme të aktivitetit që ka për qëllim kryesor. Direktiva përmban dispozita të detajuara rreth grupit të rregullave të zbatueshme për kontratat e përziera, në rastet kur është objektivisht e pamundur për të përcaktuar se cilin aktivitet ka për qëllim kryesor kontrata²⁴.

Direktiva përmban gjithashtu rregulla specifike në lidhje me kontratat e përziera që kanë aspekte të fushës së mbrojtjes dhe sigurisë. Sërish, karakteristikat e kontratës në fjalë janë vendimtare për përcaktimin e regjimit ligjor të zbatueshëm për dhënien e një koncesioni të tillë²⁵.

Kohëzgjatja e koncesionit

Direktiva e Koncesioneve përcakton se kohëzgjatja e koncesioneve duhet të jetë e kufizuar, megjithatë nuk parashikon një kohëzgjatje maksimale. Qartëson se periodha e kontratës nuk duhet të jetë padrejtësisht e gjatë, me synimin për të parandaluar mbylljen e tregut dhe kufizimin e konkurrencës. Koncesionet afatgjata

²³ Shih nenin 20 për më shumë detaje rreth kontratave të përziera.

²⁴ Shih nenin 22, paragrafin 3.

²⁵ Shih nenet 21 dhe 23 për më shumë detaje mbi prokurimin e kontratave të përziera që përfshijnë aspekte të fushës së mbrojtjes dhe sigurisë.

me shumë gjasë rezultojnë në mbylljen e tregut dhe si pasojë mund të kufizojnë lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe bizneseve²⁶.

Për rrjedhim, për koncesionet që zgjasin më shumë se 5 vjet, kohëzgjatja maksimale e koncesionit nuk duhet të kalojë kohën e parashikuar që i nevojitetit koncesionarit për të rimarrë investimet e bëra në kryerjen e punëve apo ofrimin e shërbimeve së bashku me një rikthim të kapitalit të investuar, duke marrë parasysh investimin e plotë, kapacitetin e aktivitetit për të gjeneruar të ardhura, tarifatat e përdorimit dhe kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes së aktiveve.

Operatorët ekonomikë, komunikimi, konfidencialiteti dhe terminologjia

Nocioni i një operatori ekonomik duhet të interpretohet sa më gjerë në mënyrë që të përfshijë çdo person dhe/ose entitet që ofron kryerjen e punëve, furnizimin me mallra ose ofrimin e shërbimeve, pavarësisht formës ligjore me të cilën kanë zgjedhur të operojnë.

Gjithashtu, direktiva qartëson se grupet me operatorë ekonomikë mund të marrin pjesë në procedurat e dhënies së koncesionit²⁷.

Me përjashtim të rastit kur përdorimi i mjeteve elektronike është i detyrueshëm (njoftimet e dhënies së koncesioneve dhe disponueshmëria elektronike e dokumenteve të koncesionit²⁸), shtetet anëtare ose autoritete kontraktore janë të lira të zgjedhin një ose më shumë mjete komunikimi për shkëmbimin e informacionit si: mjete elektronike, post ose faks dhe komunikim oral. Megjithatë, shtetet anëtare mund ta bëjnë të detyrueshme për koncesionet përdorimin e mjeteve të komunikimit elektronik²⁹.

Direktiva e Koncesioneve përmban dispozita të veçanta konfidencialiteti. Përveçse kur është parashikuar ndryshe në Direktivën e Koncesioneve ose në ligjin kombëtar (për shembull, legjislacionit mbi aksesin në informacion), autoriteteve ose enteve kontraktore u ndalohet të japin informacione që operatorët ekonomikë e kanë

²⁶ Shih nenin 18 dhe dispozitën e përgjithshme 52.

²⁷ Shih nenin 26.

²⁸ Shih nenet 33 (2) dhe 34.

²⁹ Shih nenin 29.

cilësuar si konfidencial, përfshirë, por pa u kufizuar, sekretet tregtare ose teknike dhe aspektet konfidenciale të tenderit³⁰.

Direktiva e Koncesioneve përcakton se Fjalori i Përgjithshëm i Prokurimit CPV përbën terminologjinë ku duhet të referohet gjatë dhënies së koncesioneve³¹.

Kreu II – Parimet e përgjithshme dhe garancitë procedurale të zbatueshme në dhënien e koncesioneve

Ndryshe nga Direktiva 2014 e Sektorit Publik, Direktiva e Koncesioneve nuk përcakton procedura specifike që duhet të ndiqen gjatë dhënies së një koncesioni. Sigurisht, shtetet anëtare nuk pengohen që të zbatojnë ato procedura të parashikuara në Direktivën e Sektorit Publik. Nga këndvështrimi i prokurimit publik, duket se ka kuptim harmonizimi i procedurave për dhënien e koncesioneve me ato të lidhjes së kontratave publike.

Direktiva e Koncesioneve krijon një kornizë bazë, që reflekton parimet e përgjithshme dhe garancitë procedurale të dala nga jurisprudenca e CJEU dhe që kanë si synim sigurimin e transparencës dhe trajtim të barabartë. Një koordinim minimal duhet të jetë i mjaftueshëm, nga pikëpamja e legjislatorit të BE-së, për të arritur objektivat e ndjekura nga Direktiva e Koncesioneve.

Çfarëdolloj mënyrë apo forme procedurale që mund të zgjedhin autoritetet apo entet kontraktore në dhënien e një koncesioni, ato janë të detyruara të respektojnë parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës përkundrejt operatorëve ekonomikë³².

Njoftimet e koncesioneve

Për të siguruar një transparencë themelore, Direktiva e Koncesioneve imponon mbi autoritetet kontraktore detyrimin për të publikuar qëllimin e tyre në dhënien e një koncesioni, nëpërmjet një “njoftimi koncesionar” botuar në OJEU. Çdo devijim nga ky detyrim i nënshtrohet kushteve strikte dhe në përputhje me jurisprudencën e CJEU-së, duhet të interpretohet në një mënyrë strikte. Si rrjedhim, dhënia e një koncesion pa një njoftim paraprak lejohet në rastet kur (i) është e qartë qysh prej fillimit se publikimi nuk do të nxisë konkurrencën, pasi vetëm një operator

³⁰ *Shin nenin 28.*

³¹ *Shih nenin 27.*

³² *Shih nenet 3 dhe 30.*

ekonomik është i aftë për të përmbushur detyrimin; (ii) qëllimi i koncesionit është krijimi ose përvetësimi i një punimi arti ose një performance artistike; (iii) konkurrenca mungon për shkak të arsyeve teknike ose për shkak të ekzistencës së një të drejte ekskluzive ose mbrojtjes së pronës intelektuale apo të drejtave të tjera ekskluzive; (iv) munguan tenderues të përshtatshëm gjatë një procedure të mëparshme koncesionare, me kushtin që kushtet fillestare të kontratës të mos jenë ndryshuar thelbësisht³³.

Direktiva e Koncesioneve thekson se njoftimet e koncesioneve duhet të përmbajnë informacione specifike përfshirë emrin, adresën, llojin e autoritetit/entit kontraktor, aktivitetin e ushtruar, një përshkrim të koncesionit, kriteret e pjesëmarrjes dhe afatin kohor për paraqitjen e aplikimeve ose pranimeve të operatorëve ekonomikë.

Direktiva i detyron autoritetet kontraktore të përdorin formatet standarte të Komisionit për njoftimin e koncesioneve, të cilat u përcillen elektronikisht Zyrës së Publikimeve të BE-së për botimin në gazetën e Bashkimit Europian (OJEU)³⁴

Përpos kësaj, autoritetet kontraktore janë të detyruara të ofrojnë, me mjete elektronike pa pagesë, akses të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në dokumentet e koncesionit³⁵.

Përzgjedhja e kandidatëve dhe kriteri i ofertës fituese

Direktiva e Koncesioneve imponon rregulla për përzgjedhjen dhe kualifikimin e kandidatëve³⁶. Këto rregulla korrespondojnë me kërkesat e përcaktuara për përzgjedhjen e kandidatëve në dhënien e kontratave të punëve dhe shërbimeve publike, në përputhje me Direktivën e Sektorit Publik, të cilat i detyrojnë autoritetet kontraktore të verifikojnë kapacitetin profesional dhe teknik si dhe gjendjen financiare dhe ekonomike të kandidatëve dhe ofertuesve mbi bazën e vetëdeklarimit dhe/ose referencës, të paraqitur si provë. Kriteret e pjesëmarrjes duhet të jenë jo-diskriminuese dhe proporcionale për objektin e koncesionit dhe ato duhet të përfshihen në njoftimin e koncesionit. Si në rastin e kontratave

³³ *Shih nenin 31 për më shumë detaje mbi njoftimet e koncesioneve dhe devijimeve.*

³⁴ *Shih nenin 33.*

³⁵ *Shih nenin 34 për më shumë detaje rreth disponueshmërisë elektronike të dokumenteve të koncesionit.*

³⁶ *Shih nenin 38 për më shumë detaje.*

publike, operatorëve ekonomikë duhet t'u jepet mundësia të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera gjatë procedurave të dhënies së koncesionit.

Autoritetet Kontraktore duhet të qartësojnë se nuk ka arsye për përjashtimin (të detyrueshëm apo fakultativ) e një operatori ekonomik nga procedura e dhënies së koncesionit.

Operatorët ekonomikë që kanë qenë të dënuar me vendim përfundimtar nga Gjykata për krime të tilla si, mashtrim, korrupsion dhe pjesëmarrje në organizatë kriminale, duhet të përjashtohen nga procedura. Megjithatë, një operator ekonomik duhet të lejohet të paraqesë prova për të treguar se masat që ka marrë janë të mjaftueshme për të demonstruar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për përjashtim. Në veçanti, këto masa duhet të konsistojnë në: (i) masa organizatave dhe masa në lidhje me personelin, si ndërprerja e çdo lloj lidhjeje me personat apo organizatat e përfshira në shkelje; (ii) riorganizim të personelit; zbatimin e sistemeve të kontrollit dhe raportimit. Lihet në diskrecionin e shteteve anëtare të përcaktojnë procedurën e duhur dhe kushtet thelbësore që do të zbatohen në raste të tilla. Kësisoj, ato janë të lira për të vendosur nëse do të lejojnë autoritetet kontraktore individuale në kryerjen e vlerësimit të operatorëve ekonomikë apo do t'ia besojnë autoriteteve të tjera në nivel qendror apo lokal³⁷.

Direktiva e Koncesioneve ofron afate minimale kohore për pritjen e aplikimeve për procedurën e dhënies së koncesionit. Afati kohor minimal për pritjen e aplikimeve është 30 ditë nga data e publikimit të njoftimit të koncesionit.

Në rastin kur procedura është organizuar në faza të njëpasnjëshme, afati minimal kohor për pritjen e tenderuesve fillestarë është 22 ditë nga dita në të cilën është dërguar ftesa për pjesëmarrje³⁸.

Dhënia e koncesionit duhet të realizohet mbi bazën e një kriteri fitues objektiv, i lidhur me objektin e koncesionit dhe që është në përputhje me parimet e përgjithshme të trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit. Kriteret fituese duhet të listohen në një rend zbritës, duke marrë për bazë rëndësinë dhe t'u bëhen paraprakisht të ditura operatorëve ekonomikë. Vetëm në rrethana përjashtuese është e lejueshme që autoriteti kontraktor të ndryshojë

³⁷ Shih nenin 38, paragrafin 9 dhe dispozitat e përgjithshme 70-71 për më shumë detaje rreth "vetë-pastrimit".

³⁸ Shih nenin 39.

rendin e klasifikimit të kriterëve fituese. Rrethana përjashtimore mund të jenë, për shembull, nevoja për të shqyrtuar një zgjidhje inovative që nuk mund të ishte parashikuar nga autoriteti kontraktor dhe kur pa një ndryshim të tillë, kriteret fituese do të ishin diskriminuese³⁹.

Direktiva e Koncesioneve i detyron autoritetet kontraktore të informojnë kandidatët dhe tenderuesit sa më shpejt të jetë e mundur mbi vendimet e marra në lidhje me procedurën, përfshirë emrin e fituesit, arsyet e refuzimit të operatorëve të tjerë dhe, nëse është e rëndësishme, arsyet për mosdhënien e një koncesioni.

Me kërkesë të palës/palëve të interesuara, autoriteti kontraktor duhet të informojë sa më shpejt, jo më vonë se 15 ditë nga marrja e kërkesës, çdo operator që ka paraqitur një ofertë të pranueshme me karakteristikat dhe avantazhet e tenderit të përzgjedhur⁴⁰.

Rregullat mbi performancën e koncesioneve- nënkontratat, ndryshimi i kontratave, përfundimi, monitorimi dhe raportimi

Direktiva e Koncesioneve përmban rregulla specifike mbi nënkontraktimin, të cilat janë të ngjashme me ato të parashikuara në Direktivën e Sektorit Publik. I lejon autoritetet kontraktore të kërkojnë nga operatori ekonomik se cilën pjesë të koncesionin synon të nënkontrakttojë dhe cilët janë nënkontraktorët e propozuar. Koncesionari duhet të japë informacion mbi nënkontraktorët (emrin, kontaktin, përfaqësuesin ligjor) dhe mbi çdo ndryshim të nënkontraktorëve që punojnë në një strukturë që ndodhen nën monitorimin e drejtpërdrejtë të autoritetit kontraktor.

Kjo kërkesë, e cila zbatohet për koncesionet e punëve dhe shërbimeve publike, duhet të përmbushet fill pas dhënies së kontratës dhe jo më vonë se nga fillimi i përmbushjes së kontratës. Autoritetet kontraktore kanë diskrecionin që t'i shtrijnë më tej këto kërkesa, për shembull deri tek hallka e fundit e zinxhirit të nënkontraktorëve⁴¹.

Ligjvënësi European njih nevojën për të ofruar mekanizma që lejojnë ndryshimin e kontratës së koncesionit gjatë ekzekutimit të saj, përderisa këto kontrata përfshijnë marrëveshje afatgjata, komplekse, teknike dhe financiare që zakonisht ndryshojnë

³⁹ Shih nenin 41 për më shumë detaje.

⁴⁰ Shih nenin 40.

⁴¹ Shih nenin 42 për më shumë detaje.

sipas rrethanave që lindin. Direktiva e Koncesioneve parashikon rrethanat e mëposhtme në të cilat lejohet ndryshimi i kontratës së koncesionit, pa ndërmarrë një procedure të re koncesionare⁴²:

- Modifikimet, pavarësisht vlerës së tyre monetare, janë parashikuar në dokumentet e koncesionit, me klauzola të qarta, precize dhe pa ekuivok, që mund të përfshije klauzola apo opsione për rishikimin e vlerës
- Janë bërë të nevojshme punë apo shërbime shtesë nga koncesionari fillestar, të cilat nuk ishin të përfshira në koncesionin fillestar, por një ndryshim i koncesionarit nuk mund të bëhet për shkak të (i) arsyeve ekonomike ose teknike (pandryshueshmërisë së pajisjeve apo shërbimeve ekzistuese); ose (ii) ndryshimi do të sillte shpenzime të panevojshëm ose dublim të kostove, me kushtin që çdo rritje në vlerë nuk duhet të tejkalojë 50% të vlerës fillestare të kontratës (kur bëhen ndryshime të njëpasnjëshme, ky kufizim zbatohet për vlerën e secilit ndryshim⁴³).
- Modifikimi i kërkuar (i) ka ardhur për shkak të rrethanave të jashtme të paparashikuara nga autoriteti kontraktor; (ii) nuk ndryshon natyrën e përgjithshme të koncesionit; dhe (iii) përfshin një rritje të vlerës që nuk kalon 50% të vlerës fillestare të koncesionit (kur bëhen ndryshime të njëpasnjëshme, ky kufizim zbatohet për vlerën e secilit ndryshim).
- Një koncesionar i ri po zëvendëson koncesionarin fillestar si pasojë e (i) një klauzole apo opsioni të qartë dhe pa ekuivok; ose (ii) vazhdimit të plotë ose të pjesshëm të pozicionit të koncesionarit fillestar; ose (iii) përmbushjes nga vetë autoriteti kontraktor të detyrimeve që ka koncesionari kundrejt nënkontraktorëve⁴⁴.
- Modifikimet nuk janë thelbësore.

⁴² Shih nenin 43 për më shumë detaje mbi ndryshimet e koncesioneve.

⁴³ Duhet të theksohet se në bazë të formulimit të direktivës, rritja në vlerë duhet të zbatohet për secilin modifikim në rastet e ndryshimeve të njëpasnjëshme, pavarësisht rritjes së vlerës totale të vetë koncesionit. Megjithatë, direktiva e bën të qartë se modifikime të tilla të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë si synim shmangien e Direktivës së Koncesioneve.

⁴⁴ Qëllimi i këtij përjashtimi është disi i paqartë. Mesa duket ky parashikim mund të justifikojë ndërhyrjen e kreditorit në një koncesionit të tipi PPP, nëse një ndërhyrje e tillë është e rregulluar nga masat rishtrukturoese të përmendura në dispozitë. (Një argument kundër një interpretimi të tillë është se kreditorët nuk plotësojnë kriteret e përzgjedhjes, e cila është një nga kushtet për të kryer një ndryshim të tillë)

- Vlera e modifikimit është më e ulët se dy vlerat vijuese: kufirit monetar për koncesionet (aktualisht 5, 186, 000 euro) dhe 10% të vlerës së koncesionit fillestar.

Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që autoritetet kontraktore të kenë mundësinë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në ligjin kombëtar, të anulimit të koncesionit gjatë kohëzgjatjes së tij, kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme⁴⁵:

- Është bërë një modifikim thelbësor i koncesionit, që do të kërkonte hapjen e një procedure të re koncesionare.
- Koncesionari duhej të ishte përjashtuar nga procedura e dhënies së koncesionit për shkak të ekzistencës së kushteve përjashtuese (për shembull, dënuar për një krim).
- CJEU ka zbuluar, në një shkelje proceduriale, se autoriteti kontraktor ka dhënë një koncesion në shkelje të detyrimeve që ka sipas Traktatit për Funkcionimin e BE-së dhe Direktivës së Koncesioneve.

Shtetet anëtare duhet të sigurohen që një ose më shumë autoritete të monitorojnë zbatimin e rregullave për dhënien e koncesionit. Kjo kërkesë e re për monitorimin, zbatimin dhe funksionimin e rregullave duhet të garantojë zbatimin eficient dhe uniform të ligjit të BE-së në shtetet anëtare.

Mbrojtja ligjore

Një nga ndryshimet më të rëndësishme në regjimin ligjor lidhur me koncesionet e shërbimeve është se Direktiva e Mjeteve Juridike 89/665/EEC mbi dhënien e kontratave publike dhe Direktiva 92/13/EEC mbi mjetet juridike të prokurimit mbi shërbimet janë të zbatueshme edhe në dhënien e koncesioneve⁴⁶. Ofertuesit e skualifikuar duhet të kenë mundësinë të ankohen ndaj vendimeve të marra gjatë procedurës së koncesioneve, e si rrjedhim gëzojnë garancitë minimale të përcaktuara në këto direktiva.

Përktheu: Redi Ametllari

⁴⁵ Ky parashikim duhet të kuptohet si një kërkesë minimale që nuk pengon një shtet anëtar ose një autoritet kontraktor të vendos arsye të tjera për anulimin e parakohshëm të kontratës; kjo i nënshtrohet ligjit kombëtar.

⁴⁶ Shih nenet 46-47

IV. Formaliteti kundrejt parimeve të 3E-ve në procedurat e prokurimit

Nga: Igor Šoltes¹

Abstrakt

Përveç aspekteve të efencës, efektivitetit dhe economicitetit, prokurimet publike karakterizohen gjithashtu edhe nga parime të tjera siç janë ato të barazisë dhe mosdiskriminimit. Duke qenë se prokurimet publike janë një tërësi parimesh të ndryshme, ato shpesh shoqërohen me konflikte apo diskutime të cilat bëjnë që të vështirësohet në mënyrë të konsiderueshme arritja e objektivave. Do të doja të theksoja rëndësinë e parimeve individuale për objektiva të veçanta dhe të bëja një ilustrim se si duhet operuar në rastet kur jemi përballë konflikteve mes këtyre parimeve dhe si duhet kërkuar zgjidhja kur lind nevoja për të peshuar secilin prej këtyre parimeve. Në rastin e korrupsionit në procedurat e prokurimit publik duhet treguar kujdes se cili parim do të jetë prioritar duke kushtuar më shumë vëmendje në trajtimin e çështjes në fjalë dhe nëse të qenit formal në procedura ndihmon në luftën kundër korrupsionit apo përkundrazi e intensifikon atë. Me kaq vite eksperiencë në studimin e rasteve, mund të them se praktikisht institucionet zgjedhin veçanërisht si parimin më të rëndësishëm atë të formalitetit.

¹ CV e z. Šoltes mund ta gjeni në faqe 283

Parimet bazë të Prokurimit Publik

Për shkak të shumëllojshmërisë së situatave gjatë jetës së përditshme, legjislacioni nuk mund të përfshijë norma për çdo çështje ligjore, kështu që njohja e parimeve bazë të prokurimit publik është me shumë rëndësi.

Është e nevojshme të kuptohen rregullat ligjore nëpërmjet disa parimeve, të cilat udhëheqin vendimmarrjen e Autoritetit Kontraktor si dhe Operatorin Ekonomik në njohjen e të drejtave të tij në një procedurë prokurimi. Në fushën e prokurimeve publike, përveç parimeve të veçanta, duhen marrë në konsideratë edhe parime të tjera, të cilat në ditët e sotme shërbejnë tashmë si një kriter bazë në shoqërinë tonë dhe mbulojnë gjithë sistemin ligjor.

Ngritja e një sistemi të prokurimit publik, zhvillimi dhe implementimi i tij duhet të bazohen në parimin e lëvizjes së lirë të të mirave materiale, parimin e pavarësisë së krijimit (të sipërmarrjeve) dhe parimin e pavarësisë së ofrimit të shërbimeve. Të gjitha këto rrjedhin nga Traktati i Komunitetit Evropian, nga parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit për të siguruar konkurrencë mes operatorëve ekonomikë, nga transparenca në procedurat e prokurimit publik, trajtimi i barabartë i tyre si dhe nga parimi i proporcionalitetit.

Parimet themelore janë specifikuar në Artikullin nr. 2 të Udhëzimit nr. 2004/18/EC, i cili përcakton:

- Parimin e trajtimit në menyrë të barabartë;
- Parimin e mosdiskriminimit;
- Parimin e transparencës;

Traktati mbi Ekonominë e Komunitetit Evropian paraqet kuadrin themelor për rregullimin e legjislacionit të prokurimit publik. Fillimisht ky akt synonte vendosjen e një tregu të brendshëm të përbashkët mes Vendeve Anëtare duke ndaluar çdo diskriminim kombësie dhe çdo kufizim në përzgjedhjen e mallrave dhe shërbimeve duke përfshirë këtu lëvizjen e lirë të mallrave, të cilat janë të zhveshura nga detyrimet doganore, si dhe heqjen e kuotave dhe masave të limituara duke pasur një efekt ekuivalent përgjatë detyrimeve doganore dhe kuotave mes Vendeve Anëtare. Objektivi i këtij Traktati do të arrihej akoma më mirë me heqjen e pengesave ndaj lëvizjes së lirë të forcës punëtore dhe shërbimeve, kapitalit, pagës si dhe me pavarësinë për të vendosur mbi themelimin e ndërmarrjeve në secilin prej Vendeve Anëtare. Në bazë të këtij Traktati, do të ishte një arritje, zhvillimi i politikave kryesore

të Komunitetit Evropian, sidomos i atyre në fushën e ligjit të konkurrencës, ndihmës shtetërore dhe në agrikulturë.

Traktati i EEC (European Economic Community) nuk i përmend shprehimisht prokurimet publike, përveç se në rastin kur përmendet financimi i kontratave publike me vendet e huaja dhe në lidhje me politikat industriale. Pavarësisht kësaj, në Traktatin e EEC mund të gjenden udhëzime për të ndërtuar një bazë të sigurtë ligjore mbi të cilat të mund të ngrihet i gjithë sistemi i prokurimit publik. Këto janë kryesisht dispozita, të cilat i referohen levizjes së lirë të të mirave (Artikulli 28), pavarësisht së themelimit (Artikulli 43) dhe pavarësisht në ofrimin e shërbimeve (Artikulli 49). Dispozita të tjera të rëndësishme janë edhe ato që lidhen me ndalimin e diskriminimit (Artikulli 12) dhe çështjen e sigurimit të sipërmarrjes (Artikujt 81, 86 dhe 87).

Regjimi i lëvizjes së lirë të të mirave dhe shërbimeve është elementi më i rëndësishëm në fushën e prokurimit publik. Traktati i EEC përmban objektivisht bazën ligjore të prokurimit publik, që do të thotë krijimin e procedurave të prokurimit mes vendeve anëtare dhe mundësimin e operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në kontratat publike përtej kufijve të vendit (mes Vendeve Anëtare). Duke qenë se do të ishte e pamundur për Vendet Anëtare për të vendosur rregulla gjithnjë e më tepër specifike për prokurimin publik, në bazë të traktatit të EEC, udhëzimet ligjore për këtë fushë janë përshtatur në një kategori dytësore. Të kuptosh parimet bazë dhe prej andej të krijosh një sistem ligjor është më se e rëndësishme. Kjo kuptohet akoma më mirë nga fakti se fillimisht implementimi i udhëzimeve nuk ishte efektiv gjithandej, ndaj dhe parime të tilla krijojnë një bërthamë të vetme për interpretim dhe arritjen e objektivave që shoqërojnë sistemin e prokurimit publik nëpërmjet formulimit të kontratave dhe udhëzimeve përkatëse.

Parimet luajnë një rol mjaft të rëndësishëm, si në drejtim të legjislacionit, kur kemi të bëjmë me përshtatjen e përmbajtjes së normave ligjore, por edhe në të kuptuarin e dispozitave ligjore, veçanërisht në rastet e përcaktimeve jo të sakta të tyre. Kryesisht, interpretimi dhe kuptimi i duhur i disa parimeve thjeshtëzon së tepërmi interpretimin e normave ligjore në terma të përmbajtjes, kontekstit dhe qëllimit. Parimet ligjore lidhen me normat ligjore në një të vetme, duke sjellë kështu normat me përmbajtjen e duhur, veçanërisht për rastet kur për shkak të diversitetit të madh jo të gjitha rrethanat mund të jenë parashikuar nga këto norma ligjore. Një rregull ligjor duhet të kuptohet nëpërmjet një parimi specifik, i cili përbën

njëkohësisht si drejtimin ashtu edhe qëllimin e hartimit të një norme ligjore në veçanti.

Konfliktet praktike mes parimeve, vlerave, normave dhe marrëdhënieve

Të kuptosh saktë prokurimet publike është tejet e rëndësishme për Autoritetet Kontraktore sidomos për ti bërë ato të ndërgjegjshme për të drejtat e tyre të kufizuara në përdorimin e asetëve publike më qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit, gjatë të cilave nuk duhet të ketë përfitime personale apo përfitime të grupeve të veçanta por vetëm interesa për publikun e gjerë *“in largo sensu”*. Rëndësia e parimeve gjithashtu reflektohet edhe nga rëndësia që kanë në zgjidhjen e shumë problemeve të kufizuara.

Disa pyetje interesante që mund të na lindin kur diskutojmë mbi këto parime themelore janë:

- A janë ato reciprokisht të barabarta?
- A ka një klasifikim të tyre nga lartë poshtë për nga rëndësia?
- A janë ato përjashtuese apo plotësuese të njëra tjetrës?
- A e mbështesin këto parime prokurimin publik drejt të njëjtave objektiva?

Deri më tani marrëdhënia mes parimeve të formalitetit dhe atyre të ekonomisë (zakonisht kundërshtojnë njëra tjetrën) kanë treguar se janë disi problematike. Autoritetet Kontraktore veçanërisht e kuptojnë këtë konflikt në rastet kur, për shkaqe formale, një ofertë duhet skualifikuar si e parregullt për shkak të një mungese në dokumentacion, e cila nuk është thelbësore për një performancë të mirë të punës por që është kërkuar nga vetë Autoriteti Kontraktor dhe kjo ofertë në veçanti është më e përshtatshme për sa i përket gjithë kriterëve të tjera të dokumentacionit në tender. Një ofertë e tillë do të duhet të skualifikohet nëse i përmbahemi parimit të formalitetit dhe praktikës së institucioneve, ndonëse një vendim në favor të kësaj oferte do të ishte në përputhje me parimin e ekonomicitetit. Atëherë, në këto kushte, ku është kufiri i cili tregon se cila do të jetë zgjedhja e duhur midis këtyre dy parimeve? A është e mundur ti vendosim ato në një sistem vlerash në të cilin, në një mënyrë relative, do të krijohej një situatë e tillë ku njëri prej parimeve të vendoste një kufi të qartë se cili prej tyre është më i përshtatshëm se tjetri – apo mjafton thjesht parimi i formalitetit të vendoset mbi parimin e ekonomicitetit pa marrë në konsideratë ndonjë ndikim ekonomik? Do të ishte ideale nëse do të kishim mundësi të ofronim një përgjigje direkte. Fatkeqësisht, ende nuk mund të jepet një e tillë për aq kohë sa nuk do të ketë një

konsensus mes institucioneve të ndryshme se cili prej parimeve do të jetë më i rëndësishëm në krahasim me të tjerët. Ndërkohë, duke diskutuar mbi këtë problem, mund të marrim në konsideratë si një pikë referimi praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë në procesin e vlerësimit të proporcionalitetit, ku “rëndësia” ka më tepër peshë se sa “ndërhyrja” por me një të drejtë specifike, kur kjo e drejtë synon të mbrojë veten nga ndërhyrje të tilla dhe kur gjykohet se kemi pasur të bëjmë me një ndërhyrje më të rëndë në proporcion me nivelin më të lartë të një të drejte të cënuar. Nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se rëndësia e të drejtës, e cila duhet të mbrohet nga ndërhyrjet prevalon mbi rëndësinë për ndërhyrje mbi të drejtën në fjalë, atëherë ndërhyrja do ti nënshtrohet këtij lloj testi të proporcionalitetit. Një formë e tillë testi proporcionaliteti mund të kryhet edhe në rastin e prokurimeve publike, kur gjendemi para një rasti ku zbatimi i një parimi kërkon shkeljen e një parimi tjetër. Kjo mund të ndodh në rastet kur p.sh për mbrojtjen e parimit të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, parimi i formalitetit shkelet nën pretendimin se janë zbatuar parimet e 3E- ve. Në këtë mënyrë ky është një rast tipik për përdorimin e testit të proporcionalitetit.

Një e drejtë e caktuar (në rastin tonë parimi i formalitetit) mund të kufizohet vetëm në rastet, në të cilat është e nevojshme për qëllime të mbrojtjes së të drejtave të tjera (në rastin tonë parimi i ekonomicitetit), kur është e domosdoshme të respektohen parimet kushtetuese të proporcionalitetit, kjo do të thotë që është e detyrueshme të plotësohen tre kushte për pranueshmërinë e këtyre kufizimeve apo ndërhyrjeve në të drejta: Emergjencë, mjaftueshmëri dhe proporcionalitet në një kuptim të kufizuar. Ndërhyrja në të drejtat kushtetuese është e lejuar vetëm në rastet kur këto ndërhyrje janë të domosdoshme (të paevitueshme) për mbrojtjen e të drejtave të tjera të njeriut, që do të thotë se një objektiv ligjor nuk mund të arrihet duke kryer ose jo një ndërhyrje të vogël në të drejtat kushtetuese. Për arritjen e një objektivi kushtetues të lejuar, ndërhyrja duhet të jetë e përshtatshme (p.sh mbrojtja e të drejtave të të tjerëve apo e interesit të publikut, ku mbrojtja e interesit të publikut përfaqëson një objektiv të lejuar). Ndërhyrja në të drejta nuk duhet të jetë e tepruar, që do të thotë se vetëm ndërhyrjet më të vogla nga të gjitha ndërhyrjet e mundshme në të drejta janë të lejuara për arritjen e të drejtave kushtetuese apo objektivave të dëshiruar, siç është p.sh. mbrojtja e të drejtës së barazisë së të tjerëve. Brenda kuadrit të proporcionalitetit, rëndësia e ndërhyrjes në një të drejtë duhet gjithashtu të vlerësohet krahasuar me rëndësinë e të drejtës e cila do të kufizohet. Sigurisht që ne nuk mund të bëjmë një barazim të

drejtpërdrejtë mes prokurimeve publike dhe të drejtave kushtetuese, disa prej tyre mund edhe të rrjedhin nga përdorimi i prokurimeve publike apo janë të kufizuara me qëllim zvogëlimin e keqpërdorimit nëpërmjet akteve ligjore apo ekzekutive, apo nga vendime të ndonjë institucioni apo autoriteti. Pavarësisht kësaj, kushtet e përmendura pak më sipër pas të cilave mund të lejohen ndërhyrjet në të drejtat kushtetuese, në një mënyrë apo tjetrën, krijojnë bazat për një vlerësim të pranueshmërisë së limiteve dhe perjashtimeve të një prej parimeve themelore të prokurimeve publike me qëllim zbatimin e një parimi tjetër. Jo vetëm domosdoshmëria, por gjithashtu edhe mjaftueshmëria dhe proporcionaliteti duhen marrë në konsideratë si elementë të rëndësishëm në testin e proporcionalitetit në fushën e prokurimeve publike gjatë të cilave na duhet të vlerësojmë ndërlikimet që lindin prej shkeljes së një parimi, në kuadër të një përfitimi dhe të një objekti, i cili mund të arrihet vetëm nëpërmjet zbatimit të një parimi tjetër dhe që duhet bazuar në ligj. Në këtë mënyrë, pamjaftueshmëria e theksuar formale apo cënimi, nuk do të thotë me patjetër përjashtimin e një operatori ekonomik nga një procedurë prokurimi, në raste të tilla kur pamjaftueshmëria apo cënimi i së drejtës nuk do të ketë ndikime negative apo të pafavorshme në parimet e tjera të prokurimit publik (parimi trajtimit të barabartë, parimi i mosdiskriminimit, etj). Kjo neglizhencë mund të çojë më tej në përzgjedhjen e një oferte bazuar në parimin e ekonomikitetit me qëllimin e vetëm sipas kriterit të kushtit ekonomik më të favorshëm, i përshtatshëm ky në marrëdhënien mes investimit dhe vlerës.

Neglizhimi i parimit të formalitetit në emër të parimit të ekonomikitetit në këtë rast do të ishte i nevojshëm, i përshtatshëm dhe proporcional.

Konkluzione

Diskutimi i mësipërm mund të përfaqësojë një formulim të testit të proporcionalitetit në fushën e prokurimeve publike, diskutim i cili mund të përbëjë një hap të rëndësishëm dhe të domosdoshëm drejt vështrimit të praktikave më të fundit, si për Autoritetet Kontraktore ashtu edhe për institucionet monitoruese të rregullshmërisë, për të vendosur mbi shkeljet ne procedurat e prokurimit publik por gjithashtu edhe në shkeljet e parimeve themelore. Një nga detyrat më të vështira për përmirësime ligjore dhe praktike për t'u kryer është gjetja e një raporti të përshtatshëm mes parimeve themelore të prokurimit publik. Mund të themi se asnjë parim nuk mund të përjashtohet por dhe as të përdoret me siguri.

Përktheu: Jonild Hoxhaj

Dr. Igor Šoltes

Zoti Igor Šoltes ka lindur në Lubjanë dhe u diplomua në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Lubjanës, në vitin 1991.

Asambleja Kombëtare e zgjodhi z. Šoltes, President të Gjykatës së Auditimit të Republikës së Sllovenisë në 1 qershor 2004 dhe qëndroi në këtë detyrë deri në fund të mandatit të tij nëntë vjeçar.

Në cilësinë e Presidentit të Gjykatës së Auditimit të Republikës së Sllovenisë, z. Šoltes ka mbështetur KLSH-në vecanërisht në vitet e fundit (2012-2013) dhe ka dhënë një kontribut të spikatur në promovimin e marrëdhënieve reciproke, të drejtpërdrejta dhe të hapura ndërmjet KLSH-së dhe Gjykatës së Auditimit të Republikës së Sllovenisë. Ky bashkëpunim u konsolidua dhe mori forma konkrete në muajin prill të vitit 2012, me nënshkrimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy Institucioneve. Impakti i kësaj marrëveshje ka qenë i rëndësishëm në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së dhe të modernizimit të Institucionit, në mënyrë që auditimi i jashtëm në Shqipëri të vijë në nivel me standardet e INTOSAI-it (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit).

Z. Igor Šoltes filloi karrierën e tij në vitin 1992 kur ai ishte anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Komunës Lubjanë-Siska dhe Shef i Departamentit të Çështjeve Ekonomike në Njësinë Administrative të Lubjanës.

Nga viti 1994 deri në mes të vitit 2001, ishte edhe kryetar i Bordit të Fondit të Strehimit të të gjitha komunave të Lubjanës.

Në vitin 1997, u emërua anëtar i Komisionit Shqyrtues, me detyrë dhënien e vendimeve në procedurat e prokurimit publik, ku ai punoi kryesisht në fushën e administratës publike, ankesave dhe ligjit të prokurimit.

Për shkak të zhvillimeve në fushën e legjislacionit të prokurimit publik, ndryshime institucionale u bënë edhe në kuadër të Komisionit Shqyrtues, i cili u ristrukturuar në vitin 1999 dhe u quajt Komisioni Shqyrtues Kombëtar. Zoti Igor Šoltes ishte anëtar i tij deri në vitin 2001. Në vitin 2001, Qeveria e Republikës së Sllovenisë e emëroi Drejtor të Zyrës së sapa krijuar të Prokurimit Publik, e cila ishte një organ qeveritar i ngarkuar me zhvillimin e sistemit të prokurimit publik në shkallë

kombëtare dhe me zhvillimin e standardeve për përdorim efikas dhe efektiv të financave publike.

Z. Šoltes është një anëtar aktiv i Rrjetit Ndërkombëtar të Prokurimit Publik, një forum i përbërë nga specialistë të fushës së politikave të prokurimit publik, i cili përfshin të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Forumi është i specializuar në shkëmbimin e informacionit ndër-kufitar dhe praktikave më të mira në prokurimin publik.

Në fushën e prokurimit publik, z. Šoltes pati një rol aktiv në dy programe binjakëzimi: i pari mes Republikës së Sllovenisë dhe Mbretërisë së Suedisë; i dyti mes Republikës së Sllovenisë dhe Mbretërisë së Holandës.

Z. Šoltes është gjithashtu angazhuar në ndërtimin e kornizës institucionale dhe legislative në vendet e Evropës Juglindore, përkatësisht Republikave të ish-Jugosllavisë.

Në vitin 2008, z. Šoltes mbrojti doktoraturën në fushën e prokurimit publik, *"Rëndësia dhe roli i sistemit të prokurimit publik në funksionimin e shtetit"*.

Z. Šoltes ka një eksperiencë shumë të gjatë pune në fushën e prokurimeve publike dhe ka shkruar shumë artikuj që lidhen me këtë fushë dhe për këto arsye vendosëm që një prej punimeve të tij ta bëjmë pjesë të këtij botimi, që i dedikohet në integralitetin e tij Prokurimeve Publike.

Që prej vitit 2014, z. Igor Šoltes është Deputet i Parlamentit Evropian, Zv/Kryetar i Komisionit të Kontrollit të Buxhetit të këtij parlamenti, anëtar i Komisionit të Tregut të Brendshëm dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si edhe anëtar i Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri.

**V. LIGJI “Mbi PROKURIMIN PUBLIK”
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

LIGJI

**Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, dhe Ligjin Nr. 182/2014
“PËR PROKURIMIN PUBLIK”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti dhe qëllimi**

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kofraktore.
2. Qëllimi i këtij ligji është:
 - a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
 - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në proce-durat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 2**Parimet e përzgjedhjes**

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

- a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;
- b) transparencë në procedurat e prokurimit;
- c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofer-tuesve ose kandidatëve.

Neni 3**Përkufizime**

Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Procedurat përzgjedhëse të prokurimit” janë procedurat e ndër-marra nga autoritetet kontraktore për përzgjedhjen e fituesve për kontratat publike për mallra, punë dhe shërbime.

2. “Kontratat publike” janë kontratat me shpërblim, të lidhura nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e puni-meve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me këtë ligj.¹

2/1. “Kontratat sektoriale” janë kontrata publike, të lidhura nga autoritetet kontraktore, që veprojnë në sektorët e shërbimit ujqor, ener-gjetik, të transportit dhe atij postar, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë, që kanë si qëllim kryerjen e veprimtarive, të përcaktuara në nenin 58/1 të këtij ligji.²

3. “Kontratat e konsulencës” janë kontratat për shërbime publike³ konsulente, të një natyre intelektuale dhe këshilluese, duke përjashtuar llojet e tjera të shërbimeve, ku mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë.

4. “Fondet publike” janë:

a) çdo vlerë monetare e Buxhetit të Shtetit, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;

b) çdo vlerë monetare e buxhetit vendor, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;

c) fonde ndihme ose kredi, të dhëna nga donatorë të huaj, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën kërkohet zbatimi i procedurave të këtij ligji;⁴

ç) të ardhura nga shteti, ndërmarrjet lokale, shoqëritë tregtare dhe entet e tjera, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve ose të kapitalit.

5. “Kontratat publike për shërbime” janë kontratat publike që kanë objekt kryerjen e shërbimeve. Kontrata publike, që ka si objekt mallra dhe shërbime, vlerësohet si “kontratë publike për shërbime”, nëse vlera e shërbimeve në kontratë tejkalon atë të mallrave në të njëjtën kontratë. Kontratat publike, që kanë objekt shërbimet, por që përfshijnë edhe punime të lidhura në mënyrë dytësore me objektin kryesor të kontratës, vlerësohen “kontrata publike për shërbime”.

6. “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë publike, që ka objekt furnizimin me mallra dhe që përfshin në mënyrë dytësore edhe vendosjen dhe instalimin, vlerësohet si “kontratë publike furnizimi”, nëse vlera e mallrave e tejkalon vlerën e vendosjes apo instalimit.

¹ Fjalja e dytë e kësaj pike është shfuqizuar me ligjin nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

² Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar

³ Shtuar me ligjin nr.9800, datë 10.09.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

7. “Mall” është çdo gjë materiale me vlerë ekonomike.

8. “Kontratat për punë publike” janë kontratat publike, që kanë objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

8/1. “Marrëveshje kuadër” quhet një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve kontraktore dhe një a më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave, që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasinë e parashikuara”.⁵

9. “Punim” është përfundimi i ndërtimit ose i veprave civile, që përmbushin një funksion ekonomik ose teknik.

10. “Sistem dinamik blerjeje” është një procedurë, tërësisht elektronike, blerjeje mallrash të zakonshme në treg, që përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktor, me afat të kufizuar dhe e hapur për çdo operator ekonomik, që përmbush kriteret e përzgjedhjes e që paraqet një ofertë në përputhje me specifikimet.

11. “Blerje elektronike” është procesi që përfshin një mënyrë elektronike për paraqitjen e çmimeve të reja, të ndryshimeve dhe/ose vlerave të reja mbi

elemente të veçanta të ofertës dhe që kryhet pas vlerësimit paraprak të ofertave, duke i klasifikuar ato nëpërmjet metodave të vlerësimit automatik. Disa lloje kontratash shërbimi dhe disa lloje kontratash

12. “Kontraktues”, “furnizues” dhe “sipërmarrës i shërbimit” është çdo person fizik, juridik apo ent publik ose grup personash dhe/ose organesh të tilla, që ofrojnë në treg sipërmarrjen e një ose disa punëve, furnizimin me mallra ose shërbime.

13. “Operatorë ekonomikë” janë të gjithë kontraktuesit, furnizuesit dhe sipërmarrësit e shërbimeve, pa bërë dallim ndërmjet tyre.

a) “Ofertues” është operatori ekonomik, që paraqet një ofertë në një prokurim publik.

b) “Kandidat” është operatori ekonomik, që kërkon të ftohet në një procedurë të kufizuar ose të negociuar prokurimi publik.

14. “Autoritet kontraktor” është çdo ent, që i nënshtrohet këtij ligji për zbatimin e kontratave të tij publike. Këto ente janë:

a) institucionet kushtetuese, institucionet e tjera qendrore, institucionet qendrore të pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore; ç)⁶

14/1. “Autoritet kontraktor” është edhe:

a) çdo autoritet kontraktor, siç është përcaktuar në pikën 14, kur ai kryen secilën

⁵ Ndryshuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

⁶ Shfuqizuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

prej veprimtarive të parashikuara në nenin 58/1 të këtij ligji;

b) sipërmarrja publike, nëse kontrata shpallet fituese për qëllime të ushtrimit të secilës prej veprimtarive të parashikuara në nenin 58/1. Për qëllim të kësaj dispozite, “sipërmarrje publike” është çdo sipërmarrje, mbi të cilën autoritetet kontraktore, të parashikuara në pikën 14, mund të ushtrojnë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, një ndikim dominues, për shkak të pronësisë që kanë mbi të, pjesëmarrjes së tyre financiare në të apo nëpërmjet rregullave që e qeverisin atë. Ndikim dominues vlerësohet kur autoritetet kontraktore, të renditura në pikën 14, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në lidhje me një sipërmarrje:

i) kanë shumicën e kapitalit të nënshkruar të sipërmarrjes; ose;

ii) kontrollojnë shumicën e votave të lidhura me aksionet e lëshuara prej sipërmarrjes; ose

iii) mund të emërojnë më tepër se gjysmën e trupit administrativ, menaxherial apo mbikëqyrës të autoritetit;

c) çdo ent tjetër, që nuk është përmendur në shkronjat “a” e “b”, kur kryen njëri prej veprimtarive të parashikuara në nenin 58/1 të këtij ligji ose kryen një kombinim të tyre, mbështetur në të drejtat e veçanta apo ekskluzive, të dhëna nga një autoritet përgjegjës.”⁷

⁷ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

15. “Të drejta të veçanta apo ekskluzive” janë të drejtat e dhëna nga një autoritet përgjegjës i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet dispozitave legislative, rregullatore apo administrative, efekti i të cilave është të kufizojë ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në nenin 58/1 të këtij ligji, për një apo më shumë ente, e që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në aftësinë e enteve të tjera për të kryer atë veprimtari.”⁸

16. “Organ qendror blerës” është autoriteti kontraktor, i cili:

a) siguron për autoritetet kontraktore mallra dhe/ose shërbime;

b) përzgjedh fituesit për kontrata publike për punime, mallra ose shërbime, të caktuara për autoritetet kontraktore.

17. “Procedurë e hapur” është procedura, përmes së cilës çdo operator ekonomik i interesuar mund të dorëzojë një ofertë.

18. “Procedurë e kufizuar” është procedura, përmes së cilës çdo operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë, por vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor mund të dorëzojnë oferta.

19. “Procedurë me negociim” është procedura, përmes së cilës autoriteti kontraktor i përzgjedh vetë opera-torët ekonomikë dhe negociacion kushtet e kontratës me një ose më shumë prej tyre.

⁸ Ndryshuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

20. “Kërkesë për propozim” është procedura, me anë të së cilës autoriteti kontraktor kërkon oferta nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë të përzgjedhur prej tij, por pranon edhe oferta të paraqitura nga operatorë të tjerë ekonomikë, të interesuar.⁹

21. “Konkurs projektimi” është procedura, përmes së cilës autoriteti kontraktor përzgjedh me anë të një jurie, me konkurs, një studim ose projekt, që ka vetëm natyrë estetike.

22. “Komunikimi me shkrim” është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen, përfshirë edhe informacionet, që transmetohen ose ruhen në mënyrë elektronike.

23. “Mënyrë elektronike” është përdorimi i pajisjeve elektronike për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave (përfshirë këtu edhe përpunimin dixhital) që transmetohen, jepen e merren përmes kablllove, radios, mjeteve optike ose çdo mjeti tjetër elektromagnetik.

24. “Rregullat e prokurimit” janë aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

25. “Buletini i Njoftimeve Publike” është botimi ku publikohen proku-rimet publike të nxjerra nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe njoftime të tjera publike.

26. “Dokumentet e tenderit” janë dokumentet, që autoriteti kontraktor ua vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përga-titjen e ofertave.

27. “Informacion” është dokumenti dhe informacioni për procedurat që, sipas kërkesës, i vihen në dispozicion çdo ofertuesi apo kandidati, i cili kundërshton një ose më shumë vendime të autoritetit kontraktor të marra gjatë procedurave të proku-rimit. Dhënia e informacionit mund të kufizohet deri në atë masë që nevojitet për të përmbushur detyri-met e fshehtësisë apo të masave të sigurisë.

28. “Kufi monetar” është vlera monetare, sipas së cilës, në përputhje me këtë ligj apo me rregullat e prokurimit publik, përcaktohet proce-dura e prokurimit që do të përdoret nga autoriteti kontraktor.

29. “Shërbime postare” quhen ato shërbime, që kanë të bëjnë me zhdoganimin, klasifikimin, përca-ktimin e itinerareve dhe dorëzimin e artikujve postarë.¹⁰

30. “Artikull postar” është çdo artikull i adresuar në formën e tij përfund-imitare, në të cilën do të transportohet, pavarësisht peshës. Përveç artikujve të korrespondencës, artikuj të tillë përfshijnë, për shembull, edhe librat, katalogët, gazetatat, periodikët dhe pakot postare, me mallra, me apo pa vlerë tregtare, pavarësisht peshës.”¹¹

⁹ Riformuluar me ligjin nr. 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

¹⁰ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

23. “Mënyrë elektronike” është përdorimi i pajisjeve elektronike për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave (përfshirë këtu edhe përpunimin dixhital) që transmetohen, jepen e merren përmes kabllove, radios, mjeteve optike ose çdo mjeti tjetër elektromagnetik.

24. “Rregullat e prokurimit” janë aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

25. “Buletini i Njoftimeve Publike” është botimi ku publikohen prokurimet publike të nxjerra nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe njoftime të tjera publike.

26. “Dokumentet e tenderit” janë dokumentet, që autoriteti kontraktor ua vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave.

27. “Informacion” është dokumenti dhe informacioni për procedurat që, sipas kërkesës, i vihen në dispozicion çdo ofertuesi apo kandidati, i cili kundërshton një ose më shumë vendime të autoritetit kontraktor të marra gjatë procedurave të prokurimit. Dhënia e informacionit mund të kufizohet deri në atë masë që nevojitet për të përmbushur detyrimet e fshehtësisë apo të masave të sigurisë.

28. “Kufi monetar” është vlera monetare, sipas së cilës, në përputhje me këtë ligj apo me rregullat e prokurimit publik, përcaktohet proce-dura e prokurimit që do të përdoret nga autoriteti kontraktor.

29. “Shërbime postare” quhen ato shërbime, që kanë të bëjnë me zhdoganimin, klasifikimin, përca-ktimin e

itinerareve dhe dorëzimin e artikujve postarë.¹⁰

30. “Artikull postar” është çdo artikull i adresuar në formën e tij përfundimtare, në të cilën do të transportohet, pavarësisht peshës. Përveç artikujve të korrespondencës, artikuj të tillë përfshijnë, për shembull, edhe librat, katalogët, gazetatat, periodikët dhe pakot postare, me mallra, me apo pa vlerë tregtare, pavarësisht peshës.”¹¹

Neni 4

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji.¹²

Neni 5

Prokurimet për mbrojtjen kombëtare

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes kombëtare, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në rastet e mëposhtme:

¹¹ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar

¹² Hiqen fjalët “dhe ato që rregullohen me ligj tjetër” me ligjin nr. 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

a) kur autoriteti kontraktor rrezikon të botojë të dhëna, që mund të cenojnë interesat thelbësorë të sigurisë kombëtare;

b) për blerjen e armëve, të municioneve dhe materialeve lufta-rake e të shërbimeve të lidhura me to. Ky përjashtim nuk duhet të ndikojë negativisht në konkurrencën e lirë për produktet që nuk u shërbejnë qëllimeve të mirëfillta ushtarake;

c) në raste të veçanta, të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore, konflikte të armatosura, operacione luftarake, stërvitje ushtarake dhe pjesëmarrje në misione ushtarake jashtë shtetit.

Neni 6

Kontratat sekrete, kontratat që kërkojnë masa të veçanta sigurie dhe kontratat që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit.¹³

Ky ligj nuk zbatohet në përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike, në rast se zbatimi i tyre kërkon masa të veçanta sigurie, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi, ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësorë të shtetit.

Neni 7

Përjashtimet e veçanta

Ky ligj nuk zbatohet në kontratat e shërbimit publik për:

a) blerjen ose qiranë me çdo mjet financiar të pasurive të paluajtshme apo të drejtave mbi to. Bëjnë përjashtim kontratat për shërbime financiare, të lidhura në atë çast, para ose pas kontratës së blerjes ose të qirasë së çdo forme, të cilat i nënshtrohen këtij ligji;

b) blerjen, zhvillimin, prodhimin, bashkëprodhimin e programeve ose të reklamave për transmetimin nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat për kohë transmetimi;

c) shërbimet e arbitrazhit, pajtimit, avokatëve të caktuar kryesisht, si dhe ekspertizës për nevoja të procedimit penal, rregulluar sipas Kodit të Procedurës Penale;¹⁴

ç) shërbimet financiare për shitjen, blerjen apo transferimin e titujve ose instrumenteve të tjera financiare, veçanërisht veprimet e autoritetit kontraktor për akumulimin e vlerave monetare apo të kapitalit, si dhe shërbimet e bankës qendrore;

d) shërbimet e kërkimit dhe të zhvillimit, rezultatet e të cilave shfrytëzohen nga të gjithë, përveç rasteve kur përfitimet i shkojnë vetëm autoritetit kontraktor për përdorimin prej tij për çështjet e brendshme dhe me kusht që shërbimi i kryer të paguhet plotësisht nga ky autoritet kontraktor.

¹³ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

dh) shërbimet e parashikuara në nenet 58/3, 58/4, 58/5, 58/6, 58/7 të kreut V/1 “Zhvillimi i procedurave për kontratat sektoriale.”¹⁵

e) ¹⁶kontratat e punësimit.

Rastet përjashtimore, sipas shkronjave “a” deri në “e”¹⁷ të këtij neni, rregullohen me akte të tjera ligjore ose nënligjore.

Neni 8

Detyrimet ndërkombëtare

Në rast se ky ligj bie ndesh me një detyrim që shteti ka në bazë të një marrëveshjeje me një ose më shumë shtete të tjera apo me një organizatë ndërkombëtare, atëherë zbatohen dispozitat e marrëveshjes në fjalë. Në të gjitha rastet e tjera, procedurat e prokurimit publik i nënshtrohen këtij ligji.

Neni 9

Kontratat e shërbimit, të shpallura fituese në bazë të së drejtës ekskluzive.

Ky ligj nuk zbatohet për kontratat e shërbimit publik, të lidhura nga një autoritet kontraktor me ¹⁸ një autoritet

tjetër kontraktor ose bashkim autoritetesh kontraktore, bazuar në një të drejtë ekskluzive, që ata gëzojnë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Shërbimet e konsulencës.

Shërbimet e konsulencës shpallen në përputhje me procedurat e para-shikuara në këtë ligj dhe në rregullat e prokurimit publik.

Neni 11

Blerja e përqendruar

1. Kur më shumë se një autoritet kontraktor ka nevojë për të njëjtat mallra, punime apo shërbime, atëherë ata, nëse marrin një vendim të tillë, mund:

a) t'i ngarkojnë njërit prej tyre detyrën e prokurimit të këtyre mallrave, punimeve apo shërbimeve, në emër të të tjerëve;

b) ta udhëzojnë organin qendror blerës, të krijuar në përputhje me rregullat e prokurimit, të kryejë procedurat përkatëse të përzgjedhjes së fituesit të kontratës.

2. Autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë organit qendror blerës të kryejë një procedurë të caktuar të përzgjedhjes së fituesit ose një sërë procedurash të tilla në emër të tij, kur blerja e përqendruar do të ishte më e leverdishme për shkak të rritjes së sasisë së kërkuar për furnizimet me mallra të ngjashme dhe kushte të ngjashme sipas tregut.

¹⁵ Ndryshuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

¹⁶ Shtuar me ligjin nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

¹⁷ Zëvendësuar me ligjin nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

¹⁸ Parafjala “për” zëvendësohet me parafjalën “me” me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 “Për KLSH 2016

disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 “Për Prokurimin Publik”.

Në kryerjen e procedurave të përzgjedhjes së fituesit, organi qendror blerës zbaton dispozitat e këtij ligji.

3. Këshilli i Ministrave, me kërkesën e një autoriteti kontraktues ose me nismën e vet, mund të ngarkojë për procedura të veçanta prokurimi një autoritet tjetër kontraktues si organ qendror blerës.

Neni 11/1

Marrëveshja publike kuadër¹⁹

KREU II

ORGANIZIMI I PROKURIMIT PUBLIK

Neni 12

Përgjegjësia e autoritetit kontraktor

1. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike²⁰, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për proce-durat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.

Për çdo procedurë prokurimi, proces-verbale të duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:

a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të

prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;

c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për doku-mentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrjimeve të bëra në këto dokumente;

ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;

d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;

dh) vlerën ose mënyrën e përlogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;

e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;

ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;

f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin të këtij ligji;

g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.²¹

3. Autoriteti kontraktor administron²² për të gjitha procesverbale të dokumentet e

¹⁹ Shfuqizuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

²⁰ Hiqen fjalët "që i janë vënë në dispozicion" me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

²¹ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit.

3/1. Në rastin e prokurimit elektronik, raporti i realizuar nga vetë sistemi, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit me mjete elektronike, bëhet pjesë e dosjes së prokurimit²³.

4. Autoriteti kontraktor çdo 4 muaj duhet të dorëzojë në Agjencinë e Prokurimit Publik një raport për veprimtaritë e tij të prokurimit. Formatit dhe përmbajtja e këtij raporti përcaktohen në rregullat e prokurimit.

5. Autoriteti kontraktor krijon njësi prokurimi brenda strukturës së vet, detyrat e përgjegjësitë e së cilës përkufizohen në rregullat e prokurimit publik. Autoritetet koftra-ktore mund të kërkojnë mbështetje në formën e këshillave dhe udhëzimeve²⁴ nga Agjencia e Prokurimit Publik gjatë krijimit të njërive të tyre të prokurimit, të veçanta ose të përbashkëta.

Neni 13

Agjencia e Prokurimit Publik

1. Agjencia e Prokurimit Publik është organ qendror, person juridik publik në varësi të

²² Zëvendësuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

²³ Riformuluar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

²⁴ Shtuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 "Për Prokurimin Publik"

Kryeministrit, që financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Agjencia e Prokurimit Publik:

Neni 13

Agjencia e Prokurimit Publik

1. Agjencia e Prokurimit Publik është organ qendror, person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Agjencia e Prokurimit Publik:

a) paraqet në Këshillin e Ministrave propozime për rregullat e prokurimit;

b) nxit dhe organizon kualifikimin e punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik;

c) harton dhe nxjerr Buletinin e Njoftimeve Publike, siç është përshkruar në rregullat e prokurimit. Agjencia e Prokurimit Publik shpall në Buletinin e Njoftimeve Publike listën e operatorëve ekonomikë të përjashtuar, në përputhje me nenin 45 të këtij ligji;

ç) harton dokumentet standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit, sipas rregullave të prokurimit publik;

ç/1²⁵

d) në përputhje me kërkesën, jep këshilla dhe asistencë teknike për autoritetet kontraktore, që ndër-marrin një procedurë prokurimi;

²⁵ Shfuqizuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

dh) paraqet një raport vjetor në Këshillin e Ministrave për funksionimin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik;

e) bashkëpunon me institucionet ndërkombëtare dhe me ente të tjera të huaja për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik;

ë) planifikon dhe bashkërendon ndihmën teknike të huaj për Shqipërinë në fushën e prokurimit publik;

f) nxit dhe mbështet përdorimin e standardeve teknike ndërkombëtare për përgatitjen e specifikimeve teknike kombëtare²⁶, si dhe mban lidhje të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimeve;

g) verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, rekomandimet e organeve audituese për procedurat e prokurimit²⁷, si dhe monitoron mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik, nëpërmjet informacioneve të marra nga raportet periodike të autoriteteve kontraktore²⁸.

²⁶ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

²⁷ Fjalët "rekomandimet e organeve audituese për procedurat e prokurimit" janë shtuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

²⁸ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

gj)²⁹

h)³⁰

i) në rast shkeljesh të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendos gjoba sipas nenit 72 të këtij ligji ose i propozon drejtuesit të autoritetit kontraktor apo organeve më të larta masa disiplinore për personat e autori-teteve kontraktore, që i kanë kryer këto shkelje;

j)³¹

k) harton dhe përshtat rregulloret e saj të brendshme.

l) kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me ligj.³²

3. Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, pavarësisht nga çështja penale, që mund të ketë filluar, për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet për:

20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

²⁹ Shfuqizuar me ligjin nr.10309, datë 22.07.2010 "Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 8.7.2010, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

³⁰ Shfuqizuar me ligjin nr.10309, datë 22.07.2010 "Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 8.7.2010, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

³¹ Shfuqizuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

³² Shtuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 "Për Prokurimin Publik".

- a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kalifi-kimi, përcaktuar në nenet 45 e 46 të këtij ligji;
- b) veprime korruptive të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 26³³ të këtij ligji;
- c) dënime për vepra penale, të parashikuara në nenin 45 pika 1 të këtij ligji;
- ç) mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit³⁴;
- d) kur ka një vendim të formës së prerë të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës për marrëveshje në oferta³⁵.

4.³⁶

5. Nëpunësit e Agjencisë së Prokurimit Publik gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa stafi ndihmës³⁷ emërohet nga

Drejtori i Agjencisë dhe statusi i tyre rregullohet me Kodin e Punës.

Neni 14

Avokati i Prokurimeve³⁸

Neni 15

Zgjedhja e Avokatit të Prokurimeve³⁹

Neni 16

Papajtueshmëritë me funksionet e Avokatit të Prokurimeve⁴⁰

Neni 17

Mbarimi i funksionit të Avokatit të Prokurimeve⁴¹

Neni 18

Raportimi⁴²

³³ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

³⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

³⁵ Shtuar me ligjin nr. 131/2012“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

³⁶ Shfuqizuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

³⁷ Zëvendësuar me ligjin nr. 131/2012“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

³⁸ Shfuqizuar me ligjin nr. 131/2012“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

³⁹ Shfuqizuar me ligjin nr. 131/2012“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

⁴⁰ Shfuqizuar me ligjin nr. 131/2012“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

⁴¹ Shfuqizuar me ligjin nr. 131/2012“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

⁴² Shfuqizuar me ligjin nr. 131/2012“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

Neni 19**Personeli dhe buxheti i Avokatit të
Prokurimeve⁴³
Neni 19/1⁴⁴****Komisioni i Prokurimit Publik**

1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.
2. Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare.
3. Komisioni i Prokurimit Publik është person juridik publik, në varësi të Kryeministrit⁴⁵, që financohet nga Buxheti i Shtetit.
4. Komisioni i Prokurimit Publik paraqet raport vjetor përpara Këshillit të Ministrave. Përmbajtja e raportit përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

⁴³ Shfuqizuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁴⁴ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁴⁵ Zëvendësuar me ligjin nr. 22/2012 "Për një ndryshim në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

Neni 19/2⁴⁶**Përbërja, zgjedhja dhe mandati i
Komisionit të Prokurimit Publik**

1. Komisioni i Prokurimit Publik përbëhet nga 5 anëtarë.⁴⁷
2. Anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik emërohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Këshilli i Ministrave emëron një kryetar dhe një zëvendës të tij nga anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Kryetari drejton seancat dhe përfaqëson institucionin me të tretët. Në mungesë të tij zëvendësohet nga nënkryetari.
- 4.⁴⁸
5. Anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik kanë një mandat 5-vjeçar.

⁴⁶ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁴⁷ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

⁴⁸ Shfuqizuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Neni 19/3⁴⁹**Kriteret për t'u zgjedhur anëtar i****Komisionit të Prokurimit Publik**

Anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) ka zotësi të plotë për të vepruar;
- b) ka arsim të lartë në drejtësi;⁵⁰ vjet;
- c) ka përvojë në fushën e prokurimeve, prej të paktën 3 vjetësh dhe përvojë pune 5 ç) nuk ka qenë/është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- d) nuk është larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore.

Neni 19/4⁵¹**Papajtueshmëritë e funksionit të anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik**

Funksioni i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik është i papajtueshëm me:

- a) anëtarësimin në partitë politike dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë e tyre;
- b) administrimin apo drejtimin e shoqërive tregtare, personalisht ose me anë përfaqësimi;

⁴⁹ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁵⁰ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

⁵¹ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

- c) çdo veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies.

Neni 19/5⁵²**Mbarimi i funksionit të anëtarit të****Komisionit të Prokurimit Publik**

1. Funksioni i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik mbaron para kohe kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- c) është, për një periudhë 6-mujore, në pamundësi fizike për të ushtruar detyrën;
- ç) mbaron mandati.

2. Anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik shkarkohet nga Këshilli i Ministrave, kur ka një vendim gjykate të formës së prerë:

- a) për shkelje të dispozitave të këtij ligji apo të akteve të tjera ligjore;
- b) për kryerjen e një veprimtarie, që krijon konflikt interesash;
- c) nëse zbulohen raste të papajtueshmërisë së funksionit të tij.

3. Nga konstatimi deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë, sipas pikës 2 të këtij neni, me vendim të Këshillit të Ministrave anëtar i komisionit pezullohet nga detyra.

4. Në rast se vendi i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik mbetet vakant, Këshilli i Ministrave, brenda 30 ditëve nga data e largimit të anëtarit, emëron anëtarin e ri.

⁵² Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

Neni 19/6⁵³

Struktura dhe organika e Komisionit të Prokurimit Publik

1. Struktura dhe organika e Komisionit të Prokurimit Publik përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.
2. Punonjësit e Komisionit të Prokurimit Publik gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa personeli ndihmës emërohet nga kryetari dhe marrëdhëniet e tyre të punës rregullohen nga Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.
3. Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik shqyrtohen në seancë, me pjesëmarrjen e të paktën 3 (tre) anëtarëve, njëri prej të cilëve është kryetari ose zëvendësi i tij. Në përfundim të shqyrtimit, vendimi i marrë nga komisioni publikohet në faqen e internetit.
4. Rregullat e hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 19/7⁵⁴

Askush nuk duhet të ndikojë mbi anëtarët e komisionit në vendimmarrje. Çdo përpjekje, e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, për të ndikuar, dënohet me gjobë, sipas këtij ligji, pavarësisht procedimit civil apo penal, që mund të ketë filluar.

⁵³ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁵⁴ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

KREU III**RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË****PROKURIMIT****Neni 20****Mosdiskriminimi**

Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

Neni 21**E drejta për informim**

1. *Informacioni i administruar, sipas nenit 12 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdopersoni të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës⁵⁵.*
2. Autoriteti kontraktor⁵⁶ vë në dijeni⁵⁶ jo më vonë se 5 ditë nga marrja e vendimit:

- a) çdo kandidat të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të pjesëmarrjes së tij në tender;
- b) çdo ofertues të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të ofertës së tij;

⁵⁵ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁵⁶ Hiqen fjalët "sa më shpejt të jetë e mundur, por" me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

c) çdo ofertues të suksesshëm,⁵⁷ që ka paraqitur një ofertë të vlefshme, për klasifikimin e ofertave⁵⁸ së përzgjedhur.

3. Pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen, autoritetet kontraktore mund të mos bëjnë publike disa nga informacionet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, nëse një gjë e tillë vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave ose cenon interesin publik apo interesat ligjorë dhe ekonomikë të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë

Neni 22

Format e komunikimit

1. I gjithë dokumentacioni, njoftimet, vendimet, informacionet dhe komunikimet e parashikuara në këtë ligj bëhen me shkrim ose me mjete elektronike⁵⁹

2. Në rastet kur autoriteti kontraktor komunikon në formë elektronike, mjetet e komunikimit elektronik dhe karakteristikat e tyre teknike duhet të jenë jodiskriminuese, të disponueshme dhe të ndëroperueshme me produktet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, të cilat përdoren gjerësisht. Rregullat dhe

⁵⁷ 57 ndryshuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 "Për Prokurimin Publik"

⁵⁸ Zëvendësuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁵⁹ Shtuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

procedurat për këtë formë komunikimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik⁶⁰.

3. Në rast se komunikimi ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe autoritetit kontraktor kryhet në ndonjë formë tjetër, të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë nen, përmbajtja e tij duhet të dokumentohet menjëherë me shkrim⁶¹

4. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje. Forma e përdorur për komunikim, shkëmbim dhe ruajtjen e informacionit duhet të garantojë se autoriteti kontraktor mund të shqyrtojë përmbajtjen e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, vetëm pasi të ketë përfunduar afati kohor ligjor për dorëzimin e tyre, i përcaktuar nga ky ligj.

Neni 23

Specifikimet teknike

1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për

⁶⁰ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁶¹ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

- a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;
- b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
- c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt

kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj"⁶².

4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.

5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim

⁶² Shtuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifitime.

Neni 24

Anulimi i një procedure prokurimi

1. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:

a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik;

b) nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore;

c) kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negociim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë;

ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;

d) nëse të gjitha ofertat e paraqitura⁶³ përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;

⁶³ Kjo fjalë është zëvendësuar me ligjin nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.⁶⁴

2. Autoriteti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve, që kanë paraqitur oferta, për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.

3. Në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, autoriteti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit.

4. Autoriteti kontraktor boton njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është botuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 ditë⁶⁵ nga marrja e vendimit për anulim.

Neni 25

Fshehtësia e procesit

Pa cenuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin

⁶⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

⁶⁵ Zëvendësuar me ligjin nr. 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

Neni 26

Veprimet korruptive dhe konflikti i interesave

1. Autoriteti kontraktor refuzon një ofertë ose një kërkesë për pjesëmarrje në tender nëse:

a) ofertuesi apo kandidati i jep ose premtion t'i japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një zyrtari apo punonjësi një shpërblim në çfarëdolloj forme, mundësi punësimi ose mall, shërbim ose vlerë, si stimul për një akt, vendim apo procedurë, që ndërmerr autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit;

b) ofertuesi ose kandidati është në kushtet e konfliktit të interesit.

Refuzimi dhe arsyet për një veprim të tillë duhet të pasqyrohen në procesverbalet e procedurave të prokurimit, sipas nenit 12 të këtij ligji dhe duhet t'i komunikohet, menjëherë dhe zyrtarisht, kandidatit ose ofertuesit në fjalë. Vendimi mund të ankimohet në rrugë gjyqësore.

2. Vendimet e marra nga autoriteti kontraktor, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, nuk pengojnë kallëzimin penal në organet përkatëse, kur aktet apo veprimet në fjalë përbëjnë vepër penale.

3. Në rast se në momentin e hapjes së ofertave evidentohet se një ose disa prej operatorëve ekonomikë ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose

disa prej zyrtarëve të caktuar për vlerësimin e ofertave dhe kjo situatë konflikti nuk mund të evidentohet përpara këtij momenti, atëherë duhet të zëvendësohet zyrtari/zyrtarët në fjalë dhe më pas të vazhdojë procesi i prokurimit⁶⁶.

Neni 27

Kufijtë monetarë

1. Për qëllimet e këtij ligji zbatohen kufijtë monetarë, si më poshtë:

a) kufiri i lartë monetar;

b) kufiri i ulët monetar.

2. Kufijtë monetarë përcaktohen në rregullat e prokurimit.

3. Këshilli i Ministrave rishikon kufijtë monetarë çdo dy vjet.

Neni 28

Metodat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike

1. Përcaktimi i vlerës së një kontrate publike bazohet në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH, të përllogaritur nga autoriteti kontraktor në çastin e botimit të njoftimit të kontratës të parashikuar në nenin 38 të këtij ligji ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një botim i tillë. Përllogaritja merr parasysh shumën e plotë të vlerësuar për t'u paguar, duke përfshirë çdo formë obsioni apo rinovimi të kontratës.

⁶⁶ Shtuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

2. Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj.

3. Metodat për llogaritjen e vlerës së kontratave publike përcaktohen në rregullat e prokurimit.

Neni 29

Procedurat standarde të prokurimit

1. Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e fituesve të kontratave publike, zbaton procedurat e parashikuara në këtë ligj. Llojet e procedurave të prokurimit publik janë:

- a) procedurë e hapur;
- b) procedurë e kufizuar;
- procedurë me negociim, me ose pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
- ç) kërkesë për propozime;
- d) konkurs projektimi;
- dh) procedurë “shërbim konsulence”⁶⁷

2. Procedura e hapur mund të përdoret për të gjitha kontratat. Procedura e kufizuar mund të përdoret atëherë kur është e domosdoshme të bëhet dallimi ndërmjet fazës së përzgjedhjes, ku trajtohet kualifikimi i kandidatëve dhe fazës së përcaktimit të kontratës fituese, ku shqyrtohet oferta. Dallimi ndërmjet procedurës së hapur dhe procedurës së kufizuar bëhet sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit.

⁶⁷ Shtuar me ligjin nr. 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

3. Autoriteti kontraktor përdor procedurën e hapur dhe procedurën e kufizuar për kontratat mbi kufirin e ulët monetar⁶⁸. Procedura me negociim përdoret vetëm në rrethana të veçanta, siç përcaktohet në nenet 32 e 33 të këtij ligji dhe në rregullat e prokurimit publik.

4. Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën me negociim, me ose pa shpallje paraprake dhe kërkesën për propozime për kontratat me vlerë më të ulët se kufiri i ulët monetar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.⁶⁹

5. Për prokurimet⁷⁰ me vlerë të vogël, nën kufirin e ulët monetar, të mallrave, shërbimeve apo punëve, autoritetet kontraktore mund të përdorin procedura të thjeshtuara, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

Neni 30

Procedura e hapur

1. Procedura e hapur është procedura e preferuar në prokurimet.
2. Në procedurën e hapur autoriteti kontraktor boton një njoftim, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji, i cili përmban një

⁶⁸ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

⁶⁹ Shtuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 “Për Prokurimin Publik”

⁷⁰ Ndryshuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 “Për Prokurimin Publik”.

përshkrim të objektit që do të prokurohet dhe rregullat e veçanta procedurale.

3. Të gjithë ofertuesit e dorëzojnë ofertën e tyre, përkatësisht, ofertën ekonomike, ofertën teknike dhe provën për përmbushje të kriterëve përzgjedhëse, sipas kërkesave të neneve 45 e 46 të këtij ligji.

4. Pas mbarimit të afatit maksimal për paraqitjen e ofertave, të përcaktuar në njoftimin e kontratës, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji, autoriteti kontraktor hap ofertat, verifikon kualifikimet apo mangësitë e ofertuesve, në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenet 45 e 46 të këtij ligji dhe përzgjedh kontratën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 55 të këtij ligji.

Neni 31

Procedura e kufizuar

1. Procedura e kufizuar përdoret nga autoriteti kontraktor për të kryer një prokurim që çon në dhënien e ndonjë kontrate publike, kur:

a) malli, shërbimi ose puna përkatëse, për shkak të karakterit të tij/tyre shumë të ndërlikuar ose të veçantë, mund të furnizohen, sigurohen ose ekzekutohen nga operatorë ekonomikë, të cilët kanë kapacitetin e duhur teknik, profesional ose financiar;

b) është ekonomishtë më e leverdishme për autoritetin kontraktues, fillimisht, të shqyrtojë kapacitetin dhe kualifikimet e

operatorëve të interesuar ekonomikë dhe më pas të ftojë ata që kanë kualifikimet minimale specifike të caktuara të paraqesin ofertat.

2. Në procedurën e kufizuar autoriteti kontraktor boton një njoftim, sipas nenit 38 të këtij ligji, i cili përmban:

a) një përshkrim të objektit të kontratës që do të prokurohet;

b) një tregues të kriterëve përzgjedhëse, sipas neneve 45 e 46 të këtij ligji;

c) një ftesë, për të shprehur interesin për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit;

ç) *kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, siç përcaktohen në nenin 55⁷¹.*

3. Pas mbarimit të afatit kohor të shpallur për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, siç përcaktohet në njoftimin e kontratës, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji, autoriteti kontraktor përzgjedh kandidatët, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 45 dhe 46 të këtij ligji.

4. Më pas autoriteti kontraktor dërgon ftesën për ofertë për kandidatët e përzgjedhur, në përputhje me nenin 40 të këtij ligji, duke u kërkuar atyre të paraqesin ofertat.

5. Pas mbarimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, autoriteti kontraktor hap ofertat dhe përcakton kontratën fituese, në mbështetje të kriterëve të përcaktuara në nenin 55 të këtij ligji.

⁷¹ *Shtuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar*

Neni 32

**Procedura me negociim, me shpallje
paraprake të njoftimit**

1. Kur vlera e kontratës së prokurimit është më e lartë se kufiri i ulët monetar, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të

kontratës kur:

a) në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme, të hapura ose të kufizuara⁷², të gjitha ofertat janë të pavlefshme apo nuk përmbushin kërkesat e dispozitave ligjore kombëtare dhe për sa kohë që në kontratë nuk është bërë ndonjë ndryshim thelbësor, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik;

b) natyra e punëve, mallrave ose shërbimeve, apo rreziku i lidhur me to nuk lejon përcaktimin paraprak të çmimit të plotë dhe, në veçanti:

i) në rastet e kontratave për shërbime, veçanërisht për shërbime intelektuale, si psh shërbimet, që kanë të bëjnë me projektimin e punëve, për sa kohë natyra e shërbimeve është e pamundur të përcaktohet me saktësi të pranueshme, që të lejojë përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në përputhje me procedurat e tenderit, të hapur ose të kufizuar;

ii) në rastet e kontratave për punë kërkimore, eksperimentimi ose zhvillimi,

por jo me qëllime përfitimi apo rimbursimi të kostove të kërkimit e të zhvillimit.

2. Kur vlera e kontratës është nën kufirin e ulët monetar, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, sa herë e gjykon të nevojshme, me kusht që të respektohen parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe transparencës.

3. Autoriteti kontraktor negocion me ofertuesit, për t'i përshtatur ofertat e tyre me kërkesat e përcaktuara në njoftim, me specifikimet dhe dokumentet shtesë, nëse ka të tilla, për të përzgjedhur ofertën më të mirë, në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

4. Autoriteti kontraktor duhet të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit gjatë zhvillimit të dialogut individual me secilin prej tyre. Asnjë informacion diskriminues apo që mund t'u sjellë avantazhe disa ofertuesve mbi të tjerët nuk duhet të bëhet i njohur.

5. Autoriteti kontraktor mund të marrë masa që procedura me negociim të kryhet në faza të ndryshme, duke zbatuar kriteret e vlerësimit, të shpallura në njoftim apo në specifikime, për reduktimin e numrit të ofertave që duhen negociuar. Ky obsion, nëse përdoret, duhet të shpallet në njoftim ose në specifikime.

⁷² Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

Neni 33

**Procedura me negociim, pa shpallje
paraprake të njoftimit**

1. Autoriteti kontraktor, për kontratat me vlerë mbi ose nën⁷³ kufirin e ulët monetar, mund të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, vetëm në rrethana të veçanta, në përputhje me këtë nen dhe në rregullat e prokurimit publik. Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet të çojë në shmangien e konkurrencës ose në diskriminimin e kandidatëve.

2. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për të gjitha llojet e kontratave publike si më poshtë:

a) kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme nuk është siguruar konkurrenca minimale dhe për sa kohë që në kushtet fillestare të kontratës të mos jetë bërë asnjë ndryshim thelbësor⁷⁴;

b) kur për arsye që lidhen me të drejtat ekskluzive ose të drejtat e autorit, kontrata nuk mund të ekzekutohet përveçse nga një operator i vetëm ekonomik;

c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 për

njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim, me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure për⁷⁵ rcaktohen në rregullat e prokurimit.

ç) për mallrat e kuotuar dhe të blera në bursën e mallrave, në përputhje me rregullat e prokurimit publik;⁷⁶

d) për blerje, që mundësojnë prokurimin e mallrave për një kohë lehtësimi shumë të shkurtër, ose për një rast veçanërisht të lehtësimi, që paraqitet në një kohë shumë të shkurtër dhe me një çmim, dukshëm, më të ulët se çmimet normale të tregut dhe në përputhje me kriteret e parashikuara në rregullat e prokurimit publik;⁷⁷

dh) ⁷⁸

⁷⁵ Ndryshuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 "Për Prokurimin Publik"

⁷⁶ Shtuar me ligjin nr 9855 datë 26.12.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik".

⁷⁷ Shtuar me ligjin nr 9855 datë 26.12.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik".

⁷⁸ Shfuqizuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

⁷³ Ndryshuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 "Për Prokurimin Publik"

⁷⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

3. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për kontratat e mallrave:

a) në rast se mallrat e kërkuara janë prodhuar vetëm për qëllime kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi. Këtu nuk përfshihen prodhimi me shumicë, për qëllime tregtare apo për të mbuluar shpenzimet e kërkimit e zhvillimit;

b) për lëvrime shtesë nga furnizuesi i mëparshëm, për zëvendësimin e pjesëshëm të lëvrimeve normale ose instalimeve apo si shtesë të mallrave, instalimeve ekzistuese, pasi ndryshimi i furnizuesit do ta detyrojë autoritetin kontraktor të kërkojë mallra me karakteristika të ndryshme teknike, që mund të rezultojnë në papajtueshmëri dhe në vështirësi të mëdha teknike për vënien në punë apo mirëmbajtjen e tyre. Kontrata shtesë, në këtë rast, duhet të nënshkruhet brenda një afati 3-mujor nga përfundimi i kontratës kryesore.

4. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për kontratat e shërbimit me kandidatin e suksesshëm, të dalë pas përfundimit të konkursit të projektimit, sipas nenit 35 të këtij ligji.

5. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për kontratat e punëve dhe të shërbimeve:

a) për punë apo shërbime shtesë, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare, por që, për shkak të rrethanave të paparashikuara, janë bërë të

domosdoshme, me kusht që t'i jepen operatorit ekonomik, që realizon këto ndërtime apo shërbime, si dhe kur vlera e punës dhe/ose shërbimeve shtesë nuk e tejkalon 20 për qind të vlerës së kontratës fillestare:

i) kur ndërtimet apo shërbimet suplementare nuk mund të ndahen nga kontrata fillestare, pa shkaktuar vështirësi të mëdha, teknike e ekonomike, për autoritetin kontraktor;

ii) kur këto ndërtime e shërbime, edhe pse të ndara nga kontrata fillestare, janë të domosdoshme për përmbushjen e saj.

b) për ndërtime apo shërbime të reja, që kanë të bëjnë me përsëritjen e ndërtimeve apo të shërbimeve të ngjashme, që i janë besuar një operatori ekonomik, të cilit autoriteti kontraktor i ka akorduar kontratën fillestare, me kusht që këto ndërtime ose shërbime të përputhen me projektin bazë, për të cilin është shpallur fitues i kontratës fillestare me procedurën e hapur ose të kufizuar. Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure duhet të përfshihet në njoftimin e kontratës fillestare dhe autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë koston e përgjithshme të përlogaritur të ndërtimeve ose shërbimeve në vijim. Procedura e mësipërme mund të përdoret vetëm brenda 3 viteve nga lidhja e kontratës fillestare. Në çdo rast shtesa e kontratave nuk duhet të kalojë vlerën 20 për qind të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare.

6. Zgjedhja e operatorëve ekonomikë duhet të bëhet në mënyrë jodiskriminuese. Autoriteti kontraktues, sa më shpesh të jetë e mundur, duhet t'i ndërrojë sipërmarrësit që do të ftojë.

Neni 34

Kërkesa për propozime

1. Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e kërkesës për propozim për kontrata me vlerë nën kufirin e ulët monetar. Në bazë të kësaj procedure, autoriteti kontraktor kërkon oferta nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë të zgjedhur prej tij, ose mund të përdorë komunikimin elektronik të parashikuar në nenin 36 të këtij ligji⁷⁹. Për këtë përzgjedhje *kërkohen të ftohen të paktën 5 operatorë ekonomikë*⁸⁰, përveç rasteve kur kjo është e pamundur, për arsye teknike ose për mungesë të konkurrencës. Kjo procedurë nuk duhet të përdoret për të shmangur procedurat konkurruese të prokurimit. Në çdo rast autoriteti kontraktor duhet të pranojë oferta nga çdo ofertues tjetër, veç atyre të ftuar nga vetë ai.

2. Kur autoriteti kontraktor përdor komunikimin elektronik, ai duhet të publikojë një njoftim elektronik, sipas nenit

38 pika 4 të këtij ligji dhe të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.

Neni 34/1⁸¹

Shërbim konsulence

1. Autoriteti kontraktor, që ndërmerr një procedurë "shërbim konsulence", njofton qëllimin e prokurimit me anë të botimit të njoftimit të kontratës, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji. Njoftimi duhet të përmbajë informacionin e parashikuar në nenin 39 të këtij ligji.

2. Procedurat e hollësishme të zhvillimit të kësaj procedure prokurimi parashikohen në rregullat e prokurimit.

Neni 35

Konkurs projektimi

1. Autoriteti kontraktor mund të organizojë konkursin e projektimit, si pjesë e një procedure që çon në përzgjedhjen e kontratës fituese, për një plan apo projekt të zgjedhur nga një juri, mbi bazën e një procedure konkurrimi, kryesisht në fushën e planifikimit urban, rural, arkitektonik, inxhinierik etj.⁸²

2. Procedura konkurs projektimi mund të organizohet:

⁷⁹ Hiqen fjalët "dhe i vlerëson ato në bazë të cilësisë dhe çmimit" me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁸⁰ Zëvendësuar në Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 "Për Prokurimin Publik".

⁸¹ Ky nen është shtuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁸² Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

a) si pjesë e një procedure, që shërben për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik;

b) për përfitimin vetëm të projektit *kundrejt çmimit*⁸³.

3. Autoriteti kontraktor që ndërmerr një konkurs projektimi, njofton qëllimin e prokurimit me anë të botimit të njoftimit për pjesëmarrje në konkurs, në përputhje me nenin 38 të këtij ligji. Njoftimi duhet të përmbajë informacionin e parashikuar në nenin 39 të këtij ligji.

4. Procedurat e hollësishme të organizimit për të dyja format e konkursit të projektimit, sipas pikës 2 të këtij neni, parashikohen në rregullat e prokurimit.

5. Rregullat e konkursit u komunikohen të gjithë të interesuarve, që kërkojnë të marrin pjesë në të. Pjesëmarrja në konkurs mund të kufizohet në një numër kandidatësh të përzgjedhur, në bazë të kriterëve të qarta dhe jodiskriminuese, që u janë bërë të njohura të gjithë personave të interesuar, me kusht që numri i kandidatëve të ftuar, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit, të jetë i mjaftueshëm për të siguruar një konkurrim të drejtë.

6. Pranimi i pjesëmarrjes në konkurs nuk mund të kufizohet:

a) për shkak të shtetësisë, territorit apo rezidencës;

⁸³ Fjalët "kundrejt shpërblimit monetar" janë zëvendësuar me fjalët "kundrejt çmimit", me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

b) për shkak të qenies person fizik ose juridik.

7. Komisioni krijohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregullat e prokurimit.

Ai përbëhet nga persona, që nuk kanë konflikt interesash me pjesëmarrësit në konkurs dhe merr vendime në mënyrë të pavarur, në bazë të kriterëve të përcaktuara në njoftimin për konkurs, duke respektuar parimin e fshehtësisë.

Neni 35/1⁸⁴

Marrëveshjet kuadër

1. Për kontratat publike, autoritetet kontraktore mund të lidhin një marrëveshje kuadër pas kryerjes së një procedure të hapur, të kufizuar, kërkesë për propozim, shërbim konsulence apo me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, ndërsa për kontratat sektoriale, autoritetet kontraktore mund të lidhin një marrëveshje kuadër edhe pas kryerjes së një procedure me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit.⁸⁵

2. Palët në marrëveshjen kuadër zgjidhen duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, në përputhje me nenin 55 të ligjit.

⁸⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁸⁵ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

3. Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër lidhen në përputhje me procedurat e parashtruara në pikat 5 e 6 të këtij neni. Këto procedura mund të zbatohen vetëm ndërmjet enteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, të cilët kanë qenë që në fillim palë në marrëveshjen kuadër. Kur lidhen kontrata, të bazuara në një marrëveshje kuadër, palët nuk munden, në asnjë rrethanë, të bëjnë ndryshime thelbësore të kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër, veçanërisht në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni.

4. Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më e gjatë se katër vjet, përveç rasteve të jashtëzakonshme, plotësisht të justifikueshme, në veçanti nga subjekti i marrëveshjes kuadër.

5. Kur një marrëveshje kuadër arrihet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve dhe kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër. Për prokurimin e këtyre kontratave, autoriteti kontraktor komunikon me shkrim me operatorin palë në marrëveshjen kuadër, duke i kërkuar atij të plotësojë ofertën, në përputhje me kërkesat.

6. Kur një marrëveshje kuadër lidhet me disa operatorë ekonomikë, këta të fundit duhet të jenë, të paktën, tre, në numër, për sa kohë që ekziston një numër i mjaftueshëm operatorësh ekonomikë, për të përmbushur kriteret e përzgjedhjes dhe/ose të pranimit të ofertave, që përmbushin kriteret e përcaktimit të

ofertës fituese, në përputhje me nenin 55 të ligjit. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër, të arritura ndërmjet disa operatorëve ekonomikë, mund të lidhen në një nga këto mënyra:⁸⁶

a) nëpërmjet zbatimit të kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër, pa rihapur konkurrimin;

b) kur jo të gjitha kushtet janë të parashtruara në marrëveshjen kuadër, kur palët gjenden sërisht në konkurrim, sipas të njëjtave kushte dhe, nëse është e nevojshme, në bazë të kushteve të formuluar më saktësisht dhe aty ku kjo është e përshtatshme, kur parashikohen kushte të tjera në specifikimet e marrëveshjes kuadër, në përputhje me procedurën në vijim:

i) për çdo kontratë, që do të prokurohet, autoritetet kontraktore duhet të këshillohen, me shkrim, me operatorët ekonomikë, që janë në gjendje të zbatojnë kontratën;

ii) autoritetet kontraktore duhet të caktojnë një kufi kohor, të mjaftueshëm për dorëzimin e ofertave, për secilën kontratë specifike, duke marrë parasysh kompleksitetin e objektit, që do të prokurohet, dhe kohën e nevojshme për të dorëzuar ofertat;

iii) ofertat do të dorëzohen me shkrim dhe përmbajtja e tyre duhet të mbetet

⁸⁶ Kjo fjali është ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

konfidenciale, derisa kufiri i përcaktuar kohor për përgjigje të ketë skaduar;

iv) autoritetet kontraktore do t'ia japin secilën kontratë ofertuesit, që ka dorëzuar ofertën më të mirë, në bazë të kriterëve të shpalljes së kontratës fituese, të përcaktuara në specifikimet e marrëveshjes kuadër.

7. Autoritetet kontraktore nuk mund t'i keqpërdorin marrëveshjet kuadër për të penguar, kufizuar apo çrregulluar konkurrencën.

8. Në çdo rast, marrëveshja kuadër zbatohet sipas përcaktimeve të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.

KREU IV

PROKURIMI ELEKTRONIK

Neni 36

Rregullat e zbatueshme të komunikimeve elektronike

1. Pa cenuar parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit dhe dispozitat e nenit 22 të këtij ligji, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje nëpërmjet mjeteve të transmetimit elektronik, si më poshtë:

a) informacionet, që lidhen me specifikimet e nevojshme për paraqitjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, përfshirë enkriptimin, janë në dispozicion të palëve të interesuara. Mjetet për marrjen elektronike të ofertave dhe

kërkesave për pjesëmarrje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik dhe me legjislacionin përkatës;

b) ofertat elektronike duhet të jenë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për nënshkrimin elektronik, dokumentin elektronik, si dhe për bazat e të dhënave shtetërore;

c) përpara përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar për dorëzimin e ofertave ose të kërkesave për pjesëmarrje, ofertuesit marrin përsipër të paraqesin dokumentet, certifikatat dhe dëshmitë, të përmendura në nenet 45 dhe 46 të këtij ligji, nëse këto të fundit nuk ekzistojnë në format elektronik.⁸⁷

2. Pa paragjykuar parimin e mosdiskriminimit dhe detyrimet e nenit 22 të këtij ligji, rregullat e mëposhtme zbatohen për nënshkrimin në formë elektronike për gjithçka që ka të bëjë me paraqitjen dhe pranimin e ofertave dhe dokumenteve të lidhura me to:

a) kur ligji i prokurimit publik parashikon nënshkrimin nga ana e një personi, kjo kërkesë quhet e përmbushur për të gjitha dokumentet e tenderit, nëse nënshkrimi elektronik i përdorur është i besueshëm dhe i përshtatshëm për qëllime, për të cilat dokumenti elektronik është krijuar ose është komunikuar, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat konkrete ose në përputhje me ligjet dhe rregullat me aplikim të

⁸⁷ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

përgjithshëm për tregtinë në formë elektronike;

b) nënshkrimi në formë elektronike do të konsiderohet i besueshëm dhe në përputhje me këtë ligj nëse:

i) nënshkrimi është i dukshëm dhe brenda materialit për të cilin prezantohet, i lidhur logjikisht me personin që firmos dhe jo me ndonjë person tjetër;

ii) dokumentet origjinale ose të dhënat e përdorura për nënshkrimin në mënyrë elektronike në momentin e firmosjes kanë qenë nën kontrollin ekskluziv të personit që nënshkruan dhe mbeten të tilla gjatë procesit të prokurimeve dhe për një kohë të arsyeshme pas përfundimit të procesit të prokurimit dhe siç parashikohet nga legjislacioni ose rregullat e prokurimit publik;

iii) çdo ndryshim në nënshkrimin elektronik, i bërë pas kohës së firmosjes, mund të dallohet me një kujdes të arsyeshëm;

iv) asnjë nga parashikimet në këtë nen nuk ka për qëllim të kufizojë mundësinë e çdo personi ose operatori ekonomik që, në çdo mënyrë të lejuar nga legjislacioni në fuqi, të provojë apo të kundërshtojë besueshmërinë e nënshkrimit elektronik.

Neni 37

Blerja elektronike dhe sistemi dinamik i

blerjes

Për të kryer një procedurë elektronike prokurimi, autoriteti kontraktor ndjek rregullat e blerjes elektronike dhe të sistemit dinamik të blerjes, të përshkuara

në rregullat e prokurimit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me parimet e përmendura në nenin 2 të këtij ligji dhe me standardet ndërkombëtare e europiane.

Neni 37/1⁸⁸

KREU V

ZHVILLIMI I PROCEDURAVE

Neni 38

Njoftimet

1. Autoriteti kontraktor, që kryen procedura prokurimi për kontrata publike me anë të procedurës së hapur, të kufizuar, me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, kërkesës për propozim ose shërbim konsulence, në përputhje me nenet 30, 31, 32, 34 e 34/1 të këtij ligji, ose kur fillon procedurën për konkurs projektimi, sipas nenit 35 të ligjit, bën njoftimin publik për kryerjen e llojit përkatës të prokurimit publik.⁸⁹

2. Njoftimet për prokurimet me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në të paktën një gazetë me shpërndarje në Europë.

3. Njoftimet për prokurimet me vlerë nën kufirin e lartë monetar, por mbi kufirin

⁸⁸ Shfuqizuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

⁸⁹ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

minimal monetar botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.

4. Të gjitha njoftimet e prokurimeve shpallen në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Neni 39

Përmbajtja e njoftimeve

1. Në njoftimet që botohen, sipas nenit 38 të këtij ligji, duhet të përfshihen të gjitha informacionet që i lejojnë operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e prokurimit.

2. Në njoftimin për procedurë të hapur duhet të përcaktohen edhe vendi, adresa dhe afati i fundit kohor, ku e kur do të dërgohen ofertat, si dhe gjuha ose gjuhët në të cilat duhet të hartohen ofertat. Në njoftim duhet të përcaktohen edhe mënyra dhe kushtet për marrjen e dokumenteve të tenderit, siç parashikohet në nenin 41 të këtij ligji.

3. Përmbajtja e njoftimeve standarde përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Neni 40

Ftesa për ofertë

1. Autoriteti kontraktor fton nëpërmjet një komunikimi me shkrim *ose me mjete elektronike*⁹⁰ njëherësh të gjithë kandidatët e përzgjedhur në procedurën e kufizuar dhe në procedurat me negociim, me njoftim të objektit të kontratës, sipas

neneve 31 e 32 të këtij ligji, për të dorëzuar ofertat ose për të negociuar.

2. Ftesa për kandidatët përfshin edhe:

a) një kopje të dokumenteve të tenderit dhe çdo dokument tjetër mbështetës;

b) një referencë për akses të dokumenteve të tenderit dhe të dokumenteve të tjera, të përcaktuara më sipër me rrugë elektronike.

3. Modelet e ftesës për ofertë apo të ftesës për negociim përshkruhen në rregullat e prokurimit. Ftesa, në çdo rast, duhet të përmbajë të paktën:

a) një referencë për njoftimin e kontratës që botohet;

b) të dhëna për vendin dhe afatin e fundit kohor të paraqitjes së ofertave, si dhe dokumenteve të tjera, të përcaktuara më sipër me rrugë elektronike.

3. Modelet e ftesës për ofertë apo të ftesës për negociim përshkruhen në rregullat e prokurimit. Ftesa, në çdo rast, duhet të përmbajë të paktën:

a) një referencë për njoftimin e kontratës që botohet;

b) të dhëna për vendin dhe afatin e fundit kohor të paraqitjes së ofertave, si dhe gjuhën ose gjuhët në të cilat duhet të hartohet oferta;

c) informacion për çdo dokument shtesë që duhet dorëzuar ose në mbështetje të deklaratave të ofertuesve, në përputhje me nenet 45 dhe 46 të këtij ligji, ose për të plotësuar informacionin e përmendur në këto nene;

ç) renditjen sipas përparësisë të kriterëve të vendosura për përcaktimin e ofertës

⁹⁰ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

fituese, si dhe specifikimet apo dokumentin përshkrues, në rastet kur këto nuk janë botuar në njoftimet e ftesës.

4. Autoriteti kontraktor, kur përdor procedurën e kufizuar dhe procedurën me negociim, fton për të paraqitur ofertë të gjithë kandidatët që kualifikohen në fazën e parë të procedurës. Autoriteti kontraktor mund të vazhdojë procedurën e prokurimit vetëm kur janë të paktën 2 kandidatë, me përjashtim të procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit. Në njoftimin për tender, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kriteret objektive, jodiskriminuese, si dhe rregullat që do të zbatohen⁹¹.

Neni 41⁹²

Dokumentet e tenderit

1. Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike.

2. Autoriteti kontraktor, kur i kërkohet nga operatorët ekonomikë, do të vërë në dispozicion të të interesuarve dokumentet e tenderit, kundrejt pagesës. Në çdo rast, emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e

⁹¹ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

⁹² Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret."

Neni 42

Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit⁹³⁹⁴

2. Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për

⁹³ "Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentat e tenderit, autoriteti kontraktor e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës, me 5 ditë ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë" Shfuqizuar.

me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁹⁴ Hiqet fjalia "Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik" me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike.

2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.⁹⁵

3. Autoriteti kontraktor, gjatë takimit me operatorët ekonomikë, duhet të mbajë protokoll, ku përfshihen edhe kërkesat e dorëzuara gjatë takimit për sqarime për dokumentet e tenderit, si dhe përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, por, në çdo rast, pa identifikuar burimet e këtyre kërkesave. Ky protokoll duhet t'u vihet menjëherë në dispozicion të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë tërhequr dokumentet e tenderit, që të orientohen në përgatitjen e ofertave.

Neni 43

Afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe për dorëzimin e ofertave

1. Autoriteti kontraktor, për përcaktimin e afateve kohore për dorëzimin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, duhet të mbajë parasysh kompleksitetin e kontratës dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave, pa cenuar kufijtë kohorë minimalë, të përcaktuar në këtë nen dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Afatet kohore në këtë ligj jepen në ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur ka specifitime të tjera.

2. Në procedurën e hapur, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati për paraqitjen e ofertave është jo më pak se 52 ditë nga data në të cilën *është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik*⁹⁶

2.1⁹⁷

3. Në procedurën e kufizuar, në procedurën me negociim, me shpallje të njoftimit, në procedurën shërbim konsulente dhe në procedurën konkurs projektimi, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar:⁹⁸

⁹⁵ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

⁹⁶ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

⁹⁷ Shfuqizuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

⁹⁸ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë

a) afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje është 20 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik⁹⁹;

b) në procedurën e kufizuar, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 20 ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë te kandidatët.

4. Nëse, për çfarëdo arsye, dokumentet e tenderit, dokumentet mbështetëse ose informacionet shtesë, edhe pse të kërkuara në kohën e duhur, nuk paraqiten brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftimin e kontratës, ose nëse ofertat mund të hartohen vetëm pas një vizite në terren, pas një verifikimi të çastit të dokumenteve, në mbështetje të dokumenteve të tenderit, atëherë afatet kohore për dorëzimin e ofertave zgjaten me 10 ditë, me qëllim që të gjithë operatorët ekonomikë të marrin informacionin e nevojshëm për të hartuar ofertat.

5. Në procedurën e hapur, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar, afati kohor minimal për marrjen e ofertave është 30 ditë nga dita kur është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik¹⁰⁰.

20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

⁹⁹ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁰⁰ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në

6. Në procedurën e kufizuar ose në procedurën me negociim, me shpalljen e njoftimit të kontratës, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar:

a) afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje është 15 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik¹⁰¹;

b) në procedurën e kufizuar, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 15 ditë nga data në të cilën është dërguar te kandidatët ftesa për ofertë,¹⁰².

6/1.¹⁰³ Në procedurën shërbim konsulence dhe në procedurën konkurs projektimi, me vlerë nën kufirin e lartë monetar:

a) afati minimal kohor për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje është 15 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik;

b) afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 15 ditë nga data në të cilën është dërguar te kandidatët ftesa për ofertë.

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁰¹ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁰² Zëvendësuar në Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 "Për Prokurimin Publik".

¹⁰³ Shtuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

7. Në rastet e procedurave të prokurimit nën kufirin e ulët monetar, afati kohor minimal për dorëzimin e ofertave është 10 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik¹⁰⁴.

8. Kur njoftimet janë hartuar dhe publikuar me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik, afatet kohore për marrjen e ofertave, të parashikuara në pikat 2 e 5 të këtij neni, për procedura të hapura, mund të shkurtohen 7 ditë, ndërsa afatet kohore për marrjen e kërkesës për pjesëmarrje, të parashikuara në shkronjat "a" e "b" të pikës 3 dhe në shkronjat "a" e "b" të pikës 6 dhe të pikës 6/1¹⁰⁵ të këtij neni, për procedurat e kufizuara, shërbim konsulence, konkurs projektimi¹⁰⁶ dhe me negociim, mund të shkurtohen 5 ditë".¹⁰⁷

¹⁰⁴ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁰⁵ Fjalët "dhe të pikës 6/1" janë shtuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹⁰⁶ Fjalët "shërbim konsulence, konkurs projektimi" janë shtuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹⁰⁷ Shtuar me ligjin nr 9855 datë 26.12.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik".

Neni 44

Operatorët ekonomikë

1. Kandidatët ose ofertuesit, që ofrojnë shërbimet përkatëse, nuk duhet të refuzohen vetëm për shkak se u kërkohet të jenë persona fizikë ose juridikë. Në rastet e kontratave publike për shërbime apo punë, si dhe të kontratave publike të furnizimit për shërbime shtesë dhe/ose veprimtari instalimi, autoritetet kontraktore mund t'u kërkojnë personave juridikë të paraqesin në ofertë ose në kërkesën për pjesëmarrje emrat dhe kualifikimet profesionale përkatëse të personelit përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. Autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit.

Neni 45

Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve

1. Autoriteti kontraktor përjashton nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit çdo kandidat ose ofertues, kur ka të dhëna se janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për ndonjë nga veprat e mëposhtme:
 - a) pjesëmarrje në organizatë kriminale;
 - b) korrupsion;
 - c) mashtrim;

ç) pastrim parash.

d) fallsifikim¹⁰⁸.

Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentet e përmendura në pikën 3 të këtij neni dhe, kur ka dyshime, mund t'u drejtohet organeve kompetente për të marrë ndonjë informacion të nevojshëm për integritetin dhe gjendjen personale të ofertuesve në fjalë. Kur kërkohet informacion për ofertuesin rezident në një shtet të huaj, atëherë autoriteti kontraktor mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente.

2. Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur:

a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përbaruesit¹⁰⁹;

b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

ç)¹¹⁰;

d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë seksion, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

ë)¹¹¹ me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

3. Autoriteti kontraktor pranon si prova të mjaftueshme, që shmangin përjashtimin e kandidatëve apo ofertuesve për rastet e parashikuara në pikat e mësipërme, këto dokumente:

a) vërtetim nga dosja gjyqësore, ose në rast se nuk sigurohet kjo, një dokument të njëjvlershëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent, gjyqësor apo administrativ, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikat 1 e 2, shkronjat "a", "b" e "c";

¹⁰⁸ Shtuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 "Për Prokurimin Publik"

¹⁰⁹ Ndryshuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

¹¹⁰ Shfuqizuar me me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

¹¹¹ Shtuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Neni 46

Kualifikimi i ofertuesve

1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të

xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevoje, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;

ç) kapacitetet ligjore: operatorët ekonomikë vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh”.

2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.

3. Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik¹¹².

Neni 47

Skualifikimi i ofertuesve

Autoriteti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna

¹¹² Shtuar me ligjin nr. 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar

të rreme¹¹³, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese. Autoriteti kontraktor për çdo skualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji.

Neni 48

Paraqitja dhe pranimi i ofertave

1. Autoriteti kontraktor përcakton vendin, datën dhe orën e paraqitjes së ofertave.
2. Kur autoriteti kontraktor jep sqarime ose bën ndryshime në dokumentat e tenderit, vepron në përputhje me nenin 42 të këtij ligji¹¹⁴.
3. Vendimi për shtyrje të afatit përfundimtar u njoftohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet.
4. Paraqitja e ofertave bëhet si më poshtë:
 - a) ofertat dorëzohen me shkrim, dorazi ose përmes postës, të nënshkruara dhe të mbyllura në zarf, me përjashtim të rasteve të përmendura në shkronjën “b” të kësaj pike, kur autoriteti kontraktor, sipas kërkesës, pajis ofertuesit me një dëshmi, ku shënohen data dhe ora e pranimit të ofertës;

¹¹³ Hiqen fjalet “ose një dokument të falsifikuar” me ligjin nr. 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar

¹¹⁴ Ndryshuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 “Për Prokurimin Publik”

b) ofertat dorëzohen në rrugë elektronike, sipas përcaktimit në aktet nënligjore.5. Ofertat e marra pas mbarimit të afatit të fundit të paraqitjes së tyre u kthehen të pahapura ofertuesve, që i kanë paraqitur ato.¹¹⁵

Neni 49

Sigurimi i ofertës

1. Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas rregullave të prokurimit publik.¹¹⁶
 - a) vlera e sigurimit duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e përllogaritur¹¹⁷ e kontratës së prokurimit;
 - b) autoriteti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit çdo kërkesë për natyrën, formën, vlerën dhe kushtet e tjera thelbësore të sigurimit të ofertës. Këto kërkesa nuk duhet të lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me sjelljen e ofertuesit që dorëzon një ofertë, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:
 - i) tërheqjes ose ndryshimit të ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse

¹¹⁵ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar

¹¹⁶ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

¹¹⁷ Shtuar me ligjin nr. 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;

ii) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

iii) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimi të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

1/1.¹¹⁸

2. Në rast se autoriteti kontraktor e ka kërkuar sigurimin e ofertës, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk e pretendon vlerën e sigurimit, nëse.¹¹⁹

a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës;

b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit;

c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

Neni 50

Vlefshmëria, modifikimi dhe tërheqja e ofertave

1. Ofertat janë të vlefshme gjatë periudhës kohore të specifikuar në dokumentet e tenderit.

¹¹⁸ Shfuqizuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹¹⁹ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

2. Autoriteti kontraktor, përpara përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertave, mund t'u kërkojë ofertuesve të zgjasin këtë periudhë për një afat të caktuar. Në këtë rast:

a) ofertuesi mund të refuzojë kërkesën, pa humbur sigurimin e ofertës nëse është kërkuar¹²⁰ dhe vlefshmëria e ofertës së tij përfundon me mbarimin e periudhës fillestare të vlefshmërisë;

b) kur ofertuesi pranon zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë, me të zgjatet edhe sigurimi i ofertës nëse është kërkuar një sigurim i tillë¹²¹ apo paraqitet një sigurim i ri oferte, që mbulon periudhën e zgjatur të vlefshmërisë. Ofertuesi, që nuk zgjat periudhën e sigurimit të ofertës ose që nuk paraqet një sigurim të ri oferte, vlerësohet se e ka refuzuar kërkesën për zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

Neni 51

Ndalimi i modifikimit të ofertave

1. Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit kontraktor dhe ofertuesit për ofertën, në përputhje me pikën 1 të nenit 53 të këtij ligji.

¹²⁰ Fjalët "nëse është kërkuar" janë shtuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹²¹ Fjalët "nëse është kërkuar një sigurim i tillë" janë shtuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t'i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.
3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 32 dhe 33 të këtij ligji.

Neni 52

Hapja e ofertave

1. Autoriteti kontraktor i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuar në dokumentet e tenderit.
2. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, që kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave.
3. Emri, adresa e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, dokumentacioni ligjor dhe çdo dokument i kërkuar nga autoriteti kontraktues, si dhe çmimi i çdo oferte, lexohen me zë të lartë për ata persona që janë të pranishëm dhe regjistrohen në procesverbalin e procedurës së prokurimit, sipas nenit 12 të këtij ligji.
4. Procesverbali duhet t'i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesit që ka paraqitur ofertën, por që nuk është i pranishëm ose i

përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'i dërgohet për njoftim.

5. Procesverbali i hapjes¹²² së ofertave shpallet në faqen e internetit dhe bëhet i disponueshëm si i gjithë dokumentacioni i tenderit.

6. Në rastin e prokurimit me mjete elektronike, hapja e ofertave bëhet si më poshtë:

a) Autoriteti kontraktor i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar, të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuar në dokumentet e tenderit, sipas rregullave të prokurimit me mjete elektronike.

b) Duke qenë se dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesit regjistrohet automatikisht në sistem, pikat 2, 3, 4 e 5 nuk zbatohen në rastin e prokurimit me mjete elektronike.¹²³

Neni 53

Shqyrtimi i ofertave

1. Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin,

¹²² Hiqen fjalët " dhe i vlerësimit të " me ligjin Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 "Për Prokurimin Publik"

¹²³ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. Autoriteti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën.

3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.¹²⁴

5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë:

- a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar;
- b) kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, i bërë sipas pikës 2 të këtij neni;
- c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji;
- ç) në rastet e parashikuara në nenin 26 të këtij ligji.

Neni 54

Alternativat

1. Autoriteti kontraktor i autorizon ofertuesit të paraqesin alternativat, kur kriter për shpalljen fituese është oferta me përparësi më të mëdha ekonomike.
2. Autoriteti kontraktor, në njoftimin e kontratës duhet të përcaktojë nëse i autorizon alternativat, në të kundërt, ato nuk lejohen.
3. Autoriteti kontraktor, kur autorizon alternativa, përcakton në dokumentet e tenderit kërkesat minimale për çdo alternativë dhe çdo kërkesë tjetër për paraqitjen e tyre.
4. Vetëm alternativat që i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, merren në shqyrtim.

Neni 55

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. *Oferta fituese duhet të jetë:*

¹²⁴ *Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar*

a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; ose

b) oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriterë të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kriterë të jenë objektive dhe jodiskriminuese¹²⁵.

2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar

ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e

tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

3. Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në baza teknike dhe ekonomike.

4. Autoriteti kontraktor duhet të përgatisë një përshkrim të shkurtër të procesit të vlerësimit, i cili pasqyrohet në procesverbal, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji. Në rastin e prokurimit me mjete elektronike, sistemi administron automatikisht të

dhënat, vlerësimet dhe komentet mbi to, duke njoftuar, në rrugë elektronike, ofertuesit.¹²⁶

5. Autoriteti kontraktor përcakton ofertën më të mirë pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

Neni 56

Oferta anomalisht e ulët

1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:¹²⁷

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e

¹²⁶ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

¹²⁷ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹²⁵ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Neni 57

Administrimi i informacionit në proces

1. Pas hapjes së ofertave, pa cenuar detyrimet e përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji, informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin e ofertave dhe rekomandimet për ofertën fituese nuk u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces, derisa të nënshkruhet kontrata.

2. Pas hapjes së ofertave dhe deri në shpalljen e ofertës fituese, asnjë ofertues nuk duhet të bëjë asnjë komunikim të pajustificuar me autoritetin kontraktor ose të përpiqet, në çfarëdo mënyre, për të ndikuar në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.

Neni 58

Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës

1. Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit, që ka paraqitur ofertën më të mirë, në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

2. Brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të fituesit, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në Agjencinë e Prokurimit Publik për botimin në Buletinin e Njoftimeve Publike. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, njoftimi i fituesit dërgohet në platformën elektronike të prokurimit, ditën e nesërme të punës nga marrja e vendimit.

Njoftimi përmban minimalisht këtë informacion:

a) emrat e ofertuesve pjesëmarrës;

b) vlerat e ofertave;

c) emrat e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit;

ç) emrin e ofertuesit të suksesshëm dhe vlerën e ofruar prej tij;

d) ankesa, nëse ka pasur ose jo të tilla.¹²⁸

3. Autoriteti kontraktor dhe ofertuesi fitues nënshkruajnë kontratën, sipas afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në çdo rast kjo periudhë nuk duhet të tejkalojë afatin e vlefshmërisë së ofertës, të përcaktuar në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.¹²⁹

4. Kontrata hyn në fuqi kur nënshkruhet nga ofertuesi fitues dhe nga autoriteti kontraktor.

5. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë

¹²⁸ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

¹²⁹ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës, nëse është kërkuar. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “çmimi më i ulët” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë do të jetë jo më e madhe se 2 për qind e fondit limit.¹³⁰ *Kjo nuk cenon të drejtën e autoritetit kontraktor, sipas nenit 24 të këtij ligji, për të refuzuar të gjitha ofertat e mbetura dhe për të anuluar procedurën e prokurimit. Njoftimi, sipas pikës 1 të këtij neni, i dërgohet ofertuesit, oferta e të cilit është përzgjedhur sipas kësaj pike¹³¹.*

6. Lidhja e kontratës para përfundimit të afatit të njoftimit të klasifikimit apo para se të ketë përfunduar shqyrtimi administrativ, sipas kreut VII të këtij ligji, e bën atë absolutisht të pavlefshme.

¹³⁰ Fjalja e pare dhe e dytë e kësaj pike janë ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

¹³¹ Riformuluar me ligjin nr. 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

KREU V/1¹³² ZHVILLIMI I PROCEDURAVE PËR KONTRATAT SEKTORIALE

Neni 58/1

Kontratat sektoriale

1. Ky kre përmban dispozita të veçanta, që zbatohen nga autoritetet kontraktore, të cilat veprojnë në sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, të transportit dhe atij postar, kur ato prokurojnë kontrata sektoriale. Për qëllim të këtij kreu, kontratat sektoriale janë kontrata publike, të lidhura nga autoritetet kontraktore, siç parashikohet në pikën 14/1 të nenit 3, nëse kontrata është për kryerjen e secilës prej veprimtarive të mëposhtme:

- a) ofrimin ose përdorimin e rrjeteve fikse, që kanë për qëllim t’i ofrojnë publikut shërbime për prodhimin, transportin a shpërndarjen e energjisë elektrike, të gazit apo të nxehtësisë ose furnizimin me energji elektrike, gaz a nxehtësi të këtyre rrjeteve;
- b) shfrytëzimin e një zone gjeografike, për qëllime eksplorimi, me mundësinë për të nxjerrë naftë, gaz, qymyr apo karburante të tjera, të ngurta, furnizimin e aeroporteve dhe të porteve detare a tokësore ose të strukturave të tjera, të terminaleve për transportuesit ajrorë, detarë ose të ujërave tokësore;
- c) ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t’i ofrojnë publikut

¹³² Gjithe Kreu V/1 shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

shërbime për prodhimin, transportin a shpërndarjen e ujit të pijshëm apo furnizimin me ujë të pijshëm të këtyre rrjeteve a menaxhimin e tyre;

ç) ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut shërbime në fushën e transportit, nëpërmjet hekurudhave, sistemeve automatike, tramvajeve, autobusëve elektrikë a teleferikëve;

d) ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut shërbime në fushën e transportit me autobus;

dh) ofrimin e shërbimeve postare.

2. Autoritetet kontraktore, që prokurojnë kontrata sektoriale, zbatojnë dispozitat e kërërve të tjerë të ligjit, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në këtë kre.

3. Autoritetet kontraktore zbatojnë dispozitat e këtij kreu edhe për lidhjen e kontratave që parashikohen në shkronjën "c" të pikës 1 dhe që:

a) kanë lidhje me projekte inxhinierike hidraulike, të ujitjes apo të drenazhimit të tokës, me kusht që vëllimi i ujit, që do të përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm, të përbëjë jo më tepër se 20 për qind të vëllimit të përgjithshëm të bërë të disponueshëm nga këto projekte apo nga infrastruktura ujitëse a drenazhuese; ose

b) kanë lidhje me zhvendosjen apo trajtimin e ujërave të zeza, për sistemet e kanalizimeve dhe të trajtimit të këtyre ujërave dhe me veprimtaritë, që kanë lidhje me përfitimën e ujit të pijshëm.

4. Për sa u përket shërbimeve të transportit, të parashikuara në shkronjat "ç" e "d" të

pikës 1 të këtij neni, një rrjet vlerësohet se ekziston atëherë kur shërbimi ofrohet në kushtet e punës, të parashtruara nga një autoritet përkatës, siç janë kushtet e linjave, që do të shërbehen, në kapacitetin që do të ofrohet apo në frekuencën e shërbimit.

5. Autoritetet kontraktore, që lidhin kontratat e parashikuara në shkronjën "dh" të pikës 1 zbatojnë dispozitat e këtij kreu edhe për kontratat, që kanë lidhje me ofrimin e shërbimeve të mëposhtme: menaxhimin e shërbimit postar, para dhe pas dërgimit, transmetimit të dokumenteve të koduara, me mjete elektronike komunikimi, menaxhimin e bazave të të dhënave të adresave, transmetimin e postës së regjistruar elektronike, shërbimet financiare, filatelike dhe logjistike, veçanërisht, transportimin e mallrave të përdorimit të gjerë, si edhe paketimin e magazinimin e tyre.

Neni 58/2

Prokurimet, që përfshijnë disa veprimtari të ndryshme

1. Një kontratë, që synon të mbulojë disa veprimtari të ndryshme, është objekt i rregullave të zbatueshme për veprimtarinë kryesore të synuar. Sidoqoftë, zgjedhja ndërmjet dhënies së një kontrate të vetme dhe dhënies së një numri kontratash të veçanta nuk mund të kryhet me objektivin

e përjashtimit të saj nga fusha e këtij kreu apo, aty ku është e mundur, nga dispozita të tjera të këtij ligji.

2. Nëse njëra prej veprimtarive, për të cilën është përgatitur kontrata, është objekt i këtij kreu dhe veprimtaria tjetër i kërërve I e V të këtij ligji dhe nëse është objektivisht e pamundur të përcaktohet se cilën veprimtari kryesore mbulon kontrata, atëherë kontrata prokurohet në përputhje me kërërët I e V.

3. Nëse njëra prej veprimtarive, për të cilën është përgatitur kontrata, është objekt i këtij kreu dhe tjetra nuk është objekt as i këtij kreu apo edhe i kërërve I e V dhe nëse është objektivisht e pamundur të përcaktohet se cilën veprimtari kryesore mbulon kontrata, atëherë kontrata prokurohet në përputhje me këtë kre.

Neni 58/3

Kontratat e lidhura për qëllime të rishitjes apo dhënies me qira palëve të treta

Ky kre nuk është i zbatueshëm për kontratat sektoriale, të lidhura nga autoritetet kontraktore për qëllime të rishitjes apo dhënies me qira të objektit të kontratës palëve të treta, me kusht që autoriteti kontraktor të mos ketë të drejtë, të veçantë apo ekskluzive, për ta shitur apo dhënë me qira objektin e kontratës dhe që autoritetet e tjera të mund ta shesin dhe ta japin me qira pa kufizime dhe me të njëjtat kushte si autoriteti kontraktor.

Neni 58/4

Kontratat për sipërmarrje të lidhura, për një bashkim operatorësh ekonomikë apo për një ent kontraktor, që është pjesë e një bashkimi operatorësh ekonomikë

1. Ky kre nuk është i zbatueshëm për kontratat sektoriale të lidhura nga autoriteti kontraktor për një sipërmarrje të lidhur apo për një bashkim operatorësh ekonomikë, të formuar ekskluzivisht nga një numër autoritetesh kontraktore, për kryerjen e veprimtarive, që parashikohen në nenin 58/1, për një sipërmarrje të lidhur me njërin prej këtyre enteve kontraktore, me kusht që të përmbushen kushtet e parashtruara në pikën 3 të këtij neni.

2. Për qëllime të këtij neni, "sipërmarrje e lidhur" nënkupton çdo sipërmarrje:

a) llogaritë vjetore të së cilës janë të konsoliduara me ato të autoritetit kontraktor, në përputhje me rregullat e kontabilitetit;

b) mbi të cilën autoriteti kontraktor mund të ushtrojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndikim dominues, sipas kuptimit të shkronjës "b" të pikës 14/1 të nenit 3, apo e cila mund të ushtrojë një ndikim dominues mbi autoritetin kontraktor, ose e cila, së bashku me autoritetin kontraktor, është subjekt i ndikimit dominues të një sipërmarrjeje tjetër, si rrjedhojë e pronësisë, pjesëmarrjes financiare apo e rregullave që e drejtojnë atë.

3. Pika 1 e këtij neni është e zbatueshme nëse, të paktën, 80 për qind e xhiros mesatare së sipërmarrjes së lidhur, gjatë tri

viteve të mëparshme vjen si rezultat i ofrimit të këtyre shërbimeve, furnizimeve apo punimeve për sipërmarrjet, me të cilat ajo është lidhur. Kur, për shkak të datës në të cilën është krijuar apo ka filluar veprimtarinë një sipërmarrje e lidhur, xhiroja nuk është e disponueshme për 3 vitet pararendëse, mjafton që ajo sipërmarrje të tregojë se xhiroja e paraqitur më sipër është e besueshme, sidomos nëpërmjet parashikimeve të bëra për të ardhmen e biznesit. Kur më tepër se një sipërmarrje e lidhur me autoritetin kontraktor ofron të njëjtat shërbime, furnizime ose punime të ngjashme, përqindja e mësipërme llogaritet duke marrë parasysh xhiron e përgjithshme, që vjen, përkatësisht, nga ofrimi i shërbimeve, furnizimeve apo punimeve të atyre sipërmarrjeve të lidhura.

4. Ky kre nuk është, gjithashtu, i zbatueshëm për kontratat e lidhura:

a) prej një bashkimi operatorësh ekonomikë, të krijuar ekskluzivisht nga një numër entesh kontraktore, për kryerjen e veprimtarive brenda kuptimit të asaj që parashikohet në nenin 58/1 të këtij ligji, për njërin prej këtyre enteve kontraktore;

b) nga një ent kontraktor, pjesë e një sipërmarrjeje të përbashkët, me kusht që kjo sipërmarrje të jetë krijuar për të kryer veprimtarinë në fjalë, brenda një periudhe prej, të paktën, tre vjetësh dhe që instrumenti i krijimit të sipërmarrjes së përbashkët të përcaktojë se entet kontraktore, të cilat e formojnë atë, janë

pjesë e saj, të paktën, për të njëjtën periudhë kohore.

Neni 58/5

Përfshirjet specifike për sektorin e energjisë dhe të ujit

1. Ky kre nuk është i zbatueshëm për kontratat sektoriale, të lidhura nga autoritetet kontraktore të parashikuara në shkronjat “b” e “c”, të pikës 14/1 të nenit 3, për qëllime të kryerjes së një veprimtarie, që ka të bëjë me ofrimin e gazit apo të nxehtësisë për rrjetet e përmendura në paragrafin e parë, të pikës 1 të nenit 58/1 të këtij ligji, nëse:

a) prodhimi i gazit apo i nxehtësisë është një pasojë e pashmangshme për kryerjen e një veprimtarie tjetër, që nuk përshkruhet në nenin 58/1 të këtij ligji;

b) qëllimi i ofrimit të gazit ose i nxehtësisë është vetëm për të përdorur prodhimin për qëllime ekonomike dhe kur ai nuk kalon 20 për qind të xhiros mesatare të operatorit ekonomik gjatë periudhës së tri viteve të mëparshme, përfshirë vitin në të cilin është lidhur kontrata.

2. Ky ligj nuk është i zbatueshëm për kontratat sektoriale, të lidhura nga autoritetet

kontraktore, siç parashikohet në shkronjat “b” e “c” të pikës 14/1 të nenit 3, për qëllime të kryerjes së një veprimtarie, që ka të bëjë me ofrimin e energjisë elektrike për rrjetet e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58/1 të këtij, nëse:

a) prodhimi i energjisë elektrike është i nevojshëm për të kryer një veprimtari të ndryshme nga ajo e parashikuar në nenin 58/1 të këtij ligji;

b) ofrimi i energjisë elektrike varet vetëm nga konsumi vetjak dhe nuk tejkalon 30 për qind të prodhimit të përgjithshëm gjatë periudhës së tri viteve të mëparshme, përfshirë vitin në të cilin është lidhur kontrata.

3. Ky kre nuk është i zbatueshëm për kontratat sektoriale, të lidhura nga autoritetet

kontraktore të parashikuara në shkronjat “b” e “c” të pikës 14/1 të nenit 3, për qëllime të kryerjes së një veprimtarie, që ka të bëjë me ofrimin e ujit të pijshëm për rretet e parashikuara në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 58/1 të këtij ligji, nëse:

a) prodhimi i ujit të pijshëm është i nevojshëm për kryerjen e një veprimtarie të

ndryshme nga ajo e parashikuar në nenin 58/1 të këtij ligji;

b) ofrimi i ujit të pijshëm varet vetëm nga konsumi vetjak dhe nuk tejkalon 30 për qind të prodhimit të përgjithshëm gjatë periudhës së tri viteve të mëparshme, përfshirë vitin në të cilin është lidhur kontrata.

Neni 58/6

Përfshirja nga blerja e energjisë, e karburanteve dhe e ujit

1. Autoritetet kontraktore, që kryejnë veprimtarinë e parashikuar në shkronjën

“a” të pikës 1 të nenit 58/1 të këtij ligji, nuk i zbatojnë dispozitat e këtij kreu për të lidhur kontrata sektoriale për furnizimin me energji elektrike, nxehtësi ose karburante, të përdorura për prodhimin e energjisë. Kjo veprimtari rregullohet me akte të tjera ligjore ose nënligjore.

2. Autoritetet kontraktore, që kryejnë veprimtarinë e parashikuar në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 58/1 të këtij ligji, nuk i zbatojnë dispozitat e këtij kreu për lidhjen e kontratave për furnizimin me ujë.

Neni 58/7

Përfshirja e shërbimeve të transportit me autobus

Autoriteti kontraktor, që kryen veprimtarinë e parashikuar në shkronjën “dh” të pikës 1 të nenit 58/1 të këtij ligji, në bazë të të drejtave të veçanta, nuk zbaton dispozitat e

këtij kreu, nëse shërbimet e rregullta të transportit mund të ofrohen, gjithashtu, nga shoqëri të tjera transporti, në të njëjtën zonë dhe me të njëjtat kushte.

Neni 58/8

Procedurat për prokurimin e kontratave sektoriale

1. Për procedurat e prokurimit të të gjitha kontratave sektoriale, autoritetet kontraktore gjithmonë mund të përdorin procedurën e hapur, të kufizuar apo të negociuar, me shpallje të njoftimit.

2. Autoritetet kontraktore mund të prokurojnë kontrata sektoriale me

procedurë me negocim, pa shpallje të njoftimit, kur:

a) nuk është dorëzuar asnjë ofertë apo nuk ka asnjë ofertë apo aplikim të përshtatshëm në përgjigje të procedurës së hapur, të kufizuar ose të negociuar, me shpallje paraprake të njoftimit, me kusht që të mos ketë ndryshime thelbësore të kushteve fillestare të kontratës;

b) për arsye teknike apo artistike, ose për arsye, që kanë lidhje me të drejtat ekskluzive, kontrata mund të ekzekutohet vetëm nga një operator ekonomik i veçantë;

c) për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor, i parashikuar në nenin 43 të këtij ligji, për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negocim, me shpallje të njoftimit, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen, në asnjë rast, nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor.

Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit;

ç) një kontratë shpallet fituese, në bazë të marrëveshjes kuadër, me kusht që të respektohen kërkesat e nenit 58/9 të këtij ligji.

3. Procedurat me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoren për kontratat sektoriale, objekti i të cilave janë:

a) kur mallrat e përfshira prodhohen krejtësisht për qëllime kërkimore, eksperimentimi, studimi apo zhvillimi. Kjo dispozitë nuk zbatohet për prodhimin në sasi me qëllim krijimin e një qëndrueshmërie ekonomike apo mbulimin e kostove kërkimore dhe të atyre zhvillimore;

b) për furnizime shtesë nga furnitorit fillestar, të vlerësuara qoftë si zëvendësim i pjesshëm i furnizimeve normale apo i instalimeve ekzistuese ose si zgjerim i furnizimeve apo i instalimeve aktuale, ku një ndryshim i furnitorit do ta detyronte autoritetin kontraktor të blinte materiale, që do të kishin specifikime të ndryshme teknike, të cilat do të rezultonin në mospërputhshmëri ose në vështirësi të mëdha teknike gjatë shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes. Në këtë rast, kontrata shtesë nënshkruhet brenda një kufiri kohor prej 3 muajsh nga përfundimi i kontratës fillestare dhe nuk duhet të kalojë vlerën 20 për qind të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare;

c) për furnizime të kuotuar dhe të blera në tregun e mallrave të përdorimit të gjerë;

ç) për blerje me leverdi, kur është e mundur të prokurohen furnizime, duke shfrytëzuar një mundësi veçanërisht të mirë, të disponueshme vetëm për një periudhë të

shkurtër kohe, me një çmim shumë më të ulët se çmimet normale të tregut;

d) për blerje furnizimesh, me kushte veçanërisht favorizuese, nga një furnitor, në

likuidim përfundimtar të biznesit të vet ose nga marrësit apo likuiduesit e një falimentimi, me marrëveshje me kreditorët ose me një procedurë të ngjashme, në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare në fuqi.

4. Procedurat me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, mund të përdoren për kontratat sektoriale, objekti i së cilave janë:

a) për punime apo shërbime shtesë, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare, por që, nëpërmjet rrethanave të paparashikuara, bëhen të domosdoshme për ecurinë e punimeve apo të shërbimeve, të përshkruara në kontratë, me kusht që kontrata të lidhet me operatorin ekonomik, i cili është duke i kryer këto punime apo shërbime, për sa kohë që vlera e përgjithshme e kontratave të lidhura për punimet dhe shërbimet shtesë nuk duhet të kalojë 20 për qind të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare, kur punime a shërbime të tilla:

i) nuk mund të ndahen teknikisht apo ekonomikisht nga kontrata fillestare, pa shkaktuar probleme të mëdha për autoritetin kontraktor;

ii) megjithëse mund të ndahen nga kryerja e kontratës fillestare, janë tepër të domosdoshme për përfundimin e saj;

b) për punime të reja, që kanë të bëjnë me përsëritjen e punimeve të ngjashme, që i besohen operatorit ekonomik, me të cilin të njëjtat autoritete kontraktore kanë lidhur

kontratën fillestare, me kusht që këto punime apo shërbime të jenë në përputhje me një projekt bazë, për të cilin është lidhur kontrata fillestare, në bazë të një procedure prokurimi. Sapo projekti i parë është gati për tender, përdorimi i kësaj procedure bëhet i ditur në njoftimin e kontratës për kontratën fillestare dhe vlera e përgjithshme e përlogaritur e shpenzimeve të punimeve merret parasysht nga autoriteti kontraktor. Procedura e parashikuar në këtë shkronjë mund të përdoret vetëm gjatë 3 viteve që pasojnë përfundimin e kontratës origjinale. Në asnjë rast, kontrata shtesë nuk duhet të kalojë 20 për qind të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare.

Neni 58/9

Thirrja për konkurrim

Autoriteti kontraktor është i detyruar të njoftojë për qëllimin e tij për prokurimin e një kontrate sektoriale, nëpërmjet një njoftimi për konkurrim, e cila mund të ketë formën:

a) e një njoftimi kontrate, siç parashikohet në nenin 38 të ligjit;

b) e një njoftimi për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, siç parashikohet në nenin 58/10 të këtij ligji.

Neni 58/10

Sistemet e kualifikimit

1. Autoritetet kontraktore, nëse kanë dëshirë, mund të hartojnë dhe të vënë në

përdorim një sistem kualifikimi për operatorët ekonomikë dhe, në këtë rast, duhet të sigurohen se këta operatorë janë gjatë të gjithë kohës në gjendje për të kërkuar kualifikim.

2. Kur autoritetet kontraktore zgjedhin të krijojnë një sistem kualifikimi, sistemi do të jetë objekt i një njoftimi, që tregon qëllimin e krijimit të tij dhe mënyrat e zbatimit të rregullave për pjesëmarrjen në sistem. Kur kohëzgjatja e funksionimit të sistemit do të jetë më shumë se tre vjet, njoftimi do të botohet çdo vit, ndërsa kur kohëzgjatja e funksionimit do të jetë më e shkurtër, mjafton një njoftim fillestar.

3. Sistemet e kualifikimit mund të përfshijnë shkallë të ndryshme. Kriteret dhe rregullat e kualifikimit duhet të vendosen nga autoriteti kontraktor, në bazë të kriterëve

objektive dhe, kur kërkohet, kriteret dhe rregullat mund të ndyshojnë. Kriteret dhe rregullat për kualifikim duhet të jenë të disponueshme për operatorët ekonomikë, sipas kërkesës. Ndryshimet e këtyre kriterëve dhe të rregullave duhet t'u komunikohen të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar.

4. Kriteret dhe rregullat për kualifikim, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, mund të përfshijnë kriteret e përjashtimit, të renditura në nenet 45 e 46 të ligjit, për termat dhe kushtet e përcaktuara në të. Kur autoriteti kontraktor është i tillë, sipas kuptimit të pikës 14 të nenit 3 të ligjit, këto kriteret dhe rregulla do të përfshijnë kriteret

e përjashtimit, të renditura në pikën 1 të nenit 45.

5. Kur kriteret dhe rregullat për kualifikim, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, përfshijnë kërkesa, që kanë lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorit ekonomik, ky i fundit mundet, nëse është e nevojshme, të mbështetet në kapacitetin e operatorëve të tjerë, cilado qoftë natyra ligjore e lidhjes së tij me to. Në këtë rast, operatori ekonomik duhet t'i provojë autoritetit kontraktor se këto burime do t'i vihen atij në dispozicion përgjatë të gjithë kohës së vlefshmërisë së sistemit të kualifikimit, për shembull, duke dhënë një deklaratë se do t'i marrë nga një tjetër operator ekonomik për këtë qëllim.

Në të njëjtat kushte, një grup operatorësh ekonomikë, siç parashikohet në pikën 2 të nenit 44, mund të mbështetet në kapacitetin e pjesëmarrësve në grup ose të enteve të tjera.

6. Aty ku kriteret dhe rregullat për kualifikim, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, përfshijnë kërkesa, që kanë lidhje me kapacitetin teknik dhe/ose profesional të operatorit ekonomik, ky i fundit mundet, aty ku është e nevojshme, të mbështetet te kapaciteti i enteve të tjera, cilado qoftë natyra ligjore e lidhjes ndërmjet tij dhe enteve të tjera. Në këtë rast, operatori ekonomik duhet t'i provojë autoritetit kontraktor se këto burime do të jenë të disponueshme gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së sistemit të kualifikimit, për shembull, duke hartuar një deklaratë

sipërmarrjeje nga këto ente, të cilat ia bëjnë të disponueshme këto burime operatorit ekonomik. Në të njëjtat kushte, një grup operatorësh ekonomikë, siç parashikohet në pikën 2 të nenit 44, mund të mbështeten në aftësitë e pjesëmarrësve në grup apo të enteve të tjera.

7. Një dokument i shkruar i operatorëve ekonomikë duhet të ruhet dhe mund të ndahet në kategori, në varësi të llojit të kontratës, për të cilën kualifikimi është i vlefshëm.

8. Kur një ftesë për konkurrim bëhet nëpërmjet një njoftimi, për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, ofertuesit, në një procedurë të kufizuar ose pjesëmarrësit në një procedurë me negociim, zgjidhen nga kandidatët e kualifikuar, në përputhje me këtë sistem.

9. Autoritetet kontraktore, të cilat krijojnë dhe vënë në zbatim një sistem kualifikimi, informojnë kandidatët për vendimin e tyre për kualifikimin, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh. Nëse marrja e vendimit zgjat më tepër se katër muaj nga dorëzimi i një aplikimi, autoriteti kontraktor informon kandidatin brenda dy muajve nga aplikimi, për arsyet që justifikojnë periudhën më të gjatë dhe për datën, kur aplikimi i tij do të pranohet ose refuzohet.

10. Kandidatët, të cilët nuk do të kualifikohen, njoftohen për këtë vendim dhe për arsyet e refuzimit, sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe, në asnjë rrethanë, më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së vendimit. Arsyet bazohen në kriteret e

kualifikimit, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

11. Autoritetet kontraktore, të cilat krijojnë dhe vënë në funksionim një sistem kualifikimi, mund ta refuzojnë kualifikimin e një operatori ekonomik vetëm për arsye të bazuara mbi kriteret e kualifikimit, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni. Çdo njoftim për ta refuzuar kualifikimin i njoftohet me shkrim operatorit ekonomik, të paktën 15 ditë përpara datës së parashikuar të përfundimit të kualifikimit, së bashku me arsyen që justifikon veprimin e propozuar.

KREU VI ZBATIMI I KONTRATËS

Neni 59

Kushtet për zbatimin e kontratës

1. Autoriteti kontraktor mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

2. Kushtet, që rregullojnë zbatimin e kontratës, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës.

Neni 60

Rregullat që zbatohen për kontratën

1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkuara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese.

2. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, duhet të përmbushen në mirëbesim nga palët.

3. Pa cenuar dispozitat e këtij ligji dhe ndonjë dispozitë tjetër të zbatueshme nga autoriteti kontraktor, kontratat e prokurimit rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil.

Neni 61

Nënkontraktimi

1. Autoriteti kontraktor, në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit, u kërkon ofertuesve të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e kontratës, që ata mendojnë të nënkontraktajnë te palët e treta, si dhe nënkontraktorin e propozuar.

2. Kjo përqindje e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e kontratës dhe nuk duhet të tejkalojë 40 për qind të vlerës së përgjithshme të kontratës.

3. Autoriteti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

4. Dispozitat e këtij neni nuk prekin përgjegjësitë kryesore të operatorit ekonomik ndaj autoritetit kontraktor, për të cilin nënkontraktorët mbeten palë e tretë, kundrejt marrëdhënies kontraktuale ndërmjet operatorit ekonomik dhe nënkontraktorëve të tij/saj dhe duke e lënë

operatorin ekonomik kryesor përgjegjës për zbatimin e të gjithë kontratës, pavarësisht se një pjesë e saj zbatohet nga nënkontraktorët.

Neni 62

Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës

1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t'i kërkohet të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës.

KREU VII
PROCEDURAT E RISHIKIMIT
ADMINISTRATIV

Neni 63

Të drejtat e personit të interesuar

1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të

kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.¹³³

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor¹³⁴ i paraqitet, së pari, me

shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve¹³⁵ nga dita e nesërme e punës¹³⁶ kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6¹³⁷ të këtij neni.

4. Nëse është e nevojshme, autoriteti kontraktor zgjat afatet kohore të procedurës së prokurimit për periudhën e pezullimit, të përmendur në pikën 3 të këtij neni. Në rast se afatet kohore të procedurës së prokurimit, të njoftuara për ofertuesit, ndryshojnë për shkak të shqyrtimit të ankesës, autoriteti kontraktor duhet të njoftojë të gjithë ofertuesit për arsyet e zgjatjes së afatit kohor.

5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda

20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹³⁵ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹³⁶ Fjalët "e nesërme e punës" janë shtuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹³⁷ Zëvendësuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹³³ Shtuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹³⁴ Shtuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë

¹³⁸ ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik¹³⁹ brenda 10 ditëve¹⁴⁰ nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoritetit kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet *detyrimisht*¹⁴¹ edhe autoritetit kontraktor.

7. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik¹⁴² bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza

¹³⁸ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹³⁹ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁴⁰ Zëvendësuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁴¹ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁴² Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, *pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor*"¹⁴³ Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik¹⁴⁴ e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të

ankimit e bën ankesën të pavlefshme.

8. Me marrjen e ankesës së ankimesit për në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor mban të pezulluar procedurën e prokurimit, me përjashtim të rasteve kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos ndryshe, në përputhje me pikën 2, të nenit 64, të

këtij ligji. Autoriteti kontraktor ia dërgon të gjithë informacionin që disponon për procedurën e prokurimit të ankimeve menjëherë, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 ditë, Komisionit të Prokurimit Publik.¹⁴⁵

¹⁴³ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁴⁴ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁴⁵ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

9. Me marrjen e ankesës me shkrim të ankimesit, Komisioni i Prokurimit Publik¹⁴⁶ përgjigjet me shkrim brenda 7¹⁴⁷ ditëve. Kur për shqyrtimin e ankesës kërkohet informacion nga autoriteti kontraktor, Komisioni¹⁴⁸ përgjigjet me shkrim sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Ministrave¹⁴⁹, por jo më vonë se 10¹⁵⁰ ditë pas marrjes së informacionit¹⁵¹.

10. Çdo ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet kundrejt pagesës. Rregullat

¹⁴⁶ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁴⁷ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁴⁸ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁴⁹ Zëvendësuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁵⁰ Numri "20" është zëvendësuar me numrin "10", me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹⁵¹ Fjalët "pas marrjes së informacionit" janë shtuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

dhe tarifat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave¹⁵²

11. Për procedurat e prokurimit, për të cilat nuk bëhet njoftim publik, sipas nenit 38 të këtij ligji, nuk zbatohen dispozitat lidhur me procedurat e ankimit¹⁵³ administrativ¹⁵⁴.

Neni 64

Të drejtat e Komisionit të Prokurimit Publik¹⁵⁵

1. Me marrjen e ankesës me shkrim, Komisioni i Prokurimit Publik¹⁵⁶ duhet të sigurohet që autoriteti kontraktor e ka pezulluar procedurën e prokurimit. Pas një shqyrtimi paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik¹⁵⁷ vendos nëse do të

¹⁵² Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁵³ Fjala "rishikimit" është zëvendësuar me fjalën "ankimit", me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹⁵⁴ Shtuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁵⁵ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

¹⁵⁶ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

¹⁵⁷ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në

lëshojë ose jo një urdhër të ndërmjetëm, në përputhje me pikën 2 të këtij neni dhe vë në dijeni për këtë autoritetin kontraktor.

2. *Komisioni i Prokurimit Publik*¹⁵⁸, në çdo kohë, pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës kur nuk vendos pezullimin,¹⁵⁹ mund ta lejojë autoritetin kontraktor, me anë të

një urdhri të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit, nëse:

- a) ka të dhëna se ankimuesi nuk do të ketë sukses me ankesën;
- b) pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin kontraktor ose ofertuesit.

3. Përpara lidhjes së kontratës, *Komisioni i Prokurimit Publik*¹⁶⁰, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;
- b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit

kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;

c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;

ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.

4. Pas lidhjes së kontratës, kur *Komisioni i Prokurimit Publik*¹⁶¹ gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- a) të nxjerrë një interpretim në lidhje me rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;
- b) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së këtij ligji;
- c)¹⁶²

5. Kur *Komisioni i Prokurimit Publik*¹⁶³ gjykon se një punonjës i autoritetit

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

¹⁵⁸ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

¹⁵⁹ Shtuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 "Për Prokurimin Publik"

¹⁶⁰ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁶¹ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

¹⁶² Shfuqizuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

¹⁶³ Zëvendësuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

kontraktor ka kryer një shkelje të qëllimshme që prek parimet dhe qëllimin e këtij ligji, përveç masave korrigjuese të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, mund të bëjë kallëzim penal në organet përkatëse.

“Neni 64/1”¹⁶⁴

Procedura e rishikimit administrativ

1. Komisioni i Prokurimit Publik mund të fillojë një procedurë rishikimi administrativ, kur i paraqitet ankesë nga persona të interesuar në procedura prokurimi.
2. Gjatë rishikimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:
 - a) t’u kërkojë palëve dokumentacion ose të dhëna, për të mbështetur pretendimet e tyre;
 - b) të kërkojë të dhëna e shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material, që ka lidhje me hetimin administrativ;
 - c) të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me procedurën e rishikimit;
 - ç) të kërkojë ekspertizat përkatëse nga ekspertë të palëve të treta.
3. Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të caktojë një afat për përgjigjen ndaj kërkesave të tij për të dhënat dhe për dorëzimin e dokumenteve përkatëse, sipas

legjislationit që rregullon procedurat administrative.

Neni 64/2¹⁶⁵

Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik

1. Pas përfundimit të shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik mund të marrë këto vendime:
 - a) të pushojë gjykimin, duke qenë se veprimet ose mosveprimet e autoritetit kontraktor, që ka realizuar procedurën e prokurimit, nuk përbëjnë shkelje të këtij ligji ose të dispozitave administrative apo penale. Në këtë rast, Komisioni i Prokurimit Publik i sqaron, me shkrim, ankimuesit arsyet për pushimin e gjyimit;
 - b) t’i japë autoritetit kontraktor, të përfshirë, një vendim me shkrim, për të ndalur sjelljen e jashtëligjshme, brenda një afati të caktuar kohor.
2. Autoritetet kontraktore duhet të zbatojnë vendimin e dhënë ose të kërkojnë rishikimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga marrja dajeni për vendimin. Nëse këto veprime i kanë sjellë efektet e tyre, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik u këshillon personave të dëmtuar të ngrënë padi në gjykatë ose të bëjnë kallëzim penal.
3. Nëse Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një zyrtar i autoritetit kontraktor ka kryer

¹⁶⁴ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar

¹⁶⁵ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar

një shkelle të qëllimshme të këtij ligji, atëherë i raporton shkellen autoritetit përkatës.

Neni 64/3¹⁶⁶

Ankimi në gjykatë

1. *Palët kanë të drejtë që, kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë*^{167 168}.

2. Shqyrtimi i këtij ankimi në gjykatë nuk përzullon procedurat e prokurimit, të lidhjes së kontratës publike të prokurimit të mallrave, shërbimeve apo punëve nga autoriteti kontraktor ose ekzekutimin e detyrimeve, sipas kontratës së prokurimit nga palët respektive.”

¹⁶⁶ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

¹⁶⁷ Fjalët “gjykatën përkatëse” janë zëvendësuar me fjalët “Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë”, me ligjin nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

¹⁶⁸ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar

KREU VIII

HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 65¹⁶⁹

Procedura e hetimit administrativ

166

1. Agjencia e Prokurimit Publik verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, por, në çdo rast, jo më vonë se 2 vjet nga nënshkrimi i saj.¹⁷⁰

2. *Gjatë hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë:*

a) *të kryejë hetime administrative në vend, duke përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve ose dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton;*

b) *të kërkojë informacione e shpjegime nga çdo organ i administratës, qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin administrativ;*

c) *të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me çështjen nën hetim dhe të thërrasë të gjithë personat pa imunitet;*

ç) *të kërkojë ekspertizat përkatëse nga ekspertë të palëve të treta.*

3. *Për të realizuar funksionet, Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë të ketë akses në të gjitha zyrat e institucioneve të*

¹⁶⁹ Shtuar me ligjin nr. 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

¹⁷⁰ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

administratës publike, të cilat njihen si autoritete kontraktore, sipas këtij ligji.

4. Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë të caktojë një afat për përgjigjen ndaj kërkesave të saj për informacion dhe për dorëzimin e dokumenteve përkatëse, sipas legjislacionit që rregullon procedurat administrative.

5.¹⁷¹ Autoriteti kontraktor ka detyrimin të njoftojë personat përgjegjës të përfshirë në hetimin administrativ të nisur nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe të dokumentojë njoftimin.

Neni 66¹⁷²

Veprimet pas përfundimit të hetimit administrativ

1. Pas përfundimit të hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik mund të marrë këto vendime:

- a) të mbyllë hetimin, në qoftë se veprimet ose mosveprimet e autoritetit kontraktor nën hetim nuk përbëjnë shkelje të këtij ligji;
- b) të propozojë masë disiplinore ose të vendosë gjobë, në përputhje me nenin 72 të këtij ligji, për shkeljet e gjetura.

2. Në çdo rast, palët do të njoftohen me shkrim për vendimin e marrë. Autoriteti kontraktor ka detyrimin t'u njoftojë vendimin e dhënë nga Agjencia e

¹⁷¹ Shtuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹⁷² Shtuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

Prokurimit Publik personave përgjegjës, të përfshirë në hetimin administrativ dhe të dokumentojë njoftimin.¹⁷³

Neni 67¹⁷⁴

Neni 68¹⁷⁵

KREU IX

VEPRIMTARIA E AVOKATIT TË

PROKURIMEVE

Neni 69¹⁷⁶

Neni 70¹⁷⁷

Neni 71¹⁷⁸

Neni 71¹⁷⁹

¹⁷³ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹⁷⁴ Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁷⁵ Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁷⁶ Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁷⁷ Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁷⁸ Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

Neni 72¹⁸⁰**Kundërvajtjet administrative**

1. ¹⁸¹Mosrespektimi i rregullave të prokurimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, kur përbën kundërvajtje administrative dënohet me gjobë si më poshtë:

- a) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 4, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 20 000 deri 1 000 000 lekë;
- b) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 15 000 deri në 30 000 lekë;
- c) mospërbushja e detyrimit për formën e komunikimit, për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit, të përcaktuar në nenin 21, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 100 000 lekë;
- ç) mospërbushja e detyrimit të parashikuar në nenin 23, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë;
- d) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 25, të këtij ligji,

dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

dh) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 28, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 20 000 deri në 1 000 000 lekë;

e) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 33, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 1 000 000 lekë;

ë) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 38, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë;

f) mospërbushja e njërit prej detyrimeve të përcaktuara në nenet 39, 40, 41 e 42, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 300 000 lekë;

g) mospërbushja e detyrimeve të përcaktuara në nenin 43, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 500 000 lekë;

gj) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 45, të këtij ligji, me përjashtim të shkronjës “ë”, të pikës 2, të këtij neni, dhe në nenin 46, të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 30 000 deri në 500 000 lekë;

h) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në shkronjën “ë”, të pikës 2, të nenit 45, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 1 000 000 lekë;

i) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 53, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë;

¹⁷⁹ Ky nen është shfuqizuar me ligjin nr. 131/2012“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

¹⁸⁰ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

¹⁸¹ Ndryshuar me ligjin nr. 131/2012“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

j) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 56, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

k) mospërbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 63, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë;

l) personat, që përipiqen të ndikojnë në vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me nenin 19/7, të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

1/1.¹⁸² Masa e gjobës vendoset në raport me vlerën e përlogaritur të kontratës dhe sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

2. *Në të gjitha rastet e mësipërme, kur personat përgjegjës nuk dënohen me gjobë, dhe në çdo rast tjetër të shkëljes së dispozitave të këtij ligji, kërkohet dhënia e masave disiplinore ndaj tyre.*

3. Kundër vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, personat e interesuar mund të bëjnë ankim në gjykatën kompetente.¹⁸³

4.¹⁸⁴ Përgjegjësia për vjeljen e gjobave, të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, është e autoritetit kontraktor.

Neni 73¹⁸⁵

Sanksionet për mosbashkëpunim

1. Refuzimi i autoritetit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Agjencinë e Prokurimit Publik ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë.

2. Masa e gjobës vendoset në raport me vlerën e përlogaritur të kontratës dhe sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

3. Kundër vendimit të dënimit me gjobë, sipas pikës 1, të këtij neni, personat e interesuar mund të bëjnë ankim në gjykatën kompetente.

¹⁸² Shtuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹⁸³ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹⁸⁴ Shtuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

¹⁸⁵ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Neni 74¹⁸⁶**KREU X****DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT****Neni 75****Rregullat e prokurimit**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë rregullat e prokurimit për zbatimin e tij.

Neni 75/1**Dispozitë e vecantë**

1. *Procedurat e nisura në përputhje me ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, përfshirë dhe ankimin, trajtohen sipas ligjit nr.7571.*
2. *Shkronja ç e pikës 3 të nenit 13, zbatohet edhe në rastin e kontratave të nënshkuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.*
3. *Pikat 2 shkronja "a" dhe 5 të nenit 33 zbatohen edhe për kontratat e lidhura pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në bazë të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, edhe kur kjo nuk është parashikuar në kontratën fillestare.¹⁸⁷*

¹⁸⁶ Shfuqizuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

¹⁸⁷ Shtuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.1996 "Për Prokurimin Publik"

Neni 75/2¹⁸⁸

Procedurat për kontratat sektoriale, të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të realizohen sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Neni 76**Emërimi i Avokatit të Prokurimeve**

Ngarkohet Kuvendi që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të emërojë Avokatin e Prokurimeve dhe të miratojë strukturën dhe organikën e Zyrës së tij.

Neni 76/1¹⁸⁹**Emërimi i anëtarëve të Komisionit të****Prokurimit Publik**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të emërojë kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik, në zbatim të pikës 2 të nenit 19/2 të këtij ligji.

Neni 76/2¹⁹⁰

Shqyrtimi i ankesave nga komisioni do të fillojë 4 muaj pas krijimit të tij. Deri atëherë

¹⁸⁸ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

¹⁸⁹ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar

¹⁹⁰ Shtuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

shqyrtimi i ankesave do të bëhet nga Agjencia e Prokurimit Publik, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 77**Shfuqizime**

Ligji nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, me të gjitha ndryshimet e tij, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 78

Hyrja në fuqi. Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2007.

Shpallur me dekretin nr.5157, datë 15.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

**VI. Auditimet e KLSH-së lidhur me
prokurimet publike për periudhën
2012-2015**

VI. 1 Auditimet e KLSH-së lidhur me prokurimet publike për periudhën 2012-2015

Veprimtaria audituese është vlerësuar, matur, skanuar dhe analizuar përmes treguesve të performancës, sipas praktikave më të mira të përcaktuara nga INTOSAI, gjë që siguron një pamje të plotë të aktivitetit auditues dhe rezultateve të një SAI. Matja e performancës në formën e treguesve, i bën rezultatet të përshtatshme dhe të krahasueshme me performancën e aktivitetit të SAI-t, në mënyrë dinamike si dhe me SAI-t simotra, duke krijuar kështu një sistem të unifikuar vlerash e standardesh, sikurse e shpreh edhe motoja e INTOSAIT: *“Nga eksperiencia e përbashkët, përfitojnë të gjithë”*.

Ky dimension vlerësimi lidhet ngushtë me raportimin e auditimeve sipas llojit të tyre. Përgjithësisht treguesit e këtij dimension kryesisht lidhen me numrin dhe impaktin e auditimeve, pra veprimtarinë audituese, si dhe me reflektimin dhe reagimin e subjekteve ndaj rekomandimeve të KLSH, duke sjellë një qasje tjetër të perceptimit të punës audituese si vlerë e shtuar për subjektet e audituara.

Një vëmendje e veçantë nga KLSH i është kushtuar auditimit të prokurimeve publike, pasi ky është një proces që kërkon vëmendje nga autoritetet kontraktore, sepse çdo qeveri është blerëse e mallrave, shërbimeve dhe kryerjes së punëve.

Nëpërmjet prokurimeve publike kanalizohet zbatimi i politikave qeverisëse dhe pjesa më e madhe e fondeve të Buxhetit të Shtetit, e llogaritur kjo në qindra milionë euro në vit. Është në interes të qytetarëve dhe taksapaguesve shqiptar, por edhe të KLSH, që ky përdorim fondesh të bëhet sipas rregullave të përditësuara me Direktivat e Bashkimit Evropian për prokurimet, në mënyrë që të zvogëlohet në minimum mundësia e keqpërdorimit apo abuzimit me këto fonde, nëpërmjet shkeljeve dhe keqinterpretimit të rregullave të prokurimit.

Prokurimi publik është procesi i përzgjedhjes nga Autoritetet Kontraktore, përmes konkurrimit publik, të operatorëve ekonomikë. Meqenëse procesi është i lidhur drejtpërsëdrejti me fonde publike, ai zhvillohet sipas disa rregullave të sanksionuara në legjislacionin e prokurimit publik, i cili ka si qëllim efektivitetin e kostos dhe vlerës për lekë.

Prokurimi Publik synon të përdorë/shpenzojë paratë e taksapaguesve në mënyrën më efektive të mundshme, kurse vlera për lekë në kontekstin e prokurimit publik është cilësia më e mirë për çmim të arsyeshëm në kohën e duhur.

Fusha e prokurimit publik është një fushë shumë e rëndësishme në menaxhimin dhe shpenzimin e parasë publike, sepse prokurimi publik është mjedisi ku bëhet filtrimi i parasë publike për të pasur sa më pak keqpërdorime, stabilitet financiar të institucioneve të shtetit në mënyrë që ato të jenë më të qëndrueshme në funksionimin dhe zhvillimin e aktiviteteve profesionale.

Legjislacioni për prokurimin publik, i cili ka parimet e veta i garanton çdo autoriteti kontraktues se për të zhvilluar një aktivitet të prokurimit publik duhet të respektohen këto parime: *transparenca, konkurrenca, mosdiskriminimi dhe profesionalizmi*.

Auditimi i prokurimeve publike për zbatimin e këtyre parimeve, ka nxjerrë në pah se sa transparentë janë subjektet e audituara nga KLSH në procedurat e prokurimit publik, duke evidentuar njëkohësisht dhe shkeljet nga nëpunësit me funksione publike në këtë fushë. Ndër vite kjo paraqitet si më poshtë:

Viti	Dëmi ekonomik në total (000/lekë)	Dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve (000/lekë)	%	Nr i auditimeve të kryera	Nr i subjekteve të audituara
2012	13,522,392	444,573	3.2	153	157
2013	15,089,825	354,099	2.3	147	152
2014	11,198,404	678,118	6.1	159	160
2015	125,763,051	2,621,594	2.1	158	220 (Bashkë me subjektet e audituara nga dep.performancë)

Burimi KLSH

Sipas statistikave të viteve 2012-2015, në auditimet e kryera nga KLSH, rezultojnë se:


- Për vitin 2012, dëmi ekonomik në total shkaktuar buxhetit të shtetit është në vlerën 13,522,392 mijë lekë, ku vlera prej 444,573 mijë lekë ose 3.2% përfaqëson dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit në fushën e

prokurimeve publike. Ky fakt është rrjedhojë e 153 auditimeve të kryera nga KLSH në 157 subjekte.

- Për vitin 2013, dëmi ekonomik në total shkaktuar buxhetit të shtetit është në vlerën 15,089,825 mijë lekë, ku vlera prej 354,099 mijë lekë ose 2.3% përfaqëson dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit në fushën e prokurimeve publike. Gjatë 2013, KLSH ka audituar 152 subjekte.
- Për vitin 2014, dëmi ekonomik në total shkaktuar buxhetit të shtetit është në vlerën 11,198,404 mijë lekë, ku vlera prej 678,118 mijë lekë ose 6.1% përfaqëson dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit në fushën e prokurimeve publike. Ky fakt ka ardhur si rezultat i 159 auditimeve të kryera në 160 subjekte.
- Për vitin 2015, dëmi ekonomik në total shkaktuar buxhetit të shtetit është në vlerën 125,763,051 mijë lekë, ku vlera prej 2,621,594 mijë lekë ose 2.1% përfaqëson dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit në fushën e prokurimeve publike. KLSH ka kryer gjatë vitit 2015, 158 auditime në 220 subjekte.


Në grafikun më poshtë, ilustron dëmi ekonomik në vite dhe dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve.

Grafik 1



Burimi KLSH


Grafik 2



Burimi KLSH

Siç duket nga paraqitja grafike dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve për vitin 2015 është dy herë më i madh krahasuar me vitin 2014.

Grafik 3



Burimi KLSH

VI. 2 Në fushën e prokurimeve, abuzimet më tipike janë konstatuar në subjektet:

❖ Ministria e Punëve të Brendshme

Në procedurat e prokurimit publik për vitin 2013-2014 audituar nga KLSH në vitin 2015 janë evidentuar një sërë parregullsish dhe shkeljesh, të cilat kanë sjellë një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 85,038 mijë lekë.

Për abuzimet me tenderat të konstatuara në këtë subjekt është bërë kallzim penal për 11 nëpunës.

❖ Ministria e Arsimit dhe Sportit

Vlera e dëmit ekonomik konstatuar në procedurat e prokurimit publik për vitin 2013-2014 të audituar nga KLSH në vitin 2015 është 108,803 mijë lekë. Për abuzimet me tenderat të konstatuara në këtë subjekt është bërë kallzim penal për 3 nëpunës.

❖ Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë

Vlera e dëmit ekonomik konstatuar në procedurat e prokurimit publik për vitin 2014-2015 të audituar nga KLSH në vitin 2015 është 55,826 mijë lekë. Për abuzimet me tenderat të konstatuara në këtë subjekt është bërë indicia për kallzim penal.

VI. 3 Rekomandime të adresuara në fushën e prokurimeve

Nga të dhënat statistikore në vite, si pasojë e shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në raport me pasojën e shkaktuar, KLSH për përmirësimin e gjendjes ka rekomanduar masa disiplinore dhe administrative adresuar Agjencisë së Prokurimit Publik, si organ kompetent për dhënien e masave si dhe subjekteve të tjerë të njohur me ligj.

Masat e rekomanduara ndër vite janë si në vijim:

Masat e dhëna në fushën e prokurimeve			
Viti	Masa Disiplinore		Masa Administrative
	Rekomanduar	Masat e dhëna në fushën e prokurimeve	Masat e dhëna në fushën e prokurimeve
2012	501	163	338
2013	436	200	236
2014	519	219	300
2015	558	282	276

Burim KLSH


Për vitin **2012**, janë rekomanduar 501 masa disiplinore dhe administrative në fushën e prokurimeve, nga të cilat 163 masa disiplinore dhe 338 masa administrative.

Për vitin **2013**, janë rekomanduar gjithsej 436 masa disiplinore dhe administrative në fushën e prokurimeve, nga të cilat 200 masa disiplinore dhe 236 masa administrative.

Për vitin **2014**, janë rekomanduar 519 masa disiplinore dhe administrative në fushën e prokurimeve, nga të cilat 219 masa disiplinore dhe 300 masa administrative.

Për vitin **2015**, janë rekomanduar 558 masa disiplinore dhe administrative në fushën e prokurimeve, nga të cilat 282 masa disiplinore dhe 276 masa administrative. Paraqitur grafikisht si më poshtë:

Grafik 4



Burimi KLSH

VI. 4 Kallëzimet për ndjekje penale

Në auditimet e realizuara përgjatë viteve 2012 - 2015, janë konstatuar një sërë shkeljesh të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi nga ana e një numri të konsiderueshëm nëpunësish dhe ish-nëpunësish të administratës shtetërore të të gjitha niveleve me pasojë jo vetëm shkaktimin e dëmeve ekonomiko-financiare ndaj buxhetit të shtetit por edhe dëmtimin e interesave të tjera ligjshme të shtetit Shqiptar, për të cilat KLSH ka depozituar pranë organit të Prokurorisë kallëzimet përkatëse penale, e cila ndër vite paraqitet si më poshtë:


Viti	Nr. Kallëzimeve	Nr. i Personave	Nr. i personave të kallëzuar në fushën e prokurimeve
2012	40	125	34
2013	38	94	30
2014	41	149	40
2015	51	159	48

Burim KLSH

Për vitet 2014-2015 konstatohet një rritje e numrit të nëpunësve me funksione vendimmarrëse në fushën e prokurimeve publike në krahasim me vitet 2012-2013.


Paraqitur grafikisht si më poshtë:

Grafik 5



Burimi KLSH

Grafik 6



Burimi KLSH

VI. 5 VIZUALIZIMI I INFORMACIONIT DHE PËRDORIMI NË AUDITIM

Vizualizimi i informacionit është paraqitja interaktive e të dhënave nëpërmjet kombinimit të artit, shkencës me statistikën për të përforcuar njohjen njerëzore. Ai është një term i përgjithshëm që përshkruan çdo përpjekje për të ndihmuar njerëzit të kuptojnë rëndësinë e të dhënave duke e vendosur atë në një kontekst vizual. Të dhënat përfshijnë informacione numerike dhe jo numerike si dhe çdo informacion tjetër. Kjo teknikë lejon përdoruesit nëpërmjet qasjeve intuitive të zbulojnë dukuri mes informacioneve të mëdha, të pa strukturuara dhe shpesh abstrakte.

Analiza e të dhënave është një pjesë e domosdoshme e të gjitha hulumtimit në vizualizimin e informacionit.

Për marrjen e rezultateve kombinohen **Mjete analizuese + Mjete Vizualizuese** (*Analysis Tools + Visualization Tools*) duke arritur në **Analizë Interaktive të të dhënave**.

Kjo fushë relativisht e re i ka rrënjët në një traditë të lashtë historike ku po veçojmë atë të vitit 1854 ku Londra u përfshi nga kolera. Besohej se sëmundja shkaktonte nga era e keqe e mjegullës “miasmas”. Dr. John Snoë dyshoi se uji i pijshëm i ndotur ishte shkaku.

Për të vërtetuar teorinë e tij ai shënoj çdo rast të kolerës me një pikë të zezë në hartë dhe çdo pompë uji publik me një “X”.

Duke analizuar shpërndarjen e pikave të zeza në lidhje me pompat e ujit, Dr. John Snoë gjeti origjinën e shpërthimit të kolerës. Harta e tij nuk është vetëm një moment i rëndësishëm historik në shëndetin publik, por edhe një zbulim i madh në shfaqjen vizuale të informacionit ku statistika abstrakte mjekësore u koordinua me një imazh gjeografik.

Kongresit të IX të EUROSAT i mbajtur në Qershor 2014, në Hagë dhe Mars 2014 dhe Simpoziumi Jubilar për Teknologjinë e Informacionit mbajtur me rastin e 300 vjetorit të themelimit të Gjykatës së Auditimit të Gjermanisë theksuan rëndësinë e teknikave inovative të analizimit dhe vizualizimit të të dhënave në epokën e BIG DATA (të dhënave të mëdha).

Vlerësojmë zonat e Operatorëve Ekonomike nga:

- 0-5% mbart riskun e marrëveshjeve dhe mungesën e transparencës në procedurat e prokurimit.
- 5-20% me nivel të ulët risku.
- 20-46% me nivel të lartë risku mosplanifikim të saktë me pasojë përdorimin e fondeve pa efektivitet.


Efektiviteti i prokurimeve në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik

Ky bashkim përcaktohet nga kushtet që vendosin operatorët ekonomik për realizimin e prokurimit

dhe mbart riskun e mungesës së transparencës uljen e konkurrencës.


Nga vizualizimi vërehet se të dy zonat e riskut (me efektivitet të ulët dhe ajo me efektivitet të lartë) janë zgjeruar me rezultat të përgjithshëm të zonave me risk 71 % apo 84 raste .

Efektiviteti i prokurimeve me bashkim operatorësh ekonomik



Për ta konkretizuar fenomenin e ilustruar me një shembull nga auditimi në Ministrinë e Shëndetësisë në rolin e Autoritetit Kontraktor. Nga ky Autoritet Kontraktor janë zhvilluar 309 procedura prokurimi me fond limit 3,550 milionë lekë. Nga vizualizimi vërehet se vetëm katër operatorë ekonomikë kanë fituar 136 KLSH 2016


procedura (44%) apo 22% të fondit të shpenzuar duke vepruar me njeri-tjetrin sipas një marrëveshje të ndaluar.




Rast tjetër është Ministria e Brendshme në rolin e Autoritetit Kontraktor. Për vitin 2014 janë zhvilluar 92 procedura prokurimi të mëdha me fond limit 4,325 milionë lekë dhe fond të ofertuar prej 4,144 milionë lekë.

Nga analiza veçojmë:

- 35% e prokurimeve me efektivitet nga 0 deri në 5 % zonë e cila mbart riskun e marrëveshjeve dhe mungesën e transparencës në procedurat e prokurimit.
- 27% e prokurimeve me efektivitet nga 5 deri në 20 % zonë të cilën e vlerësojmë me nivel të ulët risku.
- 38% e prokurimeve me efektivitet nga 20 deri në 58 %, të cilën e vlerësojmë zonë me risk të lartë në mosplanifikim të saktë me pasojë përdorimin e fondeve pa efektivitet, e cila paraqitet grafikisht si më poshtë:



Rast tjetër është Ministria e Mbrojtjes në rolin e Autoritetit Kontraktor ku konstatohet se 3 operatorë ekonomikë kanë fituar 28.5% të fondit total të prokuruar paraqitur grafikiisht më poshtë.



Prokurimi publik si një proces me risk të lartë i përball audituesit me sfida të njëpasnjëshme, ndaj në praktikat e administrimit publik ai konsiderohet të jetë një KLSH 2016

nga fushat më komplekse të auditimit. Si keqpërdorimi i fondeve publike ashtu dhe ofrimi i shërbimeve publike me cilësi të ulët kontribuojnë negativisht në objektivat, misionin dhe integritetin e subjekteve publike. Ndaj auditimet rigorozë të prokurimeve dhe kontratave pas realizimit të tenderave luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e efijencës së administrimit të fondeve publike. Audituesit duhet të jenë të mirëpërgatitur dhe të pajisur me njohuritë e nevojshme për të identifikuar dobësitë, për të vlerësuar risqet në prokurime, me qëllim që të japin siguri se paratë e taksapaguesve në qeverisje janë përdorur me ekonomicitet, efektivitet dhe efijencë, si dhe për qëllimin për të cilin ato janë dhënë. Shembujt e mësipërm janë sinjalet e alarmit që po i ndihmojnë audituesit e KLSH-së për të thelluar punën dhe gjetjet e tyre pikërisht në prokurimet dhe tenderat që kanë një përqëndrim të panatyrshëm të vetëm disa operatorëve ekonomikë fitues. Prej këtij, hapi për identifikimin e parregullsive, si dhe i nëpunësve publikë që qëndrojnë pas tyre, duke çuar në denatyrimin e tenderave të kryer, është i vështirë, por i domosdoshëm.

Kjo analizë zhvilluar për identifikimin e zonave me risk të lartë, tregon se procedurat e prokurimit publik dhe sistemi i prokurimit elektronik, si mjet për realizimin e tij shprehin dobësi, dhe zhvillohet nën presionin e interesave për përfitime.

